Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT**
**Komiteti për Politikë dhe Financa**
**Nr. 001/060 – 21804**
**Më: 14 shkurt 2025**

Në bazë të nenit 52 paragrafit 1, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dhe nenit 59 paragrafit 1 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Nr. 01/011-5643, dt. 15 tetor 2008, thërras Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet me **25 shkurt 2025 (e martë)** në sallën për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së, në "Shtëpinë e Bardhë", me fillim në **orën 10:00.** Prandaj, ftoheni që në cilësinë e anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa, të merrni pjesë në punën e kësaj mbledhjeje, duke ju përmbajtur orës, datës dhe vendit të caktuar.

Për punën e kësaj mbledhjeje, propozoj këtë

**R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të datës 17 dhjetor 2024;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimin për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm ''Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit'' sipas Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit, sipas kërkesave të MMPHI-së;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Planit për Vlerësimin e rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për Komunën e Prizrenit;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e "Muzeut të Nënës Terezë" në Prizren;
7. Raporti financiar për periudhën tetor-dhjetor 2024;
8. Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024;
9. Raporti vjetor për planin e Integritetit për vitin 2024;
10. Raportet e punës të Komiteteve të themeluara nga Kuvendi i Komunës, për vitin 2024:
    - Komitetit për Politike dhe Financa,
    - Komitetit për Komunitete.

**Kryesuesja e KPF-së**
**Antigona Bytyqi**

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**SKUPŠTINA OPŠTINE PRIZREN**
**Komitet za Politiku i Finansije**
**Br. 001/060 – 21804**
**Dana: 14 februar 2025**

Na osnovu člana 52 stav l, Zakona o Lokalnoj Samoupravi i člana 59 stav l Statuta opštine Prizren, br. 01/011-5643, dt. 15.10.2008, sazivam sastanak Komiteta za Politiku i Finansije koja će se održati **25 februara 2024 (utorak)** u sali za sastanke KPF-a, u „Beloj kući", sa početkom od **10:00 časova**.

Stoga ste pozvani da učestvujete u radu ovog sastanka kao član Komiteta za Politiku i Finansije, pridržavajući se predviđenog vremena, datuma i mjesta.

Za rad ovog sastanka predlažem sljedeći

## D N E V N I R E D

1. Razmatranje i usvajanje zapisnika od dana 17 decembra 2024;
2. Razmatranje i usvajanje Dnevnog Reda;
3. Razmatranje i usvajanje predloga-odluke za usvajanje Regulativnog Detaljnog Plana „Područje Parka lake industrije u Prizrenu – Biznis park" prema Zonskoj karti Opštine Prizren, prema zahtevu MAPP;
4. Razmatranje i usvajanje Nacrta plana rada Skupštine opštine za 2025. godinu;
5. Razmatranje i usvajanje Projektnog plana za procenu rizika od prirodnih katastrofa i drugih nepogoda za opštinu Prizren;
6. Razmatranje i usvajanje predloga-odluke za osnivanje „Muzeja Majke Tereze" u Prizrenu;
7. Finansijski izvještaj za period oktobar-decembar 2024. godine;
8. Izveštaj o radu Skupštine opštine za 2024. godinu;
9. Godišnji izvještaj o Planu integriteta za 2024. godinu;
10. Izveštaji o radu komiteta koje je formirala Skupština opštine za 2024. godinu:
    - Komitet za politiku i finansije,
    - Komitet za zajednice.

**Predsedavajuća KPF-je**
**Antigona Bytyqi**
Bytyqi

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

**PRİZREN BELEDİYE MECLİSİ**
**Siyasi ve Maliye Komitesi**
**No. 001/060 – 21804**
**Tarih: 14 Şubat 2024**
**P r i z r e n**

03/L - 040 sayılı Yerel Öz Yönetim Kanun'un 52. Maddesi ve 15 Ekim 2008 tarihli ve 01/011-5643 sayılı Prizren Belediye Tüzüğün 59. Maddesi, 1. Fıkrası gereğince, **25 Şubat 2025** tarihinde **(Salı günü)** saat **10:00** da "Beyaz Evde" SMK oturum salonunda düzenlenecek olan Siyasi ve Maliye Komitesinin toplantısını çağırıyorum. Bu yüzden, toplantının belirlendiği tarih, saat ve yere bağlı kalarak Siyasi ve Maliye Komitesi üyesi niteliğinde toplantının çalışmalarına katılmak üzere davet ediliyorsunuz.

İşbu toplantı için şu gündem noktaları belirlenmiştir:

**GÜNDEMİ**
öneriyorum

1. 17 Kasım 2024 tarihli tutanakların görüşülmesi ve kabul edilmesi;
2. Gündemin görüşülmesi ve kabul edilmesi;
3. Çevre, Mekan Planlama ve Altyapı Bakanlığının talebi doğrultusunda, Prizren Belediyesi Bölgesel Haritasına göre "Hafif Sanayi Parkı Alanı – İş Parkı" Ayrıntılı Düzenleme Planının onaylanmasına ilişkin karar tasarısının görüşülmesi ve onaylanması.
4. 2025 yılı için Belediye Meclisi Çalışma Taslak Planının görüşülmesi ve onaylanması.
5. Prizren Belediyesi için doğal afetler ve diğer felaketlere yönelik Risk Değerlendirme Planı Taslağının görüşülmesi ve onaylanması.
6. Prizren'de "Rahibe Teresa Müzesi"-nin kurulmasına ilişkin karar tasarısının görüşülmesi ve onaylanması.
7. Ekim-Aralık 2024 dönemi mali raporu.
8. 2024 yılı Belediye Meclisi Çalışma Raporu.
9. 2024 yılı Bütünlük Planı Yıllık Raporu.
10. Belediye Meclisi tarafından kurulan komitelerin 2024 yılı çalışma raporları:
    - Politika ve Finans Komitesi,
    - Topluluklar Komitesi.

**SMK Başkanı**
**Antigona Bytyqi**

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT**
**Komiteti për Politikë dhe Financa**
**Nr. 001/060 – 158403**
**Më: 17 dhjetor 2024**

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 17 dhjetor 2024, në Sallën e mbledhjeve të KPF-së, në "Shtëpinë e Bardhë", me fillim në ora 10:13 minuta.

**Pjesëmarrës nga KPF-ja,** ishin: Antigona Bytyqi, Kryesuese e KPF-së, Karanfil Haxhillari, Dafina Alishani, Adem Shabanaj, Naxhije Memaj Florent Ukaj, Egzona Hoxhaj dhe Bajram Kastrati, të gjithë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

**Mungoi:** Levent Buş.

**Pjesëmarrës tjerë ishin:** Kujtim Gashi, Nënkryetar i Komunës, Ramize Sinanaj Shala nga DES, Shpresa Osmanollaj nga DUPH, Gursel Skenderi nga Sektori i Pronës, Kumrije Bytyqi nga dhe Bashkim Rakaj nga DPMS, përfaqësuesi i OSBE si dhe OJQ-të e Mediat.

**Antigona Bytyqi:** Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, shumë i nderuar nënkryetar, të nderuar zyrtarë, përfaqësues të OSBE-së, media, përshëndetje për të gjithë. Ashtu siç e keni marrë edhe materialin me kohë, për sot kemi thirrë mbledhjen e radhës të Komitetit për Politikë dhe Financa. Prezent jemi tetë anëtarë të këtij komiteti. Atëherë mund të fillojmë me pikat e kësaj mbledhje dhe këtë mbledhje e kemi thirrur me këtë rend dite:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të datës 29 tetor dhe 12 nëntor 2024;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin paraprak të listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të objektit pronë komunale për raste të veçanta;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e grupit punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Prizrenit, për vitin 2025.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e raportit të Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore 2024-2026;
9. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024.

**<u>Pika e parë;</u>**
**Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të datës 29 tetor dhe 12 nëntor 2024;**

**Antigona Bytyqi:** A ka dikush diçka me shtuar rreth procesverbaleve? Në qoftëse jo, po i hedhim në votim. Prezent jemi tetë anëtarë, kush është për që të miratohen prcesverbalet? Unanimisht ju falenderoj të gjithëve. Kalojmë te shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës.

**<u>Pika e dytë;</u>**
**Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës**

**Antigona Bytyqi:** A ka dikush diçka reth rendit të ditës? Po zonja Shpresa urdhëro.

**Shpresa Osmanollaj (DUPH):** Kështu, na e kemi pas vendimin e kaluar për miratimin e zonës industriale parku i biznesit, mirëpo ministria e mjedisit e ka kthyer në rishqyrtim. Ju e kemi pasë kryesuese që është dashur për një afat tre ditor me e përcjellë dokumentacionin, në atë periudhë unë jam kanë pushim mjekësor edhe s'ka mund drejtori me kompletu. Kanë qenë veb faqe, listat e pjesëmarrësve i kam pas unë kërkesat, raportin të gjitha i kam pas unë. Çka kam mundur me i ndihmu i kam ndihmu, po çka jo s'kam mund me e kompletu për me e çu në ministri dhe mbas një jave e kanë kthyer në rishqyrtim vetëm për procedurën e shqyrtimit publik. Unë e kam materialin këtu të kompletuar qysh e kam bërë për me çuar ministri, po veç afati pat kaluar. Kështu që na duhet me e kthyer në asamble për rishqyrtim. Se vendimi i dytë e keni marrë edhe ju Blerim, është dashur me hy në rishqyrtim, apo sipas vendimit, sipas shkresës së ministrisë edhe ato brenda 30 dite shkruajke. Kështu që vetëm për atë procedurë që unë e kam të komplettuar, e kam njekur në bazë të udhëzimit administrativ që kërkojshin ata nenit 12. Por veç për me e kompletuar me e çu në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit.

**Antigona Bytyqi:** Faleminderit. Dikush tjetër? Në qoftëse nuk keni atëherë rreth rendit të ditës, tu bë një propozim i ri, pasi që ju njoftoi zonja Shpresa, duhet për shkak të atij raporti.

**Shpresa Osmanollaj (DUPH):** Po vetëm për shkak të raportit.

**Antigona Bytyqi:** Për shkak të raportit duhet me e kthyer edhe njëherë në rishqyrtim. Po e hedhi në votim propozimin e zonjës Shpresa. Kush është për, që meqë ka afat ligjor 30 ditë? Unanimisht, ju faleminderit shumë. Atëherë po e hedhi rendin e ditës bashkë me propozimin e ri në votim. Prezent jemi tetë anëtar, kush është për që miratohet komplet rendi i ditës? Unanimisht, ju falenderoj përsëri të gjithëve. Kalojmë te pika e tretë.

**<u>Pika e tretë;</u>**
**Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin paraprak të listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të komnëss që planifikohen për dhënien në shfrytëzim gjatë vitit 2025.**

**Antigona Bytyqi:** Zotëri Gursel, fjala për ju.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës):** Faleminderit Kryesuese. Siç e dini është viti i shtatë me radhë, secila komunë e ka obligim ligjor që të votohet lista e përgjithshme dhe e veçantë e komunës. Lista është e njëjtë prej viteve paraprake me disa ndryshime dhe modifikime, domethënë janë shtuar edhe disa prona, kjo për arsye se e dini ju, janë shtuar pronat për shkak se kemi emërtime të ndryshme të pronave edhe ato prona çka i kemi identifikuar, domethënë e kemi rifleskuar listën. Domethënë e njëjtë procedura është që shtatë vite, vetëm duhet të votohet, afati është deri në 31 dhjetor.

**Antigona Bytyqi:** Faleminderit zotëri Gursel. A e dëshironi fjalën dikush? Po urdhëro Karanfil.

**Karanfil Haxhillari:** Kisha pas dëshirë me e ditë cilat janë ato prona apo lokale që i janë shtuar komunës, të cilat kanë qenë më herët në emrat të tjerë një si pyetje e parë? Besoj që keni njohuri. Dhe si pyetje e dytë, këto lokale të cilat prapë do të shpallen, normal është proces ligjor, por a janë këto lokale tashmë në funksion dhe i kanë pronarë të ndryshëm me qira dhe të cilët janë pagues të rregullt të qerasë dhe a do të ketë ndonjë, në qoftë se dikush vjet e ka marrë të njejtin lokal, ka investuar në atë lokal dhe punon në atë lokal. A do të ketë lehtësira në rimarrjen e atij lokali? apo ndryshohet ai vjen tjetër kush? Kjo është me shumë rëndësi, besoj më kuptove.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës):** Po, faleminderit Karanfil. Janë shtuar disa prona, zakonisht janë shtuar pronat të zona ekonomike edhe në Gornje Lubinjë çka kanë pasur drejtorat, drejtoritë përkatëse. Kurse sa i përket listës, domethënë të lokaleve, na Karanfil për çdo vit edhe pse kanë këta afat deri në 2027-tën, na gjithmonë e propozojmë listën. Pse? domethënë e kemi këtë praktikë për arsye se ndoshta ndonjë shfrytëzues mundem me dhënë dorëheqje, domethënë me shkëput kontratën. Atëherë nëse e shkëput kontratën me vetdëshirë ose mos me ba pagesë, atëherë ne një vit e gjysmë atë lokal s'mundemi ne me e ritenderuar për arsye se nuk është në listë. Për atë qëllim na që shtatë vite, pavarësisht se kanë afat, kanë kontratë deri në 2027, ne prapë e shpallim listën nëse domethënë na ngjanë kjo. Kurse sa i përket lehtësirave, domethënë Karanfil është këta kontratat nëse i përmban kontratas është deri në fund të 2027-tës, por dhe atëherë kur të bëhet ligji nuk ja u njeh. Edhe këtë tenderin e fundit ankandin e fundit edhe ankandin e më herët ne kemi pasur, ka pas raste çka kanë qenë pagues të rregullt 20 vjet, mirëpo ai ofertuesi tjetër i ka dhanë kushtet ma ndryshe dhe jemi kanë të detyruar me e larguar, me e marrë. Si është ajo fjala që kjo prona publike është e gjithkujt dhe e askujt, domethënë sa mundesh ti me shfrytëzu edhe unë. Ligji nuk ja parasheh pavarësisht 50 vite me shfrytëzu dhe me qenë edhe pagues i rregullt nuk i parasheh lehtësirat, kjo është Karanfil.

**Karanfil Haxhillari:** Por në kushte të barabarta i jepet përparësi.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës):** Në kushte të barabarta po, në qoftë se në kushte të barabarta atëherë ai veç shfrytëzuesi aktual adi e ka marrë.

**Antigona Bytyqi:** Fjalën e ka Bajrami, mandej Dafina.

**Bajram Kastrati:** Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Unë desha me u ndalë për dy prona konkrete. Gursel, pronat parkingjet a janë të përfshime këtu dhe qysh kanë me u trajtu? Edhe është një pronë përballë varrezave të dëshmorëve në Landovicë që është bërë kërkesë vazhdimisht për atë pronë për me u shfrytëzuar, a është e përfshim edhe ajo pronë?

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës):** Sa i përket parkingjeve listën na ka dhënë Drejtoria e Shërbimeve Publike edhe domethënë atë listë çfar na ka dhënë Drejtoria e Shërbimeve ne e kemi futur, cilat kanë qenë pronat domethënë nuk ka pas problem. Ato çka nuk kanë qenë në listë ne e kemi rifteskuar, kurse për atë.

**Bajram Kastrati:** A janë të përfshime?

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës):** Po po.

**Bajram Kastrati:** Të gjitha parkingjet apo...

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës):** Listën e Shërbimeve Publike qysh e ka pasë, se projekti i Shërbimeve Publike.

**Bajram Kastrati:** Mir por tash ju e dini a janë, se s'janë shumë prona.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës):** Po listën çka na ka dhënë shërbimet.

**Bajram Kastrati:** A ka ndonjë që s’është e përfshine ndonjë pronë?

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës):** Listën Bajram, kuptohet listën shërbimet publike çka e ka domethënë për parkingje, ne domethënë i kemi futur krejt ato.

**Bajram Kastrati:** Unë po të kuptoj Gursel, po tash janë disa prona që s'janë numër i madh i tyre që janë për parkingje, shtatë, dhjetë sa munden me qenë ato, a janë të përfshime ju duhet me e ditë a janë të përfshime të gjitha apo s'janë? Unë po të kuptoj që atë listë që ta ka dhënë ai a i keni verifikuar ju a janë?

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës):** Po i kemi verifikuar.

**Bajram Kastrati:** A janë të përfshime krejt?

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Po janë të përfshime po.

**Bajram Kastrati:** Të gjitha?

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Po lista çka na e ka dhënë Drejtoria e Shërbimeve Publike janë të përfshime.

**Adem Shabanaj:** Po ti duhesh me ditë si sektor i pronës a janë të gjitha, shumë shkurt po të thotë.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Të gjitha janë.

**Adem Shabanaj:** Po mos e devijo përgjigjen.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Të gjitha janë o Adem.

**Adem Shabanaj:** A është prona në fjalë për të cilën po folë Bajram Kastrati?

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Cila pronë?

**Bajram Kastrati:** Jo, kjo ke e përgjithshme.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Edhe në qoftëse nuk është o Adem mundet me propozue secili prej juve.

**Bajram Kastrati:** Po na sun hyjmë tash secilën me i verifikue.

**Egzona Hoxhaj:** Edhe është shum problem me i verifiku.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Egzona për çdo vit, për çdo vit që shtatë vite për çdo vit pas votimit, pas miratimit dhe konfirmimit, ajo listë e cila është në ueb-faqe edhe çdokush mundet me verifikue.

**Bajram Kastrati:** E prona në Landovicë që bana pyetje? përballë varrezave të dëshmorëve.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Nëse është për komunale është.

**Bajram Kastrati:** A është e përfshirme nëse është?

**Adem Shabanaj:** Qeta po i tham edhe unë Bajram.

**Antigona Bytyqi:** Dafina fjalën.

**Bajram Kastrati:** Na s'mundemi me i verifiku krejt.

**Dafina Alishani:** Gursel.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Urdhno.

**Dafina Alishani:** Nën një, e vlerësoj që kjo listë nuk është hiç transparente, nuk di unë si asambleiste qysh muj me verifiku me numër katastral, ishte dashur me adresa, me numra. Po na sjellni diçka me votu, ne nuk mundemi me votu qorras e para. E dyta njeri po të vet konkret për pronë, ti je përfaqësuesi i Zyrës së Pronës e thua nuk di! Kush e din? nëse ka ndonjë zyrtar tjetër që i din pronat komunale, le të vjen le të na prezantoj. Ne nuk mundemi me votu një listë për të cilën nuk jemi të informuar ose nuk mundemi me votu një listë prej një zyrtari që nuk po din me na tregu a është pronë komunale a jo! Cila është pronë komunale, ajo është në listë, konkret e pat,

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Po konkret duhet me e tregu listën. Dafina aty janë 134 faqe, 134 faqe, secila faqe ka domethënë 30-40 prona, kush mundet me i mbajtë në mend, të folim realisht qetash. Bajrami u kanë çdo të dytën ditë, çdo të dytën ditë a ke qenë? A ke mundur me thënë a është qekjo? Je i interesuar për tjerë persona e sje interesue për këtë.

**Bajram Kastrati:** jo bash të dytën ditë, por sido që të jetë, tash e keni sjellë ju një listë këtu.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Unë e thashë në fillim që i i shtati vit.

**Bajram Kastrati:** Ani qe Bajrami s'po të bën pyetje, po të bën pyetje një qytetar. Këto dy prona a janë.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Kur ke qenë ke mund që kjo numri i pronës a është i përfshim.

**Bajram Kastrati:** Mirë de, mos ta personalizojmë, leje Bajramin ti, na po pyesim për prona.

**Antigona Bytyqi:** Bajram, në qoftëse ka përgjigje, në qoftë se jo mundet edhe në kuvend për të shtuar pyetjen, merr informata edhe.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Numrat e ngastrave dhe mundemi me shiku nëse është.

**Dafina Alishani:** A bënë me adresa me na pru?

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Dafinë, kjo është, kjo listë nuk e bëjmë ne, Agjensioni Kadastral i Kosovës na ka sjerrë.

**Dafina Alishani:** Unë po dua me ditë çka po votoj.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Si ke votu qe shtatë vite. Jo s'mundem.

**Dafina Alishani:** Nuk mundesh, në rregull. Atëherës as unë s' ta votoj.

**Bajram Kastrati:** A mundemi me i verifiku në asamble?

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Mundesh qetash me e verifiku, veç listën me numrin e ngastrës ma jep.

**Florent Ukaj:** Numrin e ngastrës, edhe janë listat e pronave në faqe të komunës edhe i keni pronat. Normale që ky smundet me i mbajt ne mend sepse janë shumë, sa janë?

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): 134 faqe nga 30-40 prona.

**Florent Ukaj:** 134 faqe s'mundemi, ju mundeni me pyet edhe një në Gornje Lubinje e tjera, s'mundet me i mabjt ne mend krejt.

**Bajram Kastrati:** Lenti, pyetja ke e veçantë se për parkingje është diçka më e veçantë se pronat tjera.

**Florent Ukaj:** Po por ky tha që parkingjet janë, tash ky sun të kallzon saktë. Në Prizren janë 10.000 vende të parkingjeve, tash ky s'mundet me i mbajt në mend 10 mijë numra të ngastrave.

**Bajram Kastrati:** Jo bre s'janë 10 mijë.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Bajram, unë të tregova, parkingjet ku ka me qenë Drejtoria e Shërbimeve Publike...

**Antigona Bytyqi:** Veç ju kisha lutur folni me radhë.

**Bajram Kastrati:** Parkingjet publike Lent, s'jane 10 mijë, munden me kanë nja 10 a 15.

**Florent Ukaj:** Sa banesa i ke në Ortakoll? Secila banesë e ka parkingun e vetë edhe është me numër të ngastrës, edhe s'mundesh këtij mi thanë tash kallxom për një...

**Bajram Kastrati:** Jo bre, për qeto parkingje që janë të shfrytëzueshme, që mundem me u dhanë me u shfrytëzu edhe...

**Florent Ukaj: Qato që i** ka pru, pa dashur me ja ba avokatin por po me doket e palogjikshme kur është publike krejt lista e pronave në faqen, unë vetë e kam parë faqen publike të komunës krejt lista.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Prej 2019 është kjo Kryesuese.

**Antigona Bytyqi:** Zotëri Gursel edhe unë një diçka deshta. Dje po më duket më ka ardhur një listë, më keni thënë që me shumë pak ndryshime. A mundesh që me ja u sqaru edhe anëtarve të Komitetit. Listën që e kemi marrë dje me disa ndryshime të vogla që ato me na i konkretizu edhe listën me këto ndryshime sot do t'jua përcjellim me rekomandimet e KPF-së.

**Dafina Alishani:** Po veç unë nuk ju lypa 130 faqe të pronave, evidenca e lokaleve të cilat janë në listë ato me i paraqitë me adresë.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Ato janë.

**Dafina Alishani:** Nuk janë, janë me numër katastral, këto veç po dua me ditë. Tash po kthehem pse? A mundesh me më tregu a ka prona komunale të cilat kanë hy në tenderim me qera shumë të madhe edhe tash për shkak që është qiraja shumë e madhe ju nuk i keni bë kontratë edhe vazhdon me shfrytëzu kontratën se nuk ka hesap me pagu 3 mijë euro. Edhe çka ka ndodhur me këtë lokal këtu, unë me dijeninë time kjo nuk është dhënë me ankand publik, qysh arritën me e hap? kush është shfrytëzuesi? Ju si sektor i pronës ish dashur me ditë edhe me na informuar neve. Nëse ka prona të cilat vazhdojnë me u shfrytëzu prej pronarëve e nuk kanë kontrata, atëherë duhet me u futë këtu sepse komuna nuk po merr të hyra prej këtyre pronave. A është qashtu? A ka prona?

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Jo.

**Dafina Alishani:** Jo? Me ba me ta gjetë?

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Unë e di ku po pretendoni ju, nuk është. A këtu është me tender me tender është e dhënme me kontratë, lokalin Maksutaj e ka me kontratë.

**Dafina Alishani:** E tjetra që është.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Gjashtë lokale qetu.

**Dafina Alishani:** Lokali që ka kandiduar me shumë qira të madhe e që nuk po paguan qira të madhe, a ka kontratë?  E din shumë mire.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Lokal jo, po e di, lokal jo. Ajo është sipërfaqe, janë disa procedura të tjera nuk është. Ajo është përgjegjësia e kryetarit a qet a se qet.

**Dafina Alishani:** Qysh përgjegjësi e kryetarit?

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Kryetarit çdo propozim që asi, domethënë lokal me karakter të….

**Dafina Alishani:** Nëse prona komunale shfrytëzohet pa kontratë është uzurpim.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Dafina lokal, domethënë lokal nuk ka, unë po jap përgjegjësi këtu para të gjithëve në qoftëse është. Të gjitha lokalet, për të gjitha lokalet pronë komunale, vetëm katër janë të ndërtesa Globalit pa u shfrytëzue, është te libraria Siprinti.

**Dafina Alishani:** Po, veç këto janë?

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Po, lokale po.

**Dafina Alishani:** Të tjerët që janë fitu.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Nuk është ai lokal ku pretendojsh, nuk është ai.

**Dafina Alishani:**  Janë dy lokale që kanë çmime shumë të larta edhe nuk ja keni bë kontratën.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**):  Jo kanë, jo nuk është e vërtetë.

**Dafina Alishani:** Këqyre Gursel, del e vërtetë, e kam të faktume.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Dafina mos më kursej mundesh…

**Dafina Alishani:** As unë nuk të kursej hiç me të qu në kallxim.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): Po hiç hiç mos mos më kursej.

**Dafina Alishani:** Atëher i bën gati dokumentet.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**): U ba, ose mundesh me ardhë me kërkesë për çasje në dokumente.

**Dafina Alishani:** Jo nuk vij se kur po vij nëpër zyre po ma hallakatni krejt, a ban me imella.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës**):  Jo jo, kërkesë, të kemi prit shumë herë.

**Antigona Bytyqi:** Ju kisha lutur flisni me radhë për shkak të procesverbalit.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës):** Mundesh edhe me e-mail me bë kërkesën.

**Dafina Alishani:** Të lutem në seancë nëse mundesh këto lokale që janë, lokalet s'po flas për Gornje lubinje ato praonat, lokalet me adresa. Njerëzit duhet me e ditë për çka janë tu votu.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës):** Lokalet mundemi adresat.

**Dafina Alishani:** Është e shkurtë lista.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës):** Këto Dafina mundemi edhe është si në kërkesë lokalet, mirëpo pronat ku janë, aty nuk mundem të gjitha pronat me adresë, a a lokalet mundemi me adresë.

**Bajram Kastrati:** Veç edhe një pyetje. Nëse eventualisht i evidentojmë që nuk janë përfshime këto prona, a kemi të drejtë me propozu në séance?

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës):** Po po mundeni.

**Bajram Kastrati:** Faleminderit.

**Antigona Bytyqi:** Atëherë dikush tjetër?

**Karanfil Haxhillari:** Domethënë përveç këtyre lokaleve që e kemi listen, janë edhe prona të tjera, hapësira të tjera që kanë me u dhënë shfrytëzim.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës):** Karanfil, duhet me qenë me votuar për çdo vit deri në 31 dhjetor, se nëse nëse jipen në shfrytëzim, nëse s'janë në këtë listë, s'mundet me u zhvilluar procedura, domethënë hap i parë duhet me qenë në listë. Ju e dini, nuk është hera e parë kjo, është i shtati vit me radhe, nuk e di çka po bëhet pyetje!

**Antigona Bytyqi:** Nëqoftë se nuk kemi diçka tjetër, po e hedhim votim pikën e tretë që t'i rekomandohet mbledhjes së ardhshme. Preznet jemi 8 anëtarë, kush është për? 5 jemi për, 0 kundër dhe tre abstenim. Atëherë edhe kjo pike i rekomandohet mbledhjes së ardhshme, ju faleminderit. Kalojmë te pika e katërt.

**Pika e katërt;**
**Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e shfrytëzim të objektit pronë komunale për raste të veçanta,**

**Antigona Bytyqi:** Përsëri zotëri Gurseli fjalën.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës):** Po faleminderit Kryesuese. Është fjala për objektin e zyrës së gjendjes civile në fshatin Reçan, pikërisht për katin e parë të këtij objektit, ka kërkue me e marrë për 10 vite me qera Policia e Kosovës, ashku e ka paraparë ajo të arsyeshme derisa të ndërtohet një object. Domethënë kryetari propozon që me ja dhënë për 10 vite, kurse mënyra është domethënë pa kompensim, domethënë kati i parë i zyrës së gjendjes civile në fshatin Reçan Policisë Kosovës me janë. Ky është propozimi.

**Antigona Bytyqi:** Ju faleminderit. A keni ndonjë pyetje?

**Karanfil Haxhillari:** A shfrytëzohet tash për momentin qaj kati i pare?

**Antigona Bytyqi:** Shfrytëzohet nga zyrtari i gjendjes civile, por tash aty e kanë paraparë çka zyrtari i gjendjes civile me dalë në përdhesë kurse katin e parë me i'a liruar policies. Përkohësisht 10 vite, ndoshta nëse e ndërtojnë ndonjë stacion policor atëherë dhe munden meu shkëput përpara.

**Antigona Bytyqi:** A ka dikush tjetër diçka? Nëqoftë se jo, po e hedhim në votim. 8 anëtarë jemi. Kush është për që ti rekomandohet të mbledhjes? Unanimisht, ju falenderoj të gjithëve. Kalojmë te pika e pestë.

**<u>Pika e pestë</u>**
**Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës së Prizrenit për vitin 2025.**

**Antigona Bytyqi:** Siç e dini në mbledhje do ti propozojmë emrat nga një anëtarë të secilit subjekt politik, në mënyrë që të fillojmë procedurat për hartimin e planit të punës së kuvendit. A keni diçka me shtuar?

**Egzona Hoxhaj:** Jo.

**Bajram Kastrati:** Jo.

**Antigona Bytyqi:** Atëherë propozimet i japim në kuvend. Kush është për që të miratohet kjo pike? Unanimisht, ju falenderoj të gjithëve. Kalojmë te pika e gjashtë.

**<u>Pika e gjashtë;</u>**
**Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e raportit të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera.**

**Antigona Bytyqi:** Po drejtoreshën e kemi këtu.

**Ramize Sinanaj Shala:** Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Unë sot në pika të shkurta do të raportoj për këtë, për dëmet që na janë shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Fillimisht, dua me ju treguar se ky komision është formuar që nga viti 2022, ka qenë propozimi i AME-së, i cili është në kuadër të MPB-së, ku ata na kanë treguar edhe kualifikimet shkollore të cilat duhet me pas ky komision, edhe ky komision ka mandat katër vjeçar. Në këtë raport janë të përfshime vetëm dëmet e bujqësisë, ku gjithsej dëmet e shkaktuara janë pa u raportuar dëmet e fundit që janë bërë, domethënë nuk hyjnë brenda këtij muaji që ka pas disa serra që janë dëmtuar nuk hyjnë në këtë vlerësim, domethënë dëmi i përgjithshëm është 632.229,79 euro. Pasi që ky raport të miratohet, sigurisht që ne do ta dërgojmë në MAPL edhe pastaj ata vendosim së bashku me AME-në se çfarë do të bëjmë. Fatkeqësisht në dëmet që janë shkaktuar në ekonomi nuk është bërë vlerësimi, për arsye se mungon një çmimore, sepse dëmet që janë shkaktuar nuk ka në treg më ato gjëra të cilat janë dëmtuar, edhe për këtë arsye jemi në bashkëbisedim edhe me zyrtarët e AME-së se si me zgjidh çështjen e dëmeve që janë në ekonomi. Ndërsa këtu i kemi vetëm dëmet e bujqësisë.

**Antigona Bytyqi:** Faleminderit drejtoreshë. Fjalën e ka kërkuar Florenti.

**Florent Ukaj:** Faleminderit drejtoreshë. Unë pata disa pyetje për këtë vlerësim të dëmeve. E kuptuam që në 2022 koka formuar ky komision, e dimë që kemi pas dëme edhe vitet e kalume, është bërë një vlerësim i dëmeve, a mundeni me na shpjegu ku ka mbet ajo procedure? edhe pse nuk po kompenzohen bujqit ose kushdo që ka pësu dëme. Domethënë jemi në vitin 2024 edhe po hyjmë në vitin 2025, me dijeninë time hala asnjë nuk është kompenzuar! Unë me sa kam informatë qyteteve të tjera ju ka kompenzuar disa. Ku është arsyeja dhe pse nuk po kompenzohen?

**Ramize Sinanaj Shala:** Po është e vërtetë që edhe dëmet që janë shkaktuar në vitin 2023 ende nuk janë kompensuar qytetarëve, nuk ju kanë kompenzu, sa kam djeni unë që kam biseduar me zyrtarët e AME-së, janë pranuar si dame, ka shku deri në kuvend, janë pranuar mirëpo nuk është bë pagesa ende! Domethënë është miratuar, si raport është miratuar, mirëpo ende nuk ju kanë kompensuar qytetarëve, për vitin 2023 po flas.

**Antigona Bytyqi:** Dikush tjetër a kemi diçka? Po Dafina urdhëro.

**Dafina Alishani:** Bash rastësi ke që javën e kaluar, mua më ra me u taku me ministrin Pecin me një tubim në atë Atmaxhë, të njëjtin shqetësim e patën edhe ministri tha me i siguruar dokumentet që kanë shkuar që është bërë vlerësimi. Tash s'është mire, s'po e di te kush është përgjegjësia se ministria po thotë te ne nuk ka ardhur, komuna thotë ne i kemi dërgu. Ju kisha lutur nëse keni dokumentet që mundemi me i përcjellë, tash sipas rregullit si është institucioni, domethënë ju si komunë.

**Ramize Sinanaj Shala:** Ja dërgojmë AME-së, ME-së, AME-ja i dërgon atje.

**Dafina Alishani:** A mundemi me pas ndonjë dokument lidhur me këtë që është finalizuar prej palës të komunës?

**Ramize Sinanaj Shala:** Unë e kërkoj me shkrim prej AME-së që me na dhënë, domethënë me e-mail me na dërgu që ku ka mbetë lënda e vitit 2023 që me pas si document. Këto që unë i thashë ka qenë takim zyrtar por nuk kam, nuk është i dokumentuar a po kupton. Unë kam pyet gjatë takimeve që i kemi pas me komunat edhe me zyrtarët e AME-së edhe kam pyetur se ku ka mbetur lenda e Prizrenit, më keni thënë se është pranuar, është miratuar dhe pse nuk janë bërë vlerësimet? Ata më kanë thënë se i kemi dërguar, gjithçka në rregull dhe pritet me u bë ky kompenzim, domethënë ky ka qenë takim zyrtar, por nuk kam si me ta dokumentu. Në të kundërtën unë e bëj një e-mail edhe i them çka ka ndodhë me pse nuk janë kompenzu të vitit 2023? edhe le të na japin me shkrim që me pas një fakt për me ja u dorëzuar juve. informata është kjo Dafina.

**Floret Ukaj:** Që ka raport, atë ne e kemi votuar raportin ka me shifra me krejt, ajo s’don diskutitim që ka raport dhe që e kemi dërguar.

**Bajram Kastrati:** Ministri s’ka informata.

**Ramize Sinanaj Shala:** Është votuar Dafina, është votu.

**Dafina Alishani:** E di që është votuar, unë nuk e di çka mbetë.

**Ramize Sinanaj Shala:** Po ne e kemi për obligim tani me dërgu në AME e ata tani si dy institucione ma të afërta.

**Dafina Alishani:** Nëse mundeni me na siguru këtë atëherë edhe ne do të mundohemi në nivel qëndror nëse është, po nëse ka mbetur aty besoj që ish dashtë mu kry.

**Ramize Sinanaj Shala:** Unë kam disa informacione që disa komuna është e vërtetë që ju kanë pagu, mirëpo janë ato komunat për të cilat kanë pas fatkeqësi shumë më të mëdhaja se ne, jo si si si çmim, si monedhë, mirëpo për shembull Dragashi që pat vërshime, janë disa komuna më të specifikuara, domethënë arsyeja pse ju ka pagu është qajo.

**Florent Ukaj:** Nuk po besoj që është ajo arsyeja, për shembull Rahoveci, unë po ta spjegoj Krusha e Vogël, Krusha e Madhe, të njëjta dëme janë bë, njëjtë vlerësime janë bë, e dini kufini i Rahovecit me Krusha e Vogël, Krusha e Madhe qysh është kufini, Krushës së Madhe ju ka paguar, Krushës së Vogël nuk ju ka paguar.

**Ramize Sinanaj Shala:** E bëjnë të njëjtin raport.

**Florent Ukaj:** joi si komunë po du me thënë që Komuna e Rahovecit është kompenzu e Komuna e Prizrenit është e kompenzume.

**Bajram Kastrati:** Veç edhe një pyetje. Këto damat a trajtohen direkt prej njërës ministri? për shembull dëmet bujqësore a trajtohen prej Ministrisë së Bujqësisë apo kush i trajton? Puna që me dit kush ka me bë këtë kompenzimin e e dëmeve?

**Ramize Sinanaj Shala:** Po dëmet e bujqësisë sigurisht që duhet të Ministria e Bujqësisë, kurse këto të tjerat, këto të tjera dame ne që i dërgojmë në AME, ata i dërgojnë te ministritë përkatëse. Se nuk e di tash në kuadër të kujt, e kanë një farë fondi për këto fatkeqësitë natyrore dhe që munden.

**Bajram Kastrati:** I bie që neve edhe i 2022-tës nuk është bë kompenzimi demit?

**Ramize Sinanaj Shala:** Po gjithmonë shkon një vit mbrapa.

**Bajram Kastrati:** Po tash edhe 2023 shkoj.

**Ramize Sinanaj Shala:** Po de nuk janë bë, domethënë ai është miratuar, është miratu, por nuk janë kompenzuar, e ky raport ende nuk ka shkuar për me u miratu.

**Antigona Bytyqi:** A keni ndikush tjetër diçka? Në qoftë se jo po e hedhi në votim pikën e gjashtë.

**Bajram Kastrati:** Veç edhe një diçka Kryesuese. Po urojmë që me marrë një përgjigje konkrete. Për masnesër a kemi mundësi me pas një përgjigje në séance?

**Ramize Sinanaj Shala:** Unë sot mundem me i shkruar AME-së edhe ata nëse ma kthejnë përgjigjen nuk është hiç kurfarë problemi.

**Dafina Alishani:** çka është kjo AME?

**Ramize Sinanaj Shala:** është Agjensioni për Menaxhimin Emergjent, në raste të fatkeqësive, domethënë njëherë veprojnë komunat, kur eskalon situata më e madhe, ata e marrin përgjegjësinë në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme.

**Dafina Alishani:** A është nën Ministries e Bujqësisë a?

**Ramize Sinanaj Shala:** Jo jo, është në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

**Bajram Kastrati:** Drejtoreshë, me deshtë me marrë një përgjigje më konkrete për masnesër. Me deshtë drejtoresha dhe me marrë kerrin edhe me shku në ministri atje me marrë përgjigjen direkt mos me pritë e-mailin sepse e-mail ka mundësi s'të kthehet nja një muaj ditë. A ekziston kjo mundësi, që ne me ditë tamam ku është problem? Se ne mundemi me ba pyetje dhe ti me na dhënë një përgjigje, s'ma kanë kthyer përgjigjen edhe ok. Por me marr drejtoresha kerrin e komunës edhe me shku në ministri me marrë një përgjigje deri masnesër?

**Ramize Sinanaj Shala:** Unë më përpara nuk ajo komunikimi ndërlidhës është komunë AME a po kupton? Unë krejt çka mundem me bisedu është veç me zyrtarët e AME-së.

**Bajram Kastrati:** Po mire de, tek ata zyrtarët me shku direct.

**Ramize Sinanaj Shala:** Unë muj me siguruar një përgjigje, besoj që mundem.

**Bajram Kastrati:** Neve po na vazhdohen këto përgjigjet jo veç te ju, po na vazhdohen, i kemi shkruar, s'është, Dafina po thotë se kanë ata informatën. Ne kemi një rast më herët me një pronë të Arbanës e kanë, s'e kanë! E di për me u kanë pak më konkret, ju i keni shpenzimet e hjekne, këtë punë e bëni, vetëm që me i marrë përgjigjet pak më konkrete.

**Ramize Sinanaj Shala:** Dëgjo, në qoftëse unë i marr përgjigjet konkrete, unë i kam marrë prej takimit zyrtar përgjigjet konkrete a po kupton? se dhe ajo është diçka zyrtare se ka qenë në takim zyrtar. Qëllimi është me pas një e-mail si dokument që mua ma dokumenton. Unë krejt çka mund me bë është me kontaktu me zyrtarët e AME-së edhe me me kërku që po kërkojnë asambleistat, a po kupton? edhe ju lutem përgjigjen ma bëni me shkrim.

**Antigona Bytyqi:** Drejtoreshë që mundesh me siguru informacionet të mirëpresim në kuvend. Po e hedhi në votim pikën e gjashtë, prezent jemi të anëtarë. Kush është për që t'i rekomandohet mbledhjes? Unanimisht ju faleminderit shumë. Kalojmë në pika tjetër.

**<u>Pika e shtatë;</u>**
**Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik**

**Antigona Bytyqi:** Zotëri Gursel përsëri.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës):** Faleminderit Kryesuese. Në mungesë të drejtorit Çela unë po e prezantoj. Domethënë në bazë të propozimit është kërkesa, vetëm se propozimi sipas drejtorit domethënë ku është Agjensioni Kosovar i Privatizimit që tash duhet me qenë domethënë me u ndryshuar ky propozim Agjensioni Pyjor i Kosovës, domethënë Agjensioni Pyjor i Kosovës. Është kërkesa për me marrë pronën me numrin e parcelës 933 edhe 926 tek zona kadastrale Billushë e cila sipas komunës së Prizrenit do të shfrytëzohet si deponi e mbeturinave. Domethënë kjo me e marrë prej Agjensionit Pyjor të Kosovës në shfrytëzim. Vetëm këtu te propozimi ku është Agjencioni Kosovar i Privatizimit duhet të ndryshohet dhe ka me qenë Agjensioni Pyjor i Kosovës.

**Bajram Kastrati:** A kemi ndonjë rast tjetër që kemi marrë prej Agjensionit të pyjeve prone?

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës):** Jo unë sa di jo.

**Bajram Kastrati:** Asnjëherë a?

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës):** Veç një prej ministrisë Nashecin prej ministrisë domethënë para gjashtë-shtatë vite domethënë prej ministrisë Pushimorja e Nashecit, tjetër unë nuk e di.

**Bajram Kastrati:** Puna po më intereson se AKP-ja tash sa kërkesa ne jemi tu bë e sa intervenimet e sa…

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës):** Bajram, ndoshta në bazë informatave më fal se nuk jam shumë, qe tash domethënë unë të tregova këtu duhet me u ndryshua.

**Bajram Kastrati:** E qartë unë të kuptova, pyetjen që po dua me ta bë AKP-ja është tuj na malltretu me prona edhe tash po duhet intervenime të shumta. Unë i kam pas nja pesë-gjashtë takime me pozitë e opozitë me deputet, me ministra për me realizuar një pronë të AKP-së. Tash Agjensioni i Pyjeve po më intereson për këtë punë edhe të pyeta që a kemi pas ndonjë rast ndonjëherë me Agjencionin e Pyjeve? a është e njëjta procedurë edhe me këta si me këta të tjerët?

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës):** Jo jo, nuk kemi pas jo. Nuk është ajo procedurë se ne nuk po kërkojmë domethënë prej Agjensionit Kosovar me u bartë edhe me u bë prona, pronë komunale. Këtu po dojnë me e marrë veç në shfrytëzim edhe këtu dallon Bajram. Unë sa jam i informuar se unë thashë, më shumë informata drejtori i Çela. Këtu nuk është domethënë me u kthye prona e Agjensionit Pyjor në pronë komunale, po këtu veç me u marrë me…

**Bajram Kastrati:** I bjen me qera?

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës):** E qetash munden me qera, munden pa qera sikur ne qysh po ja japim policies.

**Bajram Kastrati:** E marrim një qartësim në seancë edhe prej drejtorit.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës):** Po prej drejtorit më shumë, më mire.

**Antigona Bytyqi:** Karanfili fjalën.

**Karanfil Haxhillari:** unë i kam në dilemat e mia sepse me deponi për mbeturina është një agjension në kuadër të nivelit të Kosovës që merret me menaxhimin e deponive të mbeturime. Në këtë rast këtu kjo parcelë që po kërkohet dhe të bëhet të po shkruan qartë deponi e mbeturinave. A keni biseduar me ata vendasit atje sepse po, është në Billushë kjo, duhet paraprakisht një pajtim prej tyre a pajtohen që të jetë një deponi e mbeturinave aty? Nuk është logjike në qoftëse nuk e kemi një pajtim, një debat me ata qytetarë atje për me vendosur sidomos një deponi të mbeturinave. Por edhe tjetra kanë me na kthyer edhe këtaj sepse unë nuk e di që komunat kanë kompetenca për menaxhim të deponive të mbeturinave në nivel Kosove. Nuk e di që një komunë e ka një deponi diku që e menaxhon vetë derisa kjo është e përcaktuar me ligj dhe është ajo qysh e kemi rastin e deponisë në Landovicë aty. Nuk e di, unë nuk e kisha votuar me dëshirë në qoftëse nuk e kisha pas

një konfirmim prej banorëve të Billushës atje që ata pajtohen që ta kenë në të ardhmen një deponi të mbeturinave. Edhe e fundit, deponi mbeturinave, cilat, ta kemi edhe të qartë, çfarë mbeturina do të hidhhen atje? Nga cilat vende do të hidhen atje? Pra, një mori pyetjesh është që pastaj është që me u kanë të qartë edhe qytetarët edhe….

**Bajram Kastrati:** Do të bëhet edhe një Landovicë e dytë!

**Karanfil Haxhillari:** Po.

**Gursel Skenderi (Sektori i Pronës):** Për më shumë informata, ju tregova nuk jam shumë i informuar, drejtori atëherë vetëm çka domethënë këto ndryshimet ai mi tregoj çka me qenë Agjensioni Pyjor i Kosovës edhe në shfrytëzim jo domethënë qysh tha Bajrami me e kaluar pronë komunale, por në shfrytëzim këto. Informatat më të hollësishme drejtori i jep në seance.

**Bajram Kastrati:** Atëherë në seancë.

**Antigona Bytyqi:** A Keni dikush tjetër diçka? Në qoftëse jo, po e hedhim votim, prezent jemi shtatë anëtarë të komitetit. Kush është për që t'i rekomandohet mbledhjes së ardhshme? Unanimisht, ju faleminderit. Kalojmë te pika e tetë,

**<u>Pika e tetë;</u>**
**Shqyrtimi dhe miratimi i planit lokal të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me baza gjinore 2024-2026.**

**Antigona Bytyqi:** E dëgjojmë zonjën Kumrije.

**Kumrije Bytyqi (DPMS-QPS):** Faleminderit e nderuara Kryesuese, përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Sot jemi para një plani shumë të rëndësishëm, siç është mbrojtja e dhunës në familje, plan i cili është përpunuar nga të gjitha institucionet komunale dhe institucionet e drejtësisë në kuadër të mekanizmit, i nënshkruar nga një marrëveshje e mirëkuptimit nga Kryetari i Komunës dhe të gjithë akterët e tjerë relevant. Ky plan pra i ka kaluar të gjitha procedurat profesionalale. i cili është i përbërë prej objektivave specifike të cilat janë ndërthura me objektiva strategjike dhe të gjitha aktivitetet të cilat janë shpërndarë në bazë të objektivave të caktuara. Pra, qëllimi i këtij plani i cili për herë të parë është në Prizren, që e kemi një plan tre vjeçar, qëllimi është parandalimi i rasteve të dhunës në familje, fuqizimi i mekanizmit dhe grumbullimi i të gjitha të dhënave të rasteve të dhunës në familje, identifikimi I të gjitha rasteve. Në momentin kur ne i identifikojmë të gjitha rastet, atëherë institucioni e kemi shumë më të lehtë mos t'rajtojmë raste të dhunës në familje, është një gjendje alarmante në gjithë kosovën sa i përket në Prizren janë mbi 170 raste të dhunës. Andaj ne e kemi marrë me përshpejtim me bë këtë plan komunal i cili do të fuqizojë mekanizmin dhe do të avokojë dhe monitoroj gjithë procesin. Nëse jeni të interesuar për të gjitha objektivat, objektivën specifike dhe objektivat strategjike të ndara në aktivitete, atëherë jemi këtu për të elaburuar në mënyrë më të saktë.

**Antigona Bytyqi:** Nëse pajtoheni sot po e lëmë për Kuvend më gjerësisht. Kështu që faleminderit shumë, meqë edhe materialin e kemi pas qe disa ditë, vetëm nëse kanë anëtarët me shtuar diçka? Po urdhëro Karanfil.

**Karanfil Haxhillari:** Veç edhe një pyetje shumë të shkurtë se e dëgjova nëpër media për këtë çështje edhe lidhur me këtë strategji e kishin parapa edhe disa i thoshin unaza apo të monitorimit, a është përfshirë.

**Kumrije Bytyqi (DPMS-QPS):** Jo, në momentin kur është bërë planifikimi, është bërë më herët dhe ka kaluar në faza, ministria në ditën e fundit, 16 ditë aktivizim të dhunës i ka përgatitur ato unazat edhe ato janë direkt të gjykatës edhe të prokurorisë edhe të policisë, se policia ka me i monitoruar, ndërsa ne kemi me pas shumë më lehtë të gjithë për me identifikuar rastet e dhunës edhe të viktimave. Kështu që, nëse jeni të interesuar, ky plan ka kaluar, janë ftu të gjithë kuvendarët e kam prezantuar edhe në kuvend, edhe ju kam ftu në mekanizëm të gjithë kuvendarët, 16 ditë është folur për këtë plan.

**Antigona Bytyqi:** Po po, faleminderit. Prezent jemi shtatë anëtarë, po e hedhim votim në pikën e tetë që t'i rekomandohet mbledhjes. Unanimisht ju faleminderit të gjithëve.

**<u>Pika e nënë;</u>**
**Raporti i punës së kryetarit për vitin 2024.**

**Antigona Bytyqi:** Kryetarin nuk e kemi këtu. Besoj po pajtoheni me e rekomandu për kuvend.

**Karanfil Haxhillari:** Veç e kam një kërkesë që raportin me ardhë kryetari me raportu.

**Antigona Bytyqi:** Vjen, besoj që po vjen. Pikën e nëntë a jemi unanimisht? Po, ju faleminderit shumë. Edhe e patëm propozimin e fundit, pra për rishqyrtimin e vendimit sipas kërkesës së ministrisë. Po urdhëro Karanfil.

**Karanfil Haxhillari:** Në këtë rast i bjen që 6 muajshi I bjen i 17-ti, një. E dyta ë jashtëzakonshme neglizhencë, paramendo qeky kthim me të vërtetë po ndina, unë isha ndi shumë keq për shkak të neglizhencës është kthyer edhe njëherë në rishqyrtim.

**Shpresa Osmanollaj (DUPH):** Është kthyer në rishqyrtim që ku e kam vendimin e Ministrisë së Mjedisit thotë për raportin e shqyrtimit publik, nuk është hartuar sipas legjistacionit në fuqi.

**Antigona Bytyqi:** Zonja Shpresa, do t'i përcjellim këto, veç tu kisha lutur edhe raportin krejt të kompletum se duhet me ja u përcjellë edhe antarëve të kuvendit.

**Shpresa Osmanollaj (DUPH):** E ka edhe Haziz Krasniqi, është edhe në web-faqe të komunës, po thjesht…

**Antigona Bytyqi:** Si zyrë e kuvendit na përcjellni edhe ne e përcjellim tek kuvendarët.

**Shpresa Osmanollaj (DUPH):** Po, raporti ka qenë i komletuar, procesverbali ka qenë i komlpetuar.

**Florent Ukaj:** Po ja falim kësaj herë pasi e ka marrë përgjegjësinë për shkak të sëmundjes. po e ka.

**Shpresa Osmanollaj (DUPH):** unë jam kanë, bile intervenim kam pas, bile më thirrke drejtori bjere ti, unë s'isha në gjendje as me ardhë. Ka qenë web-faqe, s'ka mujt dosjen me kompletu, se kur hapet shqyrtimi publik, është një fletore aty që jipet, vijnë qytetarë të japin mendime, rekomandime e qesi sene. Fletorën s'ka mund me gjetë se e kam pas unë, janë kanë document, procedurë që e kam udhëhequr unë. Kështu që nuk jam kanë në punë. Karanfil, ti mundesh me dyshu.

**Antigona Bytyqi:** Egzona a pate diçka me shtu?

**Egzona Hoxhaj:** Po kryesuese unë e pata në fakt jo për çështjen e kësaj zyrtares por tk zyra e personelit për atë e-mail që na ka ardhur në 30.09, ku është thënë që për KPF nuk mujna me u rimburësu për shkak të mungesës së mjeteve. E keni krejt e-mail, unë i kam shkruar thjesht për kuriozitet për shkak që me anëtarë të tjerë të KPF-së të komunave të tjera, e kena pas muhabet që a janë rimbursu ata, dhe um kam treguar a janë rimbursu, unë i kam edhe bisedat ku ajo më ka thënë që ju në shtator nuk keni mbajtur KPF dhe nuk kam lista nuk kam listë të nënshkrimeve për qatë nuk jeni paguar. E-mail faktikisht është që s’ka mjete. A mundesh Blerim me ja dërgu një e-mail.

**Antigona Bytyqi:** Dëgjo, ne të gjitha mbledhjet që i kemi mbajtur, ja u kemi përcjellë edhe listat.

**Florent Ukaj:** Unë po besoj që ajo është e gushtit.

**Antigona Bytyqi:** Veç se kaluam kështu tjerat. Ta qesim në votim pikën e fundit, present jemi 7 anëtar, kush është për? Unanimisht, ju falënderoj shumë për pjesëmarrje.

Përfundoi në ora: 10:58 minuta.

**Kryesuesja e KPF**
**Antigona Bytyqi**

**P R O P O Z I M**

Që në bazë të nenit 52 paragrafi 52.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe në pajtim me nenin 60 të Statutit të Kuvendit të Komunës, Kryetari i Komunës së Prizrenit, i propozon Komitetit për Politikë dhe Financa shqyrtimin e Projekt dokumentit - Plani Rregullues i Hollësishëm (PRRH) "Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit", sipas Hartë Zonale të Komunës së Prizrenit, me propozim që Komiteti për Politikë e Financa pas shqyrtimit të:

**PROPOZOJË**

Kuvendit të Komunës së Prizrenit që konform nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), e lidhur me nenin 17, shkronja a) dhe b), nenit 40, shkronja l), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 10 paragrafi 2, nën paragrafi 2.1 dhe 2.3, neni 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe 1.6, si dhe nenit 17 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174, të datës 31.07.2013, e lidhur me dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MMPHI-së Nr. 01/18 për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme, Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, si dhe nenit 25 paragrafi 1, shkronja ll) dhe m) dhe paragrafi 2 shkronja b), e lidhur me nenin 27 paragrafi 1, të Statutit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, Nr. 01/011-5643, të datës 15 tetor 2008, si dhe Vendimit për Miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022-2030, Nr. 001/011-48192, të datës 31.03.2022,e në përputhje me udhëzimet e dhëna ***në shkresën e MMPHI-së,për rishqyrtimin e ligjshmërisë aktit nr.8624-2/24 dt. 17.01.2025*** ashtu që Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më ....... shkurt 2025, të miratoi këtë:

**VENDIM**
**PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM (PRRH) "ZONA E PARKUT PËR INDUSTRI TË LEHTË NË PRIZREN - PARKU I BIZNESIT", sipas Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit**

**Neni 1**

**Miratohet** Plani Rregullues i Hollësishëm (PRRH) "Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit", sipas Hartë Zonale të Komunës së Prizrenit.

**Neni 2**

Planet Rregulluese të Hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo rurale, si çështje e përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale Komunale.

**Neni 3**

Me miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm (PRRH) "Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit", sipas Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të zhvillimit ekonomik dhe harmonizimi i tyre me nevojat reale dhe me mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, si dhe rregullimin dhe ndërtimin e zonës për të cilën hartohet plani.

**Neni 4**

Plani Rregullues i Hollësishëm përmban pjesën tekstuale dhe hartografike.

**Neni 5**

Zona për të cilën është hartuar Plani Rregullues i Hollësishëm përfshin një sipërfaqe prej S= 80.445 ha, e cila është e përcaktuar si Zonë e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit, sipas Hartë Zonale të Komunës së Prizrenit.

**Neni 6**

Bartës i Hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm (PRRH) "Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit", sipas Hartë Zonale të Komunës së Prizrenit, është Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor në Komunën e Prizrenit.

**Neni 7**

Plani Rregullues i Hollësishëm mbulon një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

**Neni 8**

Plani Rregullues i Hollësishëm (PRRH) "Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit", sipas Hartë Zonale të Komunës së Prizrenit është në gjuhë zyrtare dhe së paku në 3 (tri) kopje të shtypura dhe të vulosura dhe 3 (tri) kopje digjitale të origjinalit.

**Neni 9**

Ky vendim, hynë në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në web-faqen e Komunës.

**KOMUNA E PRIZRENIT**
**Kuvendi i Komunës**
**Nr: ____________**
**Më: .02.2025**
**P r i z r e n**

***Pjesë e këtij vendimi është raporti i shqyrtimit publik i kërkuar sipas U/A MMPH nr.05/2014***

**Kryetari i Komunës**
**Shaqir Totaj**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

**Komuna e Prizrenit**
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor**
**Datë: 24.05.2024**

Bazuar në nenin 4, neni 11 dhe neni 20 të Ligjit për Planifikim Hapësinor 04/L-174, nenit 5, 6, 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat e pjesëmarrjes së publikut në planifikimin hapësinor, Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prizrenit Nr.001/011-33938, Dt.12.03.2024 për vënien në shqyrtim publik të Planit Rregulues te Hollesishem **ZONA E PARKUT PËR INDUSTRI TË LEHTE NË PRIZREN - PARKU I BIZNESIT**, Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor shpall:

# NJOFTIM PËR HAPJEN E SHQYRTIMIT PUBLIK

**Planit Rregulues te Hollesishem**

**ZONA E PARKUT PËR INDUSTRI TË LEHTE NË PRIZREN - PARKU I BIZNESIT**

Komuna e Prizrenit fton qytetarët, sektorin publik dhe privat, ekspertët, dhe të gjithë të interesuarit që të marrin pjesë në procesin e Shqyrtimit Publik të Projektit - **Planit Rregulues te Hollesishem "ZONA E PARKUT PËR INDUSTRI TË LEHTE NË PRIZREN - PARKU I BIZNESIT".**

Shqyrtimi publik **Planit Rregulues te Hollesishem - ZONA E PARKUT PËR INDUSTRI TË LEHTE NË PRIZREN - PARKU I BIZNESIT** do të zhvillohet nga data 03 qershor 2024 deri më 12 korrik 2024, çdo ditë pune nga ora 13:30 deri ne orën 15:30, në ndërtesën e Komunës së Prizrenit në Katin I-rë dhe në në ueb faqen zyrtare te Komunës së Prizrenit https://kk.rks-gov.net/prizren/.

Propozimet, komentet apo sugjerimet ne Projekt – Plani Rregullues i Hollesishem "ZONA E PARKUT PËR INDUSTRI TË LEHTE NË PRIZREN - PARKU I BIZNESIT", mund të paraqiten në formë të shkruar gjatë periudhës së shqyrtimit publik deri më 12 korrik 2024 dhe i adresohen Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërtesa e komunës, kati I-rë, ose në emailin zyrtar: pranverim.berisha@rks-gov.net, shpresa.osmanollaj@rks-gov.net.

Materiali në kopje fizike dhe sqarimet nga stafi do të zhvillohen në Ndërtesën e Komunës së Prizrenit, në katin e I-rë, ndërsa propozimet, komentet, sugjerimet dhe propozimet mund të shkruhen në librin e prezentuar në periudhën dhe orarin ditor të përcaktuar sipas këtij njoftimi.

Draft-dokumenti i **Planit Rregullues i Hollesishem "ZONA E PARKUT PËR INDUSTRI TË LEHTE NË PRIZREN - PARKU I BIZNESIT"** ka kaluar të gjitha fazat e paraparë me ligjet në fuqi deri në fazën e shqyrtimit publik dhe paraqet rezultatin e një pune të përbashkët të profesionistëve të fushave të ndryshme dhe përfaqësueseve nga sektorët relevantë të Komunës së Prizrenit.

Gjatë periudhës së shqyrtimit publik, do të organizohet takime me profesionistët, grupet e interesit, përfaqësuesit e institucioneve etj.

| Aktiviteti | Vendi | Data | Ora |
|---|---|---|---|
| Hapja e Shqyrtimit Publik | Shtëpia e Bardhe | 03.06.2024 | 10:00 |
| Takim ditor me qytetarët - Vendosja e Librit për kërkesat në hyrje të Komunës | Komunë - One Stop Shop | 03.06.2024-12.07.2024 | 13:30-15:30 |

P.s. Për çdo ndryshim të orës, do të bëjmë njoftimet plotësuese!

Qëllimi i organizimit të shqyrtimit publik, si pjesë e procesit të hartimit të Plani Rregullues i Hollesishem "ZONA E PARKUT PËR INDUSTRI TË LEHTE NË PRIZREN - PARKU I BIZNESIT", është që të pranohet dhe vlerësohen komentet të cilat shërbejnë për ngritjen e cilësisë së dokumentit, para dorëzimit të tij për miratimin përfundimtarë.
Draft-dokumenti i Plani Rregullues i Hollesishem "ZONA E PARKUT PËR INDUSTRI TË LEHTE NË PRIZREN - PARKU I BIZNESIT": https://kk.rks-gov.net/prizren/ si dhe është e publikuar në korridorin e Katit I-të në ndërtesën e Komunës.

Njoftimi për Shqyrtim Publik vendoset në mjetet të informimit dhe në Web –faqen e Komunës së Prizrenit.

Me nderime,

Drejtor i DUPH
Pranverim Berisha

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

**Komuna e Prizrenit**
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**Direktorijat za Urbanizam i Prostorno Planiranje**
**Dana: 24.05.2024**

Na osnovu člana 4, člana 11 i člana 20 Zakona o Prostornom Planiranju 04/L-174, članova 5, 6, 7 i 8 Administrativnog Uputstva MAPP br. 05/2014 o odgovornostima organa za prostorno planiranje kao i principi i procedure za učešće javnosti u prostornom planiranju, Odluka Skupštine opštine Prizren br. 001/011-33938, dana: 12.03.2024 za stavljanje na javnu raspravu Regulativni detaljni Plan - **ZONA PARKA ZA LAKU INDUSTIJU U PRIZRENU - POSLOVNI PARK,** Opština Prizren - Direktorijat za Urbanizam i Prostorno Planiranje objavljuje:

# OBAVEŠTENJE ZA OTVARANJE JAVNOG RAZMATRANJA

**Regulativnog detaljnog Plana**

**ZONA PARKA ZA LAKU INDUSTRIJU U PRIZRENU – POSLOVNI PARK**

Opština Prizren poziva građane, javni i privatni sektor, stručnjake i sve zainteresovane da učestvuju u procesu Javnog razmatranja Projekta – **Detaljnog regulacionog plana „ZONA PARKA LAKE INDUSTRIJE U PRIZRENU – POSLOVNI PARK“.**

Javno razmatranje **Regulativnog detaljnog Plana – ZONA PARK LAKE INDUSTRIJE U PRIZRENU – POSLOVNI PARK** održaće se od 03.06.2024. do 12.07.2024, svakog radnog dana od 13:30 do 15:30, u zgradi Opštine Prizren na 1. spratu i na zvaničnom sajtu Opštine Prizren https://kk.rks-gov.net/prizren/.

Prijedlozi, komentari ili sugestije u Projektu –Regulativni Detaljni Plan „ZONA PARKA ZA LAKU INDUSTRIJU U PRIZRENU – POSLOVNI PARK“, može se dostaviti u pisanoj formi tokom perioda javnog razmatranja do 12. jula 2024. godine i uputiti Direktorijatu za Urbanizam i Prostorno Planiranje, zgrada opštine, 1. sprat, ili na službenu e-mail: pranverim.berisha@rks-gov.net, shpresa.osmanollaj@rks-gov.net.

Materijal u fizičkoj kopiji i pojašnjenja od strane osoblja održavaće se u zgradi Opštine Prizren, na 1. spratu, dok se predlozi, komentari, sugestije i predlozi mogu upisivati u knjigu koja je predstavljena u periodu i dnevnom rasporedu odreženom prema ovom obaveštenju.

Nacrt dokumenta Detaljnog regulacionog plana „PARK ZA LAKU INDUSTRIJU U PRIZRENU – POSLOVNI PARK" prošao je sve faze predviđene važećim zakonima do faze javnog razmatranja i predstavlja rezultat zajedničkog rada stručnjaka različitih oblasti i predstavnici relevantnih sektora opštine Prizren.

Tokom perioda javne rasprave biće organizovani sastanci sa stručnjacima, interesnim grupama, predstavnicima institucija itd.

| **Aktivnosti** | **Mesto** | **Dana** | **Vreme** |
|---|---|---|---|
| Otvaranje javne rasprave | Shtëpia e Bardhe | 03.06.2024 | 10:00 |
| Svakodnevni sastanak sa građanima - Postavljanje knjige za zahtjeve na ulaz u Opštini | Opština - One Stop Shop | 03.06.2024-12.07.2024 | 13:30-15:30 |

P.s. Za bilo kakvu promjenu vremena, daćemo naknadno obaveštenje!

Cilj organizovanja javne rasprave, kao deo procesa izrade Detaljnog regulacionog plana „ZONA PARKA ZA LAKU INDUSTRIJU U PRIZRENU – POSLOVNI PARK", je da se prihvate i vrednuju komentari koji služe poboljšanju kvaliteta dokumenta, pre njegovog slanja na konačno odobrenje.
Nacrt dokumenta Detaljnog regulacionog plana „PARK ZA LAKU INDUSTRIJU U PRIZRENU – POSLOVNI PARK": https://kk.rks-gov.net/prizren/ je objavljen u hodniku 1. sprata u zgradi Opštine.

Obaveštenje o javnom razmatranju je postavljeno na informativnim sredstvima i na veb stranici opštine Prizren.

S poštovanjem,

Direktor DUPP
Pranverim Berisha

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

**Komuna e Prizrenit**
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor**
**Datë: 24.05.2024**

04/L-174 sayılı Alan Planlama Kanun'un 4.maddesi, 11.maddesi ve 20.maddesi, Alan planlalama yetkilileri sorumlulukları ve kamunun alan planlamaya katılımı ilkeleri ve işlemleri hakkında 05/2014 sayılı ÇAPB İdari Talimatın 5, 6, 7 ve 8.maddesi, **PRİZREN'DE HAFİFİ SANAYİ PARK BÖLGESİ – İŞLETME PARKIN** Ayrıntılı düzenleme planın kamu görüşmesine atılması için 001/011-33938 sayı 12.03.2024 tarihli Prizren Belediyesi Meclisin Kararı gereğince, Prizren Belediyesi-Şehirleşme ve Alan Planlama Müdürlüğü şu ilanı yapar:

**PRİZREN'DE HAFİFİ SANAYİ PARK BÖLGESİ – İŞLETME PARKIN** Ayrıntılı düzenleme planın vatandaşlarla kamu istişarenin düzenlenmesi için

# KAMU BİLDİRİSİ

Prizren Belediyesi vatandaşları, kamu ve özel sektörü, uzmanları ve tüm ilgili tarafları **PRİZREN'DE HAFİFİ SANAYİ PARK BÖLGESİ – İŞLETME PARKIN** Ayrıntılı düzenleme planın – Projenin Kamu görüşme sürecine katılmak üzere davet eder.

**PRİZREN'DE HAFİFİ SANAYİ PARK BÖLGESİ – İŞLETME PARKIN** Ayrıntılı düzenleme planı için Kamu Görüşme 3 Haziran 2024 gününden 12 Temmuz 2024 gününe dek her iş günü içerisinde saat13:30 ile 15:30 arası Prizren Belediyesi binasında I.katta ve Prizren Belediyesinin resmi internet sayfasında: https://kk.rks-gov.net/prizren/ yapılacaktır.

**PRİZREN'DE HAFİFİ SANAYİ PARK BÖLGESİ – İŞLETME PARKIN** Ayrıntılı düzenleme planı-projesi hakkında öneri, yorum veya tavsiyelerinizi 12 Temmuz 2024 tarihine dek kamu görüşme aşamasında yazılı olarak yapabilirsiniz veya Şehirleşme ve Alan Planlama Müdürlüğüne, belediye binası 1. kattan yapabilirsiniz veya resmi e-posta yoluyla iletebilirsiniz: pranverim.berisha@rks-gov.net, shpresa.osmanollaj@rks-gov.net.

Malzemenin fiziki kopyasını ve çalışanlar tarafından açıklamaları Prizren Belediyesi binasında I.katta yapılacaktır, öneri, yorum ve tavsiyeler işbu bildiri ile belirtilen dönem ve çalışma saatleri içerisinde sunulan kitaba yazılabilir.

**PRİZREN'DE HAFİFİ SANAYİ PARK BÖLGESİ – İŞLETME PARKIN** Ayrıntılı düzenleme planı belgesinin taslağı kamu görüşme aşamasına dek yürürlükteki kanunların öngürdüğü tüm aşamalardan geçti ve farklı alanlardan profesyonellerin ve Prizren Belediyesi'nin ilgili sektörlerinden temsilcilerin ortak çalışmasının sonucunu sunmaktadır.

Kamu görüşmesi döneminde profesyoneller, çıkar grupları, kurum temsilcileri vb. ile toplantılar düzenlenecektir.

| Etkinlik | Yer | Tarih | Saat |
|---|---|---|---|
| Kamu tartışmanın açılışı | Beyaz Ev | 03.06.2024 | 10:00 |
| Vatandaşlarla günlük toplantı - Belediye girişine talep kitabının konulması | Belediye - One Stop Shop | 03.06.2024-12.07.2024 | 13:30-15:30 |

P.s. Herhangi bir zaman değişikliğinde ek duyurular yapacağız!

"PRIZREN HAFİF SANAYİ İÇİN PARK ALANI - İŞ PARK" Ayrıntılı Düzenleyici Plan taslağının hazırlanması sürecinin bir parçası olarak belgeyi nihai onaya sunmadan önce, belgenin kalitesini artırmaya hizmet eden yorumları kabul etmek ve değerlendirmektir.

**PRİZREN'DE HAFİFİ SANAYİ PARK BÖLGESİ – İŞLETME PARKIN** Ayrıntılı düzenleme planı belgesinin taslağına devamdaki bağlantıdan ulaşabilirsiniz: https://kk.rks-gov.net/prizren/ aynı zamanda Belediye binası 1. Kat koridorunda da yayınlanmaktadır.
Kamu Görüşmesi Duyurusu bilgi araçlarında ve Prizren Belediyesi'nin web sitesinde yer almaktadır.

Saygılarımla,

ŞAPM Müdürü
Pranverim Berisha

Republika e Kosoves
Prizren (https://kk.rks-gov.net/prizren)

kerko ketu

ALB

A

A

# U mbajt konsultim publik për Projekt-Planin Rregullues i Hollësishëm-Parku i Biznesit

*2024/06/03 - 9:57*

Në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Prizrenit (Shtëpia e Bardh), u mbajt konsultim publik me qytetarë për Projekt-Planin Rregullues të Hollësishëm-Parku i Biznesit në qytetin e Prizrenit.

Hapjen e konsultimit është bërë nga Drejtori i Urbanizmit, Planifikimit Hapësinorë (DUPMH), Pranverim Berisha i cili ka thënë se këtë dokument e kemi hartuar me njohësit e kësaj fushe e drejtorisë dhe ekspertet e angazhuar si konsulent, me këtë dokumento do të u lehtësohet puna bizneseve të komunë, realisht ky është edhe qëllimi i këtij dokumenti.

Shpresa Osmanollaj, zyrtare në DUPMH, takime me biznese dhe me qytetarë kemi pasur në vazhdimësi dhe nga ato takime kemi marrë të dhëna e që më pas ato të dhëna janë futur në dokumentin final nga zyrtarët përgjegjës, mendoj që ky dokument është shumë i mirë për bizneset e komunës.





## ADRESA

Remzi Ademaj p.n
Prizren, 20000

## KONTAKTO

**Telefoni:** 0800 11 002 (pa pagesë për thirrjet brenda Kosovës)

**Zyre:**(0) 38 200 44-702

## VEGEZA

Zyrtar për Sinjalizues (https://kk.rks-gov.net/prizren/zyrtar-per-sinjalizues/)
Intraneti komunës (http://sik.rks-gov.net/sq/Account/Login)
Kërkesat elektronike (https://semek.rks-gov.net/)
Burimet njerëzorë (http://simbnj.rks-gov.net/)
e-Pasuria (https://epasuria.rks-gov.net/)

## FAQET

Fillimi (https://kk.rks-gov.net/prizren/)
Vendimet e Kryetarit (https://kk.rks-gov.net/prizren/staff/mytaher-haskuka/#vendimet_main)
Vendimet e Kuvendit - Rregulloret (https://kk.rks-gov.net/prizren/category/vendimetrregulloret/)
Asambleistët/këshilltarët (https://kk.rks-gov.net/prizren/asambleistet-keshilltaret/)

## RRJETET SOCIALE

e-Prokurimi (https://e-prokurimi.rks-gov.net)
Institucionet Qendrorë të Prokurimit (https://kk.rks-gov.net/prizren/e-prokurimi/institucionet-qendrore/)
Gazeta Zyrtare (https://gzk.rks-gov.net/)
Deklarimi i pasurisë (https://akk-ks.org/deklarimi_i_pasuris/2075/Komuna_e_Prizrenit/2075/?)
Portali i konkurseve për punësim (https://konkursi.rks-gov.net/)
Platforma e-Kosova (https://ekosova.rks-gov.net/)
Platforma e Konsultimeve Publike (https://konsultimet.rks-gov.net/)

Thirrja për Kuvend (https://kk.rks-gov.net/prizren/category/komitetet-e-kuvendit/thirrja-per-kuvend/)
Konkurset (https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konkurset-njoftimet/konkurset/)

**Planit Rregullues te Hollesishem**

**ZONA E PARKUT PËR INDUSTRI TË LEHTE NË PRIZREN - PARKU I BIZNESIT**

**Data 03.06.2024, ora 10:00**

| | Emri dhe Mbiemri | Kompania/Profesioni | Telefoni dhe email | Vendi | Nenshkrimi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | YIPRESA GJUANSORAJ | KK PRIZREN | 044 351 503 | PRIZREN | [signature] |
| 2 | [illegible] | KK PRIZREN | 045 821-555 | PRIZREN | [signature] |
| 3 | Pranverim Berisha | KK PRIZREN | 044-290-216 | PRIZREN | [signature] |
| 4 | DRIGON SHALA | KK PZ | 049-600-531 | PRIZREN | [signature] |
| 5 | Dragojin KABASHI | PROMAR PRC | 049 300409 | KOLIQ | [signature] |
| 6 | [illegible] | PECMAR PARC | 044/154-25? | PRIZREN | [signature] |
| 7 | VIKON GERMIZAJ | INSI | 044 515 382 | PRISHTINË | [signature] |
| 8 | ISMAJL BAFTIJARI | INSI | 04499[illegible] | —"— | [signature] |
| 9 | FADIL ELSHANI | KK PRIZREN | 044-706-346 | PRIZREN | [signature] |
| 10 | | | | | |
| 11 | | | | | |
| 12 | | | | | |
| 13 | | | | | |
| 14 | | | | | |
| 15 | | | | | |
| 16 | | | | | |
| 17 | | | | | |
| 18 | | | | | |
| 19 | | | | | |
| 20 | | | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**Data: 04.06.2024**

**NR: 04-353-zyrtar**

**Procesverbali nga mbajtja e Shqyrtimi Publik me qytetarë për Projekt-Planit Rregullues i Hollësishëm-Parku i Biznesit**

Shqyrtimi publik me qytetarë është organizuar nga grupi punues për hartimin e Projekt-Planit Rregullues i Hollësishëm-Parku i Biznesit.

Njoftimet për qytetarë për organizimin e shqyrtimit publik janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Publikimet:**

Publikimet janë bërë me **24.05.2024** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/05/Njoftimi-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-Projekt-Planit-Rregullues-i-Hollesishem-Parku-i-Biznesit-1.pdf

Në facebook:

https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=pfbid02iGibBgEMtt9Afs2k3A89MGWTHZywhiJ4qfs3RZKmkSbPxo2UKheYKxEgxdM5j1Lol&id=100064489910139&mibextid=RtaFA8

Në platformë:

https://konsultimet.rks-gov.net/consultationsList.php?OpenPage=30&ClosedPage=0

Njoftimi si lajm në webfaqe:

https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/05/Njoftimi-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-Projekt-Planit-Rregullues-i-Hollesishem-Parku-i-Biznesit-1.pdf

Shqyrtimi është mbajtur në sallën e kuvendit komunal (Shtëpia e Bardh) dhe ka filluar në orën 10:15

Hapjen e shqyrtimi është bërë nga Drejtori i Urbanizmit, Planifikimit Hapësinorë (DUPMH), **Pranverim Berisha** i cili ka thënë se këtë dokument e kemi hartuar me njohësit e kësaj fushe e drejtorisë dhe ekspertet e angazhuar si konsulent, me këtë dokumento do të u lehtësohet puna bizneseve të komunë, realisht ky është edhe qëllimi i këtij dokumenti.

Ne jemi këtu që ti marrim edhe komentet, sugjerimet apo edhe vërejtjet eventuale që ju i keni për dokumentin dhe ato më pastaj të hynë në dokumentin final para se dokumenti të miratohet në kuvend nga anëtarët e kuvendit.

**Shpresa Osmanollaj**, zyrtare në DUPMH, takime me biznese dhe me qytetarë kemi pasur në vazhdimësi dhe nga ato takime kemi marrë të dhëna e që më pas ato të dhëna janë futur në dokumentin final nga zyrtarët përgjegjës, mendoj që ky dokument është shumë i mirë për bizneset e komunës. Te gjithë të interesuarit kanë kohë prej 30 ditësh që kërkesat e me shkrim ti drejtohen ne hapësirat ku është i shpalosur pjesa grafike dhe tekstuale e planit, apo edhe në mënyre zyrtare ne sportelin e drejtorisë se urbanizimit.

Qytetarët që ishin të pranishëm në hapjen e shqyrtimit i falënderuan zyrtarët komunal për hartimin e dokumentit duke thënë se një dokument të tillë do tu shërbej për të mirën e gjithë bizneseve që veprojnë në komunën e Prizrenit. Me këtë dokument ne do të kemi mundësi që të bëjmë biznesin ashtu siç edhe ne kemi nevojë.

**Shqyrtimi ka përfunduar në orën 10:45.**

**Me 03.06.2024**, është mbajtur shqyrtimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e shqyrtimit:

Në webfaqe:

https://kk.rks-gov.net/prizren/news/u-mbajt-konsultim-publik-per-projekt-planin-rregullues-i-hollesishem-parku-i-biznesit/

Procesmbajtës/e:

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

**Komuna e Prizrenit**
Opština Prizren - Prizren Belediyesi

**Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor**
**Nr: *04-353-zyrtar***
**Data:16.07.2024**
Prizren

Drejtori i Drejtoris për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor Komuna e Prizrenit, duke vepruar në në baz të deyres zyrtare e konform dispozitave të 17 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174 e lidhur me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.05/2014 bie këtë:

**AKTVENDIM**

I. **FORMOHET** komisioni profesional për shqyrtimin e kërkesave, vërejtjeve, sugjerimeve dhe ankesave të parashtruara gjatë fazës së Shqyrtimit Publik të Planit Rregullues të Hollësishëm-„Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren–Parku i Biznesit„ sipas Hartës Zonale sipas Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit i cili komision do të ketë këtë përbërje:

**1.-Shpresa Osmanollaj-Krapi- ing.dipl.ark- Menaxhere e projektit**
**2.-Afërdita Mormorina, ing.dipl.ark**
**3.-Haziz Krasniqi –Zyrtar**

**Arsyetim**

Komisioni profesional për Shqyrtimin e kërkesave, vërejtjeve, sugjerimeve dhe ankesave të parashtruara gjatë fazës së Shqyrtimit Publik të Planit Rregullues të Hollësishëm-„Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren–Parku i Biznesit„ sipas Hartës Zonale sipas Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit gjatë shqyrtimit të kërkesave, vërejtjeve, sugjerimeve ankesave ka vepruar në përputhje të plotë me Udhëzimit Administrativ Nr.05/2014 i cili i rregullon procedurat për pjesëmarrjen e publikut në Planifikimin Hapësinor

Komisioni në fjalë për gjdo periudhë-etapa të punës së të gjitha fazave do të raportojë te Drejtoi i DUPH-së lidhur me propozimet dhe përgjigjet e dhëna për palët në procedurë e dokumentacionit në fjalë

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**UDHËZIME JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marjes së këtij aktvendimi Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – Prishtinë.

Ankesa taksohet me 0,50 Euro – taksa administrative.

**DREJTORI**
**Pranverim Berisha Jur i dipl**

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Data:18.07.2024

NRP: 04-353-zyrtar

# Raporti (me komente) për ecurinë e shqyrtimit dhe hartimit të Projekt-Planit Rregullues i Hollësishëm-Parku i Biznesit 2024-2032

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH/05-2014, neni 12, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit publikon Raportin e Shqyrtimit Publik të Planit Rregullues të Hollësishëm Zona e veçantë "Parku i Biznesit" – Prizren.

Plani Rregullues i Hollësishëm ka qenë në shqyrtim publik nga data 03.06.2024 deri më 12.07.2024

Gjatë kësaj periudhe vërejtje, propozime, sugjerime dhe kërkesa me shkrim në fletoren zyrtare i kanë adresuar gjithsej 9 qytetarë.

Autoriteti përgjegjës i Planifikimit Hapësinor në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me të gjithë sektorët e tjerë i është përgjigjur secilës kërkesë dhe përgjigjet do ti gjeni në formë tabelare më poshtë me të gjitha të dhënat.

Ne i falënderojmë të gjithë qytetarët, MMPH, shoqërinë civile, mediat, institucionet, bizneset për vërejtjet dhe ndihmën e tyre në hartimin e versionit final të Planit Rregullues te Hollësishëm Zona e veçantë "Parku i Biznesit" - Prizren për periudhën 2024-2032.

Autoriteti përgjegjës për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor (Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit) dhe përfaqësuesit e sektorëve (Drejtorive) të tjerë të Komunës.

**Publikimet:**

Publikimet janë bërë me **24.05.2024** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/05/Njoftimi-per-organizimin-e- konsultimit-publik-per-Projekt-Planit-Rregullues-i-Hollesishem-Parku-i-Biznesit-1.pdf

Në facebook:

https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=pfbid02iGibBgEMtt9Afs2k3A89MGWTHZywhiJ4qfs3RZKmkSbPxo2UKhcYKxEgxdM5j1Lol&id=100064489910139&mibextid=RtaFA8

Në platformë:

https://konsultimet.rks-gov.net/consultationsList.php?OpenPage=30&ClosedPage=0

Njoftimi si lajm në webfaqe:

https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/05/Njoftimi-per-organizimin-e- konsultimit-publik-per-Projekt-Planit-Rregullues-i-Hollesishem-Parku-i-Biznesit-1.pdf

**Me 24.05.2024,** njoftimi dhe plani përmes **emailit** u është dërguar: Qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata, drejtor të shkollave fillore dhe të mesme, bizneseve, organizatave studentore, ekspertëve të fushave të ndryshme, mediat lokale, shoqata të ndryshme, organizata rinore si dhe anëtarëve të Kuvendit Komunal.

**Me 03.06.2024,** është mbajtur shqyrtimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e shqyrtimit publik:

Në webfaqe:
https://kk.rks-gov.net/prizren/news/u-mbajt-konsultim-publik-me-qytetare-per-projekt-strategjine-komunale-dhe-planit-te-veprimit-per-personat-me-aftesi-te-kufizuara-2024-2027/

Projekt-Planit Rregullues i Hollësishëm-Parku i Biznesit (në tri gjuhë) u është dërguar përmes emailit, qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata të ndryshme, drejtor të shkollave, bizneseve, organizatat studentore, ekspert të fushave, mediat lokale, shoqatave të ndryshme si dhe organizata rinore, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

**04.06.2024**, është publikuar procesverbali për mbajtjen e shqyrtimit publik, procesverbali është i publikuar në këtë vegëz:

https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/11/Procesverbali-per-Projekt-Planin-Rregullues-te-Hollesishem-Parku-i-Biznesit-PDF-SCAN.pdf

Dokumenti ka qenë në shqyrtim publik në uebfaqen zyrtare të komunës dhe platformën e konsultime publike, nga data **03.06.2024** deri me **12.07.2024**, gjatë kësaj periudhe janë pranuar komentet, sugjerimet apo edhe vërejtjet eventuale për dokumentin.

**Tabelori me të dhëna të shkurtra:**

| Metodat e shqyrtimit | Data / Kohëzgjatja | Numri i pjesëmarrësve | Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime | Numri i kërkesave të pranuara |
|---|---|---|---|---|
| 1-Takime i drejtpërdrejtë me qytetarë për Projekt-Planit Rregullues i Hollësishëm-Parku i Biznesit | 03.06.2024<br>Nga-10:15<br>Deri-12:00 | F M T<br>20 15 35 | 9 | 0-Pjesërisht<br>5-Refuzohen<br>4-Pranuara<br>0-Adresuar |

| Nr | Kërkesat /Sugjerimet / Komentet | Kush ka dhënë kërkesë/ sugjerim | Statusi i kërkesës<br>Pranuar:<br>Refuzuar:<br>Pranuar Pjesërisht:<br>Adresuar: | Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Kërkesë për ndarje të Parcelës Industriale në bazë të propozimit të Shoqatës si dhe madhësia e parcelave të jetë nga 30 ari deri në 1 hektar dhe shfrytëzueshmëri të tokës deri në 80% me mundësi zgjerimi | Shoqata e Zejtarëve dhe Afaristëve të Prizrenit - SHZAP | Refuzohet | Parcelat ndahen në bazë të kushteve të caktuara me HZK të komunës së Prizrenit, sipas nevojave bizneset mund të aplikojnë në mënyrë të kombinuara (merr 2 – 3 apo më shumë parcela me marrëveshje). |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 2 | Kërkesë për ndarje të parcelave në zonën e re industriale, Lubizhdë.Për zgjerimin e aktivitetit duke ndërtuar poligonet për të gjitha kategoritë e patent-shoferit. | Geni SH.P.K | Refuzohet | Pas miratimit të Planit do të krijohet një komision i veqantë për ndarje të parcelave. |
| 3 | Kërkesë për ndarje Parcel Industriale në Parkun e Biznesit (20-30 ari) për implementimin e projektit për prodhimin e mobilerisë dhe inventarizime dekorative të punuara me dru. | DUNNAGE BAG INTERNATIONAL SH.P.K. | Refuzohet | Pas miratimit të Planit do të krijohet një komision i veqant për ndarje të parcelave. |
| 4 | Kërkesë për Zonën Ekonomike,Lubizhdë /Kërkesë për përshpejtim të PRrH-së. | ProMetal SH.P.K | Pranohet | Si projekt është në procedurë të cilin edhe ne si komunë po mundohemi me e përshpejtu në mënyre që të jetë sa më parë i miratuar dhe të jetë në shërbim të bizneseve. |
| 5 | Kërkesë për ndarje Parcel Industriale si dhe madhësia e parcelave të jetë nga 30 ari deri në 1 hektar dhe shfrytëzueshmëri deri në 80%. | Proton Cable L.L.C | Refuzohet | Pas miratimit të Planit do të krijohet një komision i veqantë për ndarje të parcelave gjithashtu Parcelat ndahen në bazë të kushteve të caktuara me HZK të komunës së Prizrenit, sipas nevojave bizneset mund të aplikojnë në mënyrë të kombinuara (merr 2 – 3 apo më shumë parcela me marrëveshje). |
| 6 | Kërkesë për ndarje parcele në zonën industriale, Lubizhdë. | Fatmir Telaku B.I | Refuzohet | Pas miratimit të Planit do të krijohet një komision i veçantë për ndarje të parcelave. |
| 7 | Kërkojmë që në zonën A13 të shtohet edhe prodhim dhe industri | Hysni Hoti | Pranohet | Gjatë shqyrtimit të kërkesës kemi parë që është e mundur të shtohet edhe ky destinim andaj edhe kemi vendosur që të bëhet si e tillë. |
| 8 | Kërkesë për respektim të marrëveshjes me ish kryetarin | Dukagjin Kabashi | Pranohet | Ngastra ne fjale mbeten ne vendin e vet apo sipas marrëveshjes me riparcializim vendoset ne zonen e hyrjes |
| 9 | Kërkesa për ndryshim të pronësisë. | Valdet Hoxha | Pranohet | Pas verifikimit të Pronësisë si dhe Certifikatës së pronësisë të dorëzuar si dëshmi kjo vendoset te ndryshohet ashtu siç është. |

**Shkurtesat:**

F-Femra

M-Meshkuj

T-Totali

**Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:**

1. **Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Projekt-Planit Rregullues i Hollësishëm-Parku i Biznesit,**
2. **Njoftimin për mbajtjen e shqyrtimit publik.**

Raporti është përgatitur nga :

| Tabela e të dhënave për kërkesa | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Shoqara e Zejtareve te Afaristeve te Prizrenit-SHZAP | Këkesa | Refuzim |
| 2 | Geni SHPK | Këkesa | Refuzim |
| 3 | DUNNAGE BAG INTERNATIONAL SHPK | Këkesa | Refuzim |
| 4 | Prometal SHPK | Sygjerim | Pranohet |
| 5 | Proton Cable L.L.C. | Këkesa | Refuzohet |
| 6 | Fatmir Telaku | Këkesa | Refuzohet |
| 7 | Hysni Hoti | Sygjerim | Pranohet |
| 8 | Dukagjin Kabashi | Këkesa | Pranohet |
| 9 | Valdet Hoxha | Këkesa | Pranohet |

Menaxhere e Projektit:

Shpresa Osmanollaj Krapi

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIK OF KOSOVO

KUVENDI KOMUNAL PRIZREN
OPSTINA PRIZREN-PRIZREN BELEDIYESI
MUNICIPALITY OF PRIZREN

# NJOFTIM PËR TAKIM ME BIZNESET



Ne kuader te Hartimit te Planit Rregullues te Hollesishem **"Parku i Biznesit"** Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapsinor **organizon takim publik per informimin ebizneseve** meth Zones Ekonomike.

Takimi **me** bizneset mbahet ne Zonen Ekonomike **duke** filluar me daten 11.07.2024 ne **ora 10:30h**

DREJTORI:

Pranverim Benshajur

FB_IMG_173[illegible].jpg



https://mail.google.com/mail/u/0/#inbox/[illegible]




WARRIOR
39









Download Full screen

Hide email



# Foto, nje dite para mbylljes se Shqyrtimit Publik me perfaqesues te bizneseve dhe qytetar

Rrustem Baftijari <rrustembaftijari6@gmail.com>
Thu 12/12/2024, 11:19 AM
Shpresa Osmanollaj







3 attachments (1 MB) Download all

Caution! This message was sent from outside your organization.

Allow sender | Block sender

...

Rrustem 1 of 2

Download Full screen × Hide email



# Foto, nje dite para mbylljes se Shqyrtimit Publik me perfaqesues te bizneseve dhe qytetar

Rrustem Baftijari <rrustembaftijari6@gmail.com>
Thu 12/12/2024, 11:19 AM
Shpresa Osmanollaj







3 attachments (1 MB) Download all

Caution! This message was sent from outside your organization.

Allow sender | Block sender

...

Rrustem 1 of 2

Download Full screen × Hide email



# Foto, nje dite para mbylljes se Shqyrtimit Publik me perfaqesues te bizneseve dhe qytetar

Rrustem Baftijari <rrustembaftijari6@gmail.com>
Thu 12/12/2024 11:19 AM
Shpresa Osmanollaj





3 attachments (1 MB) Download all

Caution! This message was sent from outside your organization. Allow sender | Block sender

...

Rrustem 1 of 2



Kuvendi i Komunës
Nr. 001/011 -
Më: ….. 2025

Në bazë të nenit 12 paragrafit 2 pika d), dhe nenit 40, paragrafi 1 dhe 2, pika d), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 25, paragrafi 1, pika d, dhe nenit 27 paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më .......... 2025, miratoi këtë:

PROPOZIM – VENDIM
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS
PËR VITIN 2025

**Neni 1**

Miratohet Plani i Punës i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, për vitin 2025. Me këtë Plan të Punës përcaktohen: objektivat e Kuvendit të Komunës, kalendari i takimeve dhe aktiviteteve dhe aktet që propozohen të shqyrtohen, diskutohen dhe miratohen gjatë vitit 2025 (agjenda legjislative).

**Neni 2**

Përpos muajve të paraparë me këtë Plan të Punës, Kuvendi i Komunës, mund të mbajë mbledhje të tjera, nëse për një gjë të tillë paraqitet nevoja, sipas procedurave të parapara me legjislacionin në fuqi.

**Neni 3**

Aktet komunale dhe propozimet të cilat planifikohen të shqyrtohen, diskutohen dhe miratohen në mbledhjet e Kuvendit të Komunës në vitin 2025, janë dhënë në Shtojcën “Agjenda legjislative e Kuvendit të Komunës”.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës, drejtorët e Drejtorive Komunale, dhe të gjitha subjektet që janë të përfshira me këtë Plan.

**Neni 5**

Ky vendim, hynë në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në web-faqen e Komunës.

**Kryesuesja e Kuvendit**
**Antigona Bytyqi**

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

# DRAFT PLANI I PUNËS
# I KUVENDIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2025

**2025**

## Tabela e përmbajtjes

1. Vendimi për miratimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës 2025 ................**Error! Bookmark not defined.**
2. Qëllimet dhe pikësynimet e Kuvendit të Komunës së Prizrenit........................................ 3
2.1 Hyrje........................................................................................................................ 3
2.2 Struktura dhe përbërja e Kuvendit të komunës së Prizrenit.............................................. 3
2.3 Qëllimet dhe pikësynimet e Kuvendit të Komunës së Prizrenit....................................... 5
2.4 Përfundim ................................................................................................................ 6
3. Agjenda legjislative dhe kalendari i takimeve dhe aktiviteteve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit ........................................................................................................................ 7

## 2. Qëllimet dhe pikësynimet e Kuvendit të Komunës së Prizrenit

### 2.1 Hyrje

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë i cili zgjidhet drejtpërdrejti nga qytetarët dhe funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore.

Kuvendi i Komunës ka përgjegjësi ekskluzive për çështjet vijuese (Neni 40.2, LVL):

- Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas statutit apo Rregullores së punës;
- Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- Themelimin e komisioneve të kërkuara sipas Ligjit;
- Nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
- Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- Emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
- Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe
- Përgjegjësive të tjera që kërkohen me ligj.

Për marrjen e vendimeve në çështje të caktuara, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komiteteve të përhershme të Kuvendit të Komunës, apo Kryetarit të Komunës (40.3).

### 2.2 Struktura dhe përbërja e Kuvendit të komunës së Prizrenit

Legjislatura aktuale e Kuvendit të Komunës së Prizrenit është zgjedhur nga zgjedhjet lokale të tetorit të vitit 2021. Përbërja aktuale e Kuvendit të Komunës së Prizrenit sipas certifikimit të rezultateve nga KQZ-ja, është si në vijim:




**Grafiku 1: Përbërja e Kuvendit të komunës së Prizrenit**

Struktura e Kuvendit të komunës dhe organeve të tij përcaktohet me Ligjin për vetëqeverisje lokale, sipas skemës vijuese:




**Grafiku 2: Struktura e Kuvendit të komunës Prizren**

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Prizrenit është dokument i mbështetur në Ligjin për Vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe aktet tjera nënligjore, por edhe Planin komunal për zhvillim (PKZH), në mënyrë që të arritet sinergji e qëllimeve dhe e veprimit.

Për t'i përmbushur detyrimet ligjore dhe për të ushtruar përgjegjësitë e përcaktuara me ligj në dobi të qytetarëve të Prizrenit, Plani vjetor i Kuvendit të komunës synon të ngërthejë dhe të parasheh aspektet e shumta të funksionimit të tij. Prandaj, plani përbëhet nga tre pjesë, të cilat së bashku janë pjesë përbërëse e Planit vjetor të punës:

1. Vendimi per miratimin e planit të punës, nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit
2. Ky dokument narrativ, ku jepet sfondi dhe baza ligjore e punës së Kuvendit të komunës, qëllimet dhe pikësynimet për vitin përkatës
3. Agjenda legjislative e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, e dhënë në formë tabelare, krahas Kalendarit të takimeve dhe aktiviteteve

### 2.3 Qëllimet dhe pikësynimet e Kuvendit të Komunës së Prizrenit

Pas seancës së konsultimeve ku janë përfshirë të gjitha partitë politike të përfaqësuara në kuvendin e Komunës së Prizrenit, janë dakorduar qëllimet dhe pikësynimet vijuese për vitin 2025.

**Qëllimi 1: Përmirësimi i efektivitetit të punës së Kuvendit të Komunës të Prizrenit**

Për t'i kontribuar këtij qëllimi, anëtarët e kuvendit të komunës kanë përcaktuar pikësynimet vijuese:

1. Hartimi sa më cilësor i materialit të propozuar për shqyrtim dhe miratim nga kuvendi i komunës. Kudo që është e mundur, dhe posaçërisht në pikat ku shqyrtohen pronat publike apo private, të përdoren mjete ndihmëse të konkretizimit dhe ilustrimit (projektorët, skicat, hartat, etj.)
2. Shpërndarja e materialit të përgatitur me kohë, sipas dispozitave përkatëse ligjore.
3. Mbajtja e konsultimeve më të afërta ndërmjet të gjithë akterëve për përcaktimin e pikave relevante për takimet e kuvendit të komunës
4. Të kërkohet sigurimi i përkthimit cilësor për mbledhjet e kuvendit të komunës nga drejtoritë dhe shërbimet përkatëse të komunës. Gjithashtu, Kuvendi i komunës do të shqyrtojë mundësinë e përkthimit të të gjitha dokumenteve zyrtare të cilat përdoren apo lëshohen nga komuna, si dhe të përmbajtjes së ueb faqes në të gjitha gjuhët në përdorim zyrtar në komunë. Për këtë qëllim, do të bëhen përpjekje për të siguruar resurset e nevojshme.

**Qëllimi 2: Përmirësimi i transparencës së punës së Kuvendit të komunës të Prizrenit**

Kuvendi i komunës i Prizrenit synon të arrijë një nivel sa më të madh të transparencës së punës së vet, qoftë në raportin ndërmjet partive të ndryshme politike, por në veçanti në raport me qytetarët e komunës së Prizrenit.

Kuvendi i komunës synon ta arrijë këtë qëllim përmes pikësynimeve vijuese:

1. Publikon shpalljet dhe njoftimet, përmes formave të ndryshme (elektronike dhe fizike), si dhe mediave të ndryshme (ueb faqja, rrjetet sociale, portalet elektronike, mediat, etj.) lidhur me datat e mbajtjes së takimeve. Kudo që është e mundur, do të komunikohen edhe pikat e parapara të rendit të ditës, ndërsa vendimet dhe procesverbalet e takimeve publikohen në ueb faqen e komunës për qasje nga të gjithë të interesuarit.
2. Transmetimi i drejtpërdrejtë i takimeve të kuvendit të komunës, përmes rrjeteve lokale të televizionit apo rrjeteve sociale, nëse lejojnë kushtet teknike.
3. Përmes shqyrtimit adekuat, sigurohet që të gjitha informatat dhe dokumente relevante, që propozohen nga kryetari, të miratohet në formën e cila është më e përshtatshme për t'u kuptuar nga qytetarët.
4. Kuvendi i komunës vendos dhe mirëmban dialog dhe bashkëveprim të rregullt me organizatat e shoqërisë civile. Për këtë qëllim, do të shqyrtohet mundësia e vendosjes së një mekanizmi më të rregullt të konsultimeve (takimet periodike, forumet e përbashkëta, etj.)

**Qëllimi 3: Ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të anëtarëve të Kuvendit të Komunës**

Për të përmbushur detyrën e vetë në shërbim të interesit publik të qytetarëve dhe arsyetuar besimin e dhënë nga votuesit, anëtarët e kuvendit të komunës zotohen të angazhohen për ngritje të vazhdueshme të kapaciteteve dhe njohurive të tyre në mënyrë që sa më mirë ta realizojnë këtë detyrë publike.

Prandaj, anëtarët e kuvendit të komunës synojnë t'i ngrisin kapacitetet dhe njohuritë e tyre përmes pikësynimeve vijuese:

1. Trajnimeve për tema relevante, të cilat ofrohen nga partnerët dhe bashkëpunëtorët e kuvendit të komunës (DEMOS, USAID, BE, GiZ, OSBE, KDI, Ec ma Ndryshe, etj.)
2. Vizitat studimore kuvendeve të tjera komunale por edhe kuvendeve tjera simotra jashtë Republikës së Kosovës, për të shkëmbyer përvoja dhe mësuar mbi praktikat më të mira të punës.
3. Hartimit të raporteve, udhëzuesve dhe dokumenteve të tjera të cilat mundësojnë ruajtjen e kujtesës institucionale, në mënyrë që përvoja dhe dija e arritur ndër vite të mos pakësohet për shkak të ndryshimeve në përbërje të kuvendit si rezultat i zgjedhjeve.

## 2.4 Përfundim

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës, do të ndihmojë dhe lehtësojë punimet e mbledhjeve të Kuvendit, duke iu ofruar anëtarëve të Kuvendit këtë plan, ata do të kenë një pasqyrë për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2025 e që kanë të bëjnë me interesat e qytetarëve. Gjithashtu, përcaktimi i qëllimeve dhe pikësynimeve ofron një referencë të qartë të matjes së përparimit në punë dhe ofron mundësinë e veprimeve korrigjuese, sipas nevojës.

Për shkak të zgjedhjeve lokale që parashihet të mbahen gjatë vitit 2025, plani parasheh gjatë këtij viti mbajtjen e **07** seancave të rregullta, por mund të mbahen edhe seanca tjera përfshirë edhe seanca të jashtëzakonshme, siç parashihet me LVL dhe Statutin e Komunës.

Kalendari i takimeve dhe aktiviteteve të Kuvendit të Komunës (bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e planit) përcakton orarin tentativ të mbledhjeve të Kuvendit dhe të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi i Kuvendit mund të mbajë takime periodike me shefat e grupeve parlamentare të Kuvendit, për të bashkërenditur punën e komiteteve obligative dhe funksionale dhe punën e Kuvendit të Komunës.

Për realizimin e këtij Plani të punës, Kuvendi i Komunës mbështetet në shërbimin e tij profesional, por edhe në mbështetjen profesionale dhe administrative të departamenteve dhe organeve të komunës, në ndjekje të qëllimit të përbashkët në shërbim të qytetarëve.

Përveç çështjeve dhe veprimeve të rregullta të Kuvendit të Komunës, Kuvendi i Komunës mund të përfshijë në program të vet edhe shqyrtimin e çështjeve të tjera, në kuadër të detyrave dhe kompetencave të veta. Këto çështje përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

- Miratimin e iniciativave për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkombëtar.
- Propozime për debate dhe propozime përmbajtjesore,
- Propozime për raportime dhe informata,
- Peticione,
- Pyetje të anëtarëve të Kuvendit.
- Takime dhe konsultime publike **Shtojcat**: *Agjenda legjislative e Kuvendit të komunës Prizren*

**Agjenda legjislative dhe kalendari i takimeve dhe aktiviteteve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit**

**PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2025**
**SHKURT 2025**

| Nr | Aktet e propozuara për shqyrtim dhe miratim | PROPOZUESI | Muaji | Konsultimi/dëgjimi | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Po | Jo |
| 1. | Shqyrtimi i propozim - vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal; | Kryetari i Komunës – Drejtoritë Komunale | Shkurt 2025 | ☐ | ☐ |
| 2. | | | Shkurt 2025 | ☐ | ☐ |
| 3. | Raporti financiar tetor – dhjetor 2024 | Kryetari i Komunës – Drejtoria për Ekonomi dhe Financa | Shkurt 2025 | ☐ | ☐ |
| 4. | Raporti vjetor i Komitetit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale 2024 | Kryesuesi i Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale | Shkurt 2025 | ☐ | ☐ |
| 5. | Raporti i Komisionit për emërtimin e rrugëve, Shesheve dhe lagjeve në Komunën e Prizrenit | Kryesuesi i Komisionit për emërtimin e rrugëve, Shesheve dhe lagjeve në Komunën e Prizrenit | Shkurt 2025 | ☐ | ☐ |
| 6. | | | | ☐ | ☐ |

**PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2025**
**MARS 2025**

| Nr | Aktet e propozuara për shqyrtim dhe miratim | PROPOZUESI | Muaji | Konsultimi/dëgjimi | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Po | Jo |
| 1. | Shqyrtimi i propozim - vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal; | Kryetari i Komunës – Drejtoritë Komunale | Mars 2025 | ☐ | ☐ |
| 2. | Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për plotësim-ndryshimin e Rregullores për dhënie në shfrytëzim të objekteve kulturore dhe sportive | Kryetari i Komunës – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport | Mars 2025 | ☐ | ☐ |
| 3. | Kryetari i Komunës – Planit të veprimit për transparencë komunale 2025-2028 | Kryetari i Komunës – Njësia për komunikim me publikun | Mars 2025 | ☐ | ☐ |
| 4. | Raporti vjetor financiar janar – dhjetor 2024 | Drejtoria për ekonomi dhe financa | Mars 2025 | ☐ | ☐ |
| 5. | Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për buxhetimin me pjesëmarrje | Kryetari i Komunës – Drejtoria për Ekonomi dhe Financa | Mars 2025 | ☐ | ☐ |
| 6. | Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë për siguri në institucionet edukativo-arsimore | Kryetari i Komunës – Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës | Mars 2025 | ☐ | ☐ |
| 7. | Shqyrtimi dhe miratimi i komisionit pëtzgjedhës për drejtorë dhe zv.drejtorë të shkollave | Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës | Mars 2025 | ☐ | ☐ |
| 8. | Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë për siguri në institucionet edukativo-arsimore | Kryetari i Komunës – Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës | Mars 2025 | ☐ | ☐ |
| 9. | Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për përcaktimin e përqindjes së fermerëve në projektet me bashkëfinancim | Drejtoria për bujqësi, dhe Zhvillim Rural | Mars 2025 | ☐ | ☐ |
| 10. | Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për transparencë komunale | Kryetari i Komunës – Njësia për komunikim me publikun | Mars 2025 | ☐ | ☐ |

**PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2025**
**PRILL 2025**

| Nr | Aktet e propozuara për shqyrtim dhe miratim | PROPOZUESI | Muaji | Konsultimi/dëgjimi | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Po | Jo |
| 1. | Shqyrtimi i propozim - vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal; | Kryetari i Komunës – Drejtoritë Komunale | Prill 2025 | ☐ | ☐ |
| 2. | Raporti financiar janar – mars 2025 | Kryetari i Komunës – Drejtoria për Ekonomi dhe Financa | Prill 2025 | ☐ | ☐ |
| 3. | Vizitë studimore jashtë vendit e Kuvendit të Komunës | Kuvendi i Komunës | Prill 2025 | ☐ | ☐ |
| 4. | | | | ☐ | ☐ |
| 5. | | | | ☐ | ☐ |
| 6. | | | | ☐ | ☐ |
| 7. | | | | ☐ | ☐ |
| 8. | | | | ☐ | ☐ |
| 9. | | | | ☐ | ☐ |
| 10. | | | | ☐ | ☐ |

**PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 202**
**MAJ 2025**

| Nr | Aktet e propozuara për shqyrtim dhe miratim | PROPOZUESI | Muaji | Konsultimi/dëgjimi | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Po | Jo |
| 1. | Shqyrtimi i propozim - vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal; | Kryetari i Komunës – Drejtoritë Komunale | Maj 2025 | ☐ | ☐ |
| 2. | Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për varrezat e reja në Landovicë | Kryetari i Komunës – Drejtoria për Shërbime Publike | Maj 2025 | ☐ | ☐ |
| 3. | Raporti i Performancës Komunale per vitin 2024 | Kryetari i Komunës – Njësia për komunikim me publikun | Maj 2025 | ☐ | ☐ |
| 4. | Shqyrtimi dhe miratimi i planit të veprimit për Ekipet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e obliguar | Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës | Maj 2025 | ☐ | ☐ |
| 5. | | | | ☐ | ☐ |
| 6. | | | | ☐ | ☐ |
| 7. | | | | ☐ | ☐ |
| 8. | | | | ☐ | ☐ |
| 9. | | | | ☐ | ☐ |
| 10. | | | | ☐ | ☐ |

**PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2025**
**QERSHOR 2025**

| Nr | Aktet e propozuara për shqyrtim dhe miratim | PROPOZUESI | Muaji | Konsultimi / dëgjimi | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Po | Jo |
| 1. | Shqyrtimi i propozim - vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal; | Kryetari i Komunës – Drejtoritë Komunale | Qershor 2025 | ☐ | ☐ |
| 2. | Shqyrtimi dhe miratimi i Plotësim-ndryshimit të Rregullores për organizimin e transportit publik në komunën e Prizrenit | Kryetari i Komunës – Drejtoria për Shërbime Publike | Qershor 2025 | ☐ | ☐ |
| 3. | Informatë rreth furnizimit me ujë të pijes në komunën e Prizrenit | Hidroregjioni Jugor (përmes Drejtorisë për Shërbime Publike) | Qershor 2025 | ☐ | ☐ |
| 4. | Raport lidhur me furnizimin me energji elektrike | KEDS (përmes Drejtorisë për Shërbime Publike) | Qershor 2025 | ☐ | ☐ |
| 5. | Raporti i Zyrës për barazi gjinore | Zyra për barazi gjinore | Qershor 2025 | ☐ | ☐ |
| 6. | Raporti i Zyrës për burime njerëzore | Kryetari i Komunës – Njësia për Menaxhimin e Burime Njerëzore | Qershor 2025 | ☐ | ☐ |
| 7. | Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028 | Kryetari i Komunës – Drejtoria për Ekonomi dhe Financa | Qershor 2025 | ☐ | ☐ |
| 8. | Raporti gjashtëmujor i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025 | Kryetari i Komunës | Qershor 2025 | ☐ | ☐ |
| 9. | | | | ☐ | ☐ |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 10. | | | | ☐ | ☐ |

**PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2025**
**KORRIK 2025**

| Nr | Aktet e propozuara për shqyrtim dhe miratim | PROPOZUESI | Muaji | Konsultimi / dëgjimi | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Po | Jo |
| 1. | Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal | Kryetari i Komunës - Drejtoritë komunale | Korrik 2025 | ☐ | ☐ |
| 2. | Shqyrtimi dhe miratimi i Plotësim-ndryshimi i Rregullores për menaxhimin e mbeturinave | Kryetari i Komunës - Drejtoria për Shërbime Publike | Korrik 2025 | ☒ | ☐ |
| 3. | Raporti financiar janar – qershor 2025 | Drejtoria për Ekonomi dhe Financa | Korrik 2025 | ☐ | ☐ |
| 4. | Raporti i përfundimit të vitit shkollor 2024/2025 | Drejtoria për Arsim dhe Shkencë | Korrik 2025 | ☐ | ☐ |
| 5. | Informatë nga Komisioni i Aksionarëve të Eko-Regjionit dhe të Stacionit të Autobusëve | Kryesuesit e Komisioneve të Aksionarëve | Korrik 2025 | ☐ | ☐ |
| 6. | Raporti i komiteteve jo-obligative | Kryesuesit e Komiteteve jo-obligative | Korrik 2025 | ☐ | ☐ |
| 7. | | | | ☐ | ☐ |
| 8. | | | | ☐ | ☐ |
| 9. | | | | ☐ | ☐ |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 10. | | | | ☐ | ☐ |

**PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2024**
**GUSHT 2025**

| Nr | Aktet e propozuara për shqyrtim dhe miratim | PROPOZUESI | Muaji | Konsultimi / dëgjimi | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Po | Jo |
| 1. | **PUSHIM** | | | ☐ | ☐ |
| 2. | | | | ☐ | ☐ |
| 3. | | | | ☐ | ☐ |
| 4. | | | | ☐ | ☐ |
| 5. | | | | ☐ | ☐ |
| 6. | | | | ☐ | ☐ |
| 7. | | | | ☐ | ☐ |
| 8. | | | | ☐ | ☐ |
| 9. | | | | ☐ | ☐ |
| 10. | | | | ☐ | ☐ |
| 11. | | | | ☐ | ☐ |
| 12. | | | | ☐ | ☐ |

**PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2025**
**SHTATOR 2025**

| Nr | Aktet e propozuara për shqyrtim dhe miratim | PROPOZUESI | Muaji | Konsultimi / dëgjimi | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Po | Jo |
| 1. | Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal | Kryetari i Komunës - Drejtoritë komunale | Shtator 2025 | ☐ | ☐ |
| 2. | Raporti i komiteteve obligative – Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete | Kryesuesit e Komiteteve obligative | Shtator 2025 | ☐ | ☐ |
| 3. | Raporti i fillimit të vitit shkollor 2025/2026 | Drejtoria për Arsim dhe Shkencë | Shtator 2025 | ☐ | ☐ |
| 4. | Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit për vitin 2026 | Kryetari i Komunës - Drejtoria për Ekonomi dhe Financa | Shtator 2025 | ☐ | ☐ |
| 5. | Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit 2024 | Drejtoria për Ekonomi dhe Financa | Shtator 2025 | ☐ | ☐ |
| 6. | Raporti i Njësisë së Auditimit të Brendshëm | Njësia për Auditim të Brendshëm | Shtator 2025 | ☐ | ☐ |
| 7. | Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për banesa dhe parkingje publike | Kryetari i Komunës - Drejtoria për shërbime publike | Shtator 2025 | ☐ | ☐ |
| 8. | Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores komunale për vullnetarizëm | Kryetari i Komunës - Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport | Shtator 2025 | ☐ | |

Për shkak të zgjedhjeve lokale sipas kalendarit të zgjedhjeve që parashihet të mbahen gjatë muajit tetor 2025, agjenda e punës së kuvendit të komunës është planifikuar deri në muajin shtator 2025,
Nëse paraqitet nevoja, kuvendi i komunës mund të mbajë mbledhje edhe pas muajit shtator derisa të çertifikohen rezultatet e zgjedhjeve – konstituohet mandati dhe përbërja e re e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

**Kryesuesja e Kuvendit**

**Republika e Kosovës** **Komuna e Prizrenit**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti** **Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

**Kuvendi Komunës së Prizrenit**
**Nr.001/011 -**
**Më: shkurt 2025**

Në bazë të nenit 12 paragrafit 1, 2 shkronja d), nenit 17 dhe nenit 40 paragrafit 2 shkronja l) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, si dhe politikave nacionale dhe Programin e Kosovës për Barazi Gjinore, nenit 27 paragrafit 1 të Statutit të Komunës Nr. 01/011-5643, të datës 15 tetor 2008, pas shqyrtimit të propozimit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit në mbledhjen e mbajtur më ..... shkurt 2025, miratoi këtë:

**PROPOZIM-VENDIM**
**PËR MIRATIMIN E PLANIT PËR VLERËSIMIN E RREZIKSHMËRISË NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA NË KOMUNËN E PRIZRENIT.**

**Neni 1**

Miratohet Plani për Vlerësimin e rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në komunën e Prizrenit.

**Neni 2**

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi, është Plani për Vlerësimin e rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për komunën e Prizrenit.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdesen: Kryetari i Komunës, drejtoritë dhe njësitë – sektorët tjerë të përfshira në këtë Plan.

**Neni 4**

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Prizren, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024" dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Propozuesi;**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**

**Komuna e Prizrenit**

# DRAFT DOKUMENT

## VLERËSIMI I RREZIKSHMËRISË NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITËE TJERA PËR KOMUNËN E PRIZRENIT




KOMUNA E PRIZRENIT

Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë

**Prizren 2024**

- **PËRËMBAJTJA**


THEMELIMI I GRUPIT PUNUES ........ 6

VLERËSIMI I RREZIKSHMËRISË SI PJESË PËRBËRËSE E MBROJTJES DHE SHPËTIMIT NË KOMUNËN E PRIZRENIT ........ 7

MISIONI DHE SYNIMI I VLERËSIMIT TË RREZIKSHMËRISË ........ 8

INFRASTRUKTURA LIGJORE ........ 9

KREU I –RË ........ 10

PROFILI I KOMUNËS SË PRIZRENIT ........ 10

1. POZITA, KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE DHE KLIMATIKE TË KOMUNËS ........ 10

1.1 ZONA E PËRGJEGJËSISË (PËRKUFIZIMI HAPËSINOR) ........ 10
1.2 SIPËRFAQJA E PËRGJITHSHME ( E TERRITORIT ) E KOMUNËS SË PRIZRENIT ........ 10
1.3 HIDROGRAFIA -LUMENJTË DHE LIQENET ........ 14

KREU II –TË ........ 15

2. DEMOGRAFIA ........ 15

2.1. KATEGORITË E BANORËVE TË PLANIFIKUAR PËR EVAKUIM ........ 16
2.2. DENDËSIA E POPULLSISË ........ 18
*2.2.1. Shperndarja e familjeve në bazë të grupeve etnike në komunën e Prizrenit ........ 19*
*2.2.2.Të punësuarit, të papunët dhe pensionistët ........ 20*
2.3. ARSIMIMI ........ 23
2.3.1. IDENTIFIKIMI I RREZIQEVE ........ 26
2.3.2. REKOMANDIME : ........ 26

KREU I III-TË ........ 27

3. TË MIRAT MATERIALE, KULTURORE DHE TË MJEDISIT ........ 27

3.1. TRASHËGIMIA KULTURORE ........ 27
3.2. PARQET NACIONALE DHE REZERVATET ........ 35
*3.2.1. Parqet natyrore dhe rezervatet ........ 35*
*3.2. 2. Sipërfaqet pyjore ........ 35*
*3.2.3. Zonat e mbrojtura dhe trashëgimia natyrore ........ 36*
*3.2.4. Menaxhimi i zonave të mbrojtura ........ 37*
3.3. BUJQËSIA ........ 38
*3.3.1 Zonat e prodhimtarisë bujqësore ........ 38*
*3.3.2. Zonat e prodhimtarisë bujqësore ........ 39*
*3.3.3. Kultivimi i bimëve një vjeçare ........ 40*
3.4. AGROBIZNESI ........ 41
*3.4.1. Fermat bujqësore ........ 43*
*3.4.2. Turizmi ........ 43*
*3.4.3. Analiza e trendit të kapaciteteve prodhuese bujqësore ........ 45*
*3.4.4. Sektori privat /komuniteti i biznesit ........ 46*
*3.4.5. Shoqatat afariste ........ 47*
3.5. OBJEKTET ........ 47
*3.5.1. Objektet e banimit ........ 47*
*3.5.2. Objektet afariste ........ 48*
*3.5.3. Objektet sportive ........ 49*
*3.5.4. Objektet kulturore ........ 50*
3.6. STREHIMORET DHE OBJEKTET PËR STREHIM ........ 50
*3.6.1. Përcaktimi i lokacioneve ( zonave ) të grumbullimit në rast fatkeqësie ........ 50*
*3.6.2. Lokacioni i strehimoreve /titullari ........ 51*
*3.6.3. Kapacitetet ........ 51*
*3.6.4. Gjendja e tyre ........ 52*
3.7. KAPACITETET SHËNDETËSORE PUBLIKE DHE PRIVATE ........ 52

*3.7.1. Institucionet Shëndetësore Publike* ........ *52*
*3.7.2. Kapacitetet humane shëndetësore* ........ *52*
*3.7.3. Kapacitetet teknike reaguese në sektorin publik (QKMF/QMF)* ........ *53*
*3.7.5. Detyrat e ekipeve për shërbime mjekësore në situata emergjente:* ........ *54*

KREU I IV-TË ........ 55

4. INFRASTRUKTURA TEKNOLOGJIKE DHE E TRAFIKUT ........ 55

4.1. RRUGËT (RRJETI RRUGOR DHE QARKULLIMI) ........ 55
*4.1.1. Rrugët e nivelit kombëtar* ........ *56*
*4.1.2. Rrugët urbane* ........ *56*
*4.1.3. Rrugët e nivelit komunal* ........ *57*
*4.1.4. Rrugët në vendbanime lokale* ........ *57*
*4.1.6. Burimet e rreziqeve (Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve në infrastrukturën rrugore* ........ *63*
*Pjesëmarrja e Komunitetit - Bashkëpunimi me organizatat lokale: Angazhimi i organizatave lokale dhe komunitetit për të promovuar sigurinë në trafik.* ........ *64*
- *Monitorimi dhe Rishikimi - Analiza e aksidenteve: Vlerësimi i statistikave të aksidenteve për të identifikuar zonat e rrezikshme dhe për të zhvilluar masa specifike.* ........ *64*

4.2. TRANSPORTI HEKURUDHOR ........ 65
4.3. TRANSPORTI AJROR/AEROPORTET ........ 66
4.4. URA DHE TUNELE ........ 66
*4.4.1. Urat* ........ *66*
*4.4.2. Tunelet* ........ *67*
4.5. SISTEMI ENERGJETIK (OBJEKTET DHE SISTEMET) ........ 67
4.6. LARGPËRÇUESIT DHE TRAFO-STACIONET ........ 68
4.7. SISTEMET E TELEKOMUNIKIMIT ........ 69
*4.7.1. Objektet dhe shërbimet (brenda komunës)* ........ *69*
*4.7.2. Personat juridik* ........ *70*
*4.7.3. Qendrat telekominikuese transmetuese dhe repetitorët* ........ *70*
*4.7.4. TV dhe radiostacionet* ........ *71*
4.8. SISTEMET HIDROTEKNIKE ........ 71
*4.8.1. Objektet për furnizim me ujë* ........ *71*
*4.8.2. Korporata rajonale e ujërave ( KRU) dhe burimet alternative* ........ *72*
*4.8.3. Sistemi i distribuimit të ujit për pije* ........ *72*
*4.8.4. Monitorimi i ujërave për pije* ........ *75*
*4.8.5. Ndotësit e mundshëm të ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor* ........ *76*
*4.8.6. Masat parandaluese ndaj ndotjes së ujit* ........ *78*
*4.8.7. Rekomandimet:* ........ *79*
4.9. SISTEMET E SHPËRNDARJES SË GAZIT DHE NAFTËS ........ 79
*4.9.1. Pompat e derivateve;* ........ *79*
*4.9.2. Deponitë e derivateve /kapacitetet* ........ *80*

KREU I V-TË ........ 81

5. OBJEKTET E RËNDËSISË SË VEÇANTË ........ 81

5.1. OBJEKTET E SIGURISË ........ 81
5.2. OBJEKTET DHE HAPSIRAT QEVERITARE NË KOMUNËN E PRIZRENIT ........ 81
5.3. INSTITUCIONET DHE SHËRBIMET FINANCIARE ........ 82
5.4. OBJEKTET SHKOLLORE NË KOMUNËN E PRIZRENIT ........ 82

KREU VI-TË ........ 83

6. LLOJET E FATKEQËSIVE ........ 83

6.1. INTENSITETI, LLOJET DHE NDIKIMET E VEPRIMIT TË FATKEQËSIVE NATYRORE ........ 83
6.2. PRIORITIZIMI I FATKEQËSIVE NATYRORE BAZUAR NË MATRICËN E RREZIQEVE ........ 84
6.3. MATRICA E GJASAVE ........ 85
6.4. RREZIQET NGA FATKEQËSITË NATYRORE ........ 86
*6.4.1. Vërshimet* ........ *86*
*6.4.2. Identifikimi i rreziqeve nga vërshimet;* ........ *87*

*6.4.3. Karakteristikat hidrografike dhe ndikimet e saj në vërshimeve ........ 88*
*6.4.4. Historiku ........ 88*
*6.4.5. Vendet (vendbanimet) më të atakuara nga vërshimet /pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara me numrin dhe strukturën e banorëve; ........ 89*
*6.4.6. Kushtet hidro-meteorologjike ........ 90*
*6.4.7. Treguesit hidrologjik ........ 92*
*Masat Parandaluese ........ 93*
*Rekomandime: ........ 93*
*Skenari ( vërshimet); ........ 94*
6.5. ZJARRET ........ 124
*6.5.1. Karakteristikat e terrenit dhe vatrave potenciale të zjarreve, ........ 124*
*6.5.2. Kushtet klimatike ........ 126*
*6.5.3. Zjarret fushore malore, urbane, zjarret si pasojë e proceseve tekniko-teknologjike ........ 126*
*6.5.4. Intenziteti, shpeshtësia e paraqitjes, kohëzgjatja ........ 127*
*6.5.5. Sipërfaqet e përfshira nga Zjarri ........ 128*
*6.5.6. Mbrojtja nga zjarri në sektorin e ndërtimit ........ 129*
*Masat parandaluese: ........ 129*
*Rekomandimet: ........ 130*
6.6. TËRMETET ........ 156
*6.6.1. Karakteristikat sizmike të zonave dhe rreziku sizmik ........ 156*
*6.6.2. Vendbanimet e rrezikuara , numri dhe struktura e banorëve ........ 156*
*6.6.3. Rrezikshmëria e zonave të caktuara ........ 156*
*6.6.4. Shpeshtësia, intensiteti dhe epiqendra e tërmetit (dridhjeve) ........ 156*
*6.6.5. Pasojat e tërmeteve ........ 157*
*Masat parandaluese; ........ 157*
*Hartat sizmike: ........ 159*
*Skenari (Tërmeti) ........ 161*
6.7. RRËSHQITJET DHE EROZIONET ........ 170
*6.7.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonave potenciale të rrëshqitjes dhe erozioneve ........ 170*
*6.7.2. Kushtet klimatike, intensitetin, shpeshtësinë e paraqitjes; ........ 170*
*6.7.3. Zonat e rrezikuara nga rrëshqitjet dhe erozioni, numri i banorëve, objekteve, lloji i tyre, pasqyra e lokacioneve kritike; ........ 171*
*6.7.4. Përshkrimi i strukturave gjeologjike të tokës (rrëshqitjet aktive dhe pasive); ........ 171*
*6.7.5. Sipërfaqet e përfshira; ........ 172*
*6.7.6. Pasojat nga rrëshqitjet dhe erozionet; ........ 174*
*Masat parandaluese ........ 174*
*Harta e rreziqeve ........ 175*
*Skenari 1 i Erozionit ........ 175*
*Skenari i 2 i Erozionit ........ 181*
*Skenari 3 i Erozionit ........ 186*
6.8. RESHJET E DËBORËS DHE NGRICAT; ........ 191
*6.8.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonave potenciale me të reshura të dendura të dëborës dhe ngricave; ........ 191*
*6.8.2. Intensiteti i reshjeve, shpeshtësia e paraqitjes, temperaturat ekstreme; ........ 191*
*6.8.3. Pasojat nga dëbora dhe ngrica; ........ 192*
*Masat parandaluese ........ 192*
*Harta e rreziqeve ........ 192*
6.9. BRESHËRI ........ 192
*6.9.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale të prekura nga breshëri; ........ 192*
*6.9.2. Shpeshtësia e paraqitjes dhe muajt kritik; ........ 193*
*6.9.3. Pasojat nga breshëri; ........ 193*
6.10. ORTEKËT ........ 194
*6.10.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale ........ 194*
*6.10.2. Treguesit statistikor të pasojave nga ortekët; ........ 194*
*Masat parandaluese; ........ 194*
6.11. ERËRAT E FUQISHME DHE STUHITË ........ 195
*6.11.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale ........ 195*
*6.11.2. Pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve; ........ 195*
*6.11.3. Treguesit statistikor të pasojave nga erërat e fuqishme dhe stuhitë ; ........ 195*

*Masat parandaluese;* ........................................................ *196*
*Harta e rreziqeve;* ........................................................ *196*
6.12. THATËSIRAT ........................................................ 196
*6.12.1. Treguesit statistikor për mungesën e theksuar të të reshuarave atmosferike;* .......... *196*
*6.12.2. Dëmet dhe pasojat;* ........................................................ *196*
*6.12.3. Pasqyra e vendbanimeve/zonave të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve;* .......... *197*
*6.12.4.Rezervat ujore ( mbitokësore dhe nëntokësore);* .......... *197*
*Masat parandaluese;* ........................................................ *197*
*Harta e rreziqeve;* ........................................................ *198*
6.13. RREZIQET NGA EPIDEMITË DHE PANDEMITË .......... 198
*6.13.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale;* .......... *198*
*6.13.2. Pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve ;* .......... *198*
*6.13.3. Shkaktarët e paraqitjes së epidemisë, endemisë dhe pandemisë;* .......... *198*
*6.13.4. Sëmundjet ngjitëse;* .......... *198*
*6.13.5. Pasojat nga epidemitë dhe pandemitë ;* .......... *199*
*6.13.6. Epidemitë dhe pandemitë/vlerësimet e bazuara në vlerësimet dhe analizat e shërbimeve kompetente;* .......... *200*
*6.13.7. Bartësit dhe përgjegjësit e aktiviteteve të rregullta dhe masat parandaluese;* .......... *200*
*Harta e rreziqeve;* .......... *201*

KREU VII-TË .......... 201

7. FATKEQËSITË TJERA .......... 201

7.1. VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË TJERA .......... 201
*7.1.1. Numrin, llojin dhe madhësinë e objekteve në të cilat deponohen, përdoren apo prodhohen materiet e rrezikshme;* .......... *201*
*7.1.2. Numrin, llojin dhe cenueshmërinë e trafikut rrugor, hekurudhor dhe ajror;* .......... *201*
*7.1.3. Llojin dhe sasinë e materieve të rrezikshme;* .......... *202*
*7.1.4. Distanca nga zonat e banuara;* .......... *202*
*7.1.5. Përqendrimin e materieve të rrezikshme dhe të dëmshme* .......... *202*
*7.1.6. Llojin dhe sasinë reale të materieve të rrezikshme dhe të dëmshme në qarkullim;* .......... *202*
*7.1.7. Rrjedhjen e materieve të rrezikshme dhe të dëmshme në vendet me rrezikshmëri të lartë/tubacionet, rrugët të cilat kalojnë nëpër vendet me specifika të veçanta;* .......... *202*
*7.1.8. Rreziku nga shpërthimi i pendave hidro-akumuluese,* .......... *202*
*7.1.9. Pasojat nga shpërthimi i pendës hidro-akumuluese;* .......... *202*
*7.1.10. Raporti vlerësues i matjeve dhe gjendjes së trupit të pendës;* .......... *203*
7.2. VLERËSIMI PËR FATKEQËSITË NUKLEARE RADIOLOGJIKE KIMIKE BIOLOGJIKE .......... 203
7.3. VLERËSIMI PËR RREZIQET NGA VEPRIMET LUFTARAKE DHE TERRORISTE .......... 203
7.4. VLERËSIMI PËR PASOJAT E INFRASTRUKTURËS KRITIKE .......... 204
7.5. STRUKTURAT PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE NDIHMË /SMSHN .......... 204
7.6. NË VLERËSIM DUHET TË PËRCAKTOHEN KAPACITETET, FORCAT DHE SHËRBIMET .......... 205

KREU I VIII-TË .......... 211

8. VLERËSIMET PËRFUNDIMTARE –SPECIFIKE .......... 211

8.1. VLERËSIMET PËFUNDIMTARE .......... 211
*8.1.1. Vlerësimet për strukturën dhe madhësinë e forcave për reagim emergjent.* .......... *212*
8.2. KOSTOJA FINANCIARE E DOKUMENTIT TË VLERËSIMIT; .......... 213
*8.2.1. Identifikimi dhe analizmi i rreziqeve nga FNFT.* .......... *213*
*8.2.2. Identifikimi i nevojave për resurset humane dhe teknike;* .......... *214*
*8.2.3. Identifikimi i nevojave për trajnim dhe aftësim profesional;* .......... *215*
*8.2.4. Zbatimi i akteve ligjore, nënligjore dhe monitorimi i tyre;* .......... *215*
*8.2.5. Masat parandaluese për zvogëlimin e efekteve nga FNFT;* .......... *215*

9. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE .......... 215

10. REKOMANDIME .......... 215

REFERENCAT: .......... 216

**PARATHËNIE**

Dokumenti i Vlerësimit të Rrezikshmerisë nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera në Komunën e Prizrenit, bazohet në Ligjin Nr.04/L-027, si dhe në Rregulloren Nr. 25/2020 për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë.Me këtë dokument identifikohen kërcënimet dhe rreziqet në në Komunën e Prizrenit si dhe bëhet vlerësimi i shkallës së rrezikshmërisë. Bazuar në këtë vlerësim, identifikohen mundësitë dhe nevojat për parandalimin, zvogëlimin (zbutjen) e rreziqeve, reagimin, rimëkëmbjen dhe evitimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Ky vlerësim shërben si bazament për hsrtimin e Planit Lokal të Reagimit Emergjent (PLRE) si dhe planeve tjera locale, me qëllim të mbrojtjes dhe shpëtimit të jetës së qytetarëve, të mirave materiale, mjedisit dhe trashëgimisë kulturore në Komunën e Prizrenit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera.

## THEMELIMI I GRUPIT PUNUES

Kryetari i Komunës së Prizrenit z. Shaqir Totaj bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë brenda juridiksionit komunal, nxjerrë vendimin për themelimin e Grupit Punues, për hartimin /rishikimin e dokumentit të vlerësimit të rrezikshmërisë.

Vendimi i Kryetarit të Komunës për themelimin e grupit punues



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr 265/23 Dt. 13.04.2023

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas propozimit të Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, kryetari i Komunës, mori këtë:

**VENDIM**
**Për formimin e Grupit Punues**

1. Formohet dhe emërohet Grupi Punues për Planin e Vlerësimit të Rrezikut në komunën e Prizrenit. Për anëtarë të këtij Grupi Punues, emërohen:

1.1. Ramize Shala, .................Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë....... .....kryesuese,
1.2. Urim Daka,......................Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë......... ...anëtar,
1.3. Haziz Krasniqi,.................Zyra e Kryetarit,............................................anëtar,
1.4. Përparim Shala, ...............Drejtoria e Shërbimeve Publike,................. ..anëtar,
1.5. Rrahim Destani,...............Drejtoria e Inspektorateve,..............................anëtar,
1.6. Sami Vehapi, ..................Drejtoria e Administratës,............................ ..anëtar,
1.7. Halil Lika,.........................Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave,...........anëtar,
1.8. Jahja Baca,........................Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, ................anëtar,
1.9. Fatlum Berisha,.................Drejtoria e Shëndetësisë, ..............................anëtar,
1.10. Enver Kryeziu,.................Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale... anëtar,
1.11. Artan Gashi,......................Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrës.......... anëtar,
1.12. Jakup Kastrati,..................Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural... anëtar,
1.13. Zana Belloda, .................. Drejtoria e Urbanizmit dhe Plani. Hapës.. ....anëtare,
1.14. Sherife Çengaj............... ..Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, anëtare,
1.15. Vetan Xhemaj, ............... Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit...........anëtar,
1.16. Sherif Sallahu, ..................KEDS në Prizren......................................... .anëtar,
1.17. Vehbi Zekolli,...................Drejtoria Rajonale e Policisë në Prizren......... anëtar,
1.18. Fejzullah Berisha, ............Brigada e Zjarrfikësve,...................................anëtar,
1.19. Urim Bytyqi, ....................HidroRegjioni Jugor,.......................................anëtar,
1.20. Ismail Krasniqi, ...............Kryqi i Kuq në Prizren...................................anëtar,
1.21. Xhevat Elezkurtaj,.............QKMF,...........................................................anëtar,
1.22. Hekuran Vezgishti,............Spitali Regjional në Prizren,...........................anëtar,
1.23. Kujtesa Godeni Skenderi....QRTK,...........................................................anëtare,
1.24. Riza Poniku,.......................EkoRegjioni,..................................................anëtar,
1.25. Përfaqësues të FSK,......................................... ........................................anëtar,
1.26. Përfaqësues të OJQ-së.................................................................................. anëtar.

## VLERËSIMI I RREZIKSHMËRISË SI PJESË PËRBËRËSE E MBROJTJES DHE SHPËTIMIT NË KOMUNËN E PRIZRENIT

**HYRJE:**

Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera (FNFT) të shkaktuara nga dukuritë natyrore apo nga faktori njeri mund të rrezikojnë jetën e njerëzve, kafshëve, të mirat materiale dhe trashëgiminë kulturore. Dukuritë dhe fenomenet, qofshin ato natyrore apo të shkaktuara nga faktori njeri, manifestohen me rreziqe dhe paraqesin sfida me të cilat ballafaqohet njerëzimi, prandaj vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërmarrja e masave, veprimeve dhe aktiviteteve për parandalimin e tyre është një nga prioritetet e Komunës së Prizrenit.

**"Vlerësimi i rrezikshmërisë nënkupton analizën sasiore dhe cilësore të fatkeqësive të shkaktuara nga fenomenet natyrore, proceset teknologjike dhe rrethanat e caktuara tjera për dukuritë e mundshme nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera "**

-Fatkeqësitë nuk zgjedhin kohen as vendin se ku do të ndodhin. Andaj te gjithë jemi të kërcënuar nga rreziqet e ndryshme që i kërcënojnë interesat e sigurisë në çdo kohë dhe në çdo vend.

Si çdo pjesë e Kosovës edhe komuna e Prizrenit mund të ballafaqohet me fatkeqësitë natyrore. Bazuar në historikun e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, në të kaluarën ka pasur shkatërrime dhe

humbje të jetës së njerëzve, të mirave materiale, trashëgimisë kulturore dhe ambientit. Me qëllim të ngritjes së vetëdijes qytetare, ngritjes së kapaciteteve për mbrojtje dhe shpëtim, masave parandaluese, zhvillimin e programeve për një jetë më kualitative dhe më të sigurt, hartohet dokumenti i vlerësimit të rrezikshmërisë nga **fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.**

-Bazuar në historikun e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, Komuna e Prizrenit në të kaluarën ka pasur shkatërrime dhe humbje të konsiderueshme të: jetës së njerëzve, të mirave materiale, trashëgimisë kulturore dhe ambientit, andaj edhe në të ardhmen komuna e jonë mund të ballafaqohet me fatkeqësitë natyrore dhe ato të shkaktuara nga proceset tekniko-teknologjike apo faktori njeri. Me qëllim të ngritjes së vetëdijes qytetare, ngritjes së kapaciteteve për mbrojtje dhe shpëtim, masave parandaluese, zhvillimin e programeve për një jetë më kualitative dhe më të sigurt, hartohet dokumenti i vlerësimit të rrezikshmërë.

-Rreziku nga fatkeqësitë natyrore ndër të tjera paraqet një përjetim të humbjes apo dëmit i cili mund të shfaqet në cilin do vend dhe në çdo kohë, intensiteti i të cilit mund të jetë i kufizuar apo me përmasa tragjike, prandaj parandalimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera nënkupton zvogëlimin/lehtësimin e rreziqeve, ndërmarrjen e masave lehtësuese, ngritjen e nivelit të gatishmërisë dhe kapaciteteve të nevojshme për të ndërmarrë veprimet e duhura në situata emergjente.

Ky dokument është bazë për hartimin e planeve të reagimit emergjent, planeve operative dhe planeve tjera sipas legjislacionit në fuqi.

Komuna e Prizrenit, bazuar në misionin, detyrat, përgjegjësitë si dhe në Rregulloren (QRK) Nr. 25/2020 për Metodologjinë e Hartimit të **Vlerësimit të Rrezikshmërisë** në bashkëpunim me institucionet lokale dhe ato qendrore, OJQ-të, si dhe palët tjera të interesit, ka hartuar draft/dokumentin: Vlerësimi i Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, përmes të cilës synon identifikimin, vlerësimin dhe ndërmarrjen e masave parandaluese dhe zbutjen-zvogëlimin e tyre.

Komuna e Prizrenit është përgjegjëse për organizimin e Mbrojtjes dhe Shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera në kufijtë territorial të përgjegjësisë të saj, si përgjegjëse dhe koordinuese e sistemit unik të emergjencave civile lokale, e cila përmban planifikimin, organizimin, aftësimin, koordinimin, realizimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha masave dhe aktiviteteve për Mbrojtje dhe Shpëtim brenda juridiksionit komunal.

***Dokumenti i vlerësimit të rrezikshmërisë duhet të rishikohet sipas rregullores në fuqi çdo tri vite e në raste sepcifike edhe më herët.***

## MISIONI DHE SYNIMI I VLERËSIMIT TË RREZIKSHMËRISË

Mënyra më e mirë për tu mbrojtur për situata të tilla është Vlerësimi, Planifikimi dhe Programimi i veprimit të menduar për menaxhim emergjent, me udhëzime të qarta dhe veprime emergjente të nevojshme dhe me kohë.

Hartimi i Dokumentit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë konsiston në identifikimin, analizimin, vlerësimin, strukturimin dhe arkivimin e informatave nga të gjitha subjektet juridike pjesëmarrëse dhe reaguese ndaj situatave emergjente në komunë, me qëllim të:

a. Hartimit të planeve të reagimit emergjent, planeve operative dhe planeve tjera përkatëse sipas legjislacioneve në fuqi;
b. Profilizimit dhe standardizimit të masave parandaluese dhe veprimeve konkrete për zvogëlimin, zbutjen dhe sanimin e pasojave të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
c. Caktimit të shkallës së cenueshmërisë (vatrave potenciale të rrezikut sipas shkallës së rrezikshmërisë), përcaktimit të moduleve vlerësuese për situatat e krijuara emergjente si dhe koordinimit të resurseve humane dhe teknike, të cilat do të përfshihen si përgjigje adekuate në situatat emergjente;

Vlerësimi i rrezikut nënkupton procesin e analizimit, vlerësimit dhe konkluzioneve të cilat inkorporohen në hartimin e planeve dhe strategjive afatshkurtra dhe afatgjate, me qëllim të zvogëlimit të rreziqeve nga FNFT, realizimin e projekteve konkrete dhe menaxhimin e situatave emergjente me të cilat mund të përballet komuna.

## INFRASTRUKTURA LIGJORE

Hartimi i "Vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera ", në nivel vendi është i bazuar në ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, si dokument bazë për hartimin e planeve të reagimit emergjent dhe planeve tjera**.**

Vlerësimi i Rrezikshmërisë nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera është dokument me karakter nacional, hartimi i të cilit është i bazuar në:

1. "Ligjin Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera", si dhe
2. Rregulloren nr. 25/2020 për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë;
3. Statutin e Komunës së Prizrenit.
4. "Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri" Nr. 04/L-012;
5. "Ligji për transportin tokësorë të mallrave të rrezikshme"Nr. 06/L-071;
6. "Ligji për sigurinë në komunikacionin rrugor' Nr. 02/L-70;
7. " Ligji për ndërtim", Nr. 04/L-110;
8. "Ligji për pajisjet nën presion" Nr. 08/L-031;
9. "Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-109, për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse" Nr. 08/L-046;
10. "Ligji për përdorimin civil të eksplozivëve" Nr. 04/L-022;
11. "Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis"Nr. 03/L-214.
12. "Ligji për mbrojtjen e mjedisit" Nr. 03/L-025;
13. "Ligji për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore" Nr. 06/L-029;
14. "Ligji për rezervat shtetërore të mallrave" Nr. 03/L-244;
15. "Ligji për ujrat e Kosovës" Nr. 04/L-147;
16. Udhëzimi Administrativ (MPB)-04/2018-UA, për kategorizimin dhe klasifikimin e objekteve në kategorinë përkatëse të rrezikshmërisë nga zjarri;
17. Statuti i Komunës së Prizrenit

# KREU I –RË

# PROFILI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Komuna e Prizrenit përfshin një sipërfaqe prej 640 kilometra katrorë. Komuna e Prizrenit kufizohet me dy shtetet fqinje, në perëndim me Republikën e Shqipërisë dhe në juglindje me Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndërsa në jug kufizohet me Komunën e Dragashit, në lindje me Komunën e Shtërpcës, me Komunën e Suharekës në verilindje, me komunën e Mamushës në veri dhe Komunën e Gjakovës në veriperëndim. Territori i Komunës së Prizrenit shtrihet rreth koordinantave gjeografike: 42$^{O}$ 12’ 58.06’’ N, të gjerësisë gjeografike veriore dhe 20$^{O}$ 44’ 14.16’’ E të gjatësisë gjeografike lindore.

*Harta 1. Pozita gjeografike e komunës së Prizrenit në Kosovë, aneksi i hartave, faqe 2. (burimi i të dhënave për rrugët Ministria e Mjedisit, planifikimit hapësinor dhe Infrastruktures, ndërsa kufiri i komunës së Prizrenit nga Harta zonale e komunës së Prizrenit).*

## 1. POZITA, KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE DHE KLIMATIKE TË KOMUNËS

### 1.1 Zona e përgjegjësisë (përkufizimi hapësinor)

Qyteti i Prizrenit shtrihet në pjesën jugore të Kosovës, në rajonin e Prizrenit dhe kufizohehet me:

- në juglindje me Maqedoninë e Veriut (20.2 km)
- në Jug me komunën e Dragashit (30.7 km)
- në lindje me komunën e Shtërpcës (19.6 km);
- në verilindje me komunën e Suharekës (20.4 km)
- në perëndim me Shqipërinë (20.8 km)
- në veri-perëndim me komunën Gjakovën (18.2 km),
- në veri me komunën e Rahovecit me 19.5 km .
- në veri me komunën e Mamushës me 8.9 km .

### 1.2 Sipërfaqja e përgjithshme ( e territorit ) e komunës së Prizrenit

Komuna e Prizrenit përfshin një sipërfaqe prej 640 km² (5.94 % nga territori i përgjithshëm i Kosovës, në të jetojnë 147,428 banorë (2024), ndërsa vetëm në qytetin e Prizrenit jetojnë 85119 banorë (2011).

Teritorin e komunës së Prizrenit e përshkon lumi “Drini i Bardhë me degët kryesore Toplluha dhe Lumbardhi i Prizrenit. Qyteti i Prizrenit është larg nga Prishtina me distance afër 85 km. Me komunën e Prizrenit gjatësia e kufirit është 158.43 km . Duke pas parasysh

shtrirjen gjeografike, relievin, lartësinë mbidetare, etj. mund të thuhet që Komuna e Prizrenit ka një pozitë të favorshme gjeografike nga se këto komponente natyrore dhe shoqërore janë shumë të rëndësishëm në çdo hapësirë. Komuna e Prizrenit është mjaft komunikative, pasi ajo me të gjitha komunat fqinje lidhet nëpërmjet rrugëve automobilistike të cilat ndjekin kryesisht korridoret dhe kalimet natyrore . Në aspektin morfologjik brenda territorit të Komunës së Prizrenit mund të diferencohen këto njësi morfologjike, malet e Sharrit, Oshlak, Koritinik, Pashtrik, duke i shtuar edhe pjesët e ulëta, si ato të Rrafshit të Dukagjinit. Në këtë pjesë shtrihet edhe lartësia më e madhe relievore (maja e Malit Sharr-Bistra 2600 m). Malet e Sharrit kufizohen me Maqedoninë Veriore në juglindje, me Komunën e Dragashit në Jug, me Komunën Shtërpcës në lindje dhe me Komunën e Suharekës në verilindje. Lugina e Zhupës, baza e lumit Lumëbardhi, shtrihet përgjatë këtyre maleve drejt Prizrenit. Malet e Pashtrikut në kufirin Shqiptar në perëndim janë malet e dyta me lartësi mbidetare me 1950 m.Topografia e Prizrenit ka strukturë të valëzuar. Lartësia mbidetare sillet prej 300 m -2600 m. Përderisa qyteti i Prizrenit ndodhet në sipërfaqen e rrafshët, topografia kodrinore vërehet në pjesën perëndimore dhe lindore të komunës. Lartësia mbidetare e qendrës së qytetit është 400 m. Pjesët malore me lartësi mbidetare mbi 1500 m përfshijnë afro 15% të gjithë kufijve komunal. Rrafshina e Prizrenit është një sipërfaqe e rrafshët me një pjerrësi 0-5%. Ajo mbulon 14000 ha apo 22% të Komunës së Prizrenit. Sipas Statutit të Komunës së Prizrenit nenit 6, territori i komunës si njësi territoriale përbëhet prej lagjeve urbane, fshatrave dhe vendbanime sipas zonave kadastrale si në tabelën e mëposhtme. Ndërsa me rregulloren për "Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatra, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Prizrenit" nr. Nr. 01/011-141691 është bërë rregullimi dhe ndarja e vendbanimeve të komunës si në vijim:

Tab 1. Emrat e lagjeve në qytetin e Prizrenit

| Emri i lagjeve në qytetin e Prizrenit | Emri i lagjeve në qytetin e Prizrenit |
|---|---|
| "Lidhja e Prizrenit" | "Jeta e Re" |
| "Dardani" | "Kurrillë" |
| "Shaban Polluzha" dhe "Gani Qavdarbasha" | "Xhevat Berisha" dhe "UQK" |
| "Petrovë" | "Vellezerit Stavileci" |
| "11 Marsi" . "2 Korriku" dhe "Bazhdarhane" | "10 Qershori" |
| "Ortakoll dhe Ganimete Tërbeshi" | "Bajram Curri" |
| "Kongresi i Manastirit" | "Arbanë" |

Tab 2. Numri i banoreve sipas moshës dhe vendbanimeve për komunën e Prizrenit

| Emri vendbanimit | 0-4 | 5-9 | 10-14 | 15-19 | 20-24 | 25-29 | 30-34 | 35-39 | 40-44 | 45-49 | 50-54 | 55-59 | 60-64 | 65+ | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Atmaxhë | 187 | 167 | 176 | 157 | 162 | 159 | 146 | 116 | 83 | 86 | 67 | 51 | 31 | 97 | **1685** |
| Billushë | 133 | 140 | 164 | 153 | 152 | 130 | 117 | 108 | 106 | 72 | 50 | 46 | 35 | 89 | **1495** |
| Caparc | 65 | 82 | 89 | 113 | 74 | 81 | 67 | 53 | 57 | 51 | 27 | 32 | 19 | 38 | **848** |

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Dedaj | 66 | 74 | 74 | 71 | 46 | 55 | 54 | 46 | 41 | 19 | 16 | 15 | 10 | 32 | **619** |
| Dobrushtë | 61 | 44 | 38 | 40 | 60 | 70 | 40 | 27 | 27 | 12 | 23 | 17 | 11 | 25 | **495** |
| Dojnicë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **0** |
| Drajçiq | 19 | 18 | 3 | 7 | 10 | 14 | 8 | 6 | 9 | 14 | 7 | 8 | 9 | 19 | **151** |
| Dushanovë | 849 | 966 | 1017 | 946 | 948 | 774 | 718 | 683 | 590 | 467 | 380 | 312 | 250 | 498 | **9398** |
| Gërnçar | 125 | 138 | 93 | 89 | 123 | 135 | 99 | 71 | 91 | 82 | 88 | 63 | 31 | 90 | **1318** |
| Gornjasellë | 23 | 12 | 6 | 29 | 30 | 25 | 21 | 14 | 20 | 21 | 18 | 25 | 12 | 36 | **292** |
| Gorozhup | 42 | 45 | 22 | 24 | 31 | 25 | 30 | 22 | 9 | 8 | 1 | 6 | 7 | 18 | **290** |
| Grazhdanik | 82 | 112 | 114 | 99 | 65 | 64 | 63 | 64 | 61 | 42 | 20 | 26 | 21 | 51 | **884** |
| Gjonaj | 545 | 533 | 553 | 475 | 509 | 437 | 415 | 354 | 214 | 203 | 153 | 113 | 84 | 230 | **4818** |
| Hoçë e Qytetit | 268 | 309 | 420 | 457 | 349 | 232 | 251 | 273 | 239 | 170 | 131 | 82 | 58 | 171 | **3410** |
| Jabllanicë | 6 | 26 | 36 | 39 | 40 | 16 | 20 | 16 | 24 | 31 | 29 | 15 | 14 | 39 | **351** |
| Jeshkovë | 21 | 36 | 47 | 50 | 51 | 35 | 33 | 34 | 35 | 34 | 19 | 15 | 7 | 17 | **434** |
| Kabash | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **0** |
| Kabash i Hasit | 113 | 116 | 103 | 89 | 98 | 78 | 65 | 55 | 45 | 25 | 30 | 23 | 14 | 28 | **882** |
| Karashëngjergj | 105 | 102 | 111 | 121 | 98 | 95 | 91 | 90 | 72 | 63 | 46 | 22 | 22 | 61 | **1099** |
| Kobajë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **0** |
| Kojushë | 82 | 65 | 46 | 46 | 49 | 53 | 49 | 23 | 20 | 19 | 13 | 17 | 9 | 18 | **509** |
| Korishë | 482 | 477 | 553 | 518 | 563 | 489 | 409 | 415 | 322 | 284 | 204 | 194 | 118 | 251 | **5279** |
| Krajk | 198 | 202 | 187 | 175 | 173 | 155 | 148 | 117 | 81 | 55 | 47 | 35 | 31 | 72 | **1676** |
| Krushë e Vogël | 76 | 82 | 128 | 117 | 85 | 79 | 84 | 68 | 56 | 42 | 35 | 27 | 23 | 35 | **937** |
| Kushnin | 289 | 244 | 251 | 209 | 213 | 179 | 164 | 133 | 96 | 72 | 57 | 53 | 48 | 102 | **2110** |
| Kushtendil | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **0** |
| Landovicë | 107 | 110 | 147 | 113 | 115 | 88 | 100 | 87 | 75 | 39 | 48 | 33 | 18 | 69 | **1149** |
| Leskovec | 11 | 11 | 10 | 21 | 20 | 10 | 4 | 11 | 7 | 7 | 8 | 1 | 1 | 12 | **134** |
| Lez | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 0 | 0 | **2** |
| Lubinjë e Epërme | 134 | 151 | 160 | 231 | 155 | 145 | 102 | 104 | 149 | 168 | 106 | 71 | 55 | 194 | **1925** |
| Lubinjë e Poshtme | 73 | 101 | 99 | 107 | 108 | 79 | 79 | 90 | 79 | 89 | 88 | 68 | 39 | 128 | **1227** |
| Lubiqevë | 213 | 233 | 177 | 146 | 156 | 141 | 116 | 101 | 72 | 52 | 51 | 40 | 28 | 76 | **1602** |
| Lubizhdë | 478 | 523 | 551 | 536 | 536 | 528 | 496 | 437 | 356 | 390 | 331 | 276 | 197 | 347 | **5982** |
| Lubizhdë e Hasit | 317 | 261 | 323 | 291 | 304 | 255 | 233 | 179 | 137 | 101 | 82 | 67 | 51 | 118 | **2719** |
| Lukinaj | 58 | 57 | 63 | 76 | 53 | 54 | 43 | 36 | 31 | 27 | 19 | 19 | 5 | 17 | **558** |
| Lutogllavë | 97 | 120 | 109 | 140 | 126 | 99 | 99 | 109 | 79 | 57 | 51 | 44 | 22 | 66 | **1218** |
| Llokvicë | 7 | 19 | 37 | 30 | 26 | 29 | 10 | 10 | 21 | 51 | 34 | 17 | 11 | 37 | **339** |
| Malësi e Re | 69 | 81 | 67 | 71 | 79 | 79 | 58 | 54 | 45 | 36 | 31 | 13 | 25 | 34 | **742** |

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Manastiricë | 77 | 85 | 123 | 135 | 81 | 74 | 62 | 90 | 103 | 61 | 51 | 34 | 26 | 105 | **1107** |
| Mazrek | 123 | 122 | 152 | 123 | 89 | 91 | 82 | 77 | 56 | 41 | 31 | 25 | 19 | 46 | **1077** |
| Medvec | 83 | 100 | 146 | 123 | 94 | 74 | 69 | 77 | 77 | 65 | 31 | 42 | 21 | 60 | **1062** |
| Milaj | 8 | 2 | 5 | 3 | 4 | 3 | 3 | 3 | 1 | 0 | 1 | 1 | 1 | 2 | **37** |
| Muradem | 55 | 51 | 64 | 63 | 64 | 40 | 30 | 39 | 38 | 20 | 11 | 11 | 8 | 21 | **515** |
| Mushnikovë | 82 | 101 | 122 | 116 | 85 | 81 | 81 | 59 | 77 | 65 | 50 | 48 | 34 | 132 | **1133** |
| Nashec | 149 | 133 | 166 | 166 | 114 | 124 | 112 | 118 | 72 | 45 | 48 | 37 | 25 | 70 | **1379** |
| Nebregoshtë | 24 | 30 | 52 | 83 | 38 | 42 | 31 | 42 | 55 | 56 | 41 | 22 | 14 | 49 | **579** |
| Novak | 6 | 8 | 9 | 7 | 5 | 2 | 7 | 6 | 5 | 7 | 3 | 8 | 0 | 15 | **88** |
| Novosellë | 32 | 27 | 27 | 22 | 23 | 28 | 29 | 25 | 22 | 12 | 12 | 12 | 13 | 25 | **309** |
| Petrovë | 113 | 119 | 126 | 145 | 125 | 88 | 92 | 100 | 92 | 59 | 31 | 27 | 20 | 57 | **1194** |
| Piranë | 201 | 245 | 287 | 265 | 222 | 176 | 169 | 190 | 165 | 115 | 102 | 90 | 52 | 138 | **2417** |
| Pllanejë | 110 | 84 | 67 | 58 | 65 | 63 | 59 | 43 | 25 | 26 | 15 | 21 | 17 | 28 | **681** |
| Pllanjan | 108 | 104 | 111 | 89 | 84 | 99 | 87 | 72 | 63 | 67 | 68 | 45 | 30 | 77 | **1104** |
| Poslishtë | 161 | 146 | 179 | 157 | 153 | 133 | 110 | 91 | 89 | 78 | 72 | 47 | 28 | 76 | **1520** |
| Pouskë | 59 | 61 | 53 | 69 | 59 | 68 | 49 | 51 | 54 | 41 | 41 | 23 | 13 | 43 | **684** |
| Prizren | 6537 | 7091 | 8011 | 8211 | 7478 | 6511 | 6337 | 6472 | 6034 | 5281 | 4558 | 3896 | 2701 | 6001 | **85119** |
| Randobravë | 99 | 116 | 146 | 121 | 108 | 76 | 91 | 89 | 66 | 46 | 38 | 37 | 32 | 77 | **1142** |
| Reçan | 63 | 77 | 94 | 85 | 75 | 55 | 47 | 74 | 77 | 82 | 48 | 47 | 35 | 92 | **951** |
| Romajë | 327 | 276 | 307 | 314 | 307 | 267 | 192 | 175 | 129 | 113 | 100 | 63 | 45 | 132 | **2747** |
| Sërbicë e Epërme | 11 | 11 | 25 | 24 | 24 | 8 | 11 | 12 | 10 | 15 | 10 | 4 | 1 | 13 | **179** |
| Sërbicë e Poshtme | 43 | 49 | 66 | 91 | 78 | 53 | 45 | 35 | 40 | 45 | 36 | 25 | 25 | 43 | **674** |
| Skorobishtë | 89 | 79 | 102 | 129 | 87 | 92 | 75 | 89 | 74 | 86 | 62 | 45 | 24 | 95 | **1128** |
| Smaç | 37 | 29 | 31 | 43 | 31 | 47 | 20 | 30 | 21 | 25 | 19 | 15 | 5 | 22 | **375** |
| Sredskë | 2 | 2 | 0 | 1 | 2 | 0 | 2 | 5 | 4 | 2 | 6 | 7 | 6 | 30 | **69** |
| Struzhë | 4 | 7 | 10 | 18 | 10 | 3 | 4 | 7 | 13 | 7 | 2 | 2 | 4 | 11 | **102** |
| Shkozë | 67 | 70 | 80 | 95 | 86 | 83 | 51 | 68 | 38 | 34 | 37 | 18 | 21 | 40 | **788** |
| Shpenadi | 87 | 88 | 127 | 130 | 125 | 106 | 88 | 88 | 81 | 78 | 49 | 23 | 31 | 67 | **1168** |
| Trepetnicë | 14 | 13 | 12 | 14 | 13 | 8 | 13 | 8 | 10 | 8 | 8 | 6 | 3 | 8 | **138** |
| Tupec | 48 | 31 | 32 | 33 | 51 | 53 | 39 | 19 | 16 | 20 | 19 | 13 | 7 | 17 | **398** |
| Velezhë | 23 | 24 | 46 | 50 | 32 | 33 | 32 | 30 | 48 | 25 | 27 | 16 | 11 | 63 | **460** |
| Vërbiçan | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **0** |
| Vërmicë | 67 | 56 | 78 | 74 | 83 | 61 | 36 | 40 | 41 | 41 | 29 | 18 | 7 | 30 | **661** |
| Vlashnjë | 191 | 200 | 206 | 177 | 174 | 119 | 137 | 109 | 120 | 66 | 51 | 39 | 30 | 81 | **1700** |
| Zojz | 75 | 73 | 76 | 113 | 97 | 63 | 70 | 57 | 51 | 45 | 26 | 28 | 23 | 31 | **828** |

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Zym | 126 | 118 | 151 | 180 | 174 | 171 | 140 | 133 | 144 | 108 | 79 | 73 | 48 | 137 | **1782** |
| Zhivinjan | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **0** |
| Zhur | 550 | 580 | 619 | 633 | 606 | 481 | 473 | 426 | 352 | 295 | 260 | 164 | 115 | 355 | **5909** |

*Harta nr 2 Harta fizike e Kosovës dhe ajo morfologjike e Prizrenit , aneksi i hartave, faqe 3 ( burimi i të dhënave për vendbanimet zyrtare, Agjencia e Statistikave të Kosovës, ndërsa kufiri i komunës është marr nga të dhënat digjitale të hartës zonale të komunës së Prizrenit.*

*Harta nr.3 Zona kadastrale e komunës së Prizrenit ,* aneksi i hartave, faqe 4 *(burimi i të dhënave për vendbanimet zyrtare, Agjencia e Statistikave të Kosovës, ndërsa kufiri i komunave kadastrale është marr nga të dhënat digjitale të hartës zonale të komunës së Prizrenit).*

## 1.3 Hidrografia -lumenjtë dhe liqenet

Komuna e Prizrenit është një prej komunave më të pasura me ujëra sipërfaqësorë dhe nëntokësorë. Lumenjtë e kësaj komunë i takojnë pellgut të lumit Drini i Bardhë i cili derdhet në Detin Adriatik.

Në komunën e Prizrenit ndodhet një rrjet i dendur i lumenjve. Lumi më i gjatë dhe më i rëndësishëm në Prizren është Drini i Bardhe (111 km). Ajo hyn në Prizren nga ana veriore dhe vazhdon rrugën e tij kah Shqipëria dhe Deti Adriatik. Lumi formon një liqe të vogël në fshatin Dorusht. Lumi Lumbardhi i gjatë 35 km, rrjedh nga Zhupa dhe vazhdon nëpr qendrën e Prizrenit. Një lum tjetër i rëndësishëm është Lumi Toplluha i gjatë 37 km. Ajo hyn në Komunën e Prizrenit nga ana veriore prej Mamushës dhe derdhet në Drinin e Bardhe në fshatin Krajk. Sipas profilit komunal të Prizrenit ky lym ka rrezikshmëri më të madhe të vërshimit. Të gjithë lumenjtë e territorit të Prizrenit rrjedhin kah Drini i Bardhë, dhe i takojnë derdhjes së Detit Adriatik.

Klima e Prizrenit ka karakter kontinental me një ndikim të lehtë të klimës mesdhetare në lartësistë më të ulta, ndërsa në male dominon klima e ashpër alpine. Klima mesdhetare vjen nga deti adriatik nëpërmes të kanjonit të Drinit të Bardhë. Karakteristikat e buta klimatike janë arsye e resurseve të pasura natyrore. Kompania rajonale për furnizim me ujë dhe menaxhimin e ujërave të zeza “Hidroregjioni Jugor” është autoriteti përgjegjës për mirëmbajtjen dhe për furnizim me ujë të pijshëm për popullatën e komunës se Prizrenit. Një ndër qëllimet themelore të kompanisë është të siguroj ujë të kualitetit të pijes (në marrëveshjeme standardet **WHO** për ujë të pijshëm), në sasi të mjaftueshme, me presion të mjaftueshëm, pa ndërprerje dhe me çmime të arsyeshme për konsumatorin. Rrjeti furnizues që i kryen sherbimet perfshinë 4 njësi operacionale: Njësinë Prizren, Suharekë, Dragash dhe Malishevë. Furnizimi me ujë bëhet prej burimeve vetanake. Në nivel te Kompanisë furnizohen edhe 76 fshatra që janë të kyçur ne rrjetin e Kompanise Regjionale Prizren, Suharekë, Malishevë dhe Dragash.Numri i popullatës në të cilen Kompania e Ujesjellesit Regjional Prizren i kryen sherbimet e veta vleresohet të jetë rreth 200.000 banorë. Kapaciteti prodhues sillet rreth 1100 l/sec.- Kapaciteti ndryshon varësisht nga kapacitetit i burimeve. Furnizimi bëhet 40% me pompa, 60% me gravitet.

*Harta 4. Harta hidrografike në Kosovë dhe në komunën e Prizrenit , aneksi i hartave, faqe 5*
*Burimi i të dhënave: Vjetari statistikor 2023 Agjencia e Statistikave të Kosovës.*

*Harta 5. Harta hidrografike në komunën e Prizrenit , aneksi i hartave, faqe 6*

*Burimi i të dhënave: Për vendbanimet zyrtare Agjencia e Statistikave të Kosovës, ndërsa rrjeti hidrografik është digjitalizuar nga hartat topografike (gjeoportali kombëtar).*

## KREU II –të

## 2. DEMOGRAFIA

Numri i popullsisë dhe vendbanimet janë një indikator i rëndësishëm për demografinë. Për të identifikuar numrin e popullsisë kemi shfrytëzuar të dhënat e regjistrimeve të popullsisë nga Agjencija e Statistikave të Kosoves (ASK) ndër vite. Në Kosovë regjistrimet zyrtare të popullsisë pas luftës së fundit, janë bërë në vitin 2011 dhe në këtë vit/2024. Pasqyrën e popullsisë së Komunës së, vendbanimet, aspektet gjinore dhe variablat krahasimore si dhe diagramet sipas trendeve dhe zhvillimeve të Komunës së Prizrenit do ti paraqesim në tabeloret dhe diagramet e mëposhtme:

*Tab.3. Nr. Popullsia e Komunës së Prizrenit.sipas gjinisë dhe etnive 2011*

| Gjithsej | Gjinia | | Etnia | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Komuna e Prizrenit | Meshkuj | Femra | Shqiptarë | Serbë | Turq | Boshnjak | Rom | Ashkali | Egjiptas | Goran | Të tjerë |
| 177781 | 89176 | 88605 | 145718 | 237 | 9091 | 16896 | 2899 | 1350 | 168 | 655 | 767 |

*Tab. Nr 4. Popullsia sipas tipit të vendbanimit, gjinisë dhe kontingjenteve themelore 2011*

| | Popullsia | | | | | | | Popullsia e aftë për punë | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Komuna e Gjilanit | Gjithsej | Meshkuj | Femra | Foshnje 0 vjeç | Fëmijë 1-6 | Fëmijë 7-14 | Rinia 15-27 | 15-64 | Meshkuj | Femra | 65 + |
| Gjith. | 177781 | 89176 | 88605 | 3253 | 17997 | 27949 | 43288 | 117178 | 58271 | 58907 | 11404 |
| Urban | 94517 | 46884 | 47633 | 1573 | 8792 | 14106 | 21999 | 63547 | 31217 | 32330 | 6499 |
| Rural | 83264 | 42292 | 40972 | 1680 | 9205 | 13843 | 21289 | 53631 | 27054 | 26577 | 4905 |

*Tab. Nr 5 Gjithsej popullsia e komunës së Prizrenit .e vlerësuar për vitin 2024*

| Komuna e Prizrenit Sipërfaqja në km² | Popullsia e vlerësuar 2023 | Shtimi natyror | Bilanci i migrimeve (2023) | Rritja e Përgjithshme (shtimi natyror dhe migrimi) për vitin 2023 | Popullsia e vlerësuar/ 2023 | Numri i banorëve në 1 km² |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 627 km² | 193806 | 1755 | -1461 | 294 | 194100 | 310 |

[2] Burimi: Agjencioni i Statistikës së Kosovës (ASK); Data e botimit: Dhjetor, 2023

https://askapi.rks-gov.net/Custom/09246935-0817-4685-8174-c080ed3b7a6c.pdf

## 2.1. Kategoritë e banorëve të planifikuar për evakuim

- Nënat me fëmijë – Foshnje 0 vjeç janë 3253
- Fëmijë 0 deri në 14 vjeç, janë 49 199 banorë (Vjetari statistikor 2023)
- Të moshuarit mbi 70 vjeç- Janë 7 380 banore. (Vjetari statistikor 2023)
- Personat me nëvoja të veçanta 7652

*Tab. Nr 6 Popullsia e komunës së Prizrenit sipas gjinisë dhe grup-moshave 2011*

| Komunat e Prizrenit | | Gjithsej | Grup-mosha | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **0-4** | **5-9** | **10-14** | **15-19** | **20-24** | **25-29** | **30-34** |
| | Gjithsej | 177781 | 15252 | 16065 | 17882 | 17946 | 16553 | 14363 | 13407 |
| | Meshkuj | 89176 | 7935 | 8397 | 9349 | 9193 | 8467 | 7270 | 6575 |
| | Femra | 88605 | 7317 | 7668 | 8533 | 8753 | 8086 | 7093 | 6832 |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| **35-39** | **40-44** | **45-49** | **50-54** | **55-59** | **60-64** | **65-69** | **70-74** | **75-79** | **80+** |
| 13055 | 11712 | 10069 | 8383 | 6879 | 4811 | 4024 | 3419 | 2294 | 1667 |
| 6352 | 5676 | 4895 | 4191 | 3382 | 2270 | 1864 | 1618 | 1053 | 689 |
| 6703 | 6036 | 5174 | 4192 | 3497 | 2541 | 2160 | 1801 | 1241 | 978 |

*Tab. Nr 7 Kategoritë e pensionistëve në Komunën e Prizrenit*

| **Kategoritë e pensionistëve në Komunën e Prizrenit** | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pensionistët kointribues | Pensione bazë | Pens. e Personave me Aftësi të Kufizuar | FSK | Pens. Invalidor i Punës | Trepça | TMK | Pen. Paraplegjik e Tetraplegjik | Pensione familjare | Kompensime monetare | Arsimi | Totali |
| **5406** | **13931** | **2009** | **38** | | **0** | **102** | **386** | **295** | | | |

2 Burimi: Agjencioni i Statistikës së Kosovës (ASK);

*Tab 8 Punëkërkuesit sipas moshës dhe gjinisë (Burimi i të dhënave: Punëkërkuesit të regjistruar - AKTIV - deri më 31.10.2024 – Zyra e Punësimit - Prizren*

| Grupë mosha | Totali | Femër | Mashkull |
|---|---|---|---|
| **15 - 24** | 650 | 281 | 369 |
| **25 - 29** | 592 | 290 | 302 |
| **15 - 29** | 1242 | 571 | 671 |
| **30 - 39** | 1166 | 627 | 539 |
| **40 - 54** | 1399 | 726 | 673 |
| **55+** | 748 | 409 | 339 |
| **Total** | **4555** | **2333** | **2222** |

*Tab 9 Punëkërkuesit sipas nivelit të shkollimit dhe gjinisë (Burimi i të dhënave: Punëkërkuesit të regjistruar - AKTIV - deri më 31.10.2024 – Zyra e Punësimit - Prizren*

| Niveli i edukimit | Totali | Femër | Mashkull |
|---|---|---|---|
| **Pa Kualifikuar** | 999 | 554 | 445 |
| **Klasët I –IX (Shkolla fillore)** | 2685 | 1324 | 1361 |
| **Arsim i mesëm profesional** | 432 | 186 | 246 |
| **Shkollë e mesme - gjimnaz** | 139 | 72 | 67 |
| **Bachelor** | 263 | 173 | 90 |
| **Master** | 37 | 24 | 13 |
| **PhD** | 0 | 0 | 0 |
| **Total** | **4555** | **2333** | **2222** |

*Tab 10 Punëkërkuesit sipas përbërjet etnike dhe gjinisë (Burimi i të dhënave: Punëkërkuesit të regjistruar - AKTIV - deri më 31.10.2024 – Zyra e Punësimit - Prizren*

| Etniciteti | Totali | Femër | Mashkull |
|---|---|---|---|
| **Shqiptar** | 3111 | 1592 | 1519 |
| **Serb** | 12 | 5 | 7 |
| **Boshnjak** | 693 | 387 | 306 |
| **Rom** | 342 | 161 | 181 |
| **Ashkali** | 126 | 58 | 68 |
| **Egjiptas** | 7 | 2 | 5 |
| **Malazez** | 1 | 1 | 0 |
| **Turk** | 255 | 122 | 133 |
| **Tjetër** | 8 | 5 | 3 |
| **Total** | **4555** | **2333** | **2222** |

*Grafiku nr 1 Numri i popullsisë ndër vite në Komunën e Prizrenit.*




## 2.2. Dendësia e popullsisë

Komuna e Prizrenit me dendësi mesatare rreth 310 b/km², bënë pjesë në komunat me dendësi relativisht të lartë të banimit në Kosovë. Dendësia e popullsisë në Prizren është e ndryshme në vendbanimet e kësaj komune, ku radhë të parë është e lidhur me kushtet natyrore, shoqërore-ekonomike etj. Pjesët më të banuara janë ato të ulëta fushore, që kanë ndikuar lidhjet e mira gjeokomunikative me komunat tjera, duke përmendur kushtet klimatike, ujërat dhe tokat produktive. Qyteti i Prizrenit me rrethinë ka dendësinë më të madhe të popullsisë me mbi 2000 banorë në një km², po ashtu edhe vendbanimet si Lagjeja Arbana ish. Dushanovë, Hoçë e Qytetit kanë një numër të madh të popullsisë, që është i shprehur edhe me dendësi të lartë. Pjesa më e madhe e vendbanimeve kanë dendësi prej 500-1000 banorë në një km², sikurse fshatrat Zym, Gjonaj, Zhur, Lubizhdë etj. Dendësi më të vogël të popullsisë kanë pjesët periferike të Komunës, të cilat shtrihen në Malin e Sharrit dhe Koritnik, por me një numër të vogël të popullsisë janë edhe fshatrat, të cilat janë të banuara nga komunitetet jo shqiptare, të cilat dendësia shkon më pak se 10 banorë 1km². Popullsia urbane është 94517 banorë, kurse ajo rurale 83264 banorë. Nëse e analizojmë në përqindje, atëherë Komuna e Prizrenit ka 53.2 % të popullsisë urbane dhe 46.8 % asaj rurale.

*Harta nr 6 Dendësia e popullsisë në komunën e Prizrenit sipas rrjetit 1km x 1km. ,* aneksi i hartave, faqe 7
*Burimi i të dhënave: Baza digjitale e të dhënave në GIS, Agjencia e Statistikave të Kosovës*

*Harta nr 7 Dendësia e popullsisë në komunën e Prizrenit sipas vendbanimeve.* aneksi i hartave, faqe 8
*(burimi i të dhënave për vendbanimet zyrtare, Agjencia e Statistikave të Kosovës, ndërsa kufiri i komunave kadastrale është marr nga të dhënat digjitale të hartës zonale të komunës së Prizrenit).*

### 2.2.1. Shperndarja e familjeve në bazë të grupeve etnike në komunën e Prizrenit

Komuna e Prizrenit është njëra ndër komunat që dallohet për strukurë heterogjene etnike. Në këtë territor përveç shqiptarëve jetojnë edhe turqit, boshnjakët, ashkalinjët, egjiptianët etj.

*Harta nr 8 Shpërndarja e popullsisë në Komunën e Prizrenit.* aneksi i hartave, faqe 9
*(burimi i të dhënave për vendbanimet zyrtare, Agjencia e Statistikave të Kosovës, ndërsa kufiri i komunës është marr nga të dhënat digjitale të hartës zonale të komunës së Prizrenit).*

*Tab nr 11 Përkatësia etnike e popullsisë në komunën e Prizrenit*

| | |
|---|---|
| Shqiptar | 145718 |
| Boshnjak | 16896 |
| Turq | 9091 |
| Rom | 2899 |
| Ashkali | 1350 |
| Serb | 237 |
| Egjiptian | 168 |
| Goran | 655 |
| Të tjerë | 767 |
| Numri i Përgjithshëm | 177781 |

*Grafiku nr 2. Përkatësia etnike në Komunën e Prizrenit 2011*[1]




## 2.2.2.Të punësuarit, të papunët dhe pensionistët

Papunësia është një ndër problemet me të cilin më së shumti po përballet shoqëria kosovare. Shkalla e papunësisë në Kosovë është më e larta në rajon. Kjo shkallë e lartë e papunësisë është 44.4%. Vlerësohet se 1/3 e popullsisë së Kosovës është nën moshën 16 vjeç, ndërkaq rreth 60% e popullsisë janë në moshë pune. Kjo shkallë e lartë e papunësisë prek më së shumti femrat, të cilat në bazë të të dhënave statistikore të Ask-së 2011, numri i të punësuarave femra, në Komunën e Prizrenit, arrin diku rreth 19.7 % nga numri total i të punësuarve.

*Tabela nr. 12 Numri i të punësuarve sipas gjinisë*

| Gjinia | Numri i të punësuarve | % |
|---|---|---|
| Meshkuj | 23705 | 80.3% |
| Femra | 5822 | 19.7% |
| Gjithsej | 29527 | 100.00% |

*Burimi i të dhënave ASK – Regjistrimi 2011.*

[1] Agjensia e Statistikave të Kosovës (Regjistrimi i Popullsisë 2011), Të dhënat demografike sipas komunave, Prishtinë 2011, f.49.

**Pensionistët**

Numri i pensioneve bazike të moshës në komunën e Prizrenit  ishte  13931 (janar-dhjetor 2023).

*Grafiku nr 3 Trendi në muaj për pensionet bazike te moshës*




Numri i pensioneve  kontribut-paguese të moshës ishte 5492 (dhjetor 2023 ).

Numri i pensioneve  me aftësi të kufizuara (mosha 18-65) ishte 2009  (gjendja dhjetor 2023 ).

*Grafiku nr 4 Trendi në muaj pensionet e personave me aftësi të kufizuara (mosha 18-65 vjeç)*




Numri i familje nga skema për fëmijët  me aftësi të kufizuara (mosha 1- 18) ishte 261 (gjendja dhjetor 2023 ).

Grafiku nr 5 Trendi në muaj , Femijët me aftësi të kufizuara (mosha 1-18 vjeç)




Numri i *anëtarëve, të familjeve të cilët kanë përfituar nga skema sociale* ishte 2300 (gjendja dhjetor 2023 ).

*Graf nr 6 Numri I anëtareve të familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale – viti 2023*




*Grafiku nr 7 Trendi në muaj Numri i familjeve të cilat kanë përfituar nga skema sociale*



## 2.3. Arsimimi

Procesi edukativo-arsimor në komunën e Prizrenit zhvillohet në objekte arsimore (çerdhe, objekte shkollore dhe objekte universitare publike dhe private , të ndërtuara në komunën e Prizrenit dhe atë në disa nivele, siç janë: niveli parashkollor në 5 çerdhe, fillor dhe i mesëm i ultë në 71 shkolla në funksion në 5 objekte shkollore , i mesëm i lartë, gjimnaze dhe profesionale në funksion , me gjithësej 90 Objekte shkollore , që nënkupton edhe stafin edukativo-arsimor prej 2286 mësimdhënësve, ndërsa të dhënat statistikore janë paraqitur në tabelat në vijim. Ndërsa shpërndarja e objekteve ( ndërtesave) shkollore në tabela dhe harta.

*Tabela nr. 13 Institucionet shkollore sipas niveleve dhe vitit në Komunën e Prizrenit*

| **Institucionet shkollore sipas niveleve dhe vitit në Komunën e Prizrenit** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Viti shkollor** | **Parashkollor/çerdhe** | **Fillor dhe i mesëm i ulët** | **I mesëm i lartë** | **Gjithsej** |
| **2015/2016** | - | 72 | 14 | 86 |
| **2016/2017** | - | 71 | 14 | 85 |
| **2017/2018** | - | 70 | 16 | 86 |
| **2018/2019** | - | 70 | 16 | 86 |
| **2019/2020** | - | 70 | 16 | 86 |
| **2020/2021** | - | 69 | 15 | 84 |
| **2021/2022** | 1 | 70 | 15 | 86 |
| **2022/2023** | 1 | 72 | 18 | 91 |
| **2023/2024** | 1 | 71 | 18 | 90 |

*Tabela nr 14 Numri i nxënësve në institucionet publike parauniversitare sipas viteve shkollore dhe gjinisë në Komunën e Prizrenit*

| **Numri i nxënësve në institucionet publike parauniversitare sipas viteve shkollore dhe gjinisë në Komunën e Prizrenit** | | | |
|---|---|---|---|
| **Vitet** | **Meshkuj** | **Femra** | **Gjithsej** |
| **2015/2016** | 17481 | 16018 | 33499 |
| **2016/2017** | 16957 | 15615 | 32572 |
| **2017/2018** | 16592 | 15461 | 32053 |
| **2018/2019** | 15817 | 14856 | 30673 |
| **2019/2020** | 15340 | 14266 | 29606 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **2020/2021** | 14981 | 13973 | 28954 |
| **2021/2022** | 14523 | 13493 | 28016 |
| **2022/2023** | 13954 | 13202 | 27156 |
| **2023/2024** | 13563 | 12967 | 26530 |

*Grafiku nr 8 Numri I nxënësve në institucionet publike parauniversitare sipas viteve shkollore në komunën e Prizrenit.*




.

*Tab 15: Numri i nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar sipas viteve*

| **Numri i nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar sipas viteve** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Vitet | **Arsimi parashkollor** | **Arsimi parafillor** | **Arsimi fillor-të mesëm të ulët** | **Arsimi e mesëm të lartë** |
| *2015/2016* | 10 | 1739 | 24059 | 7691 |
| *2016/2017* | 10 | 1814 | 22985 | 7763 |
| *2017/2018* | 139 | 1808 | 22194 | 7912 |
| *2018/2019* | 14 | 1688 | 21607 | 7364 |
| *2019/2020* | 14 | : | 21044 | 6773 |
| *2020/2021* | 71 | 1694 | 20686 | 6503 |
| *2021/2022* | 270 | 1602 | 20101 | 6043 |
| *2022/2023* | 233 | 1612 | 19486 | 5825 |
| *2023/2024* | 168 | 1556 | 19163 | 5643 |

*Grafiku nr 9. Numri i nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar sipas viteve*




*Tab 16 Numri i fëmijëve sipas përkatësisë etnike në arsimin parauniversitar*

| | Shqiptar | Turq | Bosnjakë | Ashkalinjë | Romë | Egjiptianë | Goran | Tjeter | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Arsimi parashkollor | 168 | | | | | | | | 168 |
| Arsimi parafillor | 1313 | 105 | 88 | 16 | 33 | | 1 | | 1556 |
| arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët | 16293 | 973 | 1251 | 249 | 385 | 4 | | 5 | 19160 |
| arsimin e mesëm të lartë | 4858 | 345 | 430 | 4 | 5 | | | 1 | 5643 |

*Tabela 17. Numri i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë*

| Shkolla profesionale | | | Gjimnaze | | | Gjithsej | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Meshkuj | Femra | Gjithsej | Meshkuj | Femra | Gjithsej | Meshkuj | Femra | Gjithsej |
| 1970 | 1673 | 3643 | 790 | 1210 | 2000 | 2760 | 2883 | 5643 |

*Tabela 18 Mësimdhënësit sipas niveleve 2023-2024*

| Mësimdhënësit sipas niveleve | Meshkuj | Femra | Gjithsej |
|---|---|---|---|
| Parashkollor | 0 | 18 | 18 |
| Paraf.fillor dhe i mesëm i ulët | 663 | 1092 | 1755 |
| I Mesëm i lartë | 289 | 215 | 504 |

Të dhënat për institucionet edukative-arsimore private të licencuara nga MASHTI

*Tab nr 19 Numri i fëmijëve në arsimin parashkollor dhe parafillor 2023- 2024*

| Parashkollor (0<5 vjeç) | | | Parafillor (5-< vjeç) | | | Gjithsej | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Meshkuj | Femra | Gjithsej | Meshkuj | Femra | Gjithsej | Meshkuj | Femra | Gjithsej |
| 166 | 172 | 338 | 121 | 116 | 237 | 287 | 288 | 575 |

Tabela 20. Numri i nxënësve në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë 2023-2024

| Fillor/mesëm i ulët | | | I mesëm i lartë | | | Gjithsej | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Meshkuj | Femra | Gjithsej | Meshkuj | Femra | Gjithsej | Meshkuj | Femra | Gjithsej |
| 757 | 654 | 1411 | 286 | 326 | 612 | 1043 | 980 | 2023 |

Numri i studentëve të regjistruar në nivelin bachelor në vitin akademik 2023/2024, Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" janë ne total 983 student prej tyre 644 ferma dhe 339 meshkuj . Ndersa ne nivelin Master janë te regjistruar 132 Student prej tyre 66 femra dhe 66 meshkuj.

*Harta nr 9 Organizimi i procesit mësimor sipas tipit të shkollave , aneksi i hartave, faqe 10, Burimi i të dhënave, Digjitalizim nga ortofotot, Gjeoportali kombëtar).*

### 2.3.1. Identifikimi i rreziqeve

Ekzistojnë rreth 90 objekte shkollore që frekuentojnë në këto objekteve shkollore, në arsimin parauniversitar të cilave shumica ju mungojnë shkallët emergjente për evakuim të nxënësve, ku në raste të fatkeqësive natyrore apo fatkeqësive tjera, ku mungojnë edhe shenjëzimet themelore informuese për nxënësit dhe mësimdhënësit, në rast të çfaqjes së nevojës për evakuim emergjent, ku mungojnë pajisjet për mbrojtje nga zjarri dhe fatkeqësi tjera si dhe edukimi bazik për reagim emergjent.

### 2.3.2. Rekomandime :

Për zvogëlimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera si zjarri, vërshimet etj. në objektet arsimore rekomandohet që të pajisen të gjitha shkollat:

-Pajisja me shkallë evakuimi për të gjitha objektet me 2 ose më tepër etazha;

-Pajisja me aparate kundër zjarrit, veshje mbrojtëse dhe vegla tjera për raste të fatkeqësive natyrore;

-Pajisja e objekteve me sinjalistikë për lajmërim të zjarrit dhe fatkeqësi tjera ;

-Pajisja e objekteve me shenjëzime informuese;

-Pajisja me planin e evakuimit për rastet e fatkeqësive, etj. ;

KREU I III-të

# 3. TË MIRAT MATERIALE, KULTURORE DHE TË MJEDISIT

## 3.1. Trashëgimia kulturore

Territori i Kosovës ka një rezervë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore ndër shekuj, në këtë rast nuk bënë përjashtim as Komuna e Prizrenit sa i përket trashëgimisë kulturore material dhe jo-materiale. Gjatë tërë historisë etniciteti lokal në përbërje të ndryshme , me kultura dhe besime fetare të ndryshme , me veqantitë-dallimet e tyre, ata kanë bashkë-jetuar por edhe kanë pasur dallime dhe kanë krijuar veqantitë kulturore në lokalitete përkatëse. Këto civilizime kanë lënë mbrapa një numër të konsiderueshëm të monumenteve që nga kohët e lashtësisë e deri në kohët modern. Në shumëllojshmërinë e vet kjo trashëgimi kulturore përfshinë objekte të trashëgimisë arkitekturale, arkeologjike, peizazh kulturor, etj. Si në pjesën tjetër të Kosovës, ashtu edhe në qytetin e Prizrenit trashëgimia kulturore( monumentet e trashëguara) mund të ndahet në tri periudha të ndryshme kohore: bizantine(ortodokse), monumente islamike dhe arkitektura vernakulare (lokacionet tradicionale, tregjet dhe qendrat urbane historike). Mbrojtja, ruajtja, restaurimi dhe mirëmbajtja e kësaj trashëgimie është kërkesë dhe nevojë imediate e kohës edhe për komunën tonë.

Trashëgimia kulturore dhe natyrore ka një rëndësi të madhe ekonomike, me mundësi të zhvillimit të turizmit që është një faktor kyç për zhvillimin e vendit dhe atë lokal. Njëkohësisht konsiderohet potencial për zhvillime dhe integrim të qëndrueshëm shoqëror ekonomik, në vend, rajon dhe me gjerë.

Më poshtë janë listuar asete të trashëgimisë natyrore dhe arkeologjike si dhe arkitekturale nën mbrojtje: LISTA E TRA SHEGIMISË K ULTURORE PËR MBROJTJE TË PERKOHSHME (2023-2024)

*Tab nr 21, Kategoria:Trashegimia arkeologjike /A. Nenkategoria: Monument/Ansambel*

| Emërtimi | Periudha | Vendi/Komuna | Statusi |
|---|---|---|---|
| Ura e vjetër e gurit në Prizren | Antikë, Mesjetë | Prizren | |
| Kisha e Shën Spasit (Shëlbuesit) | Mesjetë | Prizren | |
| Ura e vjetër e gurit në grykën e Lumbardhit (Bistricës) | Mesjetë | Prizren | |
| Kisha e Shën Nikollës –Tutiqëve | Mesjetë | Prizren | |
| Kisha e Shën Gjorgje Runoviqit | Mesjetë | Prizren | |
| Kisha e Shën Dielës – Dëftimi i Shën Mërisë | Mesjetë | Prizren | |
| Kisha e Shën Nikollës | Mesjetë | Prizren | |
| Kishë murgjish të Shën Nikollës në grykën e Bistricës | Mesjetë | Prizren | |
| Kisha e Nikollës në Shenjtë | Mesjetë | Sredskë, Prizren | Mbrojtur |
| Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë | Mesjetë | Sredskë, Prizren | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Kisha e Shën Gjergjit | Mesjetë | Sredskë, Prizren | Zonë e Veçantë e Mbrojtur |
| Kisha e Nikollës së Shenjtë | Mesjetë | Bogoshevcë, Prizren | Zonë e Veçantë e Mbrojtur |
| Kisha e Apostujve të Shenjtë (ose Premtit të Shenjtë) | Mesjetë | Mushnikovë, Prizren | Zonë e Veçantë e Mbrojtur |
| Kisha e Nikollës së Shejntë | Mesjetë | Mushnikovë, Prizren | Zonë e Veçantë e Mbrojtur |
| Kisha e Nikollës së Shejntë, | Mesjetë | Drajçiq, Prizren | Zonë e Veçantë e Mbrojtur |
| Kisha e Shën Mërisë me koleksionin e 7 ikonave në Pllanjan | Mesjetë | Pllanjan, Prizren | |
| Kisha e Shën Ilisë me 11 ikona në Llokvicë | Mesjetë | Llokvicë, Prizren | |
| Kisha e Shën Nikollës në Lubizhdë | Mesjetë | Lubizhdë, Prizren | |

*Tab nr 22 , A - Nenkategoria: Lokalitet Arkeologjik / Rezervate*

| | | | |
|---|---|---|---|
| Manastiri i i Arkangjelit të Shenjtë | Mesjetë | Prizren | Zonë e Veçantë e mbrojtur |
| Qyteti i Epërm (Vishegrad) | Mesjetë | Prizren | |
| Kisha e Shën Gjergjit | Mesjetë | Gornjasellë, Prizren | Zonë e Veçantë e mbrojtur |
| Gërmadhat e murgores dhe manastirit të Shën Pjetrit në Kabash | Mesjetë | Kabash, Prizren | |
| Mbetjet e pirgut mesjetar | Mesjetë | Kabash, Prizren | |
| Rrënojat e kishës varrezore në Quvik | Mesjetë | Kabash, Prizren | |
| Manastiri i Kryeengjujve | Mesjetë | Jabllanicë, Prizren | |
| Qyteti I Epërm(Vishegrad) –gërmadhat e keshtjellës së epërme | Mesjetë | Jabllanicë, Prizren | |
| Manastiri i Markut të Shenjtë | Mesjetë | Korishë, Prizren | Zonë e Veçantë e mbrojtur |
| Vetmia e Petrit të Shenjtë | Mesjetë | Korishë, Prizren | Zonë e Veçantë e mbrojtur |
| Rrënojat e kishës së Shën Nikollës | Mesjetë | Korishë, Prizren | |
| Rrënoja e kishës dhe të mureve në Korishë | Mesjetë | Korishë, Prizren | |
| Tumat Ilire dhe lokaliteti arkeologjik i periudhës romake | Parahistori, Romake | Korishë, Prizren | |
| Guri I murgjeve –mbetjet e kishes murgore | Mesjetë | Bilushë, Prizren | |
| Nekropola tumulare në Romajë | Parahistori | Romajë, Prizren | |
| Rrënojat e kishës me varre të vjetra | Mesjetë | Shpinadi, Prizren | |
| Gërmadhat e kishës Muzhiqan | Mesjetë | Muzhiqan, Prizren | |
| Tumat Ilire (Livadhet e Mëdhaja) | Parahistori | Kuzhnin, Prizren | |
| Lokaliteti Romak në Poslishtë:Villa Rustica Statio Mansio | Romake | Poslishtë, Prizren | |
| Lokaliteti arkeologjik shumështresor në Vlashnje | Parahistori,shumështresore | Vlashnje, Prizren | |
| Pikturimet shkëmbore te Guva e Mrrizit (Unike në Kosovë) | Parahistori | Murradem, Prizren | |
| Lokaliteti arkeologjik romak në Piranë (Arat Qeremide) | Romake | Piranë, Prizren | |

*Tabela nr. 23 Asetet e trashëgimisë kulturore – Arkitekturore*

| | | |
|---|---|---|
| Shtëpia e Musa Shehzades | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpia e Shuaip Spahiut | Shek. XIX | Prizren |
| Nishani i Suziut | Shek. XVI | Prizren |
| Përmendore mbivarrore e Emin Pashës | Shek. XIX | Prizren |

| | | |
|---|---|---|
| Shtëpia e familjes Grazhdo dhe Bilurdagu | Shek. XIX | Prizren |
| Teqja Halveti | Shek.XIX | Prizren |
| Xhamia e Mehmed Pashës | Shek.XVI | Prizren |
| Kompleksi i Mahallës së Marashit | Shek. XVIII - XIX | Prizren |
| Kulla e Sahatit - Muzeu Arkeologjik | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpia e familjes Shehu | Shek. XVIII | Prizren |
| Xhamia e Kukli Mehmed Beut | 1531 | Prizren |
| Minarja e Xhamisë Evrenos Jakup Beut | Shek. XVI | Prizren |
| Teqja e Kaderive - Rezaki | Shek. XVI | Prizren |
| Kroi i Esma Hanemit | Shek. XX | Prizren |
| Kroi i Destan Kabashit | Shek. XX | Prizren |
| Kompleksi Monumental i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit | Shek. XIX | Prizren |
| Kroi I Beledijes | Shek. XX | Prizren |
| Kërëk xhamia – Namazxhah | 1455 | Prizren |
| Xhamia e Emin Pashës | 1831 | Prizren |
| Shkolla e mesme Ryzhdie | Shek. XIX | Prizren |
| Xhamia e Sejdi Beut | Shek. XVII | Prizren |
| Xhamia e Ilijaz Kukës | Shek. XVI | Prizren |
| Xhamia e Çatip Sinanit - Levisha | Shek. XIX | Prizren |
| Xhamia e Suziut | 1513 | Prizren |
| Xhamia e Terzi mahallës | Shek. XVIII | Prizren |
| Xhamia e Terxhyman Iskenderit | Shek. XIX | Prizren |
| Xhamia e Haxhi Ramadanit | Shek. XIX | Prizren |
| Xhamia e Ahmed Beut | Shek. XIX | Prizren |
| Xhamia e Qohaxhi Mahmudit | Shek. XIX (XX) | Prizren |
| Xhamia e Sejdi beut në mahallën e Kurillës | Shek. XVII | Prizren |
| Xhamia e Xhafer Efendiut | Shek. XVI (XXI) | Prizren |
| Xhamia - Mezxhid | Shek. XX | Prizren |
| Xhamia e Haxhi Kasëmit | Shek. XVII | Prizren |
| Kisha e Shën Gjergjit (Sinodale) | Shek. XIX | Prizren |
| Kisha e Shën Pantelemonit | Shek. XIX | Prizren |
| Shkolla ortodokse për priftërinjë "Kirili dhe Metodit të Shenjët" | Shek. XIX - XX | Prizren |
| Kompleksi i rezidencës Episkopike | Shek. XIX - XX | Prizren |
| Kompleksi i Kishës Katolike Zonja Ndihmëtare | Shek. XIX - XX | Prizren |
| Teqja e Rufaive | Shek. XIX | Prizren |
| Teqja e Kaderive - Zingjirli | Shek. XVII | Prizren |
| Kompleksi i Karabashit | Shek. XIX | Prizren |
| Tyrbja e Tezqir babës | Shek. XIX | Prizren |
| Tyrbja e Dallgën babës | Shek. XIX | Prizren |
| Tyrbja e Musa Efendiut | Shek. XVI | Prizren |
| Kompleksi i Teqes Sinani | Shek. XVII | Prizren |
| Tyrbja e Kalendar babës | Shek. XVI | Prizren |
| Medresja e Sinan Pashës | Shek. XIX | Prizren |
| Kroi i Shatërvanit | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpia e Adem Agë Gjonit | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpia e familjes Fishekçiu | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpia e familjes Pomaku | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpia e familjes Myftiu | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpia e Ymer Prizrenit | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpia e Vahid Destan Kabashit | Shek. XIX | Prizren |

| | | |
|---|---|---|
| Shtëpia e Destan Kabashit | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpiai Shani Efendiut | Shek. XIX | Prizren |
| Selamllëku i Shani Efendiut | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpia e Ismet Sokolit | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpia e familjes Rekathati | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpia e famoljes Kirajtanit | Shek. XIX | Prizren |
| Islahana e vjetër | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpia e familjes Arapi | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpia e Jonuz Agallarit | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpia e familjes Okqaboll | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpia e Zija Beut | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpia e familjes Shpejti | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpia e familjes Mijiq | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpia e familjes Paçarizi | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpia e familjes Perolli | Shek. XIX | Prizren |
| Ndërtesa e Kuvendit të vjetër - Beledije | Shek. XIX | Prizren |
| Xhamia e Myderiz Ali Efendiut | Shek. XVI | Prizren |
| Tabakhane | Shek. XVI | Prizren |
| Kompleksi Nënkalaja, Pantelija dhe Potok mahalla | Shek. XIX-XX | Prizren |
| Kino Lumbardhi | Shek. XX | Prizren |
| Kinemaja e Parë e qytetit | Shek. XIX | Prizren |
| Gjimnazi Gjon Buzuku | Shek. XX | Prizren |
| Kazerma e vjetër - Internati | Shek. XIX | Prizren |
| Stacioni i trenit | Shek. XX | Prizren |
| Konsulata Austriake | Shek. XIX | Prizren |
| Ndërtesa e Armatës | Shek. XX | Prizren |
| Hani dhe Nallbani i familjes Kovaç * | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpia e Shemsidin Fishekqiut | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpia e Familjes Shukriu | Shek. XIX | Prizren |
| Posta e parë e qytetit | Shek. XX | Prizren |
| Trafot elektrike në Prizren | Shek. XX | Prizren |
| Kroi i Binbashit | Shek. XIX | Prizren |
| Kroi i Qoragës | Shek. XIX | Prizren |
| Mulliri në Tabakhane | Shek. XX | Prizren |
| Teqja e Melamive | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpia e familjes Bërlajolli | Shek. XX | Prizren |
| Shtëpija e Xhemajli Ereneit | Shek. XIX | Prizren |
| Shtëpia e Familjës Kabashi(Hapqiu) | Shek. XIX | Prizren |
| Kompleks banimi i familjes Drini | shek XIX | Prizren |
| Kompleks banimi i familjes Xhejshylmedine | Shek XIX | Prizren |
| Kompleks banimi i familjes Hadro | Shek XIX | Prizren |
| Ndërtesa e SHKA Agimi | Shek.XX | Prizren |
| Kompleks banimi i familjes Kajmakçi | Shek. XIX-XX | Prizren |
| Shtëpia e familjes Gjonaj | Shek.XIX | Prizren |
| Shtëpia e familjes Ukallo | Shek.XIX | Prizren |
| Kompleksi I Sarajit të vjetër | Shek. XIX-XX | Prizren |
| Ish Hotel Selaniku - Strehimorja e Grave | Shek. XIX-XX | Prizren |
| Ish Hotel Sumadija - Qendra Kulturore Hebraike | Shek.XX | Prizren |
| Shtëpia e familjes Rada | Shek.XIX | Prizren |
| Kulla e Sahatit e Mahmud Pashës | Shek. XIX | Mamushë, Prizren |
| Mulliri i Rexhep Shatrit | Shek. XIX | Dedaj, Prizren |

*Tabela nr 24 Fushat e konservimit arkitekturor*

| | |
|---|---|
| Qendra historike e Prizrenit | Prizren |
| Fshati Zym | Zym Prizren |

Është bërë lista e objekteve të trashëgimisë kulturore të Komunës së Prizrenit për marrjen nën mbrojte të ligjit nga Instituti për Ruajtjen e Monumenteve të Kosovës. Komuna e Prizrenit ka një thesar të çmuar të trashëgimisë kulturore, siç janë: Fushat e konservimit arkitekturor, Trashegimia arkeologjike, monumentet e natyres etj. Kalaja e Prizrenit është lokacioni më i rëndësishëm arkeologjik në Komunë dhe përcakton karakteristikat monumentale të Prizrenit sidomos nga shekujt 11-14. Ne Romajë dhe Kushnin ndodhen grumbuj gurësh që datojnë nga periudha parahistorike. Edhe në Korishë, Nashec dhe Vlashnje gjenden mbetjet arkeologjike të fortifikatave. Numri i përgjithshëm i lokacioneve arkeologjike në Prizren është 24 dhe ato paraqesin shembujt e monumenteve antike dhe trashëgimisë arkeologjike që datojnë nga shekulli 1 deri në shekullin 14 të erës sonë.



Figura 1: Prizreni dhe Kalaja

Sipas klasifikimit të monumenteve arkitektonike, në Komunën e Prizrenit ndodhen 50 objekte publike që shfrytëzohen ose janë pronë publike shtetërore e Komunës së Prizrenit. Këtu hyjnë 5 objekte arsimore, 3 objekte të ambasadave, dhe një objekt shëndetësor që njihen si monumente arkitektonike në Prizren. Objektet tjera publike përfshijnë mullinjtë, krojet publike dhe objektet administrative. Si monumente me vlerë arketetkonike janë regjistruar edhe hidrocentrali, ndërtesa e vjetër e postës dhe ura e gurit në qendër të qytetit. Në pjesën rurale të Komunës ka 24 objekte të regjistruara si monumente.

Qyteti i Prizrenit ka 66 objekte civile që shfaqin karakteristika tradicionale arkitektonike që shfrytëzohen nga banorët e saj. Pos këtyre objekteve, janë edhe 14 të tjera që ndodhen në fshatrat e Prizrenit. Të gjitha lokacionet urbane dhe komplekset që janë regjistruar si tërësi e objekteve ndodhen në qytetin e Prizrenit. Thelbi i zonës së mbrojtur urbane të Prizrenit, që ka një plan urban të ruajtjes, (e përfunduar më 2007 dhe aprovuar më 2008) ka lokacione të ndryshme në listën e saj si p.sh. Muzeu i Lidhjes së Prizrenit, sheshi i Shatërvanit, Marashi dhe kompleksi i Nënklasë. Duhet cekur edhe lokacionet tjera urbane te mbrojtura si sheshi i Karabashit, i gjimnazit Gjon Buzuku, dhe kompleksi i teqesë Sinani.

*Tabela 25: Inventari i trashëgimisë kulturore në Komunën e Prizrenit*

| Nr. | Objekti | Prizren |
|---|---|---|
| 1. | Xhami | 46 |
| 2. | Namazxhah | 1 |
| 3. | Medrese | 6 |
| 4. | Ruzhdije | 1 |
| 5. | Bibliotekë | 1 |
| 6. | Nishan | 2 |
| 7. | Teqe | 12 |
| 8. | Tyrbe | 19 |
| 9. | Kisha ortodokse | 26/10 |
| 10. | Manastire | 2 |
| 11. | Kisha katolike | 3/2 |
| 12. | Ipeshk varreza | 5 |
| 13. | Ark. e banimit | 118 |
| 14. | Objektet publike | 41 |
| 15. | Mulli | 4 |
| 16. | Valavicë | |
| 17. | Hambar | 1 |
| 18. | Lok. Arkeologjike | 30 |
| | Gjithsej: | 330 |

*Tabela 26,  Numri i objekteve të trashëgimisë kulturore në Prizren*

| | **Objektet civile** | **Objektet publike** | **Objektet fetare** | **Komplekset dhe zonat urbane** | **Lokacionet arkeologjike** | **Totali** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Qyteti i Prizrenit | 66 | 26 | 44 | 7 | 2 | 145 |
| Fshatrat | 14 | 24 | 86 | 0 | 22 | 146 |
| Totali | 80 | 50 | 130 | 7 | 24 | 291 |



*Figura 2. Hamami Gazi Mehmet Pasha dhe rrethina e saj*



*Figura 3 Xhamia e Sinan Pashës*





*Figura 4: Kisha e Shën Premtes*

*Figura 5: Kisha e Shën Shpëtimtarit*



*Figura 6. Katedralja e Shën Gjonit*

Janë evidentuar dhe kategorizuar edhe 74 objekte me karakteristika të theksuara të arkitekturës folklorike si: ura, rrugë, kroje, shtëpi, kanale dhe zona, Për ruajtjen, kultivimin dhe prezantimin e vlerave të trashëgimisë së kulturës materiale e shpirtërore, në qytetin e Prizrenit, funksionojnë dhe bashkëveprojnë mes veti, një varg institucionesh kulturore, siç janë:

- Shtëpia e Kulturës me bibliotekat për fëmijë e të rritur,
- Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, në kuadër të cilit janë: Muzeu Arkeologjik, Muzeu i Hidroelektroekonomisë, Kompleksi Memorial i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (me Muzeun Historik,Sektorin Etnografik,Galerinë e Arteve dhe Bibliotekën),
- Arkivi Historik Regjional,
- Kinema "Lumëbardhi"me kopshtin veror për projektim të filmave nën qiellin e hapur,
- Dhjetëra SHKA-amatore,
- Klubi i Letrarëve, Shoqata e Piktorëve dhe OJQ të involvuara në sferën e kulturës.

Disa nga këto subjekte kryejnë punë nga fushë veprimtaria e tyre, në mbrojtjen e objekteve të rëndësisë së veçantë të trashëgimisë së kulturës materiale siç janë: Kompleksi "KALAJA"dhe "MARASHI" objektet fetare e sakrale të konfesionit mysliman, katolik dhe ortodoks, veprat e artit, si: ura, banja publike, etj  dhe  shtëpi me vlera të theksuara të arkitekturës folklorike.

*Harta nr 10 Asetet e trashëgimisë kulturore,  aneksi i hartave, faqe 11,*
*Burimi i të dhënave; Ministria e Kulturës , rinisë dhe sportit , https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/5123-02-1_lista_total_shqip.pdf*

*Harta nr 11 Trashëgimia kulturore dhe natyrore,  aneksi i hartave, faqe 12, Burimi i te dhënave – Harta Zonale e komunës se Prizrenit, https://kk.rks-gov.net/prizren/urbanizem/harta-zonale-draft/*

*Harta nr. 12 Zonë turistike me interes të veqantë, aneksi i hartave, faqe 13, Burimi i te dhënave për Zonën e veçant të mbrojtur – Harta Zonale e komunës se Prizrenit, https://kk.rks-gov.net/prizren/urbanizem/harta-zonale-draft/*

## 3.2. PARQET NACIONALE DHE REZERVATET

### 3.2.1. Parqet natyrore dhe rezervatet

Parku Nacional “Malet e Sharrit” me një sipërfaqe prej 19.500 ha karakterizohet me lloje të shumta relikte dhe endemike të florës, vegjetacionit dhe faunës. Pastaj kemi rezervatet e natyrës si:

- Popovo Prase - me sipërfaqe prej 30 ha, një rezervat bimor me përbërje të pastër të munikës-arnenit (Pinus Heldreichi);
- Oshlaku - me sipërfaqe prej 20 ha, një rezervat bimor me përbërje të pastër të munikës-arnenit (Pinus Heldreichi) dhe i disa bimëve endemike;
- Golemi Bor – me sipërfaqe prej 35 ha, rezervat bimor i llojit të Molikës dhe i disa shpendëve këngëtarë;
- Gryka e Lumëbardhit – me një sipërfaqe prej 200 ha, një monument natyror me karakter hidrologjik dhe peizazhor;
- Rrapi në Marash (Platanus Orientalis) - një monument natyre me karakter botanik, edukativ, shkencor dhe edukativ;
- Vidhi fushor (Ulmus Campestris) në fsh. Lukinaj - ish monumenti natyror me karakter botanik.

*Harta nr.13 parku nacional “Mali Sharr” në Komunën e Prizrenit aneksi i hartave, faqe 14, Burimi i te dhënave për Parkun kombëtar “Sharri” – Harta Zonale e komunës se Prizrenit, https://kk.rks-gov.net/prizren/urbanizem/harta-zonale-draft/*

### 3.2. 2. Sipërfaqet pyjore

Pyjet në komunën e Prizrenit kanë sipërfaqe prej 8,500 ha ku hyjnë pyjet e dendura dhe ato me intensitet më të ulët që janë vetëm 13 % e komunës . Rregjioni i Hasit ka më së shumti pyje në Komunën e Prizrenit. Një sasi e madhe e pyjeve të dendura gjendet në veri të Maleve të Pashtrikut në kufi të Kushninin dhe të Lubizhdës së Hasit. Pjesa tjetër e Hasit është e mbuluar me shkure. Në malet e Sharrit gjenden pyjet e densitetit të ultë ndërsa pyjet më të dendura janë në pjesët më të larta malore.

*Tabela nr. 27 Sipërfaqet pyjore dhe karakteristikat vegjetative*

| **Lloji** | **Sipërfaqja (ha)** | **Përqindja (%)** |
|---|---|---|
| Shkuret | 11,578 | 18.15 |
| E dendur | 4,473 | 7.01 |
| Dendësia e ultë | 3,995 | 6.26 |
| Totali | 20,047 | 31.43 |

Parku Nacional “Malet e Sharrit” me një sipërfaqe prej 19.500 ha karakterizohet me lloje të shumta relikte dhe endemike të florës, vegjetacionit dhe faunës. Pyjet në komunen e Prizrenit kanë sipërfaqe prej **20046** ha, ku hyjnë pyjet e dendura dhe ato me intensitet më të ulët që janë vetëm 31.1 % e komunës. Një sasi e madhe e pyjeve të dendura gjendet në pjesën perëndimore dhe lindore të komunës. Kjo zonë paraqet hapësira pyjore ku periudha e rotacionit të një brezi pemësh është më e gjatë se 50 vjet pas së cilës pylli rigjenerohet natyrshëm ose artificialisht (me mbjellje ose mbirje fare). Në komunën e Prizrenit duke pasur parasysh shkallën e rritjes së rrezikut nga zjarret në pyje gjatë këtyre viteve të fundit duhet të merren masa për mbrojte nga zjarri pasi që është rrezik përmanent shkatërrimi i florës dhe faunës.

*Harta nr.14 Shtrirja e pyjeve në Komunën e Prizrenit , aneksi i hartave, faqe 15, Burimi i te dhënave për sipërfaqet me Pyje , Digjitalizim nga Ortofotot, Gjeoportali kombëtar).*

### 3.2.3. Zonat e mbrojtura dhe trashëgimia natyrore

Përpos begative të tjera në territorin e Komunës së Prizrenit karakterizohet me lloje të shumta relikte dhe endemike të florës, vegjetacionit dhe faunës. Trashëgimia natyrore ka një rëndësi të madhe ekonomike, me mundësi të zhvillimit të turizmit që është një faktor me rëndësi për zhvillimin e vendit. Humbja e trashëgimisë natyrore është çështje e rëndësisë jetike për të gjithë. Shkaktarët janë të ndryshëm si: ndërtimet kaotike në afërsi të zonave me trashëgimi natyrore, prerjet e pakontrolluara të pyjeve, erozioni, shkatërrimi i monumenteve të natyrës me vlera, ndotja e zonave kryesisht turistike, e të gjitha këto si pasojë e mos efikasitetit të organeve menaxhuese për mbrojtje të trashëgimisë natyrore në pajtim me kriteret ligjore dhe standardet e përcaktuara vendore e ndërkombëtare si dhe vetëdija e ulët e popullatës për ruajtjen e zonave të mbrojtura si potencial i zhvillimit të turizmit dhe ekonomisë së vendit. Në mesin e zonave të identifikuara është edhe zona “Qendra historike e Prizrenit”, si pjesë kryesore e qytetit, me specifika të veçanta krahas zonave tjera, sepse në vete përmban monumente të trashëgimisë fetare dhe kulturore të komuniteteve të ndryshme, që jetojnë në qytetin e Prizrenit . (Plani Hapësinor i Kosovës, 2010 ).

https://mmphi.rks-gov.net/MMPHIFolder/DivisionDocs/2022_55743870-1cda-4ea5-8e8d-796ae64b7766.pdf

Duke konsideruar ruajtjen e resurseve dhe mbrojtjen e trashëgimisë natyrore si qëllim të zhvillimit hapësinor, ky aspekt ka për qëllim arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor, të zhvillimit të kontrolluar hapësinor, mbrojtjen dhe respektimin e resurseve, të trashëgimisë natyrore dhe kulturore dhe duke u bazuar në gjendjen ekzistuese e cila thekson çështjet e:

- humbjes së tokës kualitative bujqësore;
- shkallën e lartë të ndotjes mjedisore;
- shfrytëzimin jo-racional të resurseve dhe zgjerimin e pakontrolluar të vendbanimeve
- Rritja e pakontrolluar e vendbanimeve ( alarmante).
- Çasja ndaj zgjidhjeve të ardhshme duhet të përbëhet nga veprimet e koncentruara për ruajtjen e burimeve natyrore dhe ambientale.

Në Kosovë ndodhen 75 zona të mbrojtura natyrore me 46.437 ha (4.25% e territorit të Kosovës). Në Prizren ndodhen tre rezervate natyrore: Maja e Arnetit, Oshljaku dhe Pisha e madhe me përbërje të pastër të munikës-arnenit (Pinus Heldreichi); Hapësira më e madhe e mbrojtur është Parku Nacional "Malet e Sharrit" që ndodhet në Komunën e Prizrenit. Malet e Sharrit ndodhen në Kosovë dhe Maqedoni dhe ka një sipërfaqe prej 1600 $km^2$. pjesa veriore e Maleve të Sharrit i takon Kosovës me një sipërfaqe prej 1100 $km^2$. Në vitin 1986, disa pjesë të Maleve të Sharrit janë shpallur si Park Nacional. Parku është në rrezik të madh nga ndotja dhe degradimi i mjedisit si rezultat i përdorimit joracional të burimeve natyrore, si dhe prerja ilegale e pyjeve dhe niveli i lartë i erozionit (Parku Nacional "Malet e Sharrit" – Plani Hapësinor Zhillimor 2007). Parku Nacional "Malet e Sharrit" dallojnë me vlera botanike, shtazore, ekologjike, turistike, rekreacionale, sportive edukative dhe kulturore. Parku është aq i pasur me biodiversitet dhe përfaqëson një thesar të llojeve bimore ku disa prej tyre janë endemike, të rralla ose të rrezikuara nga shfarosja. Në Parkun Nacional "Malet e Sharrit" ndodhen 4 rezervate të mbrojtura natyrore: Maja e Arnetit, Oshljaku dhe Pisha e madhe në Komunën e Prizrenit dhe Rusenica në komunën e Therandës ku jeton rrëqebulli i Ballkanit.

*Tabela 28. Zonat e mbrojtura natyrore në Kosovë dhe Prizren*

| | Kosova | | Prizreni | |
|---|---|---|---|---|
| Emri | Nr i hapësirave | Sipërfaqja – ha | Nr i hapësirave | Sipërfaqja – ha |
| Rezervat natyror | 11 | 847 | 3 | 65 |
| Park Nacional | 1 | 39 000 | 1 | 19 500 (*) |
| Monument natyror | 59 | 4 874 | 3 | |
| Park rajonal | 2 | 1 681 | 0 | |
| Park pyjor | 2 | | 0 | |

*Harta 15 : Harta: Pozita e PN "Mali Sharr" në Kosovë dhe rajon* aneksi i hartave, faqe 16, *Burimi i të dhënave - Burimi IPH. Parku Kombëtar "Sharri" – Plani Hapësinor*

## 3.2.4. Menaxhimi i zonave të mbrojtura

Parku Nacional "Sharri: është i shpallur që në vitin 1986 me ligj sipas të cilit sipërfaqja e Parkut është 390km² ose 35,4% nga sipërfaqja e përgjithshme e maleve të Sharrit që shtrihen në territorin e Kosovës. Kjo përbën 3.58% të sipërfaqes së përgjithshme të territorit të Republikës së Kosovës. Ndërsa komuna e Prizrenit merr pjesë me 41 % (ose rreth 9200 ha) në sipërfaqen e përgjithshme te parkut. Parku Nacional „Mali Sharr" është shpallur për të mbrojtur biodiversitetin bimor dhe shtazor sikurse edhe bukuritë e peizazheve natyrore të pyjeve, majave të maleve, lumenjve dhe liqeneve malor. Biodiversiteti i malit Sharr ka karakteristika të Ballkanit dhe Mesdheut duke e bërë atë të pasur në florë e faunë në kuptimin e llojeve endemike e të rralla.

Menaxhimi i Parkut Nacional Sharr, që ndodhet në rajonin e Sharrit në komunën e Prizrenit, është një proces kompleks që ka si qëllim ruajtjen e biodiversitetit, mbrojtjen e ekosistemeve dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Menaxhimi efektiv i Parkut Nacional Sharr është thelbësor për ruajtjen e biodiversitetit dhe për zhvillimin e një kulture që e respekton natyrën. Përmes një qasjeje të koordinuar

dhe gjithëpërfshirëse, mund të sigurohet një balancim mes mbrojtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore.

Disa nga aspektet kryesore të menaxhimit të këtij parku përfshijnë:

1. Planifikimi i Menaxhimit - Ësht hartuar plani i detajuar që përcakton objektivat e ruajtjes dhe përdorimit të burimeve. Identifikimi i zonave me rëndësi të veçantë ekologjike dhe kulturore.

2. Monitorimi i Biodiversitetit- Vlerësimi i llojeve të florës dhe faunës, si dhe mbrojtja e specieve të rrezikuara. Kryerja e studimeve për të përcaktuar shëndetin e ekosistemeve.

3. Edukimi dhe Angazhimi i Komunitetit - Organizimi i aktiviteteve edukative për vizitorët dhe komunitetet lokale mbi rëndësinë e mbrojtjes së natyrës. Inkurajimi i pjesëmarrjes së komunitetit në aktivitete të menaxhimit dhe mbrojtjes.

4. Zhvillimi i Qëndrueshëm - Promovimi i turizmit të qëndrueshëm që respekton natyrën dhe ndihmon ekonominë lokale. Rregullimi i aktiviteteve si ndërtimi, bujqësia dhe djegia e pyjeve për të minimizuar ndikimet negative.

5. Politikat dhe Ligjet -Zbatimi i legjislacionit për mbrojtjen e natyrës dhe monitorimi i respektimit të këtyre rregullave. Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare për ruajtjen e biodiversitetit.

6. Infrastruktura dhe Shërbimet për Vizitorët - Krijimi i rrugëve dhe infrastrukturës së nevojshme për vizitorët, duke siguruar që ato të jenë të qëndrueshme dhe të kenë ndikim minimal në natyrë.

## 3.3. Bujqësia

### 3.3.1 Zonat e prodhimtarisë bujqësore

Bujqësia është një nga veprimtaritë kyçe në këtë trevë mirëpo, sipas regjistrimit të ekonomive familjare (2011), me pak se 5 % të të punësuarve janë të punësuar në sektorin e bujqësisë. Bujqësia, në sektorin privat është e zhvilluar kryesisht në formë të bujqësisë familjare, fermave për jetesë dhe tokave të vogla private bujqësore, ku viteve të fundit sektorit të bujqësisë është duke iu kushtuar vëmendje më e shtuar si nga institucionet qeveritare ashtu edhe nga ato komunale, me subvencione, ndërtim të kanaleve për ujitje dhe aplikimit të masave intensive agro-teknike. Pjesa më e madhe e koncentrimit bujqësorë-agrar është në zonat e tokës bujqësore pjesën veriore të komunës së Prizrenit (sipërfaqet e rrafshëta) duke rritur prodhimtarin e produkteve të Perime në fushë të Hapur, Miser, Grure etj.

Komuna e Prizrenit është e njohur me përpunimin e qumështit dhe prodhimin e produkteve prej qumështit. Prodhimet e qumështit, në veçanti djathi i freskët i njohur si “Djathi i Sharrit”, është i njohur në përmasa ndërkombëtare.

#### 3.3.1.1. Zhvillimi bujqësor dhe rural

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë për Komunën e Prizrenit ka rëndësi të veçantë, si në aspektin e përmirësimit të bilancit tregtar, uljes së papunësisë, sigurisë së produkteve ushqimore, mbrojtjes së ambientit dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve në përgjithësi. Si rezultat i mbështetjes se këtij sektori të ardhurat neto për fermerët janë rritur ndjeshëm.

Sa i përket bujqësisë Komuna e Prizrenit ka: 5704 hektarë tokë të punueshme (ara), kullosa, 15667 hektarë livadhe, 35 hektarë kopshte(serra), 35 hektarë pemishte 151.8 hektarë vreshta 193.7 ha etj. Tokat e punueshme shfrytëzohen për të siguruar ushqim për njerëz, kafshë dhe për kultivimin e kulturave lavërtare: grurë, misër dhe perime. Sa i përket sektorit të pemëtarisë, Komuna e Prizrenit ka mbështetur me subvencione ngritjen e plantacioneve që kultivohen: mollë, dardhë, kumbulla, mjedra arra, manaferra, etj. Për 151.8 hektarë. Komuna ka mbështetur zhvillimin e ekonomisë bujqësore lokale, edhe përmes sigurimit të serrave afer 35 ha për 41 ekonomi familjare. Kjo mbështetje ka treguar rezultate premtuese në prodhimin e kulturave perimore (tranguj, domate, speca, sallatë e gjelbër etj.). Prodhimtaria bujqësore është orientuar në: prodhimtarinë bimore, prodhimtarinë blegtoral (produktet e qumështit), shpeztari, bletari si dhe prodhimet e verës.

***Harta nr 16****: Struktura dhe shpërndarja e tokave bujqësore në komunën e Prizrenit, aneksi i hartave, faqe 17, Burimi i të dhënave Digjitalizim nga ortofotot*

### 3.3.2. Zonat e prodhimtarisë bujqësore

Bujqësia si degë e ekonomisë është bazë e zhvillimit të ekonomisë së Komunës së Prizrenit Bazuar në zhvillimet bujqësore të katër viteve paraprake janë identifikuar trendët prodhuese, në bazë të analizave nga të dhënat statistikore lokale , ku sektori i bujqësisë ka një rritje të vogël reale ndërsa, prodhimtaria bujqësore në bazë të dhënave të grumbulluara dhe më pastaj të analizuara vërehet një ngritje e prodhimit sipas trendeve të zhvilluara, ku jep të kuptohet se sektori i prodhimit të bujqësore nuk është në gjendjen e dëshirueshme prandaj institucionet përkatëse rekomandojmë që duhet ndërmarrë masat e duhura me qëllim të përmirësimit sa me të shpejt të këtij sektori mjaft të rëndësishëm në të ushqyerit e njerëzve si dhe zhvillimit ekonomik. Ekzistojn kushte specifike të cilat favorizojnë bujqësinë e kësaj komune për prodhumin e rendimenteve bujqësore të kualitetit të lartë . Prodhimtarija bujqësore është e orjentuar në prodhimtarinë: bimore, blegtorale, shpenztari, bletari, etj. Sa i përket shpërndarjes hapësinore të tokave bujqësore në komunën e Prizrenit në vazhdim paraqesim zonat (vendbanimet) me fond më të madh të tokës bujqësore dhe me rendimente të larta në vendbanimet si: Pirana, Krushë Vogël, Landovicë, Atmaxhë, Sërbicë e Poshtme, Serbicë e Epërme,Korishë, Lutogllavë,Novak etj.

Komuna e Prizrenit, me një reliev mjaft heterogjen dhe me një klimë të mesme kontinentale, ofron kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë, përkatësisht të degëve të saj: lavërtarisë dhe blegtorisë. Në këto vendbanime mbizotrojnë kulturat dominuese si: drithërat e bardha, si dhe kulturat tjera si: pemët, perimet, etj, dhe kryesisht për nevoja familjare dhe të tregut lokal dhe nuk kanë ndonjë shpërndarje hapësinore specifike.

*Harta nr 17. Zonat industriale në komunën e Prizrenit., aneksi i hartave, faqe 18 (burimi i të dhënave, Harta zonale e komunës së Prizrenit).*

*Tabela nr 29, Shfrytëzimi i sipërfaqes se tokës nga ekonomitë familjare bujqësore (Regjistrimi i bujqësisë 2014)*

| Komuna | Gjithsej | | Sipërfaqja e tokës në përdorim nga ekonomitë familjare | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Ekonomi familjare | Ekonomi familjare qe kane tokë ne pronesi apo ne shfrytezim | Tokë e punueshme (të korrat vjetore) | Serrat | Livadhet (tërfili, bari i përzier, jonxhe etj) | Pemishte | Vreshta | Djerrinë (tokë e pakultivuar për më shumë se 2 vite) | Kullosë | Pyje | Të tjera (oborre shtëpie, hurdha peshqish ...) |
| | | | ha | ha | ha | ha | ha | ha | ha | ha | ha |
| **1** | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 |
| **Prizren** | 31048 | 6521 | 4117 | 35 | 35 | 200 | 105 | 671 | 15667 | 2194 | 2502 |

### 3.3.3. Kultivimi i bimëve një vjeçare

Siperfaqe e punueshme me kultura bujqësore njëvjeqare(ara) në Komunen e Prizrenit janë 6547 hektarë, Siperfaqe me drithëra të bardha janë 6150 hektar (sipas vitit 2023).

Egziston infrastruktura pjesërisht në kuadër të industrisë përpunuese të ktyre produkteve agrare e cila mundëson: grumbullim, vendosjen dhe ruajtjen/deponimin dhe përpunimin e drithërave në komunën tonë e cila bënë pjesë në segmentin e biznesit agro-industrial. Komuna e jonë është e përfshirë në kuadër të sistemit të ujitjes “Radoniqi”. Aktualisht ujiten 840 hektare të tokës punuese nga sistemi i Radoniqit Problemi me pamjaftueshmërinë e sistemit të ujitjes është i theksuar më së shumti në fshatra që kanë prodhimin e kulturave njëvjeçare. Ujitja është një çështje shumë e rëndësishme dhe vitale për kultivimin e produkteve bujqësore.

Grafiku nr 10, Numri i fermerëve 2022-2024



### 3.3.3.1. Kultivimi i kulturave bujqësore shumë-vjeçare

Në komunën e Prizrenit me veprimtarinë e kulturave shumë-vjeqare / plantacione të reja të ngritura pas luftës, afërsisht 1394 ekonomi familjare bujqesore me sipërfaqe rreth 305 hektar me kultura shumë-vjeqare. me sipërfaqet e kultivuara me mollë përfshijnë 23.27 %, me mjedër 7.20 % , me arrë 28.18 %, dardhë 6.88%. Sa i përket sasisë së prodhimit, analizat e statistikave për periudhën 2021 – 2024 tregojnë rritje të prodhimit të të gjitha pemëve.

*Tabela nr 30 Sipërfaqet e planifikuar/realizuara me kulturat shumë-vjeqare*

| Nr. | **Kulturat** | **Fermer / numri** | **Sipërfaqja e planifikuar /ha** | | | **Sipërfaqja e realizuar /ha** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 2022 | 2023 | 2024 | 2022 | 2023 | 2024 |
| 1. | Pemë molla | 60 | 65 | 51 | 55 | 71 | 75 | 71 |
| 2. | Arra | 47 | 55 | 71 | 86 | 60 | 71 | 86 |
| 3. | Njedër | 25 | 21 | 23 | 21 | 19 | 20 | 22 |
| 4. | Dardha | 21 | 25 | 21 | 18 | 25 | 21 | 21 |
| 5. | Hardhi rrushi | 102 | 110 | 105 | 103 | 102 | 110 | 105 |

*Grafiku 11, Sipërfaqet e planifikuar/realizuar me kulturat shum-vjeçare*




## 3.4. Agrobiznesi

Ekonomia e komunës së Prizrenit është kryesisht bazuar biznesin individual në sektorin e bujqësisë, tregtisë, ndërtimtarisë dhe përpunimit të ushqimit. Në komunën e Prizrenit janë të regjistruara dhe zhvillojnë aktivitete 5200 biznese private që operojnë brenda juridiksionit komunal. Bujqësia është një

ndër sektorët me potencial të madh e të rëndësishëm në rritjen e ekonomisë dhe të sigurisë së ushqimit. Sektorët të cilët vazhdojnë të kenë kushte të favorshme dhe me rendimente në rritje janë: Sektori i pemëtarisë, blegtorisë, drithërat si dhe kultivimi i frutave dhe perimeve dhe përpunimi i tyre në produkte finale. Përkundër potencialeve për zhvillimin e bujqësisë, ky sektor mbetet pak i përfaqësuar nga se zhvillimet e hovshme në sektorët e tjerë, sidomos migrimi dhe emigrimi i popullatës një pjesë e madhe e tokës ka mbetur e pa punuar, ndikim negativ ka edhe ndërtimi i objekteve të ndryshme në toka bujqësore, siç janë: objektet e banimit, objektet hoteliere, pompat e benzinës dhe objektet e ndryshme industriale, kjo ka ndikuar që sipërfaqet e tokës bujqësore të zvogëlohen gradualisht, duke u shëndërruar në tokë ndërtimore.

*Tab 31. Numri i ekonomive bujqesore dhe sipërfaqeve sipas kulturave bujqesore (burimi i të dhënave Regjistrimi i bujqësisë 2014*)

| Kultura bujqësore | Nr Ekonomive bujqësore | Sipërfaqja ha |
|---|---|---|
| Grurë | 3007 | 2592 |
| Misri | 2573 | 1075 |
| Elbi | 52 | 35 |
| Thekra | 29 | 23 |
| Tërshëra | 151 | 113 |
| Fasulja kokërr | 1409 | 133 |
| Patate | 810 | 35 |
| Jonxhë | 1143 | 693 |
| Tërfili | 55 | 36 |
| Përzierje bari | 369 | 198 |
| Speca | 1820 | 83 |
| Domate | 1667 | 37 |
| Qepë | 1474 | 39 |
| Lakra | 523 | 34 |
| Shalqiri | 563 | 127 |

Grafiku 12, Sipërfaqet në hektar me kultura bujqësore në komunën e Prizrenit 2014




### 3.4.1. Fermat bujqësore

Kultivimi i shtazëve, shpezëve dhe përpunimit të mishit ka të bëjë me biznesin privat andaj bartës ekskluziv të kësaj sfere janë subjektet private dhe fermerët individual të cilët merren me këtë veprimtari. Ne komunen e Prizrenit subjektet private( fermerët individual) që zhvillojnë veprimtarinëjanë afër 1145. fermer, të cilët zotërojnë sipërfaqe prej 90 hektar.

*Tabela nr 32 Fermat e shtazëve në komunën e Prizrenit*

| Nr. | Kategoria e fermave | Nr. i fermave | Njësia në copë/krerë | Lokacioni | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ferma e lopëve me mbi 5 krerë | 179 | 1972krerë lopë 424 krer.viça | Në të gjitha fshatrat e komunës së Prizrenit | Qumështore Reprodukim |
| 2 | Fermer të deleve | 110 | 19617 | Në të gjitha fshatrat e komunës së Prizrenit | |
| 3 | Ferma të dhive | 23 | 669 | Në të gjitha fshatrat e komunës së Prizrenit | |
| 4 | Ferma të Pulave | 9 | 25000 | Në të gjitha fshatrat e komunës së Prizrenit | |
| 5 | Bletë | 119 Bletar | Gjithësej 47,682.00 krer | Në të gjitha fshatrat e komunës së Prizrenit | |

Burimi i të dhënave , Drejtoria e bujqësisë Prizren 2024

### 3.4.2. Turizmi

Komuna e Prizrenit është e pasur me atraksione të ndryshme natyrore. Komuna jonë disponon me bukuri natyrore, shtigjet e përshtatshme për ecje, ajri i pastër, burimet e ujit/lumi, (ambientet shëruese për sëmundjet kardiake, pulmologjike, kronike, etj.) , me veçoritë dhe pasuritë reale natyrore për zhvillimin e turizmit(arkitektonik, malor , dimëror, sportiv, shëndetësor, etj.).

Grafiku 13, Numri i vizitorëve në Regjionin e Prizrenit sipas viteve




*Tab. 33 Kapacitetet hoteliere në regjionin e Prizrenit*

| Vitet | Njësi akomoduese | Dhoma | Shtretër |
|---|---|---|---|
| **Viti 2023** | 95 | 1460 | 3112 |
| **Viti 2022** | 88 | 1297 | 2593 |
| **Viti 2021** | 88 | 1297 | 2593 |
| **Viti 2020** | 84 | 1227 | 2504 |
| **Viti 2019** | 84 | 1227 | 2504 |
| **Viti 2018** | 83 | 1219 | 2483 |
| **Viti 2017** | 74 | 1101 | 2271 |

Grafiku 14, Kapacitetet hoteliere në Regjionin e Prizrenit




*Harta nr 18: Harta turistike e Komunës së Prizrenit, aneksi i hartave, faqe 19*
*Burimi i të dhënave: Digjitalizim nga Ortofotot dhe hartat topografike (gjeoportali kombëtar).*

### 3.4.3. Analiza e trendit të kapaciteteve prodhuese bujqësore

*Tabela nr 34 Sipërfaqet e realizuara me mbjellje një-vjeqare*

| Nr. | **Kultura:** | **Fermer /numri** | **Sipërfaqja e planifikuar /ha** | | | **Sipërfaqja e realizuar/ ha** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 2022 | 2023 | 2024 | 2022 | 2023 | 2024 |
| 1. | Misër | 145 | 1880 | 1400 | 1450 | 1900 | 1400 | 1480 |
| 2. | Grurë | 148 | 2540 | 2550 | 2600 | 2500 | 2600 | - |
| 3. | Elb | 30 | 15 | 18 | 21 | 16 | 17 | 18 |
| 4. | Tërshërë | 41 | 85 | 78 | 85 | 75 | 75 | 74 |
| 5. | Bimë Furragjere | 25 | 25 | 30 | 35 | 25 | 30 | 35 |
| 6. | Bimë industrial | 20 | 37 | 32 | 25 | 37 | 30 | 25 |
| 7. | Perime në serra | 41 | 25 | 30 | 35 | 25 | 30 | 35 |
| 8. | Perime në fushë të Hapur | 220 | 350 | 320 | 360 | 340 | 350 | 330 |
| 9. | Patate | 12 | 20 | 15 | 17 | 15 | 22 | 17 |

Graf. 15 Mbjelljet një vjeçare për periudhën 2022-2024 në hektar



### 3.4.4. Sektori privat /komuniteti i biznesit

Qyteti i Prizrenit ka një traditë të hershme manifakturale dhe për përpunimin e materialeve të ndryshme nga : guri, druri, për ndërtimtari dhe shërbime të ndryshme zejtare si dhe veprimtari hoteliere. Komuna e Prizrenit ka kushte mjaftë të mira edhe për zhvillimin e industrisë ekstraktuese, ndërtimit, industrisë së ushqimit dhe përpunimit, që do të mund të ishin shtesë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik e cila ka potencial ende të pa shfrytëzuar nga aspekti i pasurisë mbitokësore, nëntokësore , burimet e ujit, malore , bujqësia , energjia, etj. Burimi kryesor i gjenerimit të hyrave të qytetarëve të komunës së Prizrenit janë: ekonomitë e vogla familjare, shërbimet, bujqësia, tregtia dhe remitencat nga Diaspora. Në përgjithësi, mjedisi për zhvillimin e bizneseve makro, ende mbetet i pafavorshëm dhe kërkon mbështetje institucionale të fuqishme.

*Tab 35 Ndërmarrjet sipas sektorëve në komunën e Prizrenit*

| Sektori | | Ndërmarrje |
|---|---|---|
| A | Bujqësi, pylltari dhe peshkatari | 65 |
| B | Xehetari dhe gurëthyes | 22 |
| C | Prodhim | 734 |
| D | Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar | 2 |
| E | Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash | 7 |
| F | Ndërtimtari | 251 |
| G | Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave | 1,959 |
| H | Transport dhe ruajtje | 161 |
| I | Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim | 544 |
| J | Informacion dhe komunikim | 77 |
| K | Aktivitete financiare dhe sigurimit | 12 |
| L | Aktivitete të patundshmërisë | 23 |
| M | Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike | 290 |
| N | Aktivitete administrative dhe mbështetëse | 125 |
| O | Administratë publike dhe mbrojtje | 11 |
| P | Arsim | 30 |
| Q | Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale | 170 |
| R | Art, zbavitje dhe rekreacion | 91 |

| | | |
|---|---|---|
| S | Aktivitete të shërbimeve tjera | 472 |
| T | Aktivitete të ekonomive familjare si punëdhënës | 0 |
| U | Aktivitete të organizatave dhe organeve jashtë-territoriale | 0 |
| **Total** | | **5,046** |

### 3.4.5. Shoqatat afariste

Në Komunën e Prizrenit veprojnë; Shoqata e Bjeshkatare Alpiniste , Organizata për mbrojtjen e mjedisit , Shoqata e Gjuetarëve**,** Shoqata e Peshkatarëve **,** Shoqata e Bizneseve, Shoqata e zejtareve etj.

## 3.5. OBJEKTET

### 3.5.1. Objektet e banimit

Objektet e banimit në të kaluarën jo të largt, ndërtoheshin kryesisht në kate përdhese, në raste të veqanta , në disa vise edhe të ashtuquajtura kulla guri, të ngritura deri në tri kate, nga materiale të dobëta (guri, qerpiçi-tjegulla dhe druri). Në dekadat e fundit, ndërtimi i objekteve të banimit ka ndryshuar tërësisht, si në formë ashtu edhe në cilësi. Tani objektet e banimit ndërtohen me një e më shumë kate, ndërsa janë të ndërtuara me material të fortë ndërtimor, si: tulla, blloka të pjekur, betoni e hekuri dhe materiale izoluese. Edhe pse organizimi i jetës dhe hapësirës në fshat ka një dallim nga pjesa urbane e qytetit, objektet e banimit të ndërtuara në fshat, fare pak dallojnë me ato në qytet nga se nuk ka ndonjë stil unik të ndërtimit të objekteve të banimit.

Zona urbane e qytetit të Prizrenit karakterizohet me dendësi më të lartë se zonat rurale dhe kjo dendësi është rreth 24.5 banorë/për hektar apo 2453 banorë për $km^2$. Kjo dendësi është më e lartë se në zonat rurale por është e ulët për një zonë urbane, ku shtrihen kryesisht njësi të banimit. Sa përket numrit të strukturave të ndërtuara, në nivel komune numri më i madh i ndërtesave i përkasin shtëpive të banimit më 98.8 %, pasuar me banim me shumë njësi 1.2 %. Viteve të fundit, për shkak të presionit për zhvillim ka kërkesë më të madhe për objekteve të banimit me shumë njësi.

Cilësia e jetës në komunë gjithashtu ndikohet edhe nga vlerat rekreative të trashëgimisë natyrore, zhvillimin e objekteve dhe pajisjeve për një infrastrukture adekuate sociale dhe teknike, e cila i merr parasysh nevojat e banorëve. Promovohet ndërtim i objekteve sipas standardeve në hapësirat jo të ndërtuara dhe masat mbrojtëse për reduktimin e pasojave nga fatkeqësitë( tërmetet, vërshimet, erozionet etj.) si dhe vënia në zbatim e rregullave të ndërtimit për banim në dobi të rritjes së dendësisë për sipërfaqe në zonat e banimit. Çdo ndërtim i ri do të respektojë masat për Efiçencë të Energjisë sipas kërkesave, bazuar në rregulloren për kërkesat minimale të performancës energjetike të ndërtesave (MEA Nr. 04/18). Të gjitha këto veprime do të mundësojnë që komuna të përmirësojë kualitetin e banimit në komunë, dhe në të njëjtën kohë të akomodojë kërkesat për njësi të reja të banimit.

Në vendbanimet rurale, që gjenden me pozita hapësinore atraktive dhe distanca të afërta me vendet urbane si dhe pranë akseve rrugore që lidhin qytetet më të fuqishme në vend, dendësia e banimit brenda zonës së ndërtuar, është mjaft e lartë dhe është e përafërt me shumë qytete të vogla të Kosovës. Ndërsa në vendbanimet më periferike, sidomos ato afër brezit kufitarë, dekadave të fundit ka ndodhur

imigrim i pa kontrolluar drejt venbanimeve urbane. Vendbanimet rurale, përveç objekteve të banimit janë të ndërtuara edhe edhe një numër të konsiderueshëm të objekteve përcjellëse (ekonomike). Në dy dekadat e fundit në Komunën e Prizrenit ka ndodhur një zhvillim dinamik urban, i përcjellur edhe me infrastructure kritike në vendbanime urbane dhe rurale, duke ndërtuar objekte të cilat i plotësojnë standard të afirmuara dhe kushte më të mira për banim. Në komunën e Prizrenit numri i gjithmbarshëm i njësive të banimit është 39640, ku pjesa më e madhe e njësive të banimit gjendet në zonën urbane të komunës së Prizrenit me 22202, ndërsa në atë rural 17438 banesa.

*Tabela nr 36 Banesat sipas llojit, statusit të shfrytëzimit dhe tipit të vendbanimit në Komunë*

| Lloji i objektit | Urban | | | Rural | | | Gjithësej | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Banesa kolekt. | Ekon. Familjare | Persona | Banesa kolekt. | Ekon. Familjare | Persona | Banesa kolekt. | Ekon. Familjare | Persona |
| Komuna e Prizrenit | 232 | | | 20 | | | 252 | | |
| Banesë e zakonshme | 16965 | 17603 | 94447 | 11717 | 12007 | 83264 | 28682 | 29610 | 177680 |
| Lloj tjetër banese | 10 | 10 | 39 | 5 | 5 | 25 | 15 | 15 | 64 |

*Graf. 16 Ndërtesat e banuara sipas viteve të ndërtimit*




*(burimi: ASK, Banesat dhe Ndërtesat, sipas komunave).*

### 3.5.2. Objektet afariste

**Objektet afariste** - strukturë heterogjene e ndërtimeve në Komunën e Prizrenit ku dominon në vendbanimet urbane dhe rreth akseve rrugore, ku ka qasje dhe frekuentim më të madh të njerëzve dhe

automjeteve. Këto objekte ku zhvillohen veprimtari të ndryshme ndahen në dy grupe më pastaj: objekte të ndërtuara urbane, me destinime të përbashkëta, me banim kolektiv në katet më të larta, ndërsa me destinacion të veprimtarisë në të cilat zhvillohen veprimtari të ndryshme afariste: tregtare, shërbyese, zejtare, kulturore, shëndetësore, etj. Brenda hapësirave urbane afarojnë edhe biznese me objekte të cilat disponojnë sipërfaqe të mëdha të cilat merren me shërbime, si : qendrat tregtare, bao-marketet, stacionet  e derivateve, etj. Bizneset që afarojnë me objekte prodhuese, deponime  të materialeve të ndryshme, materialeve lehtë-ndezëse apo materiale të rrezikshme janë të ndërtuara në zona /park biznesi me destinacion dhe planifikim hapësinorë dhe urbanistik, në pajtueshmëri me PZhK dhe normat ligjore në fuqi.

Veprimtaritë e përshtatshme për zhvillimin e ekonomisë komunale mund të jenë:

• Industria dhe bizneset me ndotje të vogël;

• Industritë/ bizneset të cilat prodhimin e bazojnë në lëndën e parë nga resurset vendore dhe të importuara, ( me materie të rrezikshme, lehtëndezëse, shpërthyese, etj)

• Prodhimtaria dhe bizneset e përqendruara në produkte bujqësore.

Objektet afariste me shum janë të koncentruar per gjate aksit rrugor Prizren-Suharekë, Prizren-Gjakovë dhe Prizren – Vërmicë, si dhe shum qendra tregtare janë te vendosura ne zonën Industriale  në pjesën perëndimore të qytetit të Prizrenit.

### 3.5.3. Objektet sportive

Në përgjithësi infrastruktura sportive në komunën e Prizrenit ashtu si në nivel të Kosovës, nuk është nivel optimal. Aktivitetet sportive zhvillohen në kuadër të objekteve sportive që janë të shpërndara si në zonën urbane po ashtu edhe në atë rurale. Objektet sportive në komunën e Prizrenit janë Qendra Sportive e cila disponon  fushën e hapur dhe me palestrën sportive, stadiumi kryesor i qytetit” Përparim Thaçi”  si dhe 6 salla të edukatës fizike në kuadër të shkollave fillore dhe 2 salla të edukatës fizike në kuadër të shkollave të mesme, 4 pishina të notit, të cilat shfrytëzohen për aktivitete rekreative-sportive verore. Mungesa e infrastrukturës për të gjitha disiplinat e sportit dhe financimi i kufizuar janë disa nga faktorët kryesorë sfidues në nivelin komunal.



Fig 7 Fusha e sportit “Perparim Thaqi në qytet të Prizrenit

### 3.5.4. Objektet kulturore

Jeta kulturore dhe artistike në komunën e Prizrenit kryesisht zhvillohet në qytet, kryesisht objektin e shtëpisë kulturës “Xhemajli Berisha” po ashtu disa aktivitete zhvillohen edhe në objektet shkollore si dhe në fshatrat e komunës. Në Komunën e Prizrenit veprojnë shoqatat dhe klubet kulturore-artistike që merren me aktivitete koncertale, letrare, valle dhe aktivitete tjera rinore. Në kuadër të këtyre aktiviteteve ka përkrahje dhe bashkëpunime me DKRS.

*Harta nr 19 Trashëgimia kulturore dhe natyrore në komunën e Prizrenit, aneksi i hartave, faqe 19, Burimi i të dhënave: Harta zonale e komunës së Prizrenit.*

## 3.6. Strehimoret dhe objektet për strehim

Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera janë fenomene apo incidente të papritura dhe me pasoja të mëdha në njerëz dhe të mira materiale , ashtu që si pasojë e tyre, brenda një kohë periudhe të shkurtë kohore, mund të shkaktohen humbje të mëdha materiale. Në situata të tilla paraqitet nevoja emergjente për evakuim, strehim dhe përkujdesje të popullatës, krahas mbrojtjes dhe kërkim-shpëtimit duke qenë në harmoni dhe koordinim të plotë me planet e evakuimit dhe reagimit emergjent si dhe akterët menaxhues emergjent. Bazuar në Dokumenntin e vlerësimit të rrezikshmërisë nga FNFT si dhe planeve reaguese emergjente lokale, krahas evakuimit dhe strehimit, paraprakisht duhet planifikuar evakuimi, strehimi dhe përkujdesja, duke pasur në konsideratë, kushtet e nevojshme për jetë, ushqim, veshmbathje, sigurimin e mjete materiale të domosdoshme për furnizimin , mjetet higjienike, sigurinë dhe qështje të tjera sipas planeve paraprake, për të gjithë të evakuuarit nga vendbanimet e përhershme. Evakuimi bëhet nga autoritetet legjitime lokale, me qëllim të largimit të popullsisë prej vendeve dhe objekteve të rrezikuara në objekte dhe vende më pak të rrezikuara.

### 3.6.1. Përcaktimi i lokacioneve ( zonave ) të grumbullimit në rast fatkeqësie

Në raste të FNFT, kur nevojitet zhvendosje masive e komunitetit nga një zonë e caktuar, janë paraparë zona në të cilat ofrohet një ambient i sigurtë dhe që nuk i ekspozohet rrezikut. Planifikimi për evakuim të qytetarëve brenda juridiksionit komunal bëhet paraprakisht nga organi kompetent lokal respektivisht strukturat komunale përgjegjëse për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë, bazuar në Planin lokal për evakuim, ku varësisht nga lloji i fatkeqësisë dhe vlerësimi paraprak i rrezikut, përcaktohen edhe lokacionet e caktuara që plotësojnë kushte elementare për strehim dhe të jenë të mbrojtur nga fatkeqësia, kurse në raste të nevojës së qëndrimit më të gjatë në këto zona, mund të ndërtohen edhe kampe të përkoshme, e ku ndër të tjera duhet të përfshijë edhe:

¬ Përcaktimin e lokacioneve ( zonave ) të grumbullimit të qytetarëve në rast fatkeqësie;

- Udhëzimet e detajuara për qytetarët mbi mënyrën dhe kohën e evakuimit;

¬ Evidentimin e familjeve dhe anëtarët e familjeve për evakuim;

¬Mënyrën dhe mjetet për transport;

¬ Shenjëzimet informuese dhe përcaktimi i rrugëve të evakuimit / drejtimet e evakuimit;

¬ Destinimi (vendosja);

-Gjatë fazës së hartimit të planit të evakuimit duhet pasur kujdes në prioritizimin e e kategorive të veqanta të komunitetit, bazuar në profilin e  komunitetit; Zonat mund të janë:

ITP Prizren si zonë me mundësi shfrytëzimi në rast nëvoje,

Fushat e sportit dhe objektet e tjera të cilët janë jashtë zonës së rrezikut.

### 3.6.2. Lokacioni i strehimoreve /titullari

Në komunën e Prizrenit në raste të krijimit të situatave emergjente për evakuim dhe strehimin të përkohshëm, janë përcaktuar lokacionet/objektet për strehim, ashtuqë duhet të bëhet një pajtueshmëri e plotë në mes organeve  gjegjëse komunale dhe titullarëve të objekteve, duke arritur ujdi përmes memorandumeve të mirëkuptimit:

1. Shkollat fillore dhe të mesme të komunës së Prizrenit;
2. Salla sportive në Prizren si dhe objekte të tjera të pabanuara, që mund të përdoren për strehimore dhe që gjenden larg përimetrit të rrezikut.
3. ITP e Prizrenit (ish zona e KFOR-it Gjerman)



*Figura 8. ITP Prizren si zonë me mundësi shfrytëzimi në rast nëvoje*

### 3.6.3. Kapacitetet

Ka kapacitete të mjaftueshme nëse paraqitet nëvoja. Zona e ITP është një hapësire e madhe afër 40 ha, gjithashtu në këtë zonë ka shum ndërtesa të cilat ofrojnë kushte infrastrukturore.

### 3.6.4. Gjendja e tyre

Gjendja e shkollave është e mirë, palestra sportive , Stadiumi i qyteti dhe hapësirat e tjera të hapuara janë hapësira të nevojshme për strehimin e popullatës në rastet e jashtë zakonshëm.

## 3.7. Kapacitetet shëndetësore publike dhe private

### 3.7.1. Institucionet Shëndetësore Publike

Organizimi dhe funksionimi i institucioneve publike shëndetësore në ditët e sotme në vend , në aspektin e përgjithshëm ka avansuar dukshëm, në krahasim me vite më parë duke ndryshuar dhe sistemi i kujdesit shëndetësorë në përgjithësi e sidomos në nivelin parësor shëndetësor në komuna në veqanti. Kujdesi shëndetësor parësor në Komunën e Prizrenit është i organizuar në QKMF, Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulanca Shëndetësore AMF. Komuna e Prizrenit posedon edhe kujdesin shëndetësor sekondar/ Spitalin Rajonal, në të cilin kryhen shërbime të specializuara për komunitetin si dhe hospitalizime në nivel rajonal ( komunat që gravitojnë janë: Komuna e Prizrenit, Dragashit, Suharekës, Malishevës,Mamushës dhe Rahovecit). Në Komunën e Prizrenit zhvillojnë aktivitet shëndetësorë edhe në sektorin privat.

### 3.7.2. Kapacitetet humane shëndetësore

- **Drejtoria Komunale për Shëndetësi** së bashku me stafin e tij është organi përgjegjës i cili i zhvillon politikat dhe kujdeset për funksionimin dhe organizimin në nivel parësorë-komunal. DKSh aktualisht ka staf të mjaftueshëm, zyrtarë profesional dhe administrativ. Organizimi i shërbimeve shëndetësore parësore bëhet përmes Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) si dhe në Ambulanta AMF, ku numri i personelit të punësuar në QKMF dhe QMF dhe AMF është 450 nga gjithsej 475 vende pune (pozita) të lejuara. Organizimi parësor shëndetësorë në Komunën e Prizrenit është si në vijim:
- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF)/ Një qendër (1)
- Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF) qendra( 15 )
- Ambulanca shëndetësore (AMF) (27)

Tab nr 37 kapacitetet humane shëndetësore

| **Lloji i profilit të stafit** | **Numri i personelit** |
|---|---|
| Specialist i mjekësisë familjare apo tjetër | 44 |
| Mjekë të Përgjithshëm | 54 |
| Stomatolog | 25 |
| Infermier | 166 |
| Radiolog teknik | 3 |
| Teknik i farmacisë | 6 |

| | |
|---|---|
| Teknik laborant | 15 |
| Teknik stomatolog | 43 |
| Bashkëpunëtor shëndetësor i mesëm | 2 |

Totali i të punësuarve në QKMF është 450 përsona. Drejtoria Komunale për Shëndetësi ka 3 punëtorë.

### 3.7.3. Kapacitetet teknike reaguese në sektorin publik (QKMF/QMF)

Kapacitetet reaguese në sektorin publik, shërbimet e ofruara dhe pajisjet e disponuara në rast të mobilizimit emergjent/ mjetet dhe pajisjet;

*Tabela nr 38. Kapacitetet shëndetësore reaguese publike*

| Nr. | *Kapacitetet shëndetësore reaguese publike* | Dinamika |
|---|---|---|
| 1. | Dhënja e ndihmës së parë nga personeli profesional/numri | **20 infermjer dhe 10 mjek** |
| 2. | Transporti nga lokacioni i pacientit në spital (transporti me AMF) | **250 transporte** |
| 3. | Transporti nga lokacioni i pacientit në QMF/Qendra spitalore/ QSUK | **Totali I transportit janar-shtator 2024 eshte 2547** |
| 4. | Numri i ekipeve kujdestare të ndihmës së parë( 24 h) | **3 ekipe me nga nje mjek dhe 2 infermjer** |
| 5. | Numri i shtretërve në QKMF | **32** |
| 6. | Numri i shtretërve në QMF | **62** |
| 7. | Numri i shtretërve mobil në QMF/AMF | **81** |
| 8. | Numri i leseve për të lënduar | **13** |
| 9. | Autoambulanca | **8** |
| 10. | Shërbime për dializë( numri) | **611** |
| 11. | Automjetet e QKMF/QMF për realizim të detyrave dhe shërbimeve | **29** |

***Harta nr. 20 :*** *Shtrirja hapësinore e objekteve shëndetësore, aneksi i hartave, faqe 21, Burimi i të dhënave: Digjitalizim nga Ortofotot dhe hartat topografike (gjeoportali kombëtar)*

Në kuadër të QKMF funksionon edhe reparti i emergjencës, ku personeli është i angazhuar 24/h. Gjithashtu në kuadër të shërbimit të ndihmës së shpejtë si dhe secila QMF disponon me nga sëpaku një (1 )shtrat për raste dhe intervenime emergjente, në raste emergjente mobilizohen të gjitha dhomat si në Ambulancat e Mjekësisë Familjare ashtu edhe në QMF.

*Tab. 39 Vizitat e pacienteve në Kujdesin Parësor*

| Vitet | Mjekesia familjare | Intervenca sherbime | Laboratori |
|---|---|---|---|
| Viti 2022 | 296710 | 529297 | 92045 |
| Viti 2020 | 526 940 | 167 050 | 37 421 |
| Viti 2019 | 319739 | 174884 | 12235 |
| Viti 2018 | 311544 | 156661 | 36137 |
| Viti 2017 | 261711 | 158569 | 36137 |

### 3.7.5. Detyrat e ekipeve për shërbime mjekësore në situata emergjente:

Njësitë profesionale të Shërbimeve Emergjente Mjekësore ( ekipet mobile ) në raste të aksidenteve të mëdha kryejnë shërbime mjekësore emergjente dhe koordinojnë aktivitetet me institucionet relevante. Ekipet e ndihmës së parë i bashkëngjiten shërbimit mjekësorë emergjent dhe i nënshtrohen urdhrave të zyrtarit të këtij shërbimi. Detyrat dhe obligimet e shërbimeve emergjente mjekësore në raste të ngritjes së gatishmërisë emergjente respektivisht reagimit emergjent janë:

- Ofrimi i ndihmës së parë nga ekipet medicinale në vendin e incidentit,
- Triazhimi i personave të aksidentuar, plotësimi i kartonit të trijazhës së pacijentit dhe mbajtja e evidencës,
- Evakuimi dhe transportimi i personave të lënduar nga zona e fatkeqësisë në qendrat spitalore dhe repartet tjera të specijalizuara medicinale,
- Ndërmarrja e masave parandaluese anti-epidemiologjike si dhe luftimi i vatrave të mundshme të paraqitjes së tyre,
- Aplikimi i sistemit të mbrojtjes karantinë me rastin e shfaqjes së sëmundjeve të ndryshme infektive, etj.
- Informimi i popullatës lidhur me gjendjen sanitare në teren dhe dhënia e udhëzimeve-këshillave adekuate medicinale për veprim në situata të caktuara emergjente,
- Planifikimi dhe krijimi i rezervave kritike në medikamente dhe produkte tjera farmaceutike për funkcionim adekuat në situata emergjente, si dhe
- Detyra tjera, bazuar në specifikat dhe nevojat lokale.

Kujdesi shëndetësor sekondar i referohet një niveli më të lartë të sistemit të kujdesit shëndetësor, në të cilin pacientët nga kujdesi shëndetësor parësor udhëzohen për trajtime më të specializuara. Niveli i kujdesit shëndetësor sekondar përfshin shërbime mjekësore të ofruara nga mjekë specialistë ose shërbime mjekësore më të avansuara duke pasë parasysh nevojën e njohurive-aftësive ose pajisje mjekësore më të specializuara sesa niveli i kujdesit parësor. Kujdesi shëndetësor sekondar ofrohet nga:

**Spitalet rajonale**

Përveç Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), e cila është e vetmja qendër terciare e kujdesit shëndetësor, ekziston gjithashtu edhe spitali rajonal i Prizrenit që ofrojnë shërbime dytësore të kujdesit shëndetësor. Spitali i Përgjithshëm i Prizrenit me shërbime mbulon katër komunat e rajonit të Prizrenit me gjithsejt 292,597 banorë: Komuna e Prizreni me 194581 banorë, komuna e Dragashit me 33948 banorë, komuna e Suharekës me 58194 banorë dhe komuna e Mamushës me 5874 banorë *(të dhëna nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2020).*

Krahas komunave të lërtëcekura, në spitalin e Prizrenit shërbime shëndetësore marrin edhe banorët e komunës së Malishevës dhe Rahovecit, edhe pse vite më parë këto dy komuna administrativisht kanë kaluar në rajonin e Gjakovës. Aktualisht ka 739 të punësuar, prej tyre 169 mjekë specialistë, 438 infermierë ((bachelor, mësimdhënës, teknikë të farmacisë), si dhe 123 staf tjetër (administrative, teknike etj.) Ka 509 shtretër. Kompleksi spitalor përbëhet prej 7 objekteve spitalore me një sipërfaqe të përgjithshme prej 22.000 m², ku janë të vendosur repartet dhe shërbimet mjekësore, si dhe 2 objekte përcjellëse në një sipërfaqe prej 1.200 m² ku janë të vendosura shërbimet përcjellëse (lavatorja dhe ngrohtorja).

Numri total i stafit, mjekë- infermier/e dhe punëtorë të profileve tjera teknike- administrative.

- Mjekë specialist/e: 181
- Infermier/e: 436
- Të tjerë: 122

-Kontakt numri i Spitalit dhe e-maili

Fiks: +383 29 243 134

E-maili: Spitali.Prizren@rks-gov.net

KREU I IV-TË

# 4. INFRASTRUKTURA TEKNOLOGJIKE DHE E TRAFIKUT

## 4.1. Rrugët (rrjeti rrugor dhe qarkullimi)

Konfiguracioni i territorit të komunës së Prizrenit ka kushtëzuar kryesisht krijimin e disa nga rrugët me të rëndësishme dhe me specifika të veqanta, sidomos ndërlidhja e rrugëve që përshkojnë luginat përgjatë rrjedhave të lumenjve. Për të lëvizur nga një vend ose rajon gjeografik në tjetrin, nevojat jetësore dhe specifikat gjeografike krijojnë rrugë dhe mënyra të transportit të cilat kanë ndikuar dhe ndihmuar zhvillimin ekonomik si dhe lehtësimin e përmisimin e jetës së njeriut. Në zhvillimin e transportit duhet pasur për bazë shumë faktorë, si ata natyrorë dhe ekonomiko-shoqërorë me shtrirje gjeografike, ekonomike, kulturore dhe me rëndësi e ndikim shoqërore e politike. Shtrirja e rrjetit rrugor në territorin e Komunës së Prizrenit si dhe ndërlidhja rrugore me të gjitha nivelet e hierarkisë rrugore

mundëson lidhje të mira brenda juridiksionit komunal dhe qytetet tjera të Kosovës si dhe në nivel ndërkombëtar.

Harta nr.21 Infrastruktura e transportit në komunën e Prizrenit, aneksi i hartave, faqe 22 (Burimi i të dhënave: Rrugët nga baza digjitale e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit)

Intervenimet e viteve të fundit kanë bërë që cilësia e rrugëve që lidhin komunën e Prizrenit me vendbanimet tjera të jetë më e mirë por ende ka edhe shumë nevojë për intervenime në krijimin e kushteve më të mira të komunikacionit dhe të sigurisë në përgjithësi, e në veqanti për lëvizjen e këmbësorëve, shtigjet e biçikletave, etj.

### 4.1.1. Rrugët e nivelit kombëtar

Në Komunën e Prizrenit kalojnë rrugët magjistrale; Prizren–Suhareke–Prishtinë, Prizren–Gjakovë-Pejë, rrugët rajonale Prizren–Shkup, Prizren–Gjakovë–Shkodër, dhe autostrada "Ibrahim Rugova", e cila kalon në Komunën e Prizrenit. Rrjeti i rrugëve rajonale jo vetëm lidh komunën e Prizrenit me komunat fqinje, por edhe përfshinë qendrën kryesore dhe të gjitha nën-qendrat. Përfshirja e të gjitha nën-qendrave dhe qendrës kryesore në këtë rrjet, ka ndikim pozitiv në zhvillimin e balancuar të rajonit.

Me ndërtimin e autostradës "Ibrahim Rugova" Durrës-Prizren-Prishtinë në vitin 2010 është funksionalizuar drejtimi natyror determinant ndërmjet bregdetit Shqiptar dhe pjesës së brendshme të gadishullit Ballkanik. Kjo autostradë ka mundësuar që Prizreni të gjendet në një pozitë shumë më të mirë trafiku. Ndërtimi i kësaj rruge krijon mundësi për të lidhur ekonomikisht dy shtete të njëjtit komb, sidomos ndikimin që Kosova po luan në ekonominë e Shqipërisë. Sot Kosova është një ndër partnerët kryesorë tregtar, pushuesit nga Kosova zënë më shumë së gjysmën e turistëve të huaj që vinë në Shqipëri, marrëdhëniet mes bizneseve janë shtuar ndjeshëm.

Në komunën e Prizrenit pjesa më e madhe e madhe e rrugëve janë të asfaltuara, ato rrugë që janë të paasfaltuara gjenden në lagjet e vendbanimeve, sidomos në vendbanimet malore, ku kostoja e shpenzimeve është e lartë dhe në të jetojnë numër i vogël i banorëve dhe shtëpiat janë larg njëra prej tjetrës. Në territorin e Komunës së Prizrenit autoudha apo autostrada "Ibrahim Rugova" ka një gjatësi prej 26.8 km, e cila kalon mes komunës prej veriut deri në jug. Ndërsa, rrugët nacionale janë 31.7 km gjatësi, kjo është rruga Prizren-Morinë, që para ndërtimit të autostradës ka qenë një prej rrugëve më të rëndësishme të Prizrenit dhe rajonit të Dukagjinit në përgjithësi. Rrugë rajonale në territorin e Prizrenit janë 87.9 km, këto rrugë janë arterie e rëndësishme për lidhjen e kësaj komune me komunat fqinje, disa nga këto rrugë janë Prizren-Gjakovë-Pejë, rrugë tjetër e rëndësishme është edhe rruga Prizren-Shtërpcë-Doganaj, që mundëson lidhjen e kësaj komune me pjesën e Rrafshit të Kosovës, në autostradën "Arbër Xhaferi", duke i mundësuar lidhjen edhe me Republikën e Maqedonisë së Veriut. Tjetër rrugë e rëndësishme është edhe ajo Zhur-Dragash-Restelicë.

### 4.1.2. Rrugët urbane

Rrugët primare të Komunës së Prizrenit paraqesin segmentet urbane të rrugëve (nacionale-regjionale), kryqëzimi i të cilave paraqet nyjet kyqe urbane dhe ndërurbane. Këto rrugë paraqesin arteriet e qarkullimit që e lidhin qytetin dhe vendbanimet në përgjithësi. Nëpër tërë gjatësinë rrugore primare, rrugët dhe trotuaret janë të rregulluara, ndërsa në disa segmente kanë nevojë për përmirësime. Sa i përket qarkullimit në rrugët primare, si arterie kryesore lidhëse brenda qendrës

komunale, në periudha të caktuara shfaqen ngarkesa që e pengojnë qarkullimin e rrjedhshëm, por dhe jetën dhe funksionet e saj si vendbanim. Këto ngarkesa shkaktohen për disa arësye , si: psh. Trafik i dendur, trafik i dendur në sezonën e kthimit të bashkëatdhetarëve nga diaspora, mungon rruga transit, mungesa e rrugëve me më shumë korsi, rrjeti rrugëve sekondare në brendi të lagjeve i zhvilluar në formë të lirë dhe i karakterizuar me rrugë qorre, si pasojë e zhvillimeve të paplanifikuara hapësinore, ashtu që rrugët sekondare kanë nevojë edhe për përmirësimin e profileve rrugore.
Po ashtu, mungesa e trotuareve të mjaftueshme dhe të dizajnuara mirë paraqet vështërsi në lëvizjen e lirë të këmbësorëve. Mbetet e nevojshme që të ndërmerret një studim i mobilitetit / lëvizjes, së paku për vendbanimin, ashtu që të gjinden zgjidhje të qëndrueshme për mobilitet.

### 4.1.3. Rrugët e nivelit komunal

Komuna e Prizrenit ka bërë investime të konsiderueshme në infrastrukturën rrugore në të gjithë territorin e saj, është bërë një rrjetizim i qytetit dhe të vendbanimeve me njëra-tjetrën. Gjatësia e përgjithshme e rrjetit rrugor lokal është 1038 km. Gjendja e përgjithshme e rrugëve mund të konsiderohet të jetë relativisht e mirë. Rrugët lokale që lidhin qytetin dhe fshatrat shumica janë të asfaltuara, sikur edhe rrugët në brendi të fshatrave, përveç në disa lagje të veçuara, Në disa zona ka nevojë për përmirësim dhe zgjerim të rrugëve ( sidomos ne vendbanimet e zonave kodrinore-malore). Prej rrugëve të asfaltuara, vetëm disa prej tyre kanë trotuare ndërsa përmirësimi i hapësirave për për këmbësorë mbetet një çështje që len ende për tu dëshiruar.
Në kuadër të rrjetit rrugor janë mbi 113 ura (ne rruga lokale) me një gjatësi totale prej 5-20m, të gjitha të ndërtuara nga beton-hekur dhetë kalueshme për automjete.

### 4.1.4. Rrugët në vendbanime lokale

Përmirësimi i rrugëve brenda vendbanimeve është në vijim e sipër viteve të fundit. Përgjithësisht, për shkak të dendësisë rurale të ndërtimit dhe zhvillimit të vendbanimeve në lagje të ndara, rrugët e vendbanimeve karakterizohen me shpërndarje të madhe në raport me njësitë e banimit të cilave ju shërbejnë. Këto rrugë kanë nevojë për përmirësim në disa segmente, si në trajtimin e rrjetit / larg-përquesve elektrik, kabllovikut, sistemit të ujësjellësit dhe knalizimit, ujërave atmosferike dhe krijimin e kushteve për lëvizjen e sigurt të këmbësorëve, shtegun e biçiklistëve etj..

Në anën tjetër, në vendbanimet më rurale qarkullimi për këmbësorë mbetet më i vështirë me lidhje jo të mira dhe në shumë raste pa infrastrukturë përcjellëse(trotuare, shtegun e bicikletave, etj). Edhe pse komuna e Prizrenit ka bërë përpjekje për të përmirësuar lëvizshmërinë duke ndërtuar infrastrukturë rrugore ende ka mungesë të trotuareve për këmbësorë, sidomos në lagjet ku ka lëvizje të nxënësve në drejtim të shkollave, ashtu që e bën më të vështirë dhe më të pasigurtë lëvizjen në shumicën e rasteve për nxënësit që shkojnë dhe kthehen nga shkolla.

Mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore bëhet sipas kontratës për mirëmbajtje , nga kompanija kontraktuese nëpërmjet tenderit publik ku caktohet kontraktuesi që bën sanimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

*Tabela nr 40  Rrugët sipas kategorive në Komunën e Prizrenit*

| Kategoria | Gjatësia (km) | Përqindja |
|---|---|---|
| Autoudhë | 26.8 | 2.2 |
| Rrugë nacionale | 31.7 | 2.6 |
| Rrugë rajonale | 87.9 | 8.7 |
| Rrugë tjera | 1030.9 | 86.5 |
| Gjithsej | 1177.3 | 100 |

**Ngarkesa e qarkullimit në trafik**

Për vlerësimin e shpeshtësisë së trafikut në rrugët kryesore në Komunën e Prizrenit janë marrë në konsideratë karakteristikat e jo-linearitetit kohorë të qarkullimit të automjeteve në periudha të ndryshme kohore. Rezultatet më të mira janë dalë në raste të numërimit të frekuentimit të automjeteve përmes numëruesve automatik, në periudha më të gjata kohore. Nga rezultatet e numërimit gjatë periudhës brenda vitit vlerësohet trafiku mesatar ditor vjetor (TMDV), dhe shpeshtësia e frekuentimit të automjeteve brenda vitit. Ky është një tregues i rëndësishëm për planifikimin e rrugëve dhe menaxhimin e qarkullimit të automjeteve në rrjetin rrugor.




Fig 9 Qarkullimi i i fluksit të trafikut në qytetin e Prizrenit në sezone (burimi i të dhënave –Draft Plani i mobilitetit për komunën e Prizrenit)




Fig 10 Qarkullimi i automjeteve brenda ditës përgjatë rrugëve kryesore në Prizren

*Tabela nr 41 Ndryshimi i qarkullimit të automjeteve në rrugët kryesore të Prizrenit nga viti 2014-2024*

| Vitet | Qarkullimi | Aksi rrugor Suharekë-Prizren | Aksi rrugor Prizren-Suharekë | Aksi rrugor Gjakovë-Prizren | Aksi rrugor Prizren-Gjakovë | Aksi rrugor Brezovicë-Prizren | Aksi rrugor Prizren-Brezovicë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Njësia | Autom/ditë | Autom/ditë | Autom/ditë | Autom/ditë | Autom/ditë | Autom/ditë |
| 2022 | TMDV | | | | | | |
| 2023 | TMDV | 8990 | 8141 | 7021 | 6276 | 4448 | 3731 |
| 2024 | TMDV | | | | | | |
| Frekuentimi mesatar | (%) | | | | | | |

Në periudhat e ndryshme kohore kemi edhe frekuentim jo-linearë ( të ndryshëm), andaj këto ndryshime janë qartësisht të dukshme në disa nga muajt kur kemi kthimin e bashkë-atëdhetarëve në vendlindje. Këto ndryshime sezonale të fluksit të automjeteve në Komunën e Prizrenit janë dhënë në tabelën vijuese.

*Tabela nr 42 Ndryshimi  i qarkullimit të automjeteve në rrugët kryesore të Prizrenit në muajt e  vitit;*

| Viti 2023<br>Muaji: | Aksi rrugor<br>Prizren-Suhareke | Aksi rrugor<br>Suhareke-Prizren | Aksi rrugor<br>Gjakovë-Prizren | Aksi rrugor<br>Prizren - Gjakovë |
|---|---|---|---|---|
| | Automjete në ditë | Automjete në ditë | Automjete në ditë | Automjete në ditë |
| Maj | 8141 vetura | 8990 | | |
| Qershor | | | 7021 | 6276 |
| Korrik | | | | |
| Gusht | 10746 vetura | 12360 | 9899 | 8410 |
| Gjithësej: | | | | |
| TMDV | | | | |

*Graf nr 17 Ndryshimi sezonal i fluksit të trafikut në qytetin e Prizrenit*




Rruga kryesore nacionale N25 (e cila kalon nëpër pjesën qendrore të Prizrenit) është ndër rrugët më të ngarkuara me qarkullim të automjeteve në Prizren. Gjatë qarkullimit jashtë sezonal, në këtë pjesë të rrugës qarkullojnë rreth 17,131 automjete/ditë në të dy kahet, ndërsa gjatë sezonës së verës qarkullimit rritet për rreth 37%, respektivisht rreth 23,106 aut/ditë gjatë sezonës së verës.

▪ Brenda javës, dita e mërkure është dita më e ngarkuar e javës;

▪ Për nga struktura e qarkullimit, dominojnë automjetet personale me rreth 73.47%, të përcjellur nga automjetet e rënda me rimorkio rreth 17.59%, furgonët dhe Pickup-ët me 2.65%, ndërsa autobusët dhe kamionët përbëjnë rreth 6.29% të përbërjes së përgjithshme të qarkullimit;

▪ Në drejtimin e lëvizjes Prizren – Suharekë, ora e pikut të trafikut motorik paraqiten paradite nga ora 08:00-

09:00 si dhe pasdite nga ora 16:00-17:00. Qarkullimi maksimal i automjeteve brenda orës kulmore nga

Suhareka në drejtim të Prizrenit, arrihet nga 12:00-13:00, dhe sillet rreth 710 aut/h. Në rrugën nacionale N25, nga drejtimi i Suharekës në drejtim të Prizrenit, brenda 24 orëve qarkullojnë rreth

8,990 aut/ditë në dy kahe.

*Graf nr 18  Ndryshimi i qarkullimit të trafikut për periudhën kohore brenda javës (7 ditë)*




Graf nr 19 Ndryshimi i qarkullimit brenda ditës, drejtimi: Prizren - Suharekë



Graf nr 20 Ndryshimi i qarkullimit brenda ditës, drejtimi:Suharekë- Prizren




#### 4.1.5. Siguria në trafik

Vlerësimi i sigurisë në trafik në rrugët kryesore në Komunën e Prizrenit është e bazuar në analizën nga të dhënat analitike të ofruara nga sektori i sigurisë, për nivelin e sigurisë së trafikut rrugor në regjionin e Prizrenit Të dhënat janë paraqitura ndë vite kanë për qëllim vlerësimin dhe trendin e ngjarjeve /aksidenteve rrugore si dhe pasojave sipas metodës krahasuese;

Tabela nr 43 Krahasimi i aksidenteve për periudhën: Janar-dhjetor2022-2023 në komunen e Prizrenit

| Aksidente fatale | | | Persona të vdekur | | | Aksidente me lëndime | | | Persona të lënduar | | | Aksidente me dëme materiale | | | Gjithësej: | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2022 | 2023 | % | 2022 | 2023 | % | 2022 | 2023 | % | 2022 | 2023 | % | 2022 | 2023 | % | 2022 | 2023 | % |
| 4 | 6 | 50 | 4 | 8 | 100 | 399 | 470 | 17.8 | 598 | 739 | 24 | 995 | 1207 | 21.3 | 1401 | 1696 | 21.1 |

Graf nr 21 Trendi i aksidenteve në Komunën e Prizrenit




Analizat e statistikave nga aksidentet dhe trendet e tyre korresponduese mbeten njëra nga sfidat kryesore në zhvillimin e një programi të për sigurinë rrugore në Komunën e Prizrenit. Sipas të dhënave nga Policia e Kosovës- Njësia e Trafikut Rajonal në Prizren lidhur me numrin e aksidenteve në Prizren vërehet se, gjendja në komunikacionin rrugor gjatë periudhës së regjistruar 2018 deri 2022 flet për rritje të ndjeshme të aksidenteve dhe të numrit të personave të lënduar në dy vitet e fundit 2021 - 2022. (burimi i të dhënave PLANI I MOBILITETIT TË QËNDRUESHËM URBAN 2024-2034)

### 4.1.6. Burimet e rreziqeve (Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve në infrastrukturën rrugore

Identifikimi dhe vlerësimi i burimeve të rreziqeve në infrastrukturën rrugore përfshin analizimin e faktorëve që mund të shkaktojnë probleme në sistemin e trafikut. Ja disa nga burimet kryesore të rreziqeve:

Faktorët Natyrorë- Moti ekstrem: Përmbytje, dëborë e madhe, shi i fortë, dhe erëra të forta mund të dëmtojnë rrugët dhe të shkaktojnë aksidente.

Toka e paqëndrueshme: Rrëshqitjet e tokës mund të shkaktojnë bllokime dhe dëmtime të infrastrukturës.

Faktori njëri - Sjellja e shoferëve: Shpejtësia, përdorimi i celularëve, alkooli dhe ndikuar nga lodhja janë shkaktarë të rëndësishëm të aksidenteve.

Këmbësorët dhe përdoruesit e tjerë: Mosrespektimi i rregullave të qarkullimit nga këmbësorët, çiklistët ose përdoruesit e mjeteve motorike.

Faktorët Teknikë- Dizajni i infrastrukturës: Rrugë të ngushta, kthesa të rrezikshme dhe ndriçim i pamjaftueshëm.

Dëmtimi i materialeve ndërtimore, si asfalti i degraduar ose rrugët e papërshtatshme.

Faktorët Organizativë - Mungesa e mirëmbajtjes: Rrugët që nuk mbahen në gjendje të mirë mund të krijojnë kushte të rrezikshme për trafik.

Planifikimi dhe menaxhimi i trafikimit: Mungesa e planifikimit të mirë të trafikut dhe lëvizjes mund të çojë në rritjen e aksidenteve.

Faktorët Ekonomikë - Investimet e pamjaftueshme: Mungesa e fondeve për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës mund të rrisë rrezikun.

Kostot e sigurisë: Mungesa e investimeve në teknologjitë e sigurisë, si semaforët inteligjentë dhe sistemet e monitorimit.

Masat parandaluese me qëllim të zvoglimit-zbutjes së rreziqeve në trafik dhe rekomandime:

Masa parandaluese për zvoglimin e rreziqeve në trafik janë të rëndësishme për të siguruar një ambient të sigurt për të gjithë. Ja disa nga këto masa:

Fushata edukative:

Organizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit mbi sigurinë në trafik, përfshirë rregullat e qarkullimit dhe sjelljen e përgjegjshme.

Trajnime për shoferët: Ofrimi i kurseve të trajnimit për shoferët për të përmirësuar aftësitë e tyre dhe njohuritë mbi sigurinë.

Infrastrukturë e Sigurt- Rrugë dhe kalime të sigurta: Projektimi i rrugëve dhe kalimeve për këmbësorë që të jenë të dukshme dhe të lehta për t'u përdorur.

Sinjalistika e qartë: Vendosja e shenjave të qarta dhe të dukshme, si dhe ndriçimi i mjaftueshëm në zonat me rrezik.

Rregullat e qarkullimit - Zbatimi dhe forcimi i rregullave të qarkullimit, si kufizimet e shpejtësisë dhe ndalimi i përdorimit të celularëve gjatë drejtimit.

Sanksionet për shkelësit: Aplikimi i sanksioneve për ata që shkelin rregullat e qarkullimit, për të rritur ndjeshmërinë ndaj ligjit.

Përdorimi i teknologjisë

- Integrimi i sistemeve të menaxhimit të trafikut, si semaforët inteligjentë dhe monitorimi në kohë reale.
- Automjetet e mençura: Nxitja e përdorimit të automjeteve me teknologji të avancuar që ndihmojnë në parandalimin e aksidenteve.

Pjesëmarrja e Komunitetit - Bashkëpunimi me organizatat lokale: Angazhimi i organizatave lokale dhe komunitetit për të promovuar sigurinë në trafik.

- Iniciativa për ruajtjen e sigurisë: Krijimi i grupeve të punës për të identifikuar problemet dhe për të zbatuar zgjidhje të efektshme.

- Monitorimi dhe Rishikimi - Analiza e aksidenteve: Vlerësimi i statistikave të aksidenteve për të identifikuar zonat e rrezikshme dhe për të zhvilluar masa specifike.

- Implementimi i këtyre masave mund të ndihmojë në uljen e numrit të aksidenteve dhe të rrisë sigurinë për të gjithë përdoruesit e rrugës. Këto burime rreziku duhet të merren parasysh në çdo fazë të planifikimit dhe menaxhimit të infrastrukturës rrugore për të minimizuar rreziqet dhe për të rritur sigurinë e trafikimit.

- *Harta nr 22 Harta e zonave të rrezikuar nga bora dhe ngricat në Komunën e Prizrenit aneksi i hartave, faqe 24 (Burimi i të dhënave, analizë nga hartat topografike, Gjeoportali kombëtar).*

### 4.2. Transporti hekurudhor

TRAINKOS është kompani publike dhe është operatori i vetëm legal në Kosovë që ofron shërbime të transportit hekurudhor të udhëtarëve dhe mallrave.
Komuna e Prizrenit ka qasje direkte në rrjetin hekurudhor por nuk eshte aktiv ne periudhën e pasluftes Hekurudha fillon nga Prizreni dhe shkon drejt Gjakovës. Ajo lidh hekurudhën Pejë – Prishtinë në komunën e Klinës. Hekurudha është pasive që nga viti 1999. Në përgjithësi, rrjeti nuk është në gjendje të mirë. Për momentin nuk paraqet ndonjë rrezik pasi qe nuk është aktive kjo hekurudhë

Nëse aktivizohet kjo linjë atëherë Identifikimi i rreziqeve në segmentet e transportit hekurudhor janë një proces i rëndësishëm për të siguruar sigurinë dhe efikasitetin e sistemit. Disa nga rreziqet kryesore përfshijnë:

**Rreziqet e Infrastrukturës:**

- Dëmtimi i binarëve dhe sinjalizimit.
- Mungesa e mirëmbajtjes së sistemeve hekurudhore.
- Rrëshqitja e tokës apo ndryshimet klimatike që ndikojnë në stabilitetin e rrugëve.
-

**Rreziqet Operacionale:**

- Gabimet njerëzore në operimin e trenave.
- Mungesa e komunikimit efektiv ndërmjet ekipeve.
- Dështimi i sistemeve automatike të kontrollit.
- Rreziqet nga Ndërhyrjet e Jashtme:
- Akset e transportit dhe kalimet e hapura nga automjetet dhe këmbësorët.
- Dëmtimi i linjave hekurudhore nga aktivitete ndërtimore apo natyrore.

**Rreziqet Teknike:**

- Dështimi i sistemeve të sinjalizimit dhe të ndihmës.
- Probleme me motorrët dhe pajisjet mekanike të trenave.

Harta nr 23 segmenti i transportit hekurudhor lokal , aneksi i hartave, faqe 24 , Burimi i të dhënave: Digjitalizim nga Ortofotot 2018, Gjeoportali kombëtar https://geoportal.rks-gov.net/search

### 4.3. Transporti ajror/Aeroportet

Qyteti ynë është me distancë nga Aero-porti“ Adem Jashari” afërsisht 72 km. Ndërtimi i infrastrukturës rrugore Autostrada Ibrahim Rugova përshpejton mundësinë për qasje më të shpejtë në linjat e transportit ajror njëkohësishtë janë edhe mundësi reale për shfrytëzim të vijave emergjente për furnizim emergjent nga vendet tjera në raste të FNFT. Duhet pasur parasysh se transporti ajror përveq të mirave dhe dobisë në transporte publike dhe emergjente, mund të kemi edhe potencialisht rreziqe dhe fatkeqësi me pasoja për fluturaken mbi qiellin tonë por edhe me rreziqe në raste të aksidenteve ajrore. Prandaj duhet të jemi të përgatitur me ekipe profesionale të KSh, në aspektin human( të trajnuar dhe certifikuar), teknik (pajisje adekuate për reagim dhe K-Sh ), ekipe profesionale hulumtuese për fatkeqësinë, Ekipi për vlerësim të dëmeve materiale, dëmeve ambientale si dhe segmenteve tjera të sigurisë. ***Sfidat:***

- Trajnimet e pamjaftueshme profesionale për reagim në rast të fatkeqësive ajrore;
- Mungesa e Planit lokal të veprimit, mjeteve dhe pajisjeve adekuate për reagim dhe Kërkim–Shpëtim në aviacion civil;
- Faktorët e përkeqësimit (kushtet klimatike: mjegulla, shiu, bora, ngricat, shtrëngatat, temperaturat, erërat e forta ,etj);
- Mungesa e fluturakeve vendore (të helikopterëve, dronëve vëzhgues, etj.) për kërkim-shpëtim nga ajri; Etj.

### 4.4. Ura dhe tunele

#### 4.4.1. Urat

– Urat të cilat janë të evidentuara brenda juridiksionit të Komunës së Prizrenit kategorizohen në ura për komunikacion rrugor dhe hekurudhor.

**- Urat në komunikacionin hekurudhor**

Në rrjetin hekurudhor të zonës urbane të Komunës së Prizrenit titullarë e kanë TRAINKOS-in, dhe gjithësejtë janë të ndërtuara 5 ura, si pjesë përbërëse e rrjetit hekurudhor, të ndërtuara mbi degët e lumit Drin i Bardhë si Toplluha në fshati Pirane ku ura është me gjatësi afërsisht prej 60 m dhe ura në fshatin Landovice me gjatësi prej 30 m. Ndersa 3 urat e tjera janë me gjatësi të vogël.

***Harta nr*** *24 Rrjeti hekurudhor-urat në rrjetin hekurudhorë, aneksi i hartave, faqe 25, Burimi i të dhënave, Digjitalizimi nga Hartat topografike, Gjeooportali kombëtar https://geoportal.rks-gov.net/search*

**-Urat në komunikacionin rrugor**

Urat të cilat janë të evidentuara brenda juridiksionit të Komunës së Prizrenit nga 162 ura gjithësej të ndërtuara në rrjetin rrugor në komunën e Prizrenit, prej tyre 49 janë të ndërtuara në në rrugët në nivel kombëtarë ( rrugë magjistrale dhe rrugë regjionale si dhe autostrada) kurse urat tjera janë pjesë e infrastrukturës lokale si dhe në rrugët lokale të pa kategorizuara(asfaltuara).

Në autostradë afër fshatit Shkozë të komunës së Prizrenit është ura me e gjatë e identifikuar deri me tani me gjatësi afër 500 metra. Ndersa tri urat tjera janë me nje distance me te madhe se 100 metra ndërsa urat e tjera ne Autostrade, Rruge magjistrale dhe Rajonale janë të kategorisë me të vogël.

***Harta nr** 25 Urat në Komunën e Prizrenit, aneksi i hartave, faqe 26, Burimi i të dhënave: Digjitalizim nga Harta topografike , Gjeoportali Kombetar https://geoportal.rks-gov.net/search*

### 4.4.2. Tunelet

Tunelet të cilat janë të evidentuara brenda juridiksionit të Komunës së Prizrenit kategorizohen në tunele për komunikacion rrugor.

**Tunelet në rrjetin rrugor:** janë pjesë integrale e sistemit në rrjetin rrugor, në akset e rrjetit e caktuara rrugore, ku në komunën **e Prizrenit** janë të ndërtuara **g**jithsejtë 2 tunele rrugore, që gjendën ne aksin rrugor Prizren - Prevallë janë 2 tunele janë funksionale për qarkullim, me gjatësi 60 m për dy tunelet të cilat janë afër njëra tjetrës , ndërsa gjerësia e tyre është 7 metra. Gjendet ne koordinatat gjeografike:

Tuneli 1. Long = 20.790110269 dhe Lat= 42.187360453 dhe

Tuneli 2. Long = 20.78953669 dhe Lat= 42.1883837587

Tuneli në komunën e Prizrenit është një pjesë e rëndësishme e infrastrukturës lokale. Disa nga karakteristikat dhe rreziqet e mundshme që lidhen me tunelin përfshijnë:

Rreziqet Strukturorë: Mund të ketë rreziqe që lidhen me stabilitetin e tunelit, siç janë rrëshqitjet e tokës ose dëmtimi i murit për shkak të motit ekstrem.

Mirëmbajtja: Duhet të ketë një plan të rregullt mirëmbajtjeje për të siguruar që tuneli të jetë gjithmonë në kushte të mira.

***Harta nr 26** Urat dhe tunelet në Komunën e Prizrenit, aneksi i hartave, faqe 27*

*Burimi i të dhënave: Digjitalizim nga Ortofotot e vitit 2018, Gjeoportali kombëtar https://geoportal.rks-gov.net/search*

## 4.5. Sistemi energjetik (objektet dhe sistemet)

Hartimi i politikave, organizimi, rregullimi dhe menaxhimi i sektorit të energjisë në Republikën e Kosovës bëhet nga Ministria e Ekonomisë.

Nga harta e rrjetit elektroenergjetik të Kosovës të publikuar nga KOSST shifet se në komunën e Prizrenit për momentin janë 3 nënstacione energjetike , Prizreni 2 220/110 kV si nënstacioni kryesor për regjonin e Prizrenit i furnizon nënstacionet tjera Prizrenin 1, Prizrenin 3 dhe Gjakova, Gjakova 2. Pra për momentin nënstacionet energjetike në komunen e Prizrenit mbesin:

- Nënstacioni Energjetik NS Prizreni 2 220/110 kV
- Nënstacioni Energjetik NS Prizreni 1 110/35 kV
- Nënstacioni Energjetik NS Prizreni 3 110/35 kV

Komuna e Prizrenit momentalisht furnizohet me energji elektrike nga nënstacioni Prizreni 2- 220/110 kV. Ky nënstacion i furnizon Prizrenin 1 me linjë të dyfisht si dhe Prizrenin 3. Planifikohet edhe ndërtimi i nënstacionit Prizreni 4 ne afatin kohor deri në vitin 2030. Këto kapacitete pritet të jenë të mjaftueshme për regjionit e Prizrenit sa i përket nënstacioneve energjetike.

Në komunën e Prizrenit ndodhen këto objekte të veçanta të karakterit energjetik të cilat janë si pjesë e rrjetit elektro-energjetik të KEDS/KESCO:

• Linja 220kV Tirana 2(fierza) –Prizren-Feronikel-KosovaB
• Linja 110 kV Prizren 1-Prizren 2-Prizren 3
• Linja 110 kV Prizren 3-Therand
• Linja 110 kV Prizren 2-Rahovec
• Linja 110 kV Prizren 2-Gjakovë
• Nënstacioni Energjetik NS Prizreni 2 220/110 kV
• Nënstacioni Energjetik NS Prizreni 1 110/35 kV
• Nënstacioni Energjetik NS Prizreni 3 110/35 kV
• Dhe në të ardhmen (deri në vitin 2030) Kompletimi i Nënstacionit Energjetik NS Prizreni 4 (Nashec) 400/220/110 kV.

## 4.6. Largpërçuesit dhe trafo-stacionet

Në rrjetën e furnizimit me energji elektrike të komunës së Prizrenit, sipas drejtimeve të shpërndarjes së shfrytëzuesve, kemi të vendosura gjithsej 46 trafo-stacione të kapaciteteve të ndryshme. Duke u nisur nga ky fakt mund të konstatojmë se Trafo-Stacione(TS), prej tyre kolektive janë 21, ndërsa 25 të tjera janë individuale.

- *Tabela **44** Trafo-stacionet në Komunën e Prizrenit*

| Drejtimi i rrjetit energjetik | TS | Kolektive | Individuale |
|---|---|---|---|
| Ish zona industrial Banim | 8 | po | |
| Bazhderhane | 6 | po | |
| Qenrda e qytetit | 4 | po | |
| Ortokoll | 3 | po | |
| Drejtimi i Tususit | 3 | | po |
| Drejtimi i Arbanës | 5 | | po |
| Drejtimi i Zhurit | 2 | | po |
| Drejtimi i Reqanit | 2 | | po |
| Drejtimi i Korishës | 2 | | po |
| Drejtimi i Landovicës | 1 | | po |
| Drejtimi i Vlashnjës | 8 | | po |
| Drejtimi i rruges transit | 2 | | po |

Rreziqet nga rrjeti energjetik janë shumë të ndryshme dhe ndikon në mënyra të ndryshme në mjedisin, shëndetin dhe ekonominë. Disa nga këto rreziqe përfshijnë:

- Shkarkimi i energjisë: Mungesa e mbrojtjes nga shkarkimet energjetike mund të shkaktojë dëme në pajisjet elektrike dhe infrastrukturën.
- Ndikimi mjedisor: Prodhimi i energjisë nga burime fosile ndot ajrin dhe ujin, duke kontribuar në ndryshimet klimatike.
- Rreziqet shëndetësore: Ekspozimi ndaj niveleve të larta të ndotjes nga energjia e rinovueshme dhe ajo fosile mund të ketë pasoja të rënda për shëndetin e njerëzve.

- *Harta nr 27 Rrjeti elektro-energjetike në komunën e Prizrenit aneksi i hartave, faqe 28*

- *Burimi i te dhënave : Plani hapësinor i Kosoves 2010-2020+*

- *https://mmphi.rks-gov.net/MMPHIFolder/DivisionDocs/2022_55743870-1cda-4ea5-8e8d-796ae64b7766.pdf*

## 4.7. Sistemet e telekomunikimit

### 4.7.1. Objektet dhe shërbimet (brenda komunës)

**Telefonia Fikse :**
Lidhjet kryesore të telekomunikacionit për Komunën e Prizrenit me qytetet tjara dhe jashtë komunës janë kabllot optike të PTK dhe të operatorve privat të telekomunikimeve. Rrjeti i kabllove optike dhe telekomunikimeve të PTK, menaxhohet nga njësia e PTK-së, në Prizren të cila ka objektet postare ku janë cetralet e telefonisë fikse.
Përveq pjesës më të madhe të qytetit dhe tri fshatrave (Zhur, Korishë, Reqan ), telefonia fikse nuk është e shtrirë në pjesët tjera të vendbanimeve rurale.

**Telefonia mobile** : Mbulueshmeria me rrjet të telefonive mobile në Komunen e Prizrenit është mjaft mirë e shtrirë dhe mund të thuhet se të gjitha vendbanimet e Prizrenit kanë qasje në shërbimet e telefonisë mobile, të cilat ofrohen nga dy operatorët e licencuar nga ART-ja. Të dy operatoret mobil i kanë të shpërndara antenat individuale në lokacione të ndryshme të komunes. Numri i antenave të vendosura nga operatorët mobil sipas vendbanimeve dhe operatoreve në tërë territorin e komunës është 12.

Qyteti i Prizrenit ka një numër prej 8 objekte të PTK në zonën urbane dhe tri objekte në fshatrat më të mëdha si Zhur, Reqan dhe Korishë. Këto janë të gjitha objektet e PRK në komunen e Prizrenit.

Prizren 1 Prizren Adem Jashari pn., Prizren 20010

• Prizren 2 Prizren Xhevat Berisha p.n., Prizren 20020

• Prizren 3 Prizren De Radës p.n., Prizren 20030

• Prizren 4 Prizren Ismet Jashari Kumanova p.n., Prizren 20040

• Prizren 5 Prizren 272 Qazim Berisha , Prizren 20050

• Prizren 6 Prizren 103 Jusuf Gërvalla , Prizren 20060

• Prizren 9 MPB Prizren Wiliam Woker p.n, Prizren 20090

• Prizren 10 KK Prizren Rr. Remzi Ademi p.n. 20100

• Zhur Prizren Fshati Zhur p.n. 20520

• Reqan Prizren Fshati Reqanë p.n. 20530

• Korishë Prizren Fshati Korishë p.n. 20550

### 4.7.2. Personat juridik

**Shërbimet e Internetit: e**kzistojnë disa operator të cilët bëjnë shpërndarjen e shërbimeve të internetit në zonën urbane të Prizrenit, të cilët e mbulojnë tërë territorin e zonës urbane. Kryesisht interneti në zonën urbane është i shpërndarë në lidhje individuale dhe lidhjeve të institucioneve të caktuara.

Tabela nr 45 : Lista e përsonave juridik në telekomunikacion:

| Nr. | Institucioni | Adresa elektronike |
|---|---|---|
| 1 | PTK | info@telekomi.net<br>info@valamobil.com |
| 2 | IPKO | info@ipko.com |
| 3 | Kujtesa | ofice@kujtesa.com |

### 4.7.3. Qendrat telekominikuese transmetuese dhe repetitorët

Në komunë e Prizrenit ndodhen gjithësej 86 antena të operatorit Vala , IPKO dhe e PTK-së.
Operatorët me ndikim më të madh, që ofrojnë shërbime të internetit janë:

- **PTK** - Darda NET, nëpërmjet të telefonisë fikse;
- **IPKO** – ofron shërbime të internetit nëpërmjet të antenave (individuale);
- **KUJTESA** - ofron shërbime të internetit nëpërmjet të antenave (individuale); etj.

**Shërbimet Postare** : Mbulohen nga njësitë postare që janë pjesë e PTK: 8 njësi në qytetin e Prizrenit dhe tri njësi në fshatrat: Zhur, Korishë, Reqan, dhe gjithashtu nga kompanit private të cilat
kryejnë shërbime si posta të shpejta dhe ngjajshëm.

**Shërbimet e Internetit** – Ekzistojne disa operator të cilet bëjnë shpërndarjen e shërbimeve të internetit në komunën e Prizrenit. Territori i komunës është mjaftë mirë i mbuluar me shërbime të internetit, të cilat funksionojneë si rrjete të sistemeve kabllore me fije optike dhe rrjete kabllore me kabllo kaoksiale. Këto rrjete, përveq PTK që shpërndan internetin me anë të rrjetit të telefonise fikse , janë edhe operatorët privat të cilët kanë shtrirë rrjetet e tyre pothuajse në tërë teritorin e komunës së Prizrenit dhe i mirmbajnë për qëllime komerciale. Në ato fise ku nuk ka sistem kabllor, interneti shpërndahet me anë te antenave. Operatorët me ndikim më të madh, që ofrojnë shërbime të internetit në komunën e Prizrenit janë:

• PTK - , nëpërmjet të telefonise fikse
• IPKO – ofron shërbime te internetit nëpermjet të antenave dhe rrjetit kablore (individuale)
• KUJTESA - ofron shërbime të internetit nëpërmjet të antenave dhe rrjetit kabllore (individuale).
• ArtMotion- ofron shërbime të internetit nëpërmjet të antenave dhe rrjetit kabllore(individuale).

Përveq operatorve kryesor privat, në komunë operojnë edhe operatoret tjerë që kanë shtrirje më të vogël kryesisht në nivel lokal vetëm në ndonjë fshat.

### 4.7.4. TV dhe radiostacionet

**Radiotelevizioni** – rrjeti i Radiotelevizionit në zonën urbane të Prizrenit është e shpërndarë pothuajse në tërë territorin. Ekzistojnë disa forma të shfrytëzimit të valëve radio-televizive të ndara në dy grupe:

- Radio-televizionet Nacionale – RTK, RTV21, TV Klan dhe KTV,
- Radio- lokale – TV Opinion, RTV BESA, RTV Prizreni etj.
- Radio-televizionet nëpërmjet antenave satelitore,
- Radio-televizionet nëpërmjet sistemeve kabllore, etj.

Lajmi dhe komunikimi i ndërsjellë përmes: të shkruarit, të folurit, imituarit, etj.janë mënyrë /formë për të mësuar, informuar, njoftuar apo kuptuar informacionin përmes sëcilit mund të mësojmë, njohim apo kuptojmë informatën. Kriteret/normat bazë të klasifikimit të mediave përcaktohen kryesisht nga forma se si ato i ofrohen konsumatorit mediatik për tú shfrytëzuar.

Mediat klasifikohen kryesisht në katër grupe kryesore siç janë:

- Mediat televizive
- Mediat radiofonike
- Mediat e shkruara
- Mediat sociale (rrjetet sociale).

*Harta nr.28 : Shpërndarja e antenave/kullave shpërndarëse të telefonisë mobile, aneksi i hartave, faqe 29*
*Burimi i të dhënave: Digjitalizim nga hartat topografike (gjeoportali kombëtar).*

## 4.8. Sistemet hidroteknike

### 4.8.1. Objektet për furnizim me ujë

Bazuar në Planin Zhvillimor Komunal, në kuadër të sektorit të shërbimeve publike janë bërë llogari të shpenzimeve dhe kapacitetit të nevojshëm të ujit të pijes për banoret e kësaj zone e cila duhet të jetë në harmoni me kërkesat për furnizim me ujë të pijes për qytetin e Prizrenit dhe fshatrat e sajë, me qëllim të realizimit të projekteve si pjesë integrale e Planit të Veprimit të komunës së Prizrneit meqërast parashihet zgjërimi i rrjetit të ujësjellësit në territorin e komunës, në koordinim dhe bashkëveprim me K.R.U. "Hidroregjioni Jugor". Komuna e Prizrenit furnizohet me ujë nga resurset / burimet ujore natyrore / nëntokësore- Puset



Fig. 11 Furnizimi aktual me ujë (burimi i te dhënave , Harta zonale e komunës se Prizrenit)




Fig. 12 Furnizimi aktual me ujë (burimi i te dhënave , Harta zonale e komunës se Prizrenit)

### 4.8.2. Korporata rajonale e ujërave ( KRU) dhe burimet alternative

K.R.U “Hidroregjioni Jugor" Sh.A. operon dhe mirëmbanë rrjetin e Ujësjellësit në Komunën e Prizrenit Aktualisht, KRU “Hidroregjioni Jugor"Sh. A. është ofruesi kryesor me ujë të pijshëm në komunën tonë, e cila ofron shërbime për pjesën e qytetit dhe fshatrave te cilat furnizohen nga burimet ujore-puset. Kapacitetet të prodhimit të ujit (kapacitetet e shfrytëzuara) janë premtuese për nevojat e shpenzimeve nga qytetarët, ku koha e furnizimit me ujë të pijshëm në rastin më të mirë është 24 orë.

### 4.8.3. Sistemi i distribuimit të ujit për pije

K.R.U "Hidroregjioni Jugor" Sh.A operon dhe mirëmbanë rrjetin e Ujësjellësit ne Komunën e Prizrenit. Edhe pse me shumë përpjekje akoma, kjo kompani nuk ka arritur që të shtrijë rrjetin e shërbimeve në të gjitha vendbanimet rurale të komunës .Pjesa më e madhe e territorit të komunës së Prizrenit furnizohet me ujë të pijshëm.

Tab 46 Burimet e ujit për pije

| Nr Rendor | Emri i vendbanimit | Qasje në Ujësjelles Po-Jo | Menaxhimi nga: |
|---|---|---|---|
| 1 | Atmaxhë | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 2 | Billushë | Po | VETËMENAXHIM |
| 3 | Caparc | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 4 | Dedaj | Po | KRU GJAKOVA SH.A |
| 5 | Dobrushtë | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 6 | Dojnicë | Po | VETËMENAXHIM |
| 7 | Drajçiq | Po | VETËMENAXHIM |
| 8 | Dushanovë | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 9 | Gërnçar | Po | VETËMENAXHIM |
| 10 | Gornjasellë | Po | VETËMENAXHIM |
| 11 | Gorozhup | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 12 | Grazhdanik | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 13 | Gjonaj | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 14 | Hoçë e Qytetit | Po | VETËMENAXHIM |
| 15 | Jabllanicë | Po | VETËMENAXHIM |
| 16 | Jeshkovë | Po | VETËMENAXHIM |
| 17 | Kabash | | |
| 18 | Kabash i Hasit | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 19 | Karashëngjergj | Po | KRU GJAKOVA SH.A |
| 20 | Kobajë | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 21 | Kojushë | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 22 | Korishë | Po | VETËMENAXHIM |
| 23 | Krajk | Po | KRU GJAKOVA SH.A |
| 24 | Krushë e Vogël | Po | KRU GJAKOVA SH.A |
| 25 | Kushnin | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 26 | Kushtendil | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 27 | Landovicë | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 28 | Leskovec | | |
| 29 | Lez | | |
| 30 | Lubinjë e Epërme | Po | VETËMENAXHIM |
| 31 | Lubinjë e Poshtme | Po | VETËMENAXHIM |
| 32 | Lubiqevë | Po | VETËMENAXHIM |
| 33 | Lubizhdë | Po | VETËMENAXHIM |
| 34 | Lubizhdë e Hasit | Po | KRU GJAKOVA SH.A |
| 35 | Lukinaj | Po | KRU GJAKOVA SH.A |
| 36 | Lutogllavë | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 37 | Llokvicë | Po | VETËMENAXHIM |
| 38 | Malësi e Re | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 39 | Manastiricë | Po | VETËMENAXHIM |
| 40 | Mazrek | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 41 | Medvec | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 42 | Milaj | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 43 | Muradem | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 44 | Mushnikovë | Po | VETËMENAXHIM |
| 45 | Nashec | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 46 | Nebregoshtë | Po | VETËMENAXHIM |
| 47 | Novak | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 48 | Novosellë | Po | VETËMENAXHIM |
| 49 | Petrovë | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 50 | Piranë | Po | KRU GJAKOVA SH.A |
| 51 | Pllanejë | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 52 | Pllanjan | Po | VETËMENAXHIM |
| 53 | Poslishtë | Po | VETËMENAXHIM |
| 54 | Pouskë | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 55 | Prizren | Po | KRU"HRJ"Sh.A |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 56 | Randobravë | Po | KRU GJAKOVA SH.A |
| 57 | Reçan | Po | VETËMENAXHIM |
| 58 | Romajë | Po | KRU GJAKOVA SH.A |
| 59 | Sërbicë e Epërme | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 60 | Sërbicë e Poshtme | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 61 | Skorobishtë | Po | VETËMENAXHIM |
| 62 | Smaç | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 63 | Sredskë | Po | VETËMENAXHIM |
| 64 | Struzhë | Po | VETËMENAXHIM |
| 65 | Shkozë | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 66 | Shpenadi | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 67 | Trepetnicë | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 68 | Tupec | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 69 | Velezhë | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 70 | Vërbiçan | Po | VETËMENAXHIM |
| 71 | Vërmicë | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 72 | Vlashnjë | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 73 | Zojz | Po | KRU"HRJ"Sh.A |
| 74 | Zym | Po | KRU GJAKOVA SH.A |
| 75 | Zhivinjan | Po | VETËMENAXHIM |
| 76 | Zhur | Po | KRU"HRJ"Sh.A |

- *Harta nr 29 Furnizimi me ujë të pijshëm në komunën e Prizrenit, aneksi i hartave, faqe 29*

*Burimi i të dhënave KRU"HRJ"Sh.A, Prizren*

### 4.8.4. Monitorimi i ujërave për pije

Cilësia e ujit të pijes i referohet karakteristikave mikrobiologjike dhe fiziko-kimike. Cilësia e ujit të pijshëm është një tregues i rëndësishëm për mirëqenien dhe shëndetin e popullsisë.

KRU kanë përgjegjësinë për të furnizuar me ujë cilësorë konsumatorët e tyre, ato gjithashtu kanë obligim për të bërë monitorimin/testimin intern të kualitetit të ujit. Nga ana tjetër IKSHP është

institucion i ngarkuar me përgjegjësi ligjore për të bërë kontrollin dhe monitorimin e ujërave të pijshëm. IKSHP siguron se uji i distribuuar nga KRU është në përputhje me vlerat sipas standardit vendorë për parametrat mikrobiologjik dhe fiziko-kimik. Gjatë vitit 2023, janë marrë mostra të ujit në rubinetet e konsumatorëve me qëllim të testimeve të cilësisë së ujit në aspektin fiziko-kimik dhe mikrobiologjik, në të cilën 99.68 % të mostrave kanë qenë në përputhshmëri me standardet e kërkuara, në aspektin fiziko-kimik dhe mikrobiologjik në të cilën 99.68 % të mostrave kanë qenë në përputhshmëri me standardet e kërkuara.

*Tabela nr 47 : Norma (%) e testeve bakteriologjike dhe fiziko-kimike në përputhje me standardet e cilësisë së ujit sipas KRU-2023/2024*

| *Parametrat:* | *Viti* | *KRU "Hidro Regjioni Jugor."* | |
|---|---|---|---|
| | | *Mostrat /numri* | *Vlera mesatare* |
| *Mikro-biologjike* | *2023* | *628* | *99.68 %* |
| | *2024* | | *%* |
| *Fiziko-kimike* | *2023* | *628* | *99.68 %* |
| | *2024* | | *%* |
| *Mesatarja për KRU……..* | *2023* | | *%* |
| | *2024* | | *%* |

### 4.8.5. Ndotësit e mundshëm të ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor

Ndotja e ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor në Komunën e Prizrenit janë problematikë e pazgjidhur nga se ka burime dhe afektime të shumta dhe të ndryshme, të cilat kërkojnë mbikqyrje dhe kontrollë më të veqantë institucionale por edhe vetëdijësim qytetarë.

Ndotësit kryesor janë mbeturinat e ndryshme( ilegale) dhe hedhja e tyre në përrocka, lumenjë dhe në ambiente të hapura, shkarkimi i ujërave të zeza, hedhja e inerteve, mbeturrinave industriale, mbeturinave të gjeneruara nga spitali dhe klinikat,etj. Mbeturinat të cilat gjenerohen nga jeta e përditshme e qytetarëve, janë me sasi të madhe dhe paraqesin rrezikshmëri të lartë, sidomos nëse nuk deponohen apo nuk trajtohen si duhet dhe me kohë, në kontakt me ujërat mbitokësorë dhe nëntokësorë, afektojnë sasi të mëdha të ujërave dheambientit.

Ky lloji i mbeturinave shkarkohet ilegalisht ngaqë nuk ka trajtues për to në Kosovë. Është domosdoshmëri që edhe niveli qëndror por edhe lokal të merret më seriozisht me trajtimin dhe menaxhimin e mbeturinave dhe përdorimin e tyre në frymën e interesit ekonomik dhe ekologjik së bashku më Institucionet relevante.

Ndotësit e ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor mund të jenë shumë të ndryshëm dhe të ndikojnë në cilësinë e ujit. Ja disa kategori dhe shembuj konkretë:

1. Ndotës kimikë- Pesticidet: Kimi të përdorura në bujqësi që mund të derdhen në lumenj dhe liqene. Azoti dhe fosfori nga plehrat mund të shkaktojnë ndotje nga lëngjet e dherave.

2. Ndotës biologjikë-Bakteret dhe viruset: Mundi të vijnë nga ujërat e zeza ose nga sistemi i menaxhimit të mbetjeve.

3. Ndotës të origjinës bujqësore Erosioni i tokës: Mund të sjellë sediment në ujëra sipërfaqësor.Ujërat e kullimit: Mund të përmbajnë pesticide dhe plehra.

**Masat parandaluese:**

Regullimi i përdorimit të pesticideve dhe plehrave.

Menaxhimi i mbetjeve dhe riciklimi.

Konstruksioni i sistemeve të kanalizimeve të efektshme.

Mbrojtja e burimeve ujore dhe vendosja e zonave mbrojtëse.

Edukimi i publikut për rëndësinë e ruajtjes së cilësisë së ujit.

Këto masa mund të ndihmojnë në reduktimin e ndotjes dhe në mbrojtjen e ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor.

**- Mbeturina mjekësore ;**

Mbeturina mjekësore është një kategori e mbetjeve që dalin nga aktivitetet mjekësore dhe shëndetësore. Ato përfshijnë materiale dhe produkte që mund të jenë të ndotura ose potencialisht të rrezikshme për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin. Ja disa lloje të zakonshme të mbeturinave mjekësore:

1. **Mbeturina infektuese**: Të tilla si materiale që kanë qenë në kontakt me patogjenë ose janë përdorur në trajtimin e pacientëve me sëmundje infektive.
2. **Mbeturina sharpe**: Gjilpëra, thika, dhe sende të tjera që mund të shkaktojnë lëndime.
3. **Mbeturina farmaceutike**: Ilaçe të skaduara ose të papërdorura që nuk mund të hidhen në mënyrë të zakonshme.
4. **Mbeturina kimike**: Substanca kimike që përdoren në laboratore dhe që mund të jenë të rrezikshme për shëndetin dhe mjedisin.
5. **Mbeturina radiologjike**: Materiale që kanë qenë në kontakt me radiologji ose që përmbajnë substanca radioaktive.

Menaxhimi i duhur i mbetjeve mjekësore është shumë i rëndësishëm për të parandaluar rrezikun për shëndetin dhe për të mbrojtur mjedisin. Kjo zakonisht përfshin ruajtjen e veçantë, transportin dhe eliminimin në përputhje me rregullat dhe standardet e caktuara. Derisa mbeturinat medikale rrezikohet të krijojnë ndonjë infekcion patogjen, ato duhet ndarë medoemos, izoluar dhe trajtuar në burim (djegie, etj.). Kështu që, për të kuptuar situatën e trajtimit dhe shkarkimit të mbeturinave medikale që gjenerohen brenda regjionit, Kompania e pastrimit së pari duhet të hulumtoj sasinë dhe përbërësit e mbeturinave medikale që gjenerohen në qytet. Kompania e pastrimit do të ekzaminoj zgjidhje për problem në bashkpunim me MMPH, Departamentin e Shëndetësisë dhe spitalin etj. Për më shumë, Kompania e pastrimit do të përgadis sistemin legal të domosdoshëm për trajtim dhe shkarkim të mbeturinave medikale duke qenë konform me ligjet.

- **Mbeturinat shtëpiake**

Mbeturinat Komunale - janë mbeturina nga amvisëritë, po ashtu edhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.Sipas Planit Zhvillimor Komunal të Prizrenit (PZHK) një kompani publike dhe gjashtë private ofrojnë shërbime për grumbullimin e mbeturinave. Menaxhimi i mbeturinave nuk është i kënaqshëm dhe mungon kapaciteti për mbulimin e fshatrave rrethuese që rezulton në ndotjen e lumenjve. Deponia e vjetër në Korishë është mbyllur që nga viti 2005 dhe deponia e re rajonale është ndërtuar në Landovicë që ofron shërbime për komunën e Suharekës, Gjakovës, Rahovecit dhe komunës së Prizrenit. Deponia është e dizajnuar për 500,000 banorë.

Mbeturinat e gjeneruara nga Prizreni janë grumbulluar dhe transportuar në deponinë e Landovicës nga Kompania Regjionale Ekoregjioni dhe nga tri kompani tjera private.

Në Landovicë gjendet qendra për trajtimin e mbeturinave . Sipas Raportit të MIA (ISH MMPH )-së lidhur me gjendjen e menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë (2018), në deponinë e Landovicës, sistemi i pompimit të ujit nuk funksionin, ndërsa uji nga deponia dhe ujërat sipërfaqësore mund të përzihen, duke shkaktuar rrezik mjedisor. Kompresimi i mbeturinave nuk bëhet sipas standardeve.

- **Mbeturinat industriale, etj.**
- Mbeturinat industriale: Janë mbeturinat të cilat krijohen nga aktivitetet, proceset industriale, prodhimtari artizanale dhe veprimtari tjera prodhuese. Kemi mbeturina nga ndërtimtaritë dhe thërtoret, si dhe quhen mbeturina industriale dhe mbeturinat të gjeneruara nga spitali dhe klinikat, pos mbeturinave komunale. Për shkak se këto mbeturina, të cilat gjenerohen nga jeta e përditshme e qytetarëve tjerë, janë me sasi të madhe ose janë të rezikshme, duhet të trajtohen ndaras nga mbeturinat komunale.
- Ky lloji i mbeturinave shkarkohet ilegalisht ngaqë nuk ka trajtues për to në Kosovë. Qyteti do të punoj mbi synimin e trajtimit të mbeturinave të tilla së bashku më Institucionet relevante.
- Mbeturinat industriale përfshinë kategoritë:
- Xehetari dhe Guroret , Prodhimi , Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull , Furnizimi me ujë, kanalizim, menaxhim të mbeturinave dhe rregullim toke, Ndërtimtaria , Sektorët e shërbimeve etj.

*Harta nr 30 Deponia e mbeturinave në rajonin e Prizrenit aneksi I hartave, faqe 31, Burimi i të dhënave: Baza digjitale e hartave nga Harta zonale e komunës së Prizrenit.*

#### 4.8.6. Masat parandaluese ndaj ndotjes së ujit

Masat që duhet ndërmarrë për parandalimin e ndotjës së ujërave janë të shumta, por do të adresohen disa që janë më kryesore;

- Hartimi i një Plani lokal për parandalimin e ndotjës së burimeve ujore;
- Të identifikohen të gjithë ndotësit potencial të ujërave;
- Për shkelsit e ligjit për mbrotjën e ujërave të marren masat për parandalimin dhe penalizimin e tyre nga Inspektorët përgjegjës ;
- Monitorimi i vazhdueshëm i ujërave të ndotura;
- Trajtimi i ujërave për arritjen e përputhshmërisë me standardet normative vendore;

- Dhënia e lejeve të shfrytëzimit të ujit për hidrocentrale vetëm ne raste kur nuk e dëmton eko-sistemin ujor te lumenjve dhe respektimin e minimumit biologjik;
- Shmangie nga çfardo lloj shkarkimi të pesticideve, vajrave dhe kemikateve të rrezikshme në ujëra;
- Ndalimi i hudhjes së mbeturinave afër çdo burimi të ujërave, etj;

#### 4.8.7. Rekomandimet:

- Implementimi i infrastrukturës ligjore të ujërave;
- Kompletimi dhe modernizimi i sistemit për monitorimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor;
- Nevoja për investime kapitale në infrastukturën për trajtimin e ujërave urbane;
- Rritja e kapaciteteve dhe avansimi i sistemit të ujësjellësve;
- Përmirësimi dhe shtrirja e rrjetit për trajtimin e ujërave urbane dhe industriale;
- Masat për parandalimin e humbjës së ujërave në rrjet;
- Hulumtime në fushën e ujërave, s idomos resurseve ujore nëntokësore;
- Ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore;
- Ngritja e vetdijësimit në komunitetin e biznesit dhe ekonomive familjare për shfrytëzimin racional të ujërave;
- Vlerësimi dhe prioritizimi i nevojave për investime në infrastrukturën e ujërave.

### 4.9. Sistemet e shpërndarjes së gazit dhe naftës

#### 4.9.1. Pompat e derivateve;

Në territorin e Komunës së Prizrenit , në qendren urbane dhe periferike si dhe në vendbanimet në pjesën rurale të komunës, janë të evidentuara afër 57 pika të shitjes së karburanteve të cilat veprimtarinë e tyre e ushtrojnë shumica buzë akseve rrugore urbane dhe rurale. Edhe pse një numër i caktuar i këtyre pikave të shitjes nuk i plotësojnë kushtet teknike dhe hapësinore për një veprimtari të tillë, duke marë për bazë shkallen e lartë të rrezikshmërisë që paraqesin e sidomos disa pika të cilat veprimtarinë e vet e ushtrojnë në vendbanime të dendura dhe afër objekteve shkollore apo objekteve me frekuentim të madh të njerëzve. Fatmirësisht, deri më tani nuk është evidentuar asnjë rast zjarri në këto pika të shitjes së karburanteve,

### 4.9.2. Deponitë e derivateve /kapacitetet

Tab. 48 Kapacitetet e derivateve të naftës dhe gazit në komunën e Prizrenit

| EMRI I KOMPANISË | LOKACIONI | PRONARI | LONG | LAT | Z |
|---|---|---|---|---|---|
| Babani | Krushë e vogël | Xhavit Mallaku | 20.65753833 | 42.3006076 | 323 |
| Paqarizi Petrol | Arbanë | Sahit Paqarizi | 20.72082622 | 42.22549385 | 393 |
| Kabashi 2 | Prizren | Hasan Kabashi | 20.72599326 | 42.22074406 | 409 |
| Fatoni Au | Piranë | Xhavit Ukaj | 20.66335463 | 42.29736462 | 339 |
| Badallaj 1 | Vllashnjë | Mensur Badallaj | 20.66797622 | 42.19806607 | 344 |
| Zhuri | Vllashnjë | Ramadan Susuri | 20.66090124 | 42.19605493 | 346 |
| As Petrol | Jagljenic | Shaban Hoxha | 20.75361617 | 42.22776862 | 450 |
| Anex oil | Prizren | Hysen Hoxha | 20.72228569 | 42.22460468 | 397 |
| Turjak Petrol | Arbanë | Ilmi Kastrati | 20.71312406 | 42.23173632 | 392 |
| Primex | Arbanëa | Mehmet Kastrati | 20.71430317 | 42.23092877 | 390 |
| Brest Promet | Reqan | Bajram Huduti | 20.81306523 | 42.17502271 | 621 |
| Korisha Petrol | Korishë | Muharrem Kabashi | 20.77939424 | 42.26169374 | 427 |
| Hasi Petrol | Piranë | Milaim Hyseni | 20.67835607 | 42.2816648 | 325 |
| Kosova Petrol | Prizren | Bedri Selmani | 20.74675322 | 42.21972006 | 452 |
| Isa Petrol | Bajram Curri | Jakup Gashi | 20.6996509 | 42.20298979 | 410 |
| Aldi Petrol | Piranë | Reshat Ukaj | 20.67754919 | 42.28292342 | 320 |
| Albes Petrol | Korishë | Dugagjin Kabashi | 20.77811076 | 42.26120493 | 441 |
| Pagarusha Petrol | Jagljenic | Nuhi Kryeziu | 20.7606003 | 42.23628533 | 448 |
| Terra Petrol | Zhur | Hismen Gavazaj | 20.62534233 | 42.16498943 | 486 |
| Ahmet Benz | Zhur | Nexhat Badallaj | 20.60233886 | 42.16724463 | 400 |
| Apal 2000 | Hani i Laçit | Sedat Hoti | 20.72969544 | 42.20499184 | 445 |
| Kosova Petrol | Prizren | Bedri Selmani | 20.73595082 | 42.20966263 | 446 |
| Kosova Petrol | Prizren | Bedri Selmani | 20.72820609 | 42.21613813 | 412 |
| Vllezerit Bytyqi | Arbanë | Halil Bytyqi | 20.70448861 | 42.23840615 | 388 |
| Oferta | Arbanë | Rexhep Morina | 20.69963238 | 42.24230165 | 387 |
| Lindi Comm | Arbanë | Izet Hoti | 20.69750415 | 42.24416996 | 386 |
| Pashtriku | Piranë | Florim Ukaj | 20.67719596 | 42.28361423 | 315 |
| Drini Petrol | Piranë | Ramadan Ukaj | 20.67314249 | 42.29074636 | 318 |
| Mazreku Petrol | Mamush | Egjevit Mazreku | 20.71796144 | 42.31830717 | 343 |
| ASA Petrol | Mamush | Azem Mazreku | 20.71791367 | 42.31813597 | 342 |
| Bashak Petrol | Mamush | Bajram Morina | 20.72069686 | 42.32267285 | 340 |
| New York | Gjonaj | Isuf Kruma | 20.64529919 | 42.2591599 | 324 |
| Egzoni Petrol | Ramajë | Shani Duraj | 20.59303314 | 42.29299381 | 335 |
| Romaj | Ramajë | Sadik Smajlaj | 20.59334851 | 42.29299493 | 334 |
| Neza | Ramajë | Hysni çenaj | 20.59253126 | 42.29182119 | 336 |
| Mali Petrol | Korishë | Vetim Kabashi | 20.77955526 | 42.26073039 | 448 |

*Harta nr 31. Sistemi i shpërndarjes së naftës dhe gazit në komunën e Prizrenit, aneksi i hartave, faqe 32, Burimi i të dhënave: Digjitalizim nga Ortofotot e vititi 2018 (gjeoportali kombëtar).*

# KREU I V-TË

# 5. OBJEKTET E RËNDËSISË SË VEÇANTË

Sikur edhe komunat tjera edhe Komuna e Prizrenit nuk bën përjashtim ekspozimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore por duke mos e përjashtuar edhe rrezikun nga faktori njeri , qoftë si rrjedhojë e proceseve tekniko-teknologjike qoftë edhe ato të qëllimshme, andaj edhe objektet e rëndësisë së veqantë kanë rol dhe rëndësi jetike në paqë dhe në rrethana të krijuara nga FNFT.

## 5.1. Objektet e sigurisë

Termi siguri ka nocion të gjërë por edhe duhet pasur parasysh që edhe është një gamë e gjërë e disa segmenteve të ndëlidhura dhe shumë të rëndësishme , me qëllim të krijimit të një mesi të sigurtë.

Një nga shtyllat e sigurisë është Policia e Kosovës. Në komunën e Prizrenit egzistojnë objektet e tilla ku janë të vendosura : Drejtoria Rajonale e PK/ Stacioni Policor.

Për koordinimin e aktiviteteve reaguese emergjente dhe lehtësimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjeta, bëhet nga qendra operative rajonale/ objekti i QOE-112;

Ekipet për Reagim Emergjent në raste të FNFT, Objekti i NjPZSh dhe IMNZ;

Objektet korrektuese (burgu);

Objekti i Agjencisë së Shërbimeve Intelegjente, rajoni i Prizrenit

Me qëllim të funksionimit të shtetit ligjorë dhe të drejtësisë/ Objekti i Gjykatës Rajonale dhe lokale;

*Harta nr 32 Objektet e sigurisë në Komunën e Prizrenit aneksi i hartave, faqe 33. Burimi i të dhënave: Digjitalizim nga Ortofotot e vititi 2018 (gjeoportali kombëtar).*

## 5.2. Objektet dhe hapsirat qeveritare në Komunën e Prizrenit

Sikur edhe komunat tjera edhe Komuna e Prizrenit nuk bën përjashtim ekspozimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore por duke mos e përjashtuar edhe rrezikun nga faktori njeri , qoftë si rrjedhojë e proceseve tekniko-teknologjike qoftë edhe ato të qëllimshme. Objekte të karakterit të tillë në komunën tonë janë:

- Objektet e Administratës civile komunale dhe shërbimet publike; (Objekti i Komunës së Prizrenit, Objektet e Drejtorive Komunale)

- Spitali rajonal/QKMF dhe QMF në Komunën e Prizrenit;
- Objektet e shërbimeve postare dhe telekomit;
- Objektet energjetike;
- Objektet Shkollore;
- Objektet universitare (kolegjet);
- Objektet sportive;
- Objektet kulturore;
- Impiantet e ujërave/KRU,etj.
- Objekti i Njësisë së Zjarrfikëse dhe të Shpëtimit.
- Qendrat Tregtare
- Objekti i prokurisë, Gjykatës, Policisë
- Stacioni i autobusëve, Bankat etj.

-Harta nr 33 Objektet me rëndësi dhe hapësirat qeveritare në Komunën e Prizrenit, aneksi i hartave, faqe 34

### 5.3. Institucionet dhe shërbimet financiare

Në komunën e Prizrenit ka shërbime bankare, postare, gjithashtu janë evidente edhe agjencitë e sigurimeve në qytetin e Prizrenit. Operojnë shum filiala të bankave si: Raiffeisen bank Bank, Teb Bank, BKT, ProCredit bank, NLB etj. Në qytetin e Prizrenit operojnë edhe zyret postare si PTK (posta dhe telekomi i Kosovës) IPKO etj. Në komunën e Prizrenit janë në funksion kompanitë e sigurimit që operojne për sigurimin e objektëve qeveritare, objektëve komunale , sigurimin fizik të objekteve shëndetësore, Spitaleve, bizneseve etj.

*-Harta nr 34 Objektet financiare në Komunën e Prizrenit , aneksi i hartave, faqe 35 Burimi i te dhënave , Digjitalizim nga Ortofotot (gjeoportali kombëtar)*

### 5.4. Objektet shkollore në komunën e Prizrenit

Komuna e Prizrenit posedon këto institucione arsimore:

- Drejtoria Komunale e Arsimit menaxhon me 5 objekte parashkollore (çerdhe); dy ne zonat urbane dhe 3 ne zonat rurale.
- Drejtoria Komunale e Arsimit menaxhon me 50 objekte /Shkolla fillore e ultë ( SHFU );
- Drejtoria Komunale e Arsimit menaxhon me objekte / shkolla të mesme të ulëta;
- Drejtoria Komunale e Arsimit menaxhon me 5 objekte / shkolla të mesme të larta.

- Objekti universitar publik në qytetin e Prizrenit “Ukshin Hoti” dhe kolegjet private si UBT dhe Kolegji i Biznesit, etj. Vlerësohet se objektet dhe siguria në hapësirat e shkollave në komunën e Prizrenit është e mire.

*Harta nr 35 Objektet edukative-arsimore në Komunen e Prizrenit aneksi i hartave , faqe 36 Burimi i te dhënave , Digjitalizim nga Ortofotot (gjeoportali kombëtar).*

# KREU VI-TË

## 6. LLOJET E FATKEQËSIVE

Fatkeqësitë, varësisht nga shkaktari i tyre ndahen në: fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësitë tjera(FNFT);

**Fatkeqësitë natyrore** janë fenomene natyrore të cilat, varësisht nga efekti goditës mund të shkaktojnë humbje me pasoja në popullatë, në të mira materiale, mjedis dhe trashëgimi kulturore.

Ndryshimet klimatike në përgjithësi, veçanërisht frekuenca e ngjarjeve ekstreme të motit dhe luhatjet e temperaturave që parashikohen të ndodhin si rrjedhojë e ndryshimeve klimatike, po ndikojnë edhe tek ne, duke krijuar klimë me cenueshmëri më të lartë, duke përfshirë, ndër të tjera: zjarre në pyje, thatësira, reshje të dendura të shiut me shtrëngata, breshëri, bora, acari , orteqet, erërat e fuqishme, vërshimet, zjarret (urbane, malore, fushore), epidemitë/pandemitë, stuhitë e erës, rrëshqitjet e tokës, valët e të nxehtit, tërmetet dhe fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga forcat natyrore, etj;

Institucionet tona në nivel local si dhe akterë tjerë jo-qeveritar, duhet të kemi një përkushtim më të madh në zhvillimin e masave parandaluese me qëllim të vlerësimit të rreziqeve natyrore si dhe zvogëlimit të tyre për të arritur një qasje më proactive për mbrojtje nga fatkeqësitë.

**Fatkeqësi tjera** nënkuptohen ato fatkeqësi tekniko-teknologjike të shkaktuara nga faktori njeri apo përmes proceseve teknologjike /incidentet në objektet afariste, tregtare, zjarret urbane dhe malore, fatkeqësitë në miniera, shkatërrimet e pendave, aksidente në trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, aksidentet nukleare si dhe aksidentet tjera ekologjike dhe industriale të shkaktuara nga aktivitetet dhe veprimet e njeriut, veprimet luftarake dhe terroriste;

### 6.1. Intensiteti, llojet dhe ndikimet e veprimit të fatkeqësive natyrore

Secila nga fatkeqësitë apo fenomenet natyrore dhe ato të shkaktuara nga faktori njeri kanë natyralitetin e ndryshëm të ngjarjes, të shkasit dhe pasojes, ashtu që edhe identifikimi, analizimi, trajtimi dhe vlerësimi i tyre bëhet sipas specifikave dhe efekteve goditëse të tyre.

- Pika fillestare për vlerësimin e ndikimit janë pasojat, shumëllojshmëria e gjerë e pasojave të ndryshme përmblidhet në një parametër, të quajtur 'ndikim'. Ndikimi është një mbledhës apo grumbullues I informacioneve mbi pasojat, prandaj për vlerësimin e rrezikut, mund të përdorim disa kritere të ndikimit: jeta dhe shëndeti i njeriut, mjedisi, funksionaliteti i shoqërisë, ekonomia, etj.

Ngjarjet me të shpeshta që kanë ndodhur janë: Zjarret, Vershimet, Bresheri, erozioni etj.

## 6.2. Prioritizimi i fatkeqësive natyrore bazuar në matricën e rreziqeve

Vlerësimi i autoriteteve lokale për rreziqet e fatkeqësive natyrore bazohet në analizën e plotë të rreziqeve dhe pasojave të mundshme në popullatë, në të mira materiale, kulturore dhe mjedis, brenda zonës së tyre si dhe atyre që mund të vijnë nga zonat fqinje. Vlerësimet përfundimtare bëhen për secilën masë të mbrojtjes dhe shpëtimit në raport me mundësitë reale për mbrojtje dhe shpëtim si dhe vlerësimin e resurseve njerëzore dhe materiale të nevojshme për tu përballë me pasojat e fatkeqësive natyrore., duke e marrë për bazë edhe Profilin e rrezikut( fletë-pune e profilit të rrezikut);
Matrica e rrezikut pasqyron gërshetimin apo korrelacionin e probabilitetit (gjasave ) dhe pasojave, të nivelit të rrezikut e cila përbëhet nga dy boshte:

- **boshti horizontal** në të cilin paraqiten vlerat e gjasave (*e sigurtë/ gati e mundur/ e besueshme/ e pa besueshme/ e pamundur),* ndërsa
- **boshti vertikal** në të cilin paraqiten vlerat e pasojave *(e papërfillshme/ e vogel/ e mesme/ kritike/ katastrofike);*

Secili bosht ka nga pesë vlera (fusha), ku gërshetimi i tyre jep një matricë prej 25 fushash ndërsa për ta realizuar shkallëzimin e rrezikut thjeshtë shumëzohet/gërshetohet gjasa me ashpërsinë ku do të prodhojnë rezultatet/numrat nga 1 deri në 25 dhe bëhet kategorizimi si në tabelën në vijim për t'i nxjerr rreziqet e mbetura, ose rreziqet që mbesin pas vendosjes së masave të kontrollit;

- **Prioritizimi i listës së fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera** është produkt matricës së probabilitetit/gjasave. Matrica e probabiliteti/gjasave janë të bazuara në **treguesit e probabilitetit/gjasave**:

- Probabbiliteti dhe frekuenca e ndodhjes;
- Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut;
- Pasojat ekonomike nga FNFT;
- Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social-infrastruktura kritike;
- Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social-dëmi material i përgjithshëm në objekte me rëndësi të veqantë;
- Matrica përmbledhëse e cila pasqyron stabilitetin shoqëror (3a dhe 3b/pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social-dëmet nga infrastruktura kritike dhe pasojave ekonomike);

**- Matrica e cila pasqyron rrezikun e përgjithshëm;**

## 6.3. Matrica e gjasave

Gjasat

| Ashpersia | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
|---|---|---|---|---|---|
| 5 | 5 | 10 | 15 | 20 | 25 |
| 4 | 4 | 8 | 12 | 16 | 20 |
| 3 | 3 | 6 | 9 | 12 | 15 |
| 2 | 2 | 4 | 6 | 8 | 10 |
| 1 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

Shkalla e ashpërsisë

| | |
|---|---|
| 5 | Veprim katastrofik – (rrezik nr. 15 – 25) |
| 4 | Prioritet i ashpër – (rrezik nr. 10 – 12) |
| 3 | Prioritet mesatar – (rrezik nr. 5 – 9) |
| 2 | Prioritet i mbrojtur – (rrezik nr. 2 – 4) |
| 1 | Prioritet i ulët – (rrezik nr. 1)<br>nuk kërkohet veprim |

Matrica e probabilitetit:




Sipas listës se prioriteteve te fatkeqësive natyrore në komunën e Prizrenit renditen:

1. Zjarret janë dukuri me të shpeshta gjatë stinës se verës kur ka thatësi të madhe
2. Vërshimet (pasi qe janë dukuri me të shpeshta gjatë sezonit kur ka të reshura)
3. Bresheri është dukuri e shpeshte gjatë stinës së verës dhe shkakton dëme në bujqësi
4. Ngricat në rrugët ku ka qarkullim të automjeteve në zonat kodrinore-malore
5. Erat e forta janë dukuri me të rralla që mund të shkaktojnë rreziqe

## 6.4. Rreziqet nga fatkeqësitë natyrore

Fatkeqësi natyrore konsiderohen fatkeqësitë që shkaktohen nga dukuri apo fenomene natyrore deri në nivele ekstreme, duke filluar nga ato me shpeshtësi më të madhe dhe me probabilitet të lartë të ndodhjes deri tek ato më ekstreme me pasoja të rënda dhe me probabilitet të ultë. Fatkeqësitë natyrore përbëjnë një listë të gjatë të fenomeneve natyrore , si : vërshimet, tërmetet, zjarret, rrëshqitjet e dheut dhe erozionet, ortekët, erërat e fuqishme, breshëri, borë me shi, acari, thatësira, epidemitë dhe pandemitë, fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga natyra e dukuri tjera që ndikojnë në humbje të jetërave të njerëzve, të mirave materiale, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.

### 6.4.1. Vërshimet

Territori i Komunës së Prizrenit bazuar në bazën e të dhënave egzistuese si dhe në të dhëna historike, ka një cenueshmëri dhe rrezik serioz nga vërshimet, tek delta e pellgjeve lumore apo hapësirat e rrafshëta, ku shkaktohen nga fryrja e lumenjëve (përrockave) dhe ngritja e nivelit të ujërave , gjatë të reshurave të rrëkeshme apo shkrirjes së shpejtë të dëborës;




Graf.nr 22. Te dhenat hidrologjike 2021 **Nivelet** –Lokacioni Lumi Drini I Bardhë , Gjonaj

Niveli i ujit (cm): 2021, Lartësia mbidetare e st.: 306 m lmd, Distanca nga grykëderdhja: 14.6 km, Zona ujëmbledhëse: 3951 km2. Burimi i të dhënave: Vjetari Hidrometeorologjik i Kosovës 2021.




*Graf.nr 23. Lumbardhi i Prizrenit Të dhënat hidrologjike 2021 Nivelet*

Niveli i ujit (cm): 2021, Pellgu i lumit: Drini i Bardhë, Emri i lumit: Bistrica e Prizrenit, Lartësia mbidetare e st.: 525 m lmd, Distanca nga grykëderdhja: 16.3 km, Zona ujëmbledhëse: 158 km2.

### 6.4.2. Identifikimi i rreziqeve nga vërshimet;

Identifikimi i rreziqeve nga vërshimet është proces i cili duhet të fillojë që nga përcaktimi apo qartësimi i përmbajtjes së ekipit apo strukturës profesionale me qëllim të identifikimit të rreziqeve. Vetë procesi i identifikimit të rrezikut nga vërshimet është një aktivitet profesional dhe i spektrit të gjërë( shumë-disiplinarë) e cila ngërthen në vete një mori aspektesh dhe të fushave që mund të prekin dhe cenojnë: jetën e njeriut, sistemet e ndryshme, infrastrukturën, ekonominë, mjedisin, trashëgiminë kulturore, etj.

Vërshimet dhe përmbytjet determinohen nga një mori faktorësh ndër të cilët dallojmë:

- Mosrregullimi i infrastrukturës së shtretërve të lumenjve ;
- Degradimi i shtretërve të lumenjve - gërmimet dhe eksploatimet e pakontrolluara i resurseve natyrore – rërës dhe masës drunore në shtratin dhe përgjatë shtratit të lumenjve, duke inicuar vërshime, erozion të brigjeve të lumenjve dhe ndërrimin e drejtimit të lumenjve.
- Punimet e paautorizuara në dhe rreth shtretërve të lumenjëve me ç'rast paraqitet dukuria e dëmtimit të tubacioneve të ujit që për pasojë ka ngritjen e nivelit të lumenjve dhe përmbytjen e vendbanimeve të caktuara;
- Ndërtimet e egra të shtëpive të banimit dhe objekteve tjera në dhe rreth shtratit të lumenjve,
- Ndikimi i faktorit njëri në kuptimin e papërgjegjësisë qytetare në hedhjen e mbeturinave inerte në shtretërit e lumenjve, sidomos në pikat kritike si : urat, kanalet, tubacionet etj.
- Mosfunksionimi normal dhe mirëmbajtja jo e rregullt e infrastrukturës së rrjetit të ujërave atmosferikë dhe fekale, etj.

Harta nr 36 Zonat e rrezikuara nga vërshimet në komunën e Prizrenit aneksi i hartave , faqe 37,

Burimi i të dhënave : Analizë nga ekspertet, duke u bazuar edhe në harta topografike (gjeoportali kombëtar).

### 6.4.3. Karakteristikat hidrografike dhe ndikimet e saj në vërshimeve

Kushtet natyrore të Komunës së Prizrenit janë të tilla, ku pjesët e rrafshta të territorit janë të përshtatshme dhe me potencial për toka bujqësore dhe shtrirjen e vendbanimeve, vendosjen e industrisë, zhvillimin e infrastrukturës, ndërsa pjesët me lartësi më të madhe mbidetare qe shtrihen më në periferi, kushtëzon rrjedhjen e shpejt të ujërave dhe me kapacitete shpesh maksimale të ujë-rrjedhave dhe pellgjeve lumore. Vërshimet janë fatkeqësi natyrore që mund të dëmtojnë zona të mëdha të deltave lumore të lumenjve dhe të shkaktojnë vërshime rrëke në përrenj më të vegjël. Për më tepër, për shkak të ndryshimit të klimës, ndikimet e ashpra të vërshimeve mund të priten edhe në komunën tonë në të ardhmen.





Vërshimi i ujërave të Lumbardhit të Prizrenit ka ndodhur me date 17 dhe 18 nëntor të vitit 1979. Ky vërshim shkaktoi dëme të mëdha në Prizren, duke shkatërruar edhe disa prej aseteve të vlefshme të trashëgimisë kulturore. Shiu që ra për tre ditë rresht, shtoi nivelin e Lumbardhit për 3 metra, duke shkatërruar 62 shtëpi në qytet .Me datë 21 maj 2020, Breshëri dhe reshjet e shumta që kanë ndodhur, kanë shkaktuar vërshime dhe dëme të mëdha në rajonin e Anadrinisë dhe fshatrat përreth.

Nga këto fatkeqësi natyrore fatmirësisht nuk ka pasur pasoja tek njerëzit, mirëpo dëmet kanë qene serioze nëpër shtëpi dhe sidomos në kulturat e ndryshme bujqësore që janë shkatërruar tërësisht, duke ditur që rajoni i Anadrinisë është i njohur për zhvillimin e bujqësisë.

Me datë 8 Janar 2021 ka pasur vërshime në pjesë të ndryshme të territorit të komunës së Prizrenit. Sipas raportit të Drejtorisë për Emergjenca dhe Siguri, zonat më të prekura kanë qenë në Piranë, Zojz, Krajk, Bregdri dhe Romajë, ku uji ka vërshuar disa podrume të shtëpive dhe fermave të bagëtive. Në Lubizhdë të Prizrenit, uji ka dalë mbi shtratin e vet dhe ka rrezikuar disa fabrika që gjenden përreth magjistrales Prizren - Suharekë, ku në këtë pjesë drejtoria ka intervenuar me kompanitë e kontraktuara dhe ka parandaluar vërshimet dhe dëmet e mundshme në shumë biznese.

Fig 13 Vërshimi i ujërave të Lumbardhit të 17 dhe 18 nëntorit të vitit 1979 shkaktoi dëme të mëdha në Prizren (burimi https://www.epokaere.com/43-vjet-nga-vershimet-e-lumbardhit-ne-prizren/)

#### 6.4.5. **Vendet (vendbanimet) më të atakuara nga vërshimet /pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara me numrin dhe strukturën e banorëve**;

*Tabela nr 49 Të dhënat për vërshimet në në Komunën e Prizrenit*

| **Komuna e Prizrenit**<br>**Data /viti: 1979-2024** | **Pellgu lumor "             "** | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Lumi "Drini i Bardhë."** | ***Përroi i "Lumbardhi I Prizrenit"*** | **Lumi "Toplluha"** | ***Përroi i "Lubinë."*** |
| Lokacioni i vërshimeve | Fshati Krajk 2021 | Një pjesë e qytetit të Prizrenit – viti 1979 | *Fshati Piranë 2020* | *Fshati Lubinjë -2024* |
| *Profili/ numri i banorëve të përfshirë* (popullata)/ evakuimi | | Po | | |
| Sipërfaqja e vërshuar | | | | |
| Dëmet e shkaktuara në ekonomi familjare | Po | Po | Po | Po |
| Dëmet e shkaktuara në biznese | | Po | | |
| Dëmet e shkaktuara në bujqësi | Po | | Po | |
| Infrastruktura kritike egzistuese | Po | Po | Jo | Po |
| Gatishmëria për reagim emergjent/ERE | Po | | Po | Po |
| Ndikimi në natyrë dhe mjedis | Po | Po | Po | Po |
| Dëmet e shkaktuara në objektet e trashëgimisë kulturore | | Po | Jo | |
| *Strehimorete përdorura /kapacitet* | jo | | Jo | Jo |

Harta nr. 37 Vendbanimet e atakuara nga vërshimet në komunen e Prizrenit, aneksi i hartave, faqe 38, Burimi i të dhënave: Raportet komunale por edhe kontaktet me udhëheqës të vendbanimeve

### 6.4.6. Kushtet hidro-meteorologjike

Territori i komunës së Prizrenit në kuptimin klimatik i nënshtrohet ndikimeve atmosferike kontinentale dhe mediterane të pa qëndrueshme në përgjithësi në nivel vendi. Veçoritë klimatike ndryshojnë varësisht nga elementet klimatike si: diellosja (insolacioni), temperatura, reshjet, shtypja atmosferike, erërat, etj. Edhe komuna e jonë sikur në gjithë vendin, me disa dallime të vogla klimatike shënojmë vlerat ekstreme pozitive të temperaturave në komunë. Periudha me temperatura nën zero zakonisht zgjat prej majit tetor deri në fillim të prillit. Temperaturat e larta (tropike) më shpesh paraqiten në korrik e gusht, por ato ndodhin edhe në qershor, me temperatura maksimale ditore, gjendje klimatike krijon parakushte të përhapjes së zjarreve malore dhe fushore. Zjarre pyjore me përmasa me te mëdha ka pasur gjatë verës së vitit 2024, të cilat kanë përfshirë lokacionet e mbuluara me pyje afer Prevallës.

Për shkak të ndryshimeve klimatike, ngjarjeve ekstreme të motit të tilla si reshjet e mëdha të shiut dhe vërshimet, mund të rriten në frekuencë dhe intensitet duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në ekonomi familjare, infrastrukturë biznes dhe mjedis.

Sasia vjetore e reshjeve: në komunën e Prizrenit sillen rreth 620.9 mm, ndërsa, Maksimumi absolut është 102 mm në muajin Tetor që paraqet 16.4 % të sasisë mesatare. Muaji me minimum absolut është Qershori me vetëm 6.8 mm.

Tabela nr 50 Sasia e reshjeve në milimetra në komunën e Prizrenit, viti 2018

| **Muajt** | **I** | **II** | **III** | **IV** | **V** | **VI** | **VII** | **VIII** | **IX** | **X** | **XI** | **XII** | **Vjetore** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Prizren** | 15.3 | 42.6 | 30.3 | 62.8 | 91.5 | 6.8 | 14.1 | 52 | 38 | 102 | 79 | 86 | **620.9 mm** |

Grafiku nr 24. Ecuria mujore e reshjeve në Prizren (2018)




Gjatë muajit tetor Prizreni merr sasinë më të madhe të reshjeve me 102 mm, kurse sasinë më të vogël e ka në qershor 6.8 mm (viti 2018). Reshjet e borës pas atyre të shiut paraqesin formën kryesore për nga

sasia e ujit, rëndësia agroklimatike, turistike etj. Në pjesët e larta të maleve të Sharrit numri i ditëve me reshje të borës vlerësohet rreth 150 ditë, kurse në qendrën e skijimit në Brezovicë rreth 83 ditë janë me reshje të borës. Trashësia maksimale e borës në Malet e Sharrit arrin deri 180 cm.[2] Reshje më shumë paraqiten në pjesën jugore dhe jugperëndimore të Komunës së Prizrenit, të cilat kanë vlerën deri në 1500 mm, përkatësisht në malin e Sharrit dhe Koritnik, kurse në pjesën e ulët fushore të gropës së Prizrenit paraqitet minimumi i reshjeve me 700 mm.

**Lagështia:** Muaji më i lagësht është muaji Tetor (102 mm) ndërsa muaji më i thatë Qershori me 6.8 mm, kurse në aspektin stinor, vjeshta është më e lagështa (305 mm) ndërsa vera është më e thata me (72.9 mm).
**Era**: në komunën e Prizrenit është e theksuar në drejtimin të perëndimit me 2.2 m/s si dhe nga drejtimi i jug-perëndimit, të cilat kohë pas kohe arrijnë shpejtësinë 1.9 m/s.

*Tabela 51. Rastisja e erës, qetësive dhe shpejtësia mesatare për periudhën 1961-1985*[3]

| | | Drejtimi i erës | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | N | NE | E | SE | S | SW | W | NW | C |
| Prizren | Rastisja | 132.2 | 164.8 | 69.2 | 106.2 | 86 | 149.5 | 99.2 | 85 | 202 |
| | Shpejtësia | 1.8 | 2 | 1.6 | 1.7 | 1.6 | 1.9 | 2.2 | 1.5 | |

Shpejtësia më e madhe e erës shfaqet nga perëndimi V=2.2 m/s dhe jugperëndimi 1.9 m/s.




*Fig 14 Drendafili i erës për komunën e Prizrenit*

---

[2] *R.Pllana, Klima e Kosovës, ASHAK, Prishtinë, 2015, f.238*

[3]*R.Pllana, Klima e Kosovës, ASHAK, Prishtinë, 2015, fq 95*

**Thatësia** si dukuri që ndër vite çfaqet simungesë e theksuar e të reshurave atmosferike në komunën tonë, sipas të dhënave historike në rastin më ekstrem ka zgjatur deri në disa ditë pa reshje atmosferike, muajtë:Korrik, Gusht.

*Harta nr 38 Zonat e ekspozuara rrezikut potencial të vërshimeve në Komunën e Prizrenit, aneksi i hartave, faqe 39*

### 6.4.7. Treguesit hidrologjik

Ndryshimi i tipareve gjeomorfologjike, siç janë fushat e gjera të rrethuara me male dhe shtretërit e lumenjve të parregulluar dhe jo të mirëmbajtur, hedhja e mbeturinave në lumenj dhe nxjerrja e pakontrolluar e zhavorrit dhe rërës nga shtretërit e lumenjve, ndikon në shtrirjen dhe dinamikën e vërshimeve në komunën e Prizrenit, Vërshimet prekin kryesisht zonat bujqësore pothuajse çdo vit duke shkaktuar dëme të konsiderueshme ekonomike dhe ekologjike. Shumica e kanaleve të lumenjve nuk mund të pranojnë sasi shtesë të ujit të krijuar ngjarje ekstreme të motit, shpesh duke çuar në vërshime të një game të gjerë. Për shkak të ndryshimit të klimës, ngjarjeve ekstreme të motit, të tilla si reshjet e mëdha të shiut dhe vërshimet janë rritur në frekuencë dhe intensitet duke shkaktuar një rritje të konsiderueshme të dëmtimit të ekonomisë, zonave urbane, infrastrukturës, mjedisit dhe natyrës.




Graf.nr 25 Drini i Bardhë Të dhënat hidrologjike 2021 PRURJET

Rjedha e lumit (m3 /s): 2021, Pellgu i lumit: Drini i Bardhë, Emri i lumit: Drini i Bardhë, Lartësia mbidetare e st.: 306 m lmd, Distanca nga grykëderdhja: 14.6 km, Zona ujëmbledhëse: 3951 km²




Graf.nr 26 Lumbardhi/Bistrica e Prizrenit, Të dhënat hidrologjike 2021 PRURJET

Rjedha e lumit (m3 /s): 2021, Pellgu i lumit: Drini i Bardhë, Emri i lumit: Bistrica e Prizrenit, Lartësia mbidetare e st.: 525 m lmd, Distanca nga grykëderdhja: 16.3 km, Zona ujëmbledhëse: 158 km²

Harta nr 38 Zonat e vërshuara- përmbytura në komunën e Prizrenit, aneksi i hartave, faqe 39, Burimi i të dhënave : Analizë nga ekspertet, duke u bazuar edhe në harta topografike (gjeoportali kombëtar).

## Masat Parandaluese

Masat e propozuara nga Grupi Punues për hartimin e dokumentit të vlerësimit të rrezikshmërisë nga vërshimet:

- Rritja e kontrollit mbi ndërtimet e egra të objekteve të banimit në shtretërit dhe brigjet e lumit;
- Rregullimi i shtretërve të lumenjve sipas standardeve të kërkuara;
- Mirëmbajtja e rrjetit të ujërave atmosferike dhe fekale, kanaleve të hapura të ujitjes etj. që kalojnë edhe nëpër qytet, shtretërve të lumenjve, urave, etj;
- Ndalimi i mbeturinave dhe inerteve të ndryshme në lumenj, kanale dhe bllokimi i hapjeve të urave;
- Ndalimi dhe kontrolli i gërmimeve dhe eksploatimeve të pa kontrolluara të resurseve natyrore , meqërast ndërron edhe kahja e rrjedhës së ujit e më pastaj dalja nga shtrati;
- Mirëmbajtja e lumenjve nga organet kompetente;
- Zgjërimi i shtretërve të lumenjve nga pronarët që i posedojnë ngastrat pranë;
- Hapja e kanaleve anësore( të kullimit) dhe të rrugëve nga ndërtimet e paligjshme të pronarëve privat, etj.

### Rekomandime:

- Marrja e masave për rregullimin, mirëmbajtjen dhe pastrimin e shtretërve të lumenjëve;
- Ndalimi i shfrytëzimit të pakontrolluar i lëndëve inerte nga shtretërit e lumenjve në Kosovë;
- Marrja e masave nga organet e nivelit lokal në menaxhimin adekuat të mbeturinave në shtretërit e lumenjëve;
- Marrja e masave në mirëmbajtjen e rrjetit të ujërave atmosferike dhe fekale;

- Të ngritet niveli i bashkëpunimit ndërinstitucional veçënarisht në nivelin Komunal, kompanitë e furnizimit dhe shkarkimit të ujërave, lidhur me parandalimin, mbrojtjen nga vërshimet; dhe
- Masa tjera që ndikojnë pozitivisht për tu mbrojtur nga ndikimet e veprimeve të dëmshme të ujërave.etj.

Skenari ( vërshimet);

***VËRSHIMET Skenari 1***

| **Emri i skenarit:** | ***Skenari 1* – Vërshimi** |
|---|---|
| Frekuenca e ndodhjes: Piranë, Krajk | |
| ☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );<br>☐E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);<br>x Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);<br>☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); | |
| Madhësia e mundshme: | |
| ☐ E papërfillshme (më pak se 10%) x☐ E kufizuar( 10 deri 25%)<br>☐ Kritike: 25 deri 50% . ☐ Katastrofike: Më shumë se 50% | |
| Lloji i skenarit: | |
| x ☐ Skenari 1; ☐ Skenari 2; ☐ Skenari 3; | |
| Ndikimi: | |
| ☐ I papërfillshëm; **x ☐ I vogël ;** ☐ I mesëm ; ☐ Katastrofike; | |
| Data e vlerësimit: | |
| 17.09.2023 | |

***Konteksti***

| **Parametrat:** | **Përmbajtja:** |
|---|---|
| Vendi i ngjarjes (lokacioni) | Vendet më të rrezikuara nga vërshimet janë: Fshati Piranë ,Krajk, Zojz dhe Qyteti i Prizrenit |
| Kushtet meteorologjike | Shi i dendur me intensitet të lartë, i pandërprerë gjatë 24 orëve të fundit. |
| Periudha e | 17.09. 2023 |

| | |
|---|---|
| vitit: | |
| Lloji i ditës: | Ditë vikendi |
| Analiza meteorologjike për kohën | -Mundësia për të ndodhur vërshimet në këtë vit kalendarik është e madhe në Komunën e Prizrenit. Data e paraqitjes së kësaj fatkeqësie është 17.09.2023. Vërshimet në lokacioni prej urës së Piranës të lumi Toplluha si pasojë e ngritjes së nivelit të ujit në shtratin e lumit Toplluha, të shkaktuara nga reshjet intensive, përveç intensitetit të të reshurave, vërshimet në këtë pjesë të fshatit janë pasojë e hedhjes së mbeturinave. |
| Popullata | Numri i familjeve të prekura nga vërshimi, në zonën e vërshuar në pjesën e fshatit Piranë, janë 21 familje kurse numri i banorëve ishte 105, prej tyre:<br>➢ Fëmijë: 20,<br>➢ Të moshuar: 25,<br>➢ Gra:30,<br>➢ Meshkuj:30. |
| Infrastruktura kritike ekzistuese | Bazuar në kriteret e paracaktuara sipas urdhëresës administrative për rregullimin e infrastrukturës në zonën e përfshirë nga vërshimi, ka pasur infrastukturë e cila ka pasur pasoja në këtë zonë.<br>➢ Rrugët rajonale Prizren - Gjakovë<br>➢ Urat standarde,<br>➢ Sistemi i ujësjellsësit dhe kanalizimit |
| Gatishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut) | Në nivelin lokal- Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, Njësia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, Policia e Kosovës, Shërbimet Emergjente Mjekësore, Kryqi i Kuq dhe komapani të kontraktuara nga Komuna e Prizrenit për intervenime emergjente gjatë fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. |
| Info plotësuese | |

**INCIDENTI-NGJARJA**

| | |
|---|---|
| Shkaku dhe shkaktari | Nga të reshuarat intensive të shiut gjatë orëve të pasditës të datës 17.09.2023, nga qytetarët e Prizrenit, kemi marrë informacion se në këtë lokalitet janë shkaktuar vërshime. Sipas Institutit meteorologjik të Kosovës, të reshurat do të vazhdonjë edhe në ditët në vijim.<br>-Shkaqet e shkaktimit të vërshimeve kanë qenë si në vijim: shtrati i lumit relativisht i ngushtë, ndërtimet bri lumit, hedhja e mbeturinave dhe materialeve inerte, të cilat drejtpërdrejt ndikojnë në ngushtimin e shtratit të lumit.<br>Zona e vërshimit përfshin rendin e parë të oborreve dhe të bodrumeve e shtëpive individuale të banimit përgjatë shtratit të këtij lumi në gjatësi në të dy krahët e rrjedhës së lumit afër 1200 m, të rrezikuara janë 65 shtëpi. |

| | |
|---|---|
| Ngjarja kryesore | Thelbi i skenarit, i nxitur nga një sërë shkaqesh deri te pasojat.<br><br>- Më 17.09.2023, uji i dalë nga shtrati, ka bërë një vërshim përgjatë lumit Toplluha, në një gjatësi rreth 1200 m, duke përfshirë dhe rrezikuar: objekte banimi dhe infrastrukturë rrugore.<br><br>Vërshimet kanë përfshirë 65 shtëpi banimi me dëme: 150.948.00 të amvisërisë.<br><br>- Ndërtimet në këtë zonë janë standarde me material të fortë dhe rreziku nga shembja është relativisht i vogël ndërsa rreziku për jetë mund të paraqitet e improvizuara. Vërshimet në këtë pjesë të fshatit janë momentale, dhe me ndërprejen e të reshuarave pas 2- 4 orësh zvogëlohet shkalla e rrezikut.<br><br>-Ekipet Reaguese Emergjente (ShRE) kanë bërë reagimin emergjent dhe sanimin e gjendjes gjatë dhe pas vërshimeve, pastaj janë angazhuar edhe mekanizma institucionale dhe publike, siç janë: Drejtoria komunale për Emergjenca, Drejtoria për Shërbime Publike Komunale, Opertorët Ekonomik të kontraktur nga Komuna e Prizrenit për Intervenime Emergjente. |
| Pasojat primare dhe efektet anësore | -Humbje e pasurisë në objekte banimi ( pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara nga vërshimi);<br><br>-Dëmtim i Infrstrukturës rrugore, rrugë të dëmtuara në lokalitete të prekura nga vërshimet;<br><br>- Dëmtim i Infrstrukturës kritike ( sistemi i ujësjellësit, sistemi energjetik);<br><br>- Shtëpi të përmbytura ( dëmtim i orendive shtëpike: 65 shtëpi);<br><br>-Vlera e përgjithshme e përllogaritur e dëmit : 150.948.00 €. |
| Pasojat sekondare të shkaktuara nga domino-efekti | ➢ Vështirësi për qarkullim në trafik (urat në aksin rrugor Prizren - Gjakovë);<br>➢ Paraqitja e rrëshqitjes së dheut në aksin rrugor Prizren - Gjakovë e cila mund të pengon lëvizjen e qytetarëve;<br>➢ Mungesë e ujit të pijes si pasojë e dëmtimit të rrjetit apo e ujit të turbullt në impiante (afër 2417 banorë);<br>➢ Pasojat e përmbytjeve në ambient dhe tokë pjellore (afër 300 hektar). |

Situata Meteorologjike gjatë ditëve në vijim






Persistenca e probabilitetit të përmbytjeve

**Analiza standarde e indeksit të reshjeve per vitin 2015,2016, dhe 2017 (burimi : IHK)**



**Analiza Standarde e Indeksit të Reshjeve per vitin 2018, 2019 dhe 2020 ( Burimi: IHK)**



**NDIKIMI- INDIKATORËT TREGUES**

| | |
|---|---|
| Rastet me fatalitet | -Nuk ka pasur raste me fatalitet. |
| Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar | -Nuk është evidentuar asnjë rast. |
| Mungesë<br><br>e nevojave elementare | - Si pasojë e vërshimeve kemi dëmtime të rrugëve dhe të urave;<br><br>- Punëtorët nuk mund të shkojnë në punë, fëmijët në shkolla e kopshte;<br><br>- Furnizimet e nëvojave themelore: ushqim, veshmbathje, shtrojë e mbulojë, mjete higjienike, energji të pa mjaftueshme;<br><br>- Mungesa e ujit të pijshëm, etj. |
| Të evakuuarit | - Nuk kemi pasur raste për evakuim. |
| Ndikimi i përgjithshëm ekonomik | - Dëmet në njerëz (shëndetësore: fizike, traumatike, psikologjike, etj),<br><br>të pa evidentuara;<br><br>- Dëmet e shkaktuara në: Ekonomi familjare ( rreth 65 familje), të<br><br>përllogaritura: 150.948.00 €;<br><br>- Vlera e përafërt e dëmeve të përllogaritura është: 150.948.00 €. |
| Ndikimi në natyrë dhe<br><br>mjedis | -Rritja e nivelit të ujit në lumenj dhe ujëra nëntokësore mund të sjellë<br><br>ndotje dhe humbje të kualitetit të ujit (duke i shtuar edhe sasinë e konsiderueshme të shkarkimit të ujërave të zeza);<br><br>- Humbja/dëmtimi i tokës bujqësore nga erozioni;etj. |
| Ndërprerjet në jetën e përgjithshme | - Ndërprerje e furnizimit me ujë të pijshëm;<br><br>- Funksionimi i infrastrukturës rrugore( ndërprerje të akseve të<br><br>caktuara rrugore apo kalim me vështirësi). |
| Humbje në trashëgimi kulturore | Jo. |
| Implikime politike | Jo. |
| Ndikimi i përgjithshëm | Rrezik i vogël. |

**PROBABILITETI-GJASAT**

| | |
|---|---|
| Probabiliteti | - Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësor dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të mesëm të mundshëm, duke marrë për bazë të dhënat historike. |

| | |
|---|---|
| Paralajmërimi i hershëm | -Fatkeqësia ishte pjesërisht e pritshme (bazuar në parashikimet meteorologjike), por pastaj gjërat u përkeqësuan dhe rëndoi në masë të madhe ngjarjen kryesore;<br>-Informimi publik për të reshurat ishte me kohë, sipas njoftimit të parashikimeve meteorologjike, me paralajmërime për mundësi të vërshimeve dhe probabilitetit për cenueshmeri;<br>- Informimi i publikut bëhet në përputhje me PRK-në ose planin komunal për reagim emergjent(PRE) përmes: mediave të shkruara dhe elektronike, njoftimet e shkruara, mesazhe SMS, rrjete sociale, ueb-faqe interneti, etj. |
| Masat parand. gjatë periudhës së paralajmërimit të hershëm | -Pas marrjes së Paralajmërimit nga IHMK-ja për parashikimin e motit (reshjet e dendura), ngritet gatishmëria e lartë për të papriturat dhe aktivizohet Planifikimi Kontingjent për vërshimet si dhe ngritet gatishmëria e kapaciteteve humane dhe teknike të strukturave për mbrojtje dhe shpëtim. |
| Kohëzgjatja e pritshme e ngjarjes | -Faza akute e ngjarjes zgjati 3 ditë;<br>-Koha e parashikuar e nevojshme për sanim të gjendjes është rreth 3 muaj. |
| Koordinimi | -Instituti Meteorologjik i Kosovës dërgon njoftimin mbi parashikimin e motit në QOE -112 të AME-së për reshjet e dendura komplekse dhe të pafavorshme për ditët në vijim, sipas PSO-së, njoftohen organet kompetente dhe administrative shtetërore, organet vendimmarrëse të qeverisjes lokale dhe strukturat për M&Sh për menaxhimin e situatës së pritshme emergjente sipas PRE-së;<br>-Bazuar në informacionet nga terreni për shtimin enorm të prurjeve lumore nga të reshurat e dendura, në nivel lokal aktivizohet QOE komunale / Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim, i cili kryesohet nga Kryetari i Komunës apo i deleguari i tij;<br>-Koordinimi i aktiviteteve nga niveli qendror deri tek ai lokal dhe anasjelltas bëhet përmes QOE -112 në nivel rajonal;<br>-Duhet të bëhet aktivizimi i Komisionit lokal për mbledhjen e të dhënave mbi vlerësimin e dëmeve në terren të shkaktuara nga fatkeqësia /vërshimi, të përcaktojë gjendjen aktuale faktike në terren, duke bërë vlerësimin e dëmeve dhe raportimin në komisionin qeveritar;<br>- Komisioni Qendror, bashkon raportet e komisioneve lokale dhe bën verifikimin e vërtetësisë së dëmeve të vlerësuara nga komisionet lokale dhe këtë raport ia dorëzon Qeverisë së RK-së për shqyrtim dhe miratim;<br>-Raportin e miratuar nga qeveria ia dorëzon Agjencisë/DKMSh-së në afat prej 15 ditësh;<br>- Është dhënë ndihma nga shteti dhe persona të tjerë juridikë e fizikë për popullatën brenda mundësive dhe kapaciteteve;<br>-Është bërë kontakti dhe është kërkuar ndihma humanitare nga mekanizmat vendore dhe ndërkombëtare (organizata dhe OJQ humanitare). |

| Probabiliteti / frekuenca | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Kategorizimi | Cilësia | Probabiliteti/gjasat | Frekuenca | Përcaktimi |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1 | E papërfillshme/<br><br>E pamundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet | |
| 2 | E vogël/<br><br>E pabesueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në<br><br>20 deri 100 vjet | |
| 3 | Mesatare/<br><br>E mundur | 6-50 % | 1 ngjarje në<br><br>2 deri 20 vjet | |
| 4 | E madhe /<br><br>Gati e mundur | 51-98 % | 1 ngjarje në<br><br>1 deri 2 vjet | |
| 5 | Jashtëzakonisht e madhe /<br><br>E mundur | >98 % | 1 ngjarje në vit<br><br>apo më shpesh | X |

**Vlerësimi i pasojës:**

Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut

-Të dhënat për numrin e banorëve të rrezikuar janë marrë në bazë të të dhënave të mbledhura nga terreni nga Komisioni i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë, për fat të mirë nuk ka pasur viktima, por duke pasur parasysh numrin e banorëve në nevojë, rrezikun dhe pasojat, vërshimet vlerësohen (përllogariten) si mjaft serioze.

-Përveç kërcënimit të drejtpërdrejtë gjatë vërshimeve (përmbytjeve), vlerësohet si një përkeqësim afatgjatë i standardit jetësor në zonën e prekur nga vërshimet.

***Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut:***

| **Kategorizimi:** | **Pasojat:** | **Kriteret:** | **I përcaktuar:** |
|---|---|---|---|
| 1 | Të vogla/ minimale | < 50% | X |
| 2 | Të vogla | 50 - 200 | |
| 03 | Mesatare | 201 - 500 | |
| 4 | Kritike | 501-1500 | |
| 5 | Katastrofike | > 500 | |

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

-Dëmet materiale në ekonomi familjare dhe biznese janë vlerësuar në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë vlerën: 150.948.00 €.

-Dëmet materiale në infrastrukturë janë vlerësuar në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë vlerën: 500 000 €.

***Pasqyrimi i pasojave në ekonomi***

| Kategorizimi | Pasojat | Kriteret | Përcaktimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Të papërfillshme | < 3% GDP | X |
| 2 | Të vogla | 3 - 5% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5- 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 10-15% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >15% GDP | |

**Matrica e gjasës:**

Shkalla e ashpërsisë

| | |
|---|---|
| 5 | Veprim katastrofik – (rrezik nr. 15 – 25) |
| 4 | Prioritet i ashpër – (rrezik nr. 10 – 12) |
| 3 | Prioritet mesatar – (rrezik nr. 5 – 9) |
| 2 | Prioritet i mbrojtur – (rrezik nr. 2 – 4) |
| 1 | Prioritet i ulët – (rrezik nr. 1)<br>nuk kërkohet veprim |

Matrica 1: *Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut:*




**Matrica2:** ***Rreziku për pasojat në ekonomi:***



Matrica 3: *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social– dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:*




**Matrica 4:** ***Pasqyron rrezikun e përgjithshëm***






Skenari I – zonat e rrezikshmërisë nga vërshimet

**Hartëzimi i rreziqeve nga vërshimet**

***VËRSHIMET***

| Emri i skenarit: | **Skenari 2 – Vërshime** |
|---|---|
| Frekuenca e ndodhjes: Piranë , Krajk | |
| ☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );<br>x E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);<br>☐ Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);0<br>☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); | |
| Madhësia e mundshme: | |
| ☐ E papërfillshme (më pak se 10%) **X E kufizuar( 10 deri 25%)**<br>☐ Kritike: 25 deri 50% . ☐ Katastrofike: Më shumë se 50% | |
| Lloji i skenarit: | |

| | | |
|---|---|---|
| ☐ Skenari 1; | x☐ Skenari 2; | ☐ Skenari 3; |
| Ndikimi: | | |
| ☐ I papërfillshëm; ☐ I vogël ; **X ☐ I mesëm ;** ☐ Katastrofike; | | |
| Data e vlerësimit: | | |
| 17.09.2023 | | |




Skenari II – zonat e rrezikshmërisë nga vërshimet

**KONTEKSTI**

| **Parametrat:** | **Përmbajtja:** |
|---|---|
| Vendi i ngjarjes (lokacioni) | Vendet më të rrezikuara nga vërshimet janë: Krajk, Piranë, Zojz |
| Kushtet meteorologjike | Shi i dendur me intensitet të lartë, i pandërprerë për tri ditë rresht. |

| | |
|---|---|
| Periudha e vitit: | Shtator 2023 |
| Lloji i ditës: | Ditë pune dhe fundjave. |
| Analiza meteorologjike për kohën | -Mundësia për të ndodhur vërshimet në këtë vit kalendarik është e madhe në Komunën e Prizrenit. Për çdo vit kanë ndodhur vërshime, kurse nëse e marrim 10-vjeçarin e fundit, kemi pasur më shumë 6 herë vërshime në zona të ndryshme, që dmth se për çdo të dytin vit kemi kemi pasur kërcënime nga vërshimet, që nga viti 2018 deri në vitin 2021 kanë ndodhur vërshime 3 herë me dëme të konsiderueshme (materiale). Data e paraqitjes së kësaj fatkeqësie ishte 6 janar 2021. Si pasojë e të reshurave të mëdha, në janar 2021, ka pasur prurje të mëdha ujore, duke i nxjerrë lumenjtë nga shtrati dhe duke vërshuar vendbanime në rrjedhën e poshtme të pellgjeve lumore. Ashtu që më 10 janar ka filluar tërheqja e ujit nga shtretërit e lumenjve. |
| Popullata | Numri i familjeve të prekura nga vërshimi, në zonën e vërshuar në fshatin Krajk dhe Piranë, është 42, kurse numri i banorëve ishte 257, prej tyre:<br>➢ Fëmijë: 27;<br>➢ Të moshuar dhe invalidë: 20;<br>➢ Gra: 91;<br>➢ Meshkuj: 119. |

| | |
|---|---|
| Infrastruktura kritike ekzistuese | Bazuar në kriteret e paracaktuara sipas urdhëresës administrative për rregullimin e infrastrukturës në zonën e përfshirë nga vërshimi ka pasur infrastukturë e cila ka pasur pasoja në këtë zonë.<br>➢ Struktura rrugore, sa , çfarë;<br>➢ Rrugët lokale. |
| Gatishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut) | Në nivelin lokal- Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, Njësia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, Policia e Kosovës, Shërbimet Emergjente Mjekësore, Kryqi i Kuq dhe kompani të kontraktuara nga Komuna e Prizrenit për intervenime emergjente gjatë fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. |
| Info plotësuese | |

**INCIDENTI-NGJARJA**

| | |
|---|---|
| Shkaku<br><br>dhe shkaktari | Nga të reshurat intensive të shiut gjatë 4 ditëve të fundit të shoqëruara edhe me shkrirje të borës, nga qytetarët e fshatit Krajk dhe Piranë kemi marrë informacion se në këtë lokalitet janë shkaktuar vërshime. Sipas Institutit meteorologjik të Kosovës, të reshurat do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim.<br><br>-Shkaqet e shkaktimit të vërshimeve kanë qenë si në vijim: mosmirëmbajtja e shtratit të lumit Drini i Bardhë dhe i degëve të saj, argjinaturës së lumenjve dhe kanaleve kulluese, mos mirëmbajtja e shtretërve nga vegjetacioni, ndërtimet e pakontrolluara pranë lumit Toplluha dhe Drini i Bardhë.<br><br>Gjatë muajit Janar 2021, vije deri të ngritja e madhe e nivelit të ujërave, fryrja e përrenjve, lumenjve, me ç`rast ndodh vërshimi i shpejtë me ç'rast rrezikon banorët dhe të mirat materiale të fshatrave: Krajk dhe Prianë.<br><br>Një vërshim me këtë intensitet rrezikon seriozisht dëmtimin e infrastrukturës rrugore dhe bllokon urat në fshatin Pirane dhe Krajk, ku si rezultat i prurjeve të mëdha kemi ngujim të popullatës në këto fshatra dhe ndërprerje të lëvizjes së qytetarëve në këtë aks rrugor. Kemi rrezikim të popullatës së këtyre vendbanimeve, shtëpive dhe objekteve përcjellëse, ekonomisë familjare, pastaj rrezikohet edhe objektet e rëndësisë së veqantë në fshatin Krajk dhe Prianë. Të rrezikuara ndihen edhe objekte bizneseve dhe të rëndësisë së veçante: për gjatë aksit rrugor Prizren Gjakovë etj.<br><br>Vërshimi ka shkaktuar cenueshmeri serioze për objektet e banimit (shtëpitë përdhesë, përafërsisht në nivel me tokë), duke krijuar edhe sfida dhe rreziqe që paraqesin nevojën e evakuimit të banorëve. Vërshimi i shpejtë ka shkaktuar edhe ndotjen apo kontaminimin e ujit të pijes, jo vetëm në burimet vetanake të qytetarëve por edhe mundësisë së depërtimit në rrjetin e ujësjellësit, duke shkaktuar infeksione të mundshme, rritja e kërkesave nga qytetarët për trajtim medicinal, por pa fatalitet në njerëz.<br><br>-Si pasojë e këtyre vërshimeve kemi pasur 201 familje në Komunën Prizrenit të goditura nga vërshimet.<br><br>- Evakuimi i banorëve të rrezikuar nga vërshimet, vendsoja e tyre te të afërmit, për periudhë kohore nga 6 deri ne 24 orë.<br><br>-Përkrahje dhe mbështetje institucionale e mjaftueshme nga organet komunale dhe OJQ-të humanitare lokale. |

**NGJARJA KRYESORE**

| | |
|---|---|
| Pasojat primare dhe efektet anësore | -Humbje e pasurisë në objekte banimi ( pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara nga vërshimi);<br><br>-Dëmtim i infrastrukturës rrugore, rrugë të dëmtuara në lokalitete të prekura nga vërshimet;<br><br>- Dëmtim i infrastrukturës kritike ( sistemi i ujësjellësit, sistemi energjetik);<br><br>- Shtëpi të përmbytura ( dëmtim i orendive shtëpiake: 201 shtëpi);<br><br>- Sipërfaqja e tokave bujqësore ( Perimekulturë, Lavërtari, Vreshtari, Pemëtari) në sipërfaqe të dëmtuara 410.57(ha);<br><br>- Dëmtimi i pronave individuale (sera të dëmtuara);<br><br>-Dëmtimi i bizneseve: 7 biznese të dëmtuara;<br><br>- Dëmet e shkaktuara në Infrastrukturë rrugore (rrugët,urat,trotuare,etj); |

| | |
|---|---|
| | -Vlera e përgjithshme e përllogaritur e dëmit : 1,417.856.00 €. |
| Pasojat primare dhe efektet anësore | -Humbje e pasurisë në objekte banimi ( pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara nga vërshimi);<br>-Dëmtim i infrastrukturës rrugore, rrugë të dëmtuara në lokalitete të prekura nga vërshimet;<br>- Dëmtim i infrastrukturës kritike ( sistemi i ujësjellësit, sistemi energjetik);<br>- Shtëpi të përmbytura ( dëmtim i orendive shtëpiake: 201 shtëpi);<br>- Sipërfaqja e tokave bujqësore ( Perimekulturë, Lavërtari, Vreshtari, Pemëtari), në sipërfaqe të dëmtuara 410.57(ha) .<br>- Dëmtimi i pronave individuale (sera të dëmtuara);<br>-Dëmtimi i bizneseve: 7 biznese të dëmtuara;<br>- Dëmet e shkaktuara në infrastrukture rrugore (rrugët,urat,trotuare,etj);<br>-Vlera e përgjithshme e përllogaritur e dëmit: 1,417.856.00 €. |

| | |
|---|---|
| Pasojat sekondare të shkaktuara nga domino-efekti | ➢ Vështirësi për qarkullim në trafik;<br>➢ Paraqitja e rrëshqitjes së dheut;<br>➢ Mungesë e ujit të pijes,<br>➢ Pasojat e përmbytjeve në ambient dhe tokë pjellore. |

**NDIKIMI- INDIKATORËT TREGUES**

| | |
|---|---|
| **Rastet me fatalitet** | **Nuk ka pasur raste me fatalitet.** |
| Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar | -Bazuar në të dhënat nga Komisioni për vlerësimin e dëmeve në Amvisëri dhe Ekonomi Familjare të formuar nga Kryetari i Komunës, me dt. 8.1.2021, nga pasojat e vërshimeve të janarit 2021, janë prekur rreth 201 ekonomi familjare me rreth 1206 banorë. |
| Mungesë<br>e nevojave elementare | - Si pasojë e vërshimeve kemi dëmtime të rrugëve dhe të urave;<br>- Punëtorët nuk mund të shkojnë në punë, fëmijët në shkolla;<br>- Kujdesi i ofruar shëndetësor jo i duhur;<br>- Furnizimet e nevojave themelore: e ushqimit, e veshmbathjes, shtrojë e mbulojë, e mjeteve higjienike, energjia, etj/të pa mjaftueshme;<br>- Mungesa e ujit të pijshëm, etj. |
| Të evakuarit | Nuk kemi pasur raste për evakuim. |

| | |
|---|---|
| Ndikimi i përgjithshëm ekonomik | - Dëmet në njerëz ( shëndetësore: fizike, traumatike, psikologjike, etj) , të paevidentuara;<br>- Dëmet e shkaktuara në ekonomi familjare ( rreth 201 familje), të përllogaritura: 530,948.00€;<br>- Dëme të shkaktuara në biznese: 7 biznese të përllogaritura në vlerë 48,425.00€.<br>- Dëmet e shkaktuara në bujqësi ( Perimkulturë, Lavërtari, Vreshtari, Pemëtari) në sipërfaqe të dëmtuara 410.57(ha) të përllogaritura në vlerë:507, 300.95 €;<br>- Dëmtimi i pronave individuale (sera të dëmtuara dhe rrëshqitja e dheut) të përllogaritura në vlerë 131, 400.72 €.<br>- Dëmet e shkaktuara në infrastrukturë rrugore (rrugët, urat, trotuaret,etj.) të përllogaritura në vlerë 199,783.50 €;<br>- Vlera e përafërt e dëmeve të përllogaritura është: 1,417.856.00 €. |
| Ndikimi në natyrë dhe mjedisi | -Rritja e nivelit të ujit në lumenj dhe ujëra nëntokësore mund të sjellë ndotje dhe humbje të kualitetit të ujit (duke i shtuar edhe sasinë e konsiderueshme të shkarkimit të ujërave të zeza);<br>- Humbja/dëmtimi i tokës bujqësore nga erozioni etj. |
| Ndërprerjet në jetën e përgjithshme | - Ndërprerje e furnizimit me ujë të pijshëm (një ditë);<br>- Funksionimi i infrastrukturës rrugore ( ndërprerje të akseve të caktuara rrugore apo kalim me vështirësi), atëherë si alternativë është përdorimi i rrugëve tjera të cilat nuk janë të bllokuara |
| Humbje në trashëgimi kulturore | Jo |
| Implikime politike | Jo |
| Ndikimi i përgjithshëm | Rrezik i mesëm |

**PROBABILITETI-GJASAT**

| **Probabiliteti** | **- Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësor dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të mesëm të mundshëm, duke marrë për bazë të dhënat historike** |
|---|---|
| Paralajmërimi i hershëm | -Fatkeqësia ishte pjesërisht e pritshme (bazuar në parashikimet meteorologjike), por pastaj gjërat u përkeqësuan dhe rëndoi në masë të madhe ngjarjen kryesore;<br><br>-Informimi publik për të reshurat ishte me kohë, sipas njoftimit të parashikimeve meteorologjike, me paralajmërime për mundësi të vërshimeve dhe probabilitetit për cenueshmëri;<br><br>- Informimi i publikut bëhet në përputhje me PRK-në ose planin komunal<br><br>për reagim emergjent(PRE) përmes medieve të shkruara dhe elektronike, njoftimet e shkruara, mesazhe SMS, rrjete sociale, ueb-faqe interneti, etj. |
| Masat parand. gjatë periudhës së paralajmërimit të hershëm | -Pas marrjes së Paralajmërimit nga IHMK-ja për parashikimin e motit (reshjet e dendura), ngritet gatishmëria e lartë për të papriturat dhe aktivizohet Planifikimi Kontigjent për vërshimet si dhe ngritet gatishmëria e kapaciteteve humane dhe teknike të strukturave për mbrojtje dhe shpëtim. |
| Kohëzgjatja e pritshme e ngjarjes | -Faza akute e ngjarjes zgjati 3 ditë.<br><br>-Koha e parashikuar e nëvojshme për sanim të gjendjes është rreth 6 muaj. |
| Koordinimi | -Instituti meteorologjik i Kosovës dërgon njoftimin mbi parashikimin e motit në QOE -112 të AME-së për reshjet e dendura komplekse dhe të pafavorshme për ditët në vijim, sipas PSO-së, njoftohen organet kompetente dhe administrative shtetërore, organet vendimmarrëse të qeverisjes lokale dhe strukturat për M&Sh për menaxhimin e situatës së pritshme emergjente sipas PRE;<br><br>-Bazuar në informacionet nga terreni për shtimin enorm të prurjeve lumore nga të reshurat e dendura, në nivel lokal aktivizohet QOE komunale / Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim, i cili kryesohet nga Kryetari i Komunës apo i deleguari i tij.<br><br>-Koordinimi i aktiviteteve nga niveli qendror deri tek ai lokal dhe anasjelltas, bëhet përmes QOE -112 në nivel rajonal;<br><br>-Duhet të bëhet aktivizimi i Komisionit lokal për mbledhjen e të dhënave mbi vlerësimin e dëmeve në terren, të shkaktuara nga fatkeqësia /vërshimi, të përcaktojë gjendjen aktuale faktike në terren, duke bërë vlerësimin e dëmeve dhe raportimin në komisionin qeveritar;<br><br>- Komisioni Qendror, bashkon raportet e komisioneve lokale dhe bën verifikimin e vërtetësisë së dëmeve të vlerësuara nga komisionet lokale dhe këtë raport ia dorëzon Qeverisë së Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim;<br><br>-Raportin e miratuar nga qeveria ia dorëzon Agjencisë/DKMSh-së në afat prej 15 ditësh;<br><br>- Është dhënë ndihma nga shteti dhe persona të tjerë juridikë e fizikë për popullatën brenda mundësive dhe kapaciteteve; |

**Probabiliteti/Gjasat:** ***Treguesit e probabilitetit***

| **Probabiliteti / frekuenca** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kategorizimi** | Cilësia | Probabiliteti/gjasat | Frekuenca | Përcaktimi |
| **1** | E papërfillshme/<br>E pamundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet; | |
| **2** | E vogël/<br>E pabesueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në<br>20 deri 100 vjet; | |
| **3** | Mesatare/<br>E mundur | 6-50 % | 1 ngjarje në<br>2 deri 20 vjet; | X |
| **4** | E madhe /<br>Gati e mundur | 51-98 % | 1 ngjarje në<br>1 deri 2 vjet; | |
| **5** | Jashtëzakonisht e madhe / E mundur | >98 % | 1 ngjarje në vit<br>apo më shpesh. | |

**Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut**

-Të dhënat për numrin e banorëve të rrezikuar janë marrë në bazë të të dhënave të mbledhura nga terreni nga Komisioni i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësia, për fat të mirë nuk ka pasur viktima, por duke pasur parasysh numrin e banorëve në nevojë, rrezikun dhe pasojat, vërshimet vlerësohen (përllogariten) si mjaft serioze.

-Përveç kërcënimit të drejtpërdrejtë gjatë vërshimeve (përmbytjeve), vlerësohet si një përkeqësim afatgjatë i standardit jetësor në zonën e prekur nga vërshimet.

***Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut:***

| **Kategorizimi:** | **Pasojat:** | **Kriteret:** | **I përcaktuar:** |
|---|---|---|---|
| 1 | Të vogla/ minimale | < 50% | |
| 2 | Të vogla | 50 - 200 | |
| 3 | Mesatare | 201 - 500 | X |
| 4 | Kritike | 501-1500 | |
| 5 | Katastrofike | > 500 | |

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

Dëmet materiale në ekonomi familjare dhe biznese janë vlerësuar në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë vlerën: 579,373.00€.

-Dëmet materiale në infrastrukturë janë vlerësuar në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë vlerën: 899,783.50 €.

***Pasqyrimi i pasojave në ekonomi***

| **Kategorizimi** | **Pasojat** | **Kriteret** | **Përcaktimi** |
|---|---|---|---|
| 1 | Të papërfillshme | < 3% GDP | |
| 2 | Të vogla | 3 - 5% GDP | X |
| 3 | Mesatare | 5- 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 10-15% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >15% GDP | |

Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social – dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike;

- Vlerat e dëmeve materiale në infrastrukturën kritike janë përllogaritur në bazë të raportit të komisioneve lokale për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë shumën: 267.000.00 €

**Matricaa e gjasës:** ***Matrica 1. Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut***




***Matrica***

***2 Rreziku për pasoja në ekonomi***




3a: Pasqyrimi i pasojave për stabilitet social - dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturë kritike:



**Matrica 4: Pasqyron rrezikun e përgjithshëm**




***VËRSHIMET Skenari 3***

| | |
|---|---|
| Emri i skenarit: | **Skenari 3 - Vërshim** |
| Frekuenca e ndodhjes: Qyteti i Prizrenit | |
| ☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );<br>X☐E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);<br>☐ Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);<br>☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); | |
| Madhësia e mundshme: | |
| ☐ E papërfillshme (më pak se 10%)<br>X☐ Kritike: 25 deri 50% . | ☐ E kufizuar( 10 deri 25%)<br>☐ Katastrofike: Më shumë se 50% |
| **Lloji i skenarit:** | |
| **☐ Skenari 1;** **☐ Skenari 2;** | **X ☐ Skenari 3;** |
| Ndikimi: | |
| ☐ I papërfillshëm; ☐ I vogël ; | ☐ I mesëm ; X ☐ Katastrofike; |

Data e vlerësimit: 02/11/2023

| **Parametrat:** | **Përmbajtja:** |
|---|---|
| Vendi i ngjarjes (lokacioni) | Vendet më të rrezikuara nga vërshimet janë: Qyteti i Prizrenit |
| Kushtet meteorologjike | Shi i dendur me intensitet të lartë, i pandërprerë gjatë 48 orëve të fundit. |
| Periudha e vitit: | Shtator 2023 |
| Lloji i ditës: | Ditë fundjave |
| Analiza meteorologjike për kohën | -Mundësia për të ndodhur vërshimet në këtë vit kalendarik është e madhe në Komunën e Prizrenit. Data e paraqitjes së kësaj fatkeqësie është 17 Shtator 2023. Vërshimet janë të shkaktuara nga reshjet intensive. Sipas parashikimeve meteorologjike pritet të këtë reshje përsëri. |
| Popullata | Numri i familjeve të prekura nga vërshimi, në zonën e vërshuar janë 917 familje, kurse numri i banorëve ishte: 4588, prej tyre:<br>➢ Fëmijë: 1140;<br>➢ Të moshuar: 745;<br>➢ Gra: 1358;<br>➢ Meshkuj: 1345. |
| Infrastruktura kritike ekzistuese | Bazuar në kriteret e paracaktuara sipas urdhëresës administrative për rregullimin e infrastrukturës në zonën e përfshirë nga vërshimi, ka pasur infrastukturë e cila ka pasur pasoja në këtë zonë.<br>➢ Struktura rrugore,<br>➢ Rrugët lokale;<br>➢ Ura të cilat kanë kyqje nga rruga në shtëpi dhe<br>➢ Urat standarde.<br>➢ 20 Biznese<br>➢ 5 trafo |
| Gatishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut) | Pas njoftimit nga qytetarët dhe nga Policia e Kosovës, QOE (112), Në nivelin lokal- Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, Njësia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, Policia e Kosovës, Shërbimet Emergjente Mjekësore, Kryqi i Kuq dhe kompani të kontraktuara nga Komuna e Prizrenit, por edhe nga Qendra Kryesore e Agjencionit të Emergjencave të Kosovës për intervenime emergjente gjatë fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. |
| Info plotësuese | Në bazë tëvlerëmit të gjendjes në terren, situata është e vështirë e përballueshme nga njësitë emergjente komunale dhe është e nevojshme të fillohet procedurae shpalljes së gjendjes emergjente |

**INCIDENTI-NGJARJA**

| | |
|---|---|
| Shkaku dhe shkaktari | Nga të reshuarat intensive të shiut, gjatë orëve të pasditës, të datës 17.9.2023, nga qytetarët e zonës së prekur kemi marrë informacion se në këto lokalitete janë shkaktuar vërshime. Sipas Institutit meteorologjik të Kosovës, të reshurat do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim.<br><br>-Shkaqet e shkaktimit të vërshimeve kanë qenë si në vijim: Shtratet e lumenjve dhe të përrockave relativisht të ngushta, ndërtimet bri lumenjve, hedhja e mbeturinave dhe e materialeve inerte, të cilat drejtpërdrejt ndikojnë në ngushtimin e shtretërve të lumenjve.<br><br>Zona e vërshimit përfshin oborret dhe bodrumeve e shtëpive individuale të banimit përgjatë shtratit të këtij lumi në gjatësi në të dy krahët e rrjedhës së lumit afër 10 km. Të rrezikuara janë 917 shtëpi, ku më të rrezikuara janë ato shtëpi të ndërtuara bri shtratit të lumit. Në këtë gjatësi ekzistojnë 15 ura, prej tyre 8 të ngushta, që ndikojnë në përkeqësimin e situatës vërshuese dhe krijimin e barrierave nga materialet inerte dhe zënien e fyteve të urës në qarkullimin e ujit. |
| Ngjarja kryesore | Thelbi i skenarit, i nxitur nga një sërë shkaqesh deri te pasojat.<br><br>- Më 17 Shtator 2023, uji i dalë nga shtrati, ka bërë një vërshim përgjatë lumit Lumbardhi i Prizrenit: në një gjatësi rreth 10 km, duke përfshirë dhe rrezikuar: objekte banimi dhe infrastrukturë rrugore.<br><br>Vërshimet kanë përfshirë 917 shtëpi banimi me dëme: 4,175 000.00 të amvisërisë.<br><br>- Ndërtimet në këtë zonë janë standarde me material të fortë dhe rreziku nga shembja është relativisht i vogël, ndërsa rreziku për jetë mundë të paraqitet e improvizuara. Vërshimet në këtë pjesë të zones janë momentale, dhe me ndërprejen e të reshuarave pas 2- 4 orësh, zvoglohet shkalla e rrezikut.<br><br>-Ekipet reaguese Emergjente (ShRE) kanë bërë reagimin emergjent dhe sanimin e gjendjes gjatë dhe pas vërshimeve, pastaj janë angazhuar edhe mekanizma institucionale dhe publike, siç janë: Drejtoria komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtoria për Shërbime Publike Komunale, Opertorët Ekonomik të kontraktur nga Komuna e Prizrenit për Intervenime Emergjente si dhe nga Niveli Qendror Institucionet përkatëse. |
| Pasojat primare dhe efektet anësore | -Humbje e pasurisë në objekte banimi ( pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara nga vërshimi)<br><br>-Dëmtim i Infrstrukturës rrugore, rrugë të dëmtuara në lokalitete të prekura nga vërshimet.<br><br>- Dëmtim i Infrstrukturës kritike( sistemi i ujësjellësit, sistemi energjetik),<br><br>- Shtëpi të përmbytura ( dëmtim i orendive shtëpike: 917 shtëpi);<br><br>-Vlera e përgjithshme e përllogaritur e dëmit : 4,175 000.00 € |
| Pasojat sekondare të shkaktuara nga domino-efekti | ➢ Vështirësi për qarkullim në trafik;<br>➢ Paraqitja e rrëshqitjes së dheut;<br>➢ Mungesë e ujit të pijes si pasojë e dëmtimit të rrjetit apo ujit të turbullt në impiante;<br>➢ Pasojat e përmbytjeve në ambient dhe tokë pjellore; |

**NDIKIMI- INDIKATORËT TREGUES**

| | |
|---|---|
| Rastet me fatalitet | -Nuk ka pasur raste të humjes së jetës, por janë lënduar 20 përsona |
| Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar; | -20 persona në gjendje të rënde |
| Mungesë<br>e nevojave elementare | - Si pasojë e vërshimeve kemi dëmtime të rrugëve dhe urave,<br>- Punëtorët nuk mund të shkojnë në punë,fëmijët në shkolla e kopshte;<br>- Furnizimet e nevojave themelore: ushqimit, veshë-mbathjes, shtrojë e mbulojë, mjeteve higjienike, energjia, etj/të pa mjaftueshme;<br>- Mungesa e ujit të pijshëm, etj.<br>Janë ndërprerë aktivitetet ditore në gjithë hapësirën e përfsirë nga vërshimet. |
| Të evakuarit | - Banoret e rrezikuar janë evakuar në Qendren sportive në qytetin e Prizrenit. |
| Ndikimi i përgjithshëm ekonomik | - Dëmet në njerëz (shëndetësore: fizike, traumatike, psikologjike, etj) ,<br>të evidentuara;<br>- Dëmet e shkaktuara në: Ekonomi familjare ( rreth 917 familje), të<br>përllogaritura: 4,175 000.00 €<br>- Vlera e përafërt e dëmeve të përllogaritura është: 4,175 000.00 € |
| Ndikimi në natyrë dhe<br>mjedisi | -Rritja e nivelit të ujit në lumenj dhe ujëra nëntokësorë mund të sjellë<br>ndotje dhe humbje të kualitetit të ujit (duke i shtuar edhe sasinë e konsiderueshme të shkarkimit të ujërave të zeza);<br>- Humbja/dëmtimi i tokës bujqësore nga erozioni;etj. |
| Ndërprerjet në jetën e përgjithshme | - Ndërprerje e furnizimit me ujë të pijshëm,<br>- Funksionimi i infrastrukturës rrugore (ndërprerje të akseve të<br>caktuara rrugore ne qytetin e Prizrenit , rrugët skaje Lumbardhit, kalim me vështirësi) |
| Humbje në trashëgimi kulturore | Jo |
| Implikime politike | Jo |
| Ndikimi i përgjithshëm | Rrezik i lartë |

**PROBABILITETI-GJASAT**

| | |
|---|---|
| Probabiliteti | - Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësorë dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të lartë të mundshëm, duke marrë për bazë të dhënat historike, |

| | |
|---|---|
| Paralajmërimi i hershëm | -Fatkeqësia ishte pjesërisht e pritshme (bazuar në parashikimet meteorologjike) por pastaj gjërat u përkeqësuan dhe rëndoi në masë të madhe ngjarjen kryesore;<br><br>-Informimi publik për të reshurat ishte me kohë, sipas njoftimit të parashikimeve meteorologjike, me paralajmërime për mundësi të vërshimeve dhe probabilitetit për cenueshmeri;<br><br>- Informimi i publikut bëhet në përputhje me PRK ose planin komunal për reagim emergjent( PRE) përmes: mediave të shkruara dhe elektronike, njoftimet e shkruara, mesazhe SMS, rrjete sociale, web-faqe interneti, etj. |
| Masat parand. gjatë periudhës së paralajmërimit të hershëm | -Pas marrjes së Paralajmërimit nga IHMK për parashikimin e motit (reshjet e dendura), ngritet gatishmëria e lartë për të papriturat dhe aktivizohet Planifikimi Kontingjent për vërshimet si dhe ngritet gatishmëria e kapaciteteve humane dhe teknike të strukturave për mbrojtje dhe shpëtim; |
| Kohëzgjatja e pritshme e ngjarjes | -Faza akute e ngjarjes zgjati 5 ditë.<br><br>-Koha e parashikuar e nevojshme për sanim të gjendjes është rreth 9 muaj |
| Koordinimi | -Instituti meteorologjik i Kosovës dërgon njoftimin mbi parashikimin e motit në QOE -112 të AME-së për reshjet e dendura komplekse dhe të pafavorshme për ditët në vijim, sipas PSO-së, njoftohen organet kompetente dhe administrative shtetërore, organet vendimmarrëse të qeverisjes lokale dhe strukturat për M&Sh për menaxhimin e situatës së pritshme emergjente sipas PRE;<br><br>-Bazuar në informacionet nga terreni për shtimin enorm të prurjeve lumore nga të reshurat e dendura, në nivel lokal aktivizohet QOE komunale / Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim, i cili kryesohet nga Kryetari i Komunës apo i deleguari i tij.<br><br>-Koordinimi i aktiviteteve nga niveli qendror deri tek ai lokal dhe anasjelltas bëhet përmes QOE -112 në nivel rajonal;<br><br>-Duhet të bëhet aktivizimi i Komisionit lokal për mbledhjen e të dhënave mbi vlerësimin e dëmeve në terren të shkaktuara nga fatkeqësia /vërshimi, të përcaktojë gjendjen aktuale faktike në terren, duke bërë vlerësimin e dëmeve dhe raportimin në komisionin qeveritar;<br><br>- Komisioni Qendror, bashkon raportet e komisioneve lokale dhe bën verifikimin e vërtetësisë së dëmeve të vlerësuara nga komisionet lokale dhe këtë raport ia dorëzon Qeverisë së RK-së për shqyrtim dhe miratim;<br><br>-Raportin e miratuar nga Qeveria ia dorëzon Agjencisë/DKMSh-së në afat prej 15 ditësh;<br><br>- Është dhënë ndihma nga shteti dhe persona të tjerë juridikë e fizikë për popullatën brenda mundësive dhe kapaciteteve;<br><br>-Është bërë kontakti dhe është kërkuar ndihma humanitare nga mekanizmat vendore dhe ndërkombëtare (organizata dhe OJQ humanitare). |

| Kategorizimi | Cilësia | Probabiliteti/gjasat | Frekuenca | Përcaktimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | E papërfillshme/E pamundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet; | |
| 2 | E vogël/E pabesueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në 20 deri 100 vjet; | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 3 | Mesatare/E mundur | 6-50 % | 1 ngjarje në 2 deri 20 vjet; | |
| 4 | E madhe /Gati e mundur | 51-98 % | 1 ngjarje në 1 deri 2 vjet; | X |
| 5 | Jashtëzakonisht e madhe / E mundur | >98 % | 1 ngjarje në vit apo më shpesh. | |

**Vlerësimi i pasojës:**

Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut

-Të dhënat për numrin e banorëve të rrezikuar janë marrë në bazë të të dhënave të mbledhura nga terreni nga Komisioni i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësia, për fat të mirë nuk ka pasur viktima, por duke pasur parasysh numrin e banorëve në nevojë, rrezikun dhe pasojat, vërshimet vlerësohen (përllogariten) si mjaft serioze.

-Përveç kërcënimit të drejtpërdrejtë gjatë vërshimeve (përmbytjeve), vlerësohet si një përkeqësim afatgjatë i standardit jetësor në zonën e prekur nga vërshimet.

***Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut:***

| Kategorizimi: | Pasojat: | Kriteret: | I përcaktuar: |
|---|---|---|---|
| 1 | Të vogla/ minimale | < 50% | |
| 2 | Të vogla | 50 - 200 | |
| 3 | Mesatare | 201 - 500 | |
| 4 | Kritike | 501-1500 | X |
| 5 | Katastrofike | > 1500 | |

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

-Dëmet materiale në ekonomi familjare dhe biznese janë vlerësuar në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë vlerën: 20,175 000.00 €.

-Dëmet materiale në infrastrukturë janë vlerësuar në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë vlerën 27,500,000.00 €.

***Pasqyrimi i pasojave në ekonomi***

| Kategorizimi | Pasojat | Kriteret | Përcaktimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Të papërfillshme | < 3% GDP | |
| 2 | Të vogla | 3 - 5% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5- 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 10-15% GDP | X |
| 5 | Katastrofike | >15% GDP | |

**Matrica e gjasës: *Nivelet e fatkeqësive:***

Shkalla e ashpërsisë

| | |
|---|---|
| 5 | Veprim katastrofik – (rrezik nr. 15 – 25) |
| 4 | Prioritet i ashpër – (rrezik nr. 10 – 12) |
| 3 | Prioritet mesatar – (rrezik nr. 5 – 9) |
| 2 | Prioritet i mbrojtur – (rrezik nr. 2 – 4) |
| 1 | Prioritet i ulët – (rrezik nr. 1)<br>nuk kërkohet veprim |

Matrica 1: *Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut:*



**Matrica 2:** ***Rreziku për pasojat në ekonomi:***




Matrica

3: *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social– dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:*



**Matrica 4:** ***Pasqyron rrezikun e  përgjithshëm***

| Pasojat | | Gjasat 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Katastrofike | 5 | | | | | |
| Kritike | 4 | | | X | | |
| E mesme | 3 | | | | | |
| E vogel | 2 | | | | | |
| E papërfillshme | 1 | | | | | |
| | | E sigurt | Gati e mundur | **<u>E besushme</u>** | E pa besueshme | E pamundur |




Skenari III, zonat e rrezikuara nga vërshimet ne komunen e Prizrenit

## 6.5. ZJARRET

Sipas rregulloren nr. 25/2020 për Metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikshmërisë, trajtimi I zjarreve bëhet në dy kategori edhe ate: si fatkeqësi apo fenomene natyrore dhe si fatkeqësi të shkaktuara nga faktori njeri ( zjarre të qëllimshme, të pa qëllimshme apo si fatkeqësi të shkaktuara nga proceset teknologjike). Zjarri është fatkeqësi e pa kontrolluar e cila mund të kërcënojë seriozisht jetën e njeriut, të shkaktojë dëme materiale dhe mjedisin.

### 6.5.1. Karakteristikat e terrenit dhe vatrave potenciale të zjarreve,

Sikur edhe relievi i Kosovës që përbëhet prej vargmaleve, maleve, fushëgropave dhe luginave, të krijuara nga lëvizjet tektonike, nga format erozive, etj. edhe reliefi i komunës sonë, si pjesë integrale, është rezultat i bashkëveprimit të fuqive të brendshme dhe atyre te jashtme të cilat kanë modeluar atë, që lidhet me ngritjet periferike të maleve të Prizrenit që përfaqësohet me një pjesë të maleve si: Sharr, Oshlak, Koritinik, Pashtrik, duke i shtuar edhe pjesët e ulëta, si ato të Rrafshit të Dukagjinit. Pjesët malore me lartësi mbi 1500 m përfshijnë afro 15% të gjithë kufijve komunal. Maja më e lartë gjendet në Malet e Sharrit, me një lartësi prej 2600m. Malet e Sharrit kufizohen me Maqedoninë e Veriut në juglindje, me Komunën e Dragashit në jug, me Komunën Shtërpcës në lindje dhe me Komunën e Suharekës në verilindje. Lugina e Zhupës dhe lugina e Lumëbardhit, shtrihen përgjatë këtyre maleve drejt Prizrenit. Mali i Pashtrikut, i cili gjendet në kufirin shqiptar është mali i dytë me lartësi prej 1950 m. Në pjesën lindore, këtë regjion e mbyllin mali Oshlak, i Jezercit të Nerodimes, e në atë jugperëndimore ato të Pashtrikut dhe Koritnikut. Zonat malore janë të mbuluara me pyje dhe janë potencial apo vatër e zjarrëve.

Ndërsa zonat e rrafshta shtrihen në pjesën veriore të komunës të cilat i takojnë pellgut të lumit Drini i Bardhë, dhe janë të mbuluara me kultura bujqësore.

Edhe komuna e Prizrenit sikur edhe komunat e tjera gjatë dy dekadave të fundit, kanë qenë të kërcënuara nga zjarret, sidomos zjarret urbane dhe malore. Bazuar në të dhënat e mbledhura nga terreni nga IMNZ, shkaktari kryesor i përhapjes së kësaj kategorie të zjarreve është faktori njeri, qofte nga pakujdesia apo me qellim.

**Shkaqet e zjarreve** në komunën e Prizrenit kanë karakter:

- Antropogjenik (mos kujdesi i njerëzve),
- Djegia e hamulloreve dhe kullotave( zjarrëvënie e qëllimshme);
- Zjarrëvënie e qëllimshme në pyjeve për interesa ( perfitime) personale apo vese pirromanie;
- Zjarre të shkaktuara nga natyra (shumë të rralla apo të pa mundshme)

Zonat më të atakuara nga zjarret janë fshatrat e zonave malore të cilat ekspozohen nga djegja e pyjeve, kurse zjarret fushore i ekzpozohen zonave të rrafshta, të cilat i ekspozohen rrezikut si shkak i djegjes së hamulloreve dhe barërishtave.

Tabela nr: 52 Historiku sipas viteve 2020-2024 në Komunën e Prizrenit

| VITI | Nr.zjarreve | Zjarr-Shtepi Banimi | Zjarr në Obj. banesore Kolektive | Zjarre në Depo afariste | Zjarr në.Hotele | Zjarr në Ushqim Bagëtish | Lokale Afariste Podrume | Obj.Administrative | Zjarr në shtylla elektrike | Zjarr-në Mbeturina | Zjarre Fushore | Zjarre Malore | Zjarre në Automjete veture | Zjarre në Ogjaqe | Zj.në Orë dhe paisje elektrike | Zjarr në Kabllo Elektrike | Zjarr ne Trafo Stacin |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Viti 2020 | 444 | 39 | 11 | 5 | 14 | 4 | 168 | 80 | 18 | 66 | | | | | | | 39 |
| Viti 2021 | 613 | 40 | 7 | 6 | 1 | 12 | 8 | | 49 | 78 | 229 | 99 | 18 | 19 | 18 | 17 | 12 |
| Viti 2022 | 420 | 33 | 8 | 4 | 5 | 8 | 9 | 5 | 17 | 58 | 116 | 67 | 17 | 25 | 12 | 26 | 11 |
| Viti 2023 | 521 | 32 | 12 | 2 | - | 10 | 8 | 1 | 21 | 49 | 207 | 59 | 23 | 12 | 23 | 48 | 14 |
| Viti 2024 | 73 | 6 | - | - | - | 3 | 1 | - | 8 | 9 | 17 | 15 | 2 | 3 | 3 | 3 | 3 |

- Grafiku nr 27 *Përqindja e sipërfaqeve të mbuluara me pyje, tokë bujqësore dhe kullosa, sipërfaqe ujore dhe objekte ;*



- *Grafikoni 27. Numri i zjarreve sipas viteve 2020-2024 në komunën e Prizrenit (Per vitin 2024 deri në muajin mars)*




-

Harta nr 39 Reliefi i Komunës së Prizrenit , aneksi i hartave, faqe 40 (harta është punuar nga ekspertet e GIS të kyçur në projekt)

### 6.5.2. Kushtet klimatike

Në aspektin klimatik, komuna e Prizrenit i nënshtrohet ndikimeve atmosferike kontinentale dhe mediterane të pa qëndrueshme, të cilat gjatë muajve të verës shkakton mungesë të reshjeve të shiut dhe lagështisë se ajrit dhe tokës ku për pasojë kemi mungesë të theksuar të të reshurave meqërast teritori i komunës sonë përfshihet nga thatësia dhe temperaturat e larta, dukuri kjo që po merr përmasa të gjëra dhe me kosto të lartë financiare. Temperaturat në komunën tonë oscilojnë dhe kanë mjaft dallime mujore dhe sezonale. Për analizë krahasuese do të shfrytëzohen temperaturat mesatare mujore. Muaji me i ftoftë është janari me temperaturë mesatare 2.4 °C, muaji më i ngrohtë është korriku me 22.4 °C. Reshjet atmosferike se bashku me temperaturën paraqesin tiparin primar klimatik. Sasia e reshjeve, forma dhe intensiteti i reshjeve janë karakteristikat më të rëndësishme për hapësirën e një territori. Reshjet paraqesin vetëm një pjese të ciklit hidrologjik dhe ripërtritjes së ujit për një hapësire të caktuar respektivisht për territorin e komunës sonë. Zhvillimi i vegjetacionit në sezonën pranverore, mungesa e të reshurave atmosferike në sezonën verore si dhe ngritja e temperaturave krijojn ë parakushtet ideale të përhapjes së zjarreve malore dhe fushore.

### 6.5.3. Zjarret fushore malore, urbane, zjarret si pasojë e proceseve tekniko-teknologjike

**Karakteristikat e zjarreve pyjore dhe fushore**

- Zjarret pyjore dhe fushore janë fatkeqësi që shkaktojnë dëme të mëdha të sipërfaqeve të tëra drusore të llojeve dhe vlerave të ndryshme, shkakton dëme në faunë si dhe dëme ekologjike/mjedisore e që mvarësisht nga përmasat dhe pasojat, përcaktohet edhe niveli/shkalla e rrezikshmërisë.

- Zjarret e shkaktuara në sipërfaqe të mëdha në pyjeve ose shkurre ku përfshihen edhe zona të banuara (vendbanime), mund të shkaktojnë cenueshmëri /rrezikshmëri të lartë për njerëzit brenda zonës, pasurisë së tyre, për pyjet dhe mjedisin brenda zonës së caktuar.
- Zonat më të atakuara nga zjarret fushore dhe malore janë fshatrat e zonave malore të cilat ekspozohen nga djegja e pyjeve, si dhe fshatrat e zonave të rrafshta, të cilat i ekspozohen rrezikut si shkak i djegjes së hamulloreve dhe barërishtave.
- Shkaktarët e paraqitjes së këtyre kryesore të zjarreve kryesisht vijnë nga njerëzit( duke përfshirë neglizhencën, aktivitetet bujqësore të pa-kontrolluara, zjarret aksidentale dhe zjarrvëniet e qëllimshme, etj.)

### 6.5.4. Intenziteti, shpeshtësia e paraqitjes, kohëzgjatja

<table>
<tr><td colspan="2">Fletë pune e profilit të rrezikut për zjarre Pyjore dhe fushore (2019-2024)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Madhësia e mundshme ( Përqindja e komunitetit që mund të goditet): ( e Kufizuar )<br>Katastrofike: ☐ më shumë se 50%<br>Kritike: ☐ 25 deri 50%<br>E kufizuar: ☒ 10 deri 25%<br>E papërfillshme: ☐ më pak se 10%</td></tr>
<tr><td>Frekuenca e ndodhjes:<br>▪ Shumë e mundshme: mundësia afër 100% në vitin e ardhshëm;<br>▪ E mundshme: mundësia midis 10 dhe 100% në vitin e ardhshëm; ose së paku një rast në 10 vitet e ardhshme;<br>▪ Ka gjasa: mundësia midis 1 dhe 10% në vitin e ardhshëm, ose së paku një rast në 100 vitet e ardhshme;<br>▪ I pa mundshëm: Mundësia më e vogël se 1% në 100 vitet e ardhshme.</td><td>Modeli Sezonal:<br>☐ Pranverë;<br>☒ Verë;<br>☐ Vjeshtë ;<br>☐ Dimër;</td></tr>
<tr><td colspan="2">▪ Zonat e goditura: Zonën pyjore të Prevalla</td></tr>
<tr><td colspan="2">▪ Kohëzgjatja: (afër 3 ditë )</td></tr>
<tr><td colspan="2">▪ Shpejtësia e mundshme e mësymjes (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit):</td></tr>
<tr><td colspan="2">- Paralajmërim minimal (apo fare); - Paralajmrim 12 deri 24 orë;<br>- Paralajmërim 6 deri 12 orë; - Paralajmërim më shumë se 24 orë;</td></tr>
<tr><td colspan="2">▪ Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:<br>- Instituti i metrologjisë;<br>- QOE-112/AME, etj;</td></tr>
<tr><td colspan="2">▪ A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë?<br>▪ ☐ Po ( Rrugët nuk janë të hapura në pyje dhe konfiguracioni i terrenit e kufizojnë arritjen e zjarrëfikseve në vendin e duhur)<br>▪ ☐ Jo;</td></tr>
</table>

*Grafikoni 28. Zjarrët e ndodhura  nga viti 2020-2024 në komunën e Prizrenit*




### 6.5.5. Sipërfaqet e përfshira nga Zjarri

Zjarre pyjore dhe fushore të përmasave të mëdha/alarmante në Komunën e Prizrenit ka pasur gjatë verës së vitit 2007, por në përmasa shqetësuese ka pasur edhe në 10 vitet e fundit, të cilat kanë përfshirë lokacionet në pyje  dhe fushore. Në vitin 2012 në regjionin e Prizrenit në njësinë menaxhuese "Koritnik II" janë djegur 1,564 ha me llojin rrobull Pinus Heldreichii, dhe zjarri ka qenë dëme të mëdha mjedisore, ekonomike.

***Tabela nr 53*** *Numri dhe llojet e zjarreve nga viti 2020-2024 në komunën e Prizrenit*

| Zjarr-Shtepi Banimi | Zjarr në Ushqim Bagëtish | Lokale Afariste Podrume | Zjarr në shtylla elektrike | Zjarr-në Mbeturina | Zjarre Fushore | Zjarre Malore | Zjarre në Automjete veture | Zjarr ne paisje te rrymes eletrike | Tjera |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 188 | 37 | 231 | 113 | 260 | 569 | 240 | 60 | 229 | 145 |

Tabela nr. 54 : *Sipërfaqja pyjore (ha) e djegur për vitin 2003-2011 (Burimi: Strategjia për Mbrojtjen e Klimës në Sektorin e Pylltarisë në Kosovë)*

| Regjioni | Viti 2003 | V 2004 | V 2005 | V 2006 | V 2007 | V 2008 | V 2009 | V 2010 | V 2011 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Prizren | 1360 | 1134 | 947 | 881 | 3795 | 41 | 6 | 11 | 554 |

### 6.5.6. Mbrojtja nga zjarri në sektorin e ndërtimit

- Analiza profesionale dhe vlerësimi profesional i ekpertëve përkatës të fushës për mbrojtje dhe shpëtim nga zjarri është pjesë përbërëse e Planeve Komunale Zhvillimore(PZhK) si dhe planeve Urbanistike. Në këto plane është e paraparë zbatimi i dispozitave ligjore si: Ligji i Ndërtimit, Ligji për Mbrojtje nga Zjarri, akteve nënligjore përkatëse, normave teknike, si dhe normave( kodeve) ndërkombëtare të pranuara.
- Në kuadër të projekteve të ndërtimit (objekteve specifike ) dhe atyre që zhvillojnë(deponojnë) aktivitet me materie të rrezikshme apo paraqesin rrezikshmëri të lartë, pjesë e projektit duhet të jetë edhe elaborati për mbrojtje nga zjarri.
- Pjesa urbane e qytetit tonë, kohëve të fundit ka një zgjërim dhe ndërtim të hovshëm, sidomos me objekte shumë-katëshe për banim, me objekte privato-publike dhe parqe industriale , ku një pjesë dërmuese e këtyre ndërtimeve nuk i përmbushin knaqshëm kërkesat dhe nevojat për mbrojtje nga zjarri, siç janë:
- Mungesa e qasjes së NJPZSh-ve me automjete të zjarrfikjes në objekte banimi;
- Mungesa e sistemit të lajmërimit dhe alarmit;
- Mungesa e rrugëve( hapsirave ) për grubullim dhe evakuim;
- Atesti i qëndrueshmërisë së konstruksionit të objekteve ndaj zjarrit;
- Mundësia e zgjerimit të zjarrit në objektet fqinjë dhe në ndërtesë,
- Mungesa e daljeve emergjente,
- Mungesa e hidranteve në objektet e lartëcekura ( hidrante jo-funksionale); etj.

**Masat parandaluese:**

Masat e propozuara nga Grupi Punues për hartimin e dokumentit të vlerësimit të rrezikshmërisë për zjarret :

- Komunikimi me publikun, vetëdijësimi publik;
- Lëvrimi i sipërfaqeve tokësore pas korrje shirjeve;
- Hapja e rrugëve malore për intervenim;
- Zbatimi i masave ndëshkimore për zjarrëvënsit;
- Masat parandaluese për zjarret industriale
- Ngritjen e Njësisë Profesionale të Zjarrfikësve Industrial;
- Paisja me hidrante në të gjitha hapësirat e nevojshme;
- Lajmëruesit automatik të zjarrit/lajmërimi dhe alarmimi automatik;
- Atestimi i këtyre sistemeve;
- Sistemet pneumatike ;
- Jetësimi i një sistemi vrojtues dhe sinjalizues.

**Masat parandaluese të zjarreve në fusha/sezonale**

Bazuar në Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri, autoriteti lokal në sezonën e korrje – shirjeve, janë të obliguar të marrin masa parandaluese , si:

- Organizimi i kujdestarisë (shërbimin e vëzhgimit, lidhjes dhe informimit në vijimësi gjatë korrje–shirjes;
- Autokombajnat dhe mjetet pjesëmarrëse në korrje- shirje duhet të jenë teknikisht në rregull dhe të pajisura me mjete (aparate) për mbrojtje nga zjarri;
- Për të rritur sa më shumë ndërgjegjësimin në të gjithë shoqërinë, është e nevojshme të organizohen aktivitete të ndryshme ndërgjegjësuese duke përdorur forma të ndryshme që janë më të përshtatshme për komunitetin. Nëpërmjet takimeve, diskutimeve të ngushta me qytetarët, përmes mjeteve promovuese dhe sensibilizuese si broshura, postera dhe të tjera të përshtatshme për shikueshmëri, si dhe të tilla përmes mediave si mediat sociale, të shkruara dhe televizioni.

**Rekomandimet:**

-Hartimin dhe aprovimin e planeve reaguese emergjente lokale (PREL);
-Krijimin e procedurave standarde operative për reagim emergjent;
-Vendosjen e standardeve, udhëzimeve dhe protokolleve të nevojshme për koordinim dhe reagim emergjent të Shërbimeve reaguese emergjente dhe të akterëve tjerë të sigurisë;
-Identifikimi i nevojave dhe përcaktimi i prioriteteve për menaxhimin e zjarreve ;
-Ngritja (rritja) e kapaciteteve humane për reagim emergjent, përgatitja profesionale dhe certifikimi;
-Ngritja e kapaciteteve ( resurseve ) teknike dhe standardizimi i tyre;
-Të ngritet infrastruktura rrugore ( me qëllim të reagimit më të lehtë me mjete motorrike) në pyje dhe të të sigurohen burimet ujore, sa më afër vatrave potenciale të zjarreve për furnizim;
-Të bëhet sanimi dhe gjenerimi i sipërfaqeve pyjore, pas zjarreve të shkaktuara;
-Të krijohet baza e të dhënave elektronike, për pasojat nga zjarret(sipërfaqet e djegura, masa drusore, bimët aromatike, bimët mjekuese dhe dëmet ekologjike) në vlerë valutore Euro;
-Arritja e memorandumeve të mirëkuptimit me qëllim të ofrimit të ndihmës reciproke dhe bashkëpunimit me komunat fqinje, sektorin privat dhe OJQ humanitare, në rast se paraqitet nevoja;




*Harta 32. Zonat e munshme të rrezikuara nga zjarri, Analizë nga ekipi, Digjitalizimi i pyjeve është bërë nga Ortofotot , Burimi i të dhënave Gjeoportali kombëtar.*

**Skenari 1 ;**

| Emri i skenarit: | Zjarre pyjore |
|---|---|
| Frekuenca e ndodhjes: | |
| x☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );<br>☐ E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);<br>☐ Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);<br>☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); | |
| Madhësia e mundshme: | |
| X☐ E papërfillshme (më pak se 10%)<br>☐ Kritike: 25 deri 50% . | ☐ E kufizuar( 10 deri 25%)<br>☐ Katastrofike: Më shumë se 50% |

| | | |
|---|---|---|
| Lloji i skenarit: | | |
| **x☐ Skenari 1**; ☐ Skenari 2; ☐ Skenari 3; | | |
| Ndikimi: | | |
| X I papërfillshëm; ☐ I vogël ; ☐ I mesëm ; ☐ Katastrofike; | | |
| Data e vlerësimit: | | |
| 21/08/2022 | | |
| **KONTEKSTI** | | |
| **Nr. rend.** | **Parametrat:** | **Përmbajtja:** |
| 1. | Vendi i ngjarjes (lokacioni) | Vendet më të rrezikuara nga zjarre pyjore dhe fushore janë fshatrat e zonës se Hasit (Milaj,Pllanejë, Kojushë, Mazrek,Gjonaj) |
| 2. | Kushtet meteorologjike | Temperatura të larta dhe erërat e forta. |
| 3 | Periudha e vitit: | 30 Korrik 2022 |
| 4 | Lloji i ditës: | Ditë vikendi |
| 5. | Analiza meteorologjike për kohën | -Mundësia për të ndodhur zjarre pyjore në këtë vit kalendarik është e madhe në Komunën e Prizrenit. Për çdo vitë kanë ndodhur zjarre pyjore, kurse nëse e marrim 10 vjeqarin e fundit kemi pasur më shumë zjarre në zona të ndryshme, që dmth se për çdo të dytin vit kemi pasur kërcënime nga zjarre pyjore. Zakonisht koha e paraqitjes së zjarreve pyjore është periudha kohore e temperaturave të larta gjatë muajve korrik – shtator.<br>Territori Komunës në kuptim klimatik i nënshtrohet ndikimin atmosferik kontinental dhe mediteran me qrast krijohet një jo stabilitet në reshjet e shiut dhe lagështisë së ajrit, ashtu që gjatë sezonës së verës në periudhën qershor – shtator ndikohet me thatësira dhe temperatura të larta, ku vlerat më të mëdha mesatare mujore arrijnë në muaj korrik dhe gusht ku vlera e tyre sillet nga 21.5 C deri në temperatura maksimale ditore 40 C. Si pasoj e thatësisë ekstreme në këtë sezon për pasoj kemi ndezjen e zjarrëve në territoreve të pyllëzuara, me qrast gëlltiten territore të mëdha me masa pyjore për një kohë të shkurtër nga zjarri. Zjarre pyjore me përmasa më të mëdha mund të kete në zonën e Hasit Pashtrikut, me çrast janë djegur dhjetëra hektar, ku dëme në pyje kanë arrite vlerat të konsiderueshme masë drunorë. Ndër shkaqet më të shpeshta të zjarreve pyjore përveç temperaturave të larta ka ndikuar pa përgjegjësia e faktorit njeri me shkaktimin e zjarreve nga pakujdesia |

| | | |
|---|---|---|
| | | apo me qëllim. |
| **6.** | Popullata | Numri i familjeve/shtepive të prekura nga zjarre pyjore në fshatin Planejë dhe fshatrat për rreth është 263 kurse numri i banorëve ishte 1121 banore , prej tyre:<br>➢ Fëmijë- 259<br>➢ Të moshuar dhe invalid:145<br>➢ Gra:359<br>➢ Meshkuj:358 |
| **7.** | Infrastruktura kritike egzistuese | ➢ Bazuar në kriteret e paracaktuara sipas urdhëresës administrative për rregullimin e infrastrukturës në zonën e përfshirë nga zjarri ka pasur dëme të vogla tek:<br>➢ Humbja e materialit druror dhe kullosa<br>➢ Humbja e prodhimeve tjera pyjore<br>➢ Dëmet dhe shqetsimi i faunës së egër<br>➢ Dëmtimi i pejsazhit natyror<br>➢ Përkeqësim i klimës lokale |
| **8.** | Gadishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut) | Në nivelin lokal- Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, Njësia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, Policia e Kosovës, Autoriteti Pyjor Komunal |

## Incidenti – ngjarja

| | |
|---|---|
| **Shkaku dhe shkaktari** | Shkaku dhe shkaktarë kryesor të shpërthimeve të zjarrit pyjore janë temperatura të larta gjatë muajve të stinës nga të cilatë vjenë deri tekë tharja e barishteve të cilat e mundësojnë zhvillimin dhe përhapjen e shpejt të zjarrit, thatësira, si dhe pakujdesia nga faktorit njeri. |
| Lokacioni | Planejë |
| Kushtet metorologjike | Moti i nxehtë, temperatura të larta dhe erërat të forta.<br>Është shumë e rëndësishme të dihet për vetë skenar dhe operacione emergjente kushtet atmosferike të cilat mbretërojnë gjatë periudhës kohore kur janë temperatura të larta, thatësirat, tereni i pa përshtatshëm, dhe erërat të forta, këto informata na ndihmojnë shumë për intervenim emergjente. |
| Periudha kohore | Muaji Korrik<br>Kushte atmosferike të cilat mbretërojnë në këtë periudhe kohore do të vështirësojnë operacione emergjente për shkak të temperaturave të larta, era të forta dhe tereni i pa përshtatshëm për intervenime. |

| | |
|---|---|
| Lloji i ditës | Ditë vikendi |
| Ora | 16.30 |
| Dendësija e popullatës | Zona pyjore është në një larëgsi nga fshati afro 450 m.<br>Është e rëndsishme të ceket se ky fshat i ka lagjet të shpërndara dhe nuk ka qendër urbane. |
| Lloji i terenit | Tereni është i thatë i vështir për intervenime i mbuluar me barishte të thata,shkurre dhe druj të shkurta. |
| Infrastruktura kritike | Pylli i mesëm halor |
| Kapaciteti reagues | Kapaciteti reagues në nivelin lokal janë: Drejtoria për Mbrojte dhe Shpëtim, Njësija Profisionale Zjarrëfiksave dhe Autoriteti Pyjor Komunal |
| Informacione tjera | Zjarri ka qenë i intensitetit të mesëm që rrezikonte vendbanime, ekipe emergjente, bagtit, florën dhe faunën dhe ka pasur ndikim negativ në ekonomi dhe mjedis duke marrë parasysh moshën 100 vjeçare të pyjeve. |

**Shkaku**

| | |
|---|---|
| Shkaktar i zjarrit | Shkaktar kryesor i shpërthimit të zjarrit është pakujdesja e ndezjes së zjarrit nga faktori njeri. |
| Ngjarja mesatare | Ngjarja mesatare është një skenar siq është paramenduar,ose siq ka ndodhur ndërsa të tjera mund të përshkruhen si “rasti më i keq”që është skenar i njejt mirëpo në disa kushte apo faktor rëndues të përfshirë. |
| Ngjarja primare | Ngjarja primare përfshin gabime njerzore, thatësira,temperatura të larta,përhapja e zjarrit me shpetësi të madhe për shkak të llojit të drunjve të shkurta dhe barnishteve të thata. |
| Ngjarja sekundare | Ngjarja sekondarë përfshin dëmtimin e florës dhe faunës, humbjet ekonomike, ndikim negativ mjedisor. |

**NGJARJA**

| | |
|---|---|
| Kohzgjatja e mundshme | Kohëzgjatja e mundshme është 3 ditë |
| Zona që kanë gjasa të goditen më së shumti | Zona e prekur e pyjeve të mesme në sipërfaqe rreth 100 ha.<br>Pasi që këto pyje janë në një reze të njëjtë ekziston mundësia që zjarri të përhapet në drejtim të Kojushë Mazrek dhe Gjonaj. |
| Modeli sezonal | Për shkak se ishte stina e verës me temperatura të larta ndikimi negativ dhe pasoja kanë qenë në nivel të lartë. |
| Shpejtësija e mundëshme e momentit fillestar | Janë kushte të njohura meteorologjikë që mund të ndikojnë shumë negativisht dhe të risin rrezikun e zjarreve pyjore pa supozuar lokacionin aktual andaj përgjigja fillon me njoftimin e parë për zjarrin nga njësit reaguese. |

| | |
|---|---|
| Sistemi ekzistues i paralajmrimit të hershëm | Sistemi ekzistues i paralajmërimit të hershëm është Instituti meteorologjik i Kosovës i cili dërgojnë njoftime mbi parashikimin e motit në QOE – 112 të AME-së për temperatura të larta komplekse dhe të pafavorshme për ditët në vijim njoftohen organet kompetentë shtetërorë, organe vendimmarrës të qeverisjes lokale dhe struktura për menagjimin e situatës së pritshme emergjente. |
| Ngjarja kryesore | Thelbi i skenarit i nxitur nga një sërë shkaqesh deri të pasojat.<br>Patrulla e Policisë e cila ishte duke vëzhguar terrenin e fshatit Planejë lajmëron SHZSH për një zjarrë i cili ka shpërthyer në kodrat e fshatit Planejë të cilët urgjentisht i përgjigjen lajmit për intervenim. Duke parë se zjarri me shpejtësi është duke depërtuar në drejtim të shtëpive të banimit tentohet të krijohet një bllokade natyrore-hapje shtigjeve për lokalizimin e zjarrit. Arrihet që zjarri pjesërisht të lokalizohet ndërsa nën ndikimin e erës së madhe ai shkon në drejtim të shtëpive të banimit me ç 'rast digjen 4 shtëpi në afërsi të malit, mirëpo me ndihmën e zjarre fikseve dhe vullnetarëve arrijnë të evakuohen banorët e këtij fshati të rrezikuar. Gjatë evakuimit 2 persona janë dërguar në qendrën medicinale pasi që ishin në gjendje të vështirë shëndetësore dhe për një person invalid duhet të sigurohet transport i veçantë. Përveç djegës së 4 shtëpive, 3 të tjera janë dëmtuar pjesërisht dhe duhet të sigurohet strehimi afatgjatë për 25 banorë të këtyre shtëpive ndërsa për të dëmtuarat duhet që të sigurohen mjetet financiare për riparimin e tyre. Për shkak të dëmtimit të 3 shtyllave elektrike fshati ka mbete 72 orë pa rrymë duke vështirësuar funksionimin normal të komunitetit. |
| Pasojat primare dhe efektet anësore | Humbje e pasurisë në objekte banimi ( pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara nga zjarri) Dëmtim i rrjetit elektrik lokal të prekura nga zjarri. Humbja e materialit drunor dhe kullosat. Humbja e prodhimeve tjera pyjore. Dëmtimi dhe shqetësimi i faunës së egër. Dëmtimi i peisazhit natyror. Përkeqësimi i klimës lokale. |

**Ndikimi- Indikatorët Tregues**

| | |
|---|---|
| Rastet me fatalitet | -Nuk ka pasur raste me fatalitet; |
| Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar; | Dy persona të lënduar |
| Mungesë e nevojave elementare | Furnizimet e nevojave themelore: ushqimit, veshë-mbathjes, shtrojë e mbulojë, mjeteve higjienike, energjia. |
| Të evakuuarit | 25 persona të evakuar , 1 person invalid. |

| | |
|---|---|
| Ndikimi i përgjithshëm ekonomik | - Dëmet në njerëz (shëndetësore: fizike, traumatike, psikologjike, etj) , të pa evidentuara;<br>- Dëmet e shkaktuara në objekte banimi (4 shtëpi të djegura dhe 3 shtëpi të dëmtuar nga zjarri). |
| Ndërprerjet në jetën e përgjithshme | - Ndërprerje e furnizimit me ujë të pijshëm,<br>- Funksionimi i infrastrukturës rrugore ( ndërprerje të akseve të caktuara rrugore apo kalim me vështirësi) |
| Humbje në trashëgimi kulturore | Jo |
| Implikime politike | Jo |
| Ndikimi i përgjithshëm | Rrezik i mesëm |
| Probiliteti-gjasat | |
| Probabiliteti | - Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësorë dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të mesëm të mundshëm. |
| Masat parand. gjatë periudhës së paralajmërimit të hershëm | -Pas marrjes së Paralajmërimit nga IHMK për parashikimin e motit (temperatura të larta dhe erërat të forta), ngritët gatishmëria e lartë për të papriturat dhe aktivizohet Planifikimi Kontingjent për zjarre pyjore si dhe ngritët gatishmëria e kapaciteteve humane dhe teknike të strukturave për mbrojtje dhe shpëtim; |

**Reagimi dhe rimëkëmbja**

| | |
|---|---|
| Koha e paralajmrimit | Disa orë |
| Masat parandaluese dhe pregaditore të zbatuara gjatë periudhës së paralajmrimit | Angazhimin e punëtorve në teren për vëzhgim dhe parandalim të shpërthimit të zjarreve . Të jetë në kontakt me qytetar dhe banorët e fshatrave në pjesët malore po ashtu edhe me barinjt të cilat i shfrytëzojnë këto pjesë malore për kullosa të bagtive për informimin e pasojave, dëmeve dhe rreziqet nga zjarret. Të vendosen shenjat për mos përdorimin e zjarrit të hapur në vend pikniqe dhe vende më të rizikuara për shpërthimin e zjarreve.<br>Në rastë të shpërthimit të zjarreve të informoj njësin zjarrfikëse me kohë për intervenim sa më të shpejtë për lokalizimin e zjarrit dhe mosëpërhapjes së tijë.<br>Të sigurohen të dhëna për pjesët më të rrezikuara nga shpërthimi i zjarrit.<br>Të bëhet sigurimi i makinave për hapjen e rrugëve për depërtimin e |

| | |
|---|---|
| | automjeteve zjarrfikëse dhe formimin e brezave mbrojtëse.<br>Të evidentohen burimet e ujrave në teren për furnizim të mundshëm të zjarrfikësve.<br>Gjith ashtu, në bazë të vlerësimit të gjendjes të përforcohen patrullimet dhe vëzhgimet në teren të përgjegjësisë dhe për ngjarjet eventuale me kohë ta informoni njësin e zjarrfikësve, Stacionin policor ose Qendrën Operative 112 , për angazhimin e mundshëm të NJPZSH-ve të tjera për këtë ngjarje. |
| Kohë zgjatja e pritur e ngjarjes | Disa javë |
| Nevoja për kordinim | Kordinimi ndërmjet Agjencive përkatëse - AME, APK, ISH, shërbimet e reagimit emergjent, FSK. |

**Matrica 4:** ***Pasqyron rrezikun e përgjithshëm***






Hartezimi i Skenarit i të zjarreve pyjore

**Vlerësimi i pasojës:** Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut -Të dhënat për numrin e banorëve të rrezikuar janë marrë në bazë të të dhënave të mbledhura nga terreni nga Komisioni i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësia, për fat të mirë nuk ka pasur viktima, -Përveç kërcënimit të drejtpërdrejtë gjatë incidentit, vlerësohet si një përkeqësim afatgjatë i kushteve të jetesë në zonën e prekur nga zjarri;

***Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut:***

| Kategorizimi: | Pasojat: | Kriteret: | I përcaktuar: |
|---|---|---|---|
| 1 | Të vogla/ minimale | < 50% | X |
| 2 | Të vogla | 50 - 200 | |
| 3 | Mesatare | 201 - 500 | |
| 4 | Kritike | 501-1500 | |
| 5 | Katastrofike | > 1500 | |

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

-Dëmet materiale në ekonomi familjare janë vlerësuar në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë vlerën: 105 000.00 €.

***Pasqyrimi i pasojave në ekonomi***

| Kategorizimi | Pasojat | Kriteret | Përcaktimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Të papërfillshme | < 3% GDP | X |
| 2 | Të vogla | 3 - 5% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5- 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 10-15% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >15% GDP | |

**Skenari 2 i Zjarrëve Malore**

| **Emri i skenarit** | Zjarre malore |
|---|---|

Frekuenca e ndodhjes: Prevalla dhe fshati Gornjasellë

x☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );

☐ E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);

☐ Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);

☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);

Madhësia e mundshme:

☐ E papërfillshme (më pak se 10%) **X☐ E kufizuar( 10 deri 25%)**

☐ Kritike: 25 deri 50% . ☐ Katastrofike: Më shumë se 50%

Lloji i skenarit: Zjarre malore

☐ Skenari 1**;** **X☐ Skenari 2;** ☐ Skenari 3;

Ndikimi:

☐ I papërfillshëm; ☐ I vogël ; X ☐ I mesëm ; ☐ Katastrofike;

Data e vlerësimit:

14/08/2024

**KONTEKSTI**

| **Nr. rend.** | **Parametrat:** | **Përmbajtja:** |
|---|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| 1. | Vendi i ngjarjes (lokacioni) | Vendet më të rrezikuara nga zjarre pyjore është Prevalla dhe fshati Gornjasellë |
| 2. | Kushtet meteorologjike | Temperatura të larta dhe erërat e forta. |
| 3 | Periudha e vitit: | Gusht 2024 |
| 4 | Lloji i ditës: | Ditë pune dhe vikendi |
| 5. | Analiza meteorologjike për kohën | -Mundësia për të ndodhur zjarre pyjore në këtë vit kalendarik është e madhe në Komunën e Prizrenit. Për çdo vitë kanë ndodhur zjarre pyjore, kurse nëse e marrim 10 vjeqarin e fundit kemi pasur më shumë zjarre në zona të ndryshme, që dmth se për çdo të dytin vit kemi pasur kërcënime nga zjarre pyjore. Zakonisht koha e paraqitjes së zjarreve pyjore është periudha kohore e temperaturave të larta gjatë muajve korrik – shtator.<br><br>Territori Komunës në kuptim klimatik i nënshtrohet ndikimin atmosferik kontinental dhe mediteran me qrast krijohet një jo stabilitet në reshjet e shiut dhe lagështisë së ajrit, ashtu që gjatë sezonës së verës në periudhën qershor – shtator ndikohet me thatësira dhe temperatura të larta, ku vlerat më të mëdha mesatare mujore arrijnë në muaj korrik dhe gusht ku vlera e tyre sillet nga 21.5 C deri në temperatura maksimale ditore 40 C. Si pasoj e thatësisë ekstreme në këtë sezon për pasoj kemi ndezjen zjarrëve në territoret e pyllëzuara, me qrast gëlltiten territore të mëdha me masa pyjore për një kohë të shkurtër nga zjarri. Zjarre pyjore me përmasa më të mëdha mund të kete në zonën e Prevallës, me çrast janë djegur dhjetëra hektar, ku dëme në pyje kanë arrite vlerat të konsiderueshme masë drunorë. Ndër shkaqet më të shpeshta të zjarreve pyjore përveç temperaturave të larta ka ndikuar pa përgjegjësia e faktorit njeri me shkaktimin e zjarreve nga pakujdesia apo me qëllim. |
| **6.** | Popullata | Numri i familjeve/shtepive të prekura nga zjarre pyjore në Prevallë është rreth është 120 kurse numri i banorëve ishte 350 banore , prej tyre:<br>➢ Fëmijë- 85<br>➢ Të moshuar dhe invalid:60<br>➢ Gra:102<br>➢ Meshkuj:103 |
| **7.** | Infrastruktura kritike egzistuese | Bazuar në kriteret e paracaktuara sipas urdhëresës administrative për rregullimin e infrastrukturës në zonën e përfshirë nga Zjarri ka pasur infrastukturë e cila ka pasur pasoja në këtë zonë.<br>➢ 3 Shtylla elektrike<br>➢ Humbja e materialit druror dhe kullosa<br>➢ Humbja e prodhimeve tjera pyjore<br>➢ Dëmet dhe shqetsimi i faunës së egër<br>➢ Dëmtimi i pejsazhit natyror<br>➢ Përkeqësim i klimës lokale |

| | | |
|---|---|---|
| **8.** | Gadishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut) | Në nivelin lokal- Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, Njësia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, Policia e Kosovës, Autoriteti Pyjor Komunal janë në gadishmeri, por Gjendja mundë të përkeqësohet, pasi sipas njoftimeve të Instituti Hidrometeorologjik të Kosovës, mund të ketë edhe erëra të cilat e favorizojnë përhapjen e zjarrit; |

## Incidenti – ngjarja

| | |
|---|---|
| **Shkaku dhe shkaktari** | Shkaku dhe shkaktarë kryesor të shpërthimeve të zjarrit pyjore janë temperatura të larta gjatë muajve të stinës së verës nga të cilatë vjenë deri tekë tharja e barishteve të cilat e mundësojnë zhvillimin dhe përhapjen e shpejt të zjarrit, thatësira, si dhe pakujdesia nga faktorit njeri. |
| Lokacioni | Prevallë dhe Gornjasellë |
| Kushtet metorologjike | Moti i nxehtë, temperatura të larta dhe erërat të forta.<br>Është shumë e rëndësishme të dihet për vetë skenar dhe operacione emergjente kushtet atmosferike të cilat mbretërojnë gjatë periudhës kohore kur janë temperatura të larta, thatësirat, tereni i pa përshtatshëm, dhe erërat të forta, këto informata na ndihmojnë shumë për intervenim emergjente. |
| Periudha kohore | Muaji gusht 2024<br>Kushte atmosferike të cilat mbretërojnë në këtë periudhe kohore do të vështirësojnë operacione emergjente për shkak të temperaturave të larta, era të forta dhe tereni i pa përshtatshëm për intervenime. |
| Lloji i ditës | Ditë pune |
| Ora | 16.30 |
| Dendësija e popullatës | Zona pyjore është në një largësi nga fshati afro 100 m. dhe lartësia mbidetare afër 1450 metra<br>Është e rëndsishme të ceket se kjo zone është e dendur me ndërtesa |
| Lloji i terenit | Tereni është i thatë i vështir për intervenime i mbuluar me barishte të thata,shkurre dhe druj të shkurta. |
| Infrastruktura kritike | Pylli i mesëm halor |
| Kapaciteti reagues | Kapaciteti reagues në nivelin lokal janë: Drejtoria për Mbrojte dhe Shpëtim, Njësija Profisionale Zjarrëfiksave dhe Autoriteti Pyjor Komunal |
| Informacione tjera | Zjarri ka qenë i intensitetit të mesëm që rrezikonte vendbanime, ekipe emergjente, bagtit, florën dhe faunën dhe ka pasur ndikim negativ në ekonomi dhe mjedis duke marrë parasysh moshën 100 vjeçare të pyjeve. |

## Shkaku

| | |
|---|---|
| Shkaktar i zjarrit | Shkaktar kryesor i shpërthimit të zjarrit është pakujdesija e ndezjes së zjarrit nga faktori njeri. |

| | |
|---|---|
| Ngjarja mesatare | Ngjarja mesatare është një skenar siq është paramenduar,ose siq ka ndodhur ndërsa të tjera mund të përshkruhen si “rasti më i keq”që është skenar i njejt mirëpo në disa kushte apo faktor rëndues të përfshirë. |
| **Ngjarja primare** | Ngjarja primare përfshin gabime njerzore, thatësira,temperatura të larta,përhapja e zjarrit me shpetësi të madhe për shkak të llojit të drunjve të shkurta dhe barnishteve të thata. |
| **Ngjarja sekundare** | Ngjarja sekondarë përfshin dëmtimin e florës dhe faunës, humbjet ekonomike, ndikim negativ mjedisor. |

**NGJARJA**

| | |
|---|---|
| Kohzgjatja e mundshme | Kohe zgjatja e mundshme është 5 ditë |
| Zona që kanë gjasa të goditen më së shumti | Zona e prekur e pyjeve të mesme në sipërfaqe rreth 300 ha.<br>Pasi që këto pyje janë në një reze të njëjtë ekziston mundësia që zjarri të përhapet në drejtim të pyjëve të komunës së Shtërpcës. |
| Modeli sezonal | Për shkak se ishte stina e verës me temperatura të larta ndikimi negativ dhe pasoja kanë qenë në nivel të lartë. |
| Shpejtësija e mundëshme e momentit fillestar | Janë kushte të njohura meteorologjikë që mund të ndikojnë shumë negativisht dhe të risin rrezikun e zjarreve pyjore pa supozuar lokacionin aktual andaj përgjigjja fillon me njoftimin e parë për zjarrin nga njësit reaguese. |
| Sistemi ekzistues i paralajmrimit të hershëm | Sistemi ekzistues i paralajmërimit të hershëm është Instituti meteorologjik i Kosovës i cili dërgojnë njoftime mbi parashikimin e motit në QOE – 112 të AME-së për temperatura të larta komplekse dhe të pafavorshme për ditët në vijim njoftohen organet kompetentë shtetërorë, organe vendimmarrës të qeverisjes lokale dhe struktura për menagjimin e situatës së pritshme emergjente. |
| Ngjarja kryesore | Thelbi i skenarit i nxitur nga një sërë shkaqesh deri të pasojat.<br>Patrulla e Policisë e cila ishte duke vëzhguar terrenin zonën e Prevallës lajmëron SHZSH për një zjarrë i cili ka shpërthyer në malet e Prevallës të cilët urgjentisht i përgjigjen lajmit për intervenim. Duke parë se zjarri me shpejtësi është duke depërtuar në drejtim të shtëpive të banimit tentohet të krijohet një bllokade natyrore-hapje shtigjeve për lokalizimin e zjarrit. Arrihet që zjarri pjesërisht të lokalizohet ndërsa nën ndikimin e erës së madhe ai shkon në drejtim të shtëpive të banimit me ç 'rast digjen 6 shtëpi në afërsi të malit, mirëpo me ndihmën e zjarrë fiksëve dhe vullnetarëve arrijnë të evakuohen banorët dhe turistet e kësaj zonë të rrezikuar. Gjatë evakuimit 3 persona janë dërguar në qendrën medicinale pasi që ishin në gjendje të vështirë shëndetësore dhe për një person invalid duhet të sigurohet transport i veçantë. Përveç djegës së 6 shtëpive, 3 të tjera janë dëmtuar pjesërisht dhe duhet të sigurohet strehimi afatgjatë për 30 banorë të këtyre shtëpive ndërsa për të dëmtuarat duhet që të sigurohen mjetet financiare për riparimin e tyre. Për shkak të dëmtimit të 5 shtyllave elektrike zona ka mbetë 72 orë pa rrymë duke vështirësuar funksionimin normal të komunitetit. |

| | |
|---|---|
| Pasojat primare dhe efektet anësore | Humbje e pasurisë në objekte banimi ( pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara nga zjarri) Dëmtim i rrjetit elektrik lokal të prekura nga zjarri. Humbja e materialit drunor dhe kullosat. Humbja e prodhimeve tjera pyjore. Dëmtimi dhe shqetësimi i faunës së egër. Dëmtimi i peisazhit natyror. Përkeqësimi i klimës lokale. |

**Ndikimi- Indikatorët Tregues**

| | |
|---|---|
| **Rastet me fatalitet** | **-Nuk ka pasur raste me fatalitet;** |
| **Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar;** | Dy persona të lënduar |
| **Mungesë e nevojave elementare** | Furnizimet e nevojave themelore: ushqimit, veshë-mbathjes, shtrojë e mbulojë, mjeteve higjienike, energjia. |
| **Të evakuuarit** | 30 persona të evakuar , 1 person invalid. |
| **Ndikimi i përgjithshëm ekonomik** | - Dëmet në njerëz (shëndetësore: fizike, traumatike, psikologjike, etj) , të pa evidentuara; Dëmet e shkaktuara në objekte banimi (4 shtëpi të djegura dhe 3 shtëpi të dëmtuar nga zjarri). |
| **Ndërprerjet në jetën e përgjithshme** | - Ndërprerje e furnizimit me ujë të pijshëm,<br>- Funksionimi i infrastrukturës rrugore ( ndërprerje të akseve të caktuara rrugore apo kalim me vështirësi) |
| **Humbje në trashëgimi kulturore** | Jo |
| **Implikime politike** | Jo |
| **Ndikimi i përgjithshëm** | Rrezik i mesëm |
| **Probiliteti-gjasat** | |
| **Probabiliteti** | - Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësorë dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të mesëm të mundshëm. |

| | |
|---|---|
| **Masat parand. gjatë periudhës së paralajmërimit të hershëm** | -Pas marrjes së Paralajmërimit nga IHMK për parashikimin e motit (temperatura të larta dhe erërat të forta), ngritët gatishmëria e lartë për të papriturat dhe aktivizohet Planifikimi Kontingjent për zjarre pyjore si dhe ngritët gatishmëria e kapaciteteve humane dhe teknike të strukturave për mbrojtje dhe shpëtim; |

**Reagimi dhe rimëkëmbja**

| | |
|---|---|
| **Koha e paralajmërimit** | **Disa orë** |
| **Masat parandaluese dhe pregaditore të zbatuara gjatë periudhës së paralajmrimit** | Angazhimin e punëtorve në teren për vëzhgim dhe parandalim të shpërthimit të zjarreve . Të jetë në kontakt me qytetar dhe banorët e fshatrave në pjesët malore po ashtu edhe me barinjt të cilat i shfrytëzojnë këto pjesë malore për kullosa të bagëtive për informimin e pasojave, dëmeve dhe rreziqet nga zjarrët.<br><br>Të vendosen shënjat për mos përdorimin e zjarrit të hapur në vend pikniqe dhe vende më të rizikuara për shpërthimin e zjarrëve.<br><br>Në rastë të shpërthimit të zjarreve të informoj njësin zjarrfikëse me kohë për intervenim sa më të shpejtë për lokalizimin e zjarrit dhe mosëpërhapjes së tijë. Të sigurohen të dhëna për pjesët më të rrezikuara nga shpërthimi i zjarrit. Të bëhet sigurimi i makinave për hapjen e rrugëve për depërtimin e automjeteve zjarrfikëse dhe formimin e brezave mbrojtëse.<br><br>Të evidentohen burimet e ujrave në teren për furnizim të mundshëm të zjarrfikësve. Gjithë ashtu, në bazë të vlerësimit të gjendjes të përforcohen patrullimet dhe vëzhgimet në teren të përgjegjësisë dhe për ngjarjet eventuale me kohë ta informoni njësin e zjarrfikësve, Stacionin policor ose Qendrën Operative 112 , për angazhimin e mundshëm të NJPZSH-ve të tjera për këtë ngjarje. |
| **Kohë zgjatja e pritur e ngjarjes** | Disa ditë |
| **Nevoja për kordinim** | Kordinimi ndërmjet Agjencive përkatëse - AME, APK, ISH, shërbimet e reagimit emergjent, FSK por edhe KFOR |

**Vlerësimi i pasojës:**

Matrica 1: *Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut:*




**Matrica 2:** ***Rreziku për pasojat në ekonomi:***

Matrica



3: *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social– dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:*




**Matrica 4:** ***Pasqyron rrezikun e përgjithshëm***

\



**Vlerësimi i pasojës:** Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut -Të dhënat për numrin e banorëve të rrezikuar janë marrë në bazë të të dhënave të mbledhura nga terreni nga Komisioni i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësia, për fat të mirë nuk ka pasur viktima, -Përveç kërcënimit të drejtpërdrejtë gjatë incidentit, vlerësohet si një përkeqësim afatgjatë i kushteve të jetesë në zonën e prekur nga zjarri;

***Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut:***

| Kategorizimi: | Pasojat: | Kriteret: | I përcaktuar: |
|---|---|---|---|
| 1 | Të vogla/ minimale | < 50% | |
| 2 | Të vogla | 50 - 200 | X |
| 3 | Mesatare | 201 - 500 | |
| 4 | Kritike | 501-1500 | |
| 5 | Katastrofike | > 1500 | |

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

-Dëmet materiale në ekonomi familjare janë vlerësuar në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë vlerën: 300 000.00 €.

***Pasqyrimi i pasojave në ekonomi***

| Kategorizimi | Pasojat | Kriteret | Përcaktimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Të papërfillshme | < 3% GDP | |
| 2 | Të vogla | 3 - 5% GDP | X |
| 3 | Mesatare | 5- 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 10-15% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >15% GDP | |




Hartezimi i Skenarit II të zjarreve pyjore

**Skenarit 3 i zjarreve**

| | |
|---|---|
| Emri i skenarit | Zjarr në zonën industriale-tregtare Prizren |
| Frekuenca e ndodhjes: Qyteti i Prizrenit | |
| x☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );<br>☐ E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);<br>☐ Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);<br>☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); | |
| Madhësia e mundshme: | |
| ☐ E papërfillshme (më pak se 10%) ☐ E kufizuar( 10 deri 25%)<br>☐ Kritike: 25 deri 50% . X Katastrofike: Më shumë se 50% | |
| Lloji i skenarit: Zjarr në zonën industriale-tregtare Prizren | |
| ☐ Skenari 1; ☐ Skenari 2; X☐ Skenari 3; | |
| Ndikimi: | |
| ☐ I papërfillshëm; ☐ I vogël ; ☐ I mesëm ; X Katastrofike; | |
| Data e vlerësimit: 10/08/2024 | |
| KONTEKSTI | |

| Nr. rend. | Parametrat: | Përmbajtja: |
|---|---|---|
| 1. | Vendi i ngjarjes (lokacioni) | Zjarr në zonën industriale-tregtare të qytetit të Prizrenit |
| 2. | Kushtet meteorologjike | Temperatura të larta , Më 02.08.2024, në orën 10:30, në qendrën tregtare Galeria (Abi çarshia), ka shpërther zjarr. Personeli i qendrës përmes telefonit ka njoftuar njësinë zjarrëfikse e cila në kohën prej 10 minutave ka qenë në vendin e incidentit dhe ka filluar operimin për shuarjen e zjarrit. Në vendin e incidentit ka dal policia e cila ka vendosur perimetrin e sigurisë |
| 3 | Periudha e vitit: | Gusht 2024 |
| 4 | Lloji i ditës: | Ditë pune |
| 5. | Analiza meteorologjike për kohën | Ditë vere, temperatura 30 gradë, favorizon pëhapjen e zjarrit dhe vështirëson ndërhyrjen e njësive të Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit. |
| 6. | Popullata | ➢ Zona urbane e qytetit, incidenti i ndodhur ka ndikim direkt në mbi 3.000 banorë |
| 7. | Infrastruktura kritike egzistuese | ➢ Bazuar në kriteret e paracaktuara sipas urdhëresës administrative për rregullimin e infrastrukturës në zonën e përfshirë nga zjarri, nuk ka pasur dëme në infrastukturë publike. |
| 8. | Gadishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut) | Pas njoftimit nga personeli i qendrës tregëtare për shpërthimin e zjarrit, DMSH, ka dalur në terren për të vëzhguar situatën, dhe pas informacioneve të grumbulluara nga komandanti i njësisë së zjarrëfikësve, nga qendra 112, Drejtoria dhe Policia e Kosovës, ka bërë vlersimin e situatës, ku ka vlerësuar:<br>1. Gjendja është e nivelit “të ashpër” me tendencë të përkeqësohet në nivelin “katastrofë”, pasi një numër i qytetarëve dhe punëtorëve të qendrës nuk kanë arritur të dalin jashtë.<br>Në parkingun e qendrës tregëtare ndodhën të parkuara rreth 50 vetura.<br>Në kohën e shpërthimit të zjarrtit, brenda qendrës kanë qenë rreth 200 persona, një pjesë të moshuar dhe fëmijë.<br>Pas vlerësimit, DMSH ka njoftuar kryetarin e komunës për gjendjen dhe i ka rekomanduar për aktivizimin e QOE komunale.<br>Eshtë kontaktuar Ministria e Punëve të Brendëshme, me qëllim të njoftimit për përmasat e incidentit dhe gadishmërinë për intervenim |

**Incidenti – ngjarja**

| | |
|---|---|
| Shkaku dhe shkaktari | Nga faktorë të pa identifikuar ende, në njërën nga depot e qendrës tregëtare, ka shpërthyer zjarr, i cili ka filluar të përhapet me shpejtësi. Zjarri është përhapur me shpejtësi, dhe deri në kohën e arritjes së njësive NjZSH, ka përfshirë pjesën më të madhe të sipërfaqes së objektit. |

| | |
|---|---|
| Ngjarja kryesore | Më: 02.08.2024, ka shpërthyer zjarri në qendrën tregëtare Galeria, të cilin, në mungesë të pajisjeve adekuate dhe të njohurive, personeli nuk ka arritur që ta parandaloi përhapjen. Zjarri ka përfshirë pjesën më të madhe të depove dhe hapësirës komerciale. -Janë ndërmarrë masat për shuarjen e zjarrit: 1. NjZSH me dy njësi ka filluar operacionin e shuarjes në dy drejtime, mirëpo për shkak se pjesa më e madhe e mallrave që ndodhën në objekt përbëhen nga materjali që ndizet lehët, zjarri ka marr përmasa të mëdha dhe kapacitetet e zjarrëfikësve janë të pa mjaftueshme për t'u përballur me incidentin. 2. Krahas shuarjes, po zhvillohet edhe operacioni i kërkim – shpëtimit të personave të mbetur brenda obektit, ku një pjesë e tyre janë asfiksuar dhe një pjesë janë përfshirë nga zjarri. Në këtë fazë janë 2 persona të vdekur dhe 13 me lëndime të rëda.<br><br>Në vendin e incidentit kanë ardhur edhe njësitet e ndihmës mjekësore, të cilët në një hapësirë të sigurtë, po reanimojnë personat e asfiksuar dhe po i transportojnë për në qendrën spitalore.<br><br>Veturat e policisë dhe të qytetarëve privat po shftytëzohen për të transportuar persona me lëndime më të lehëta.<br><br>Kryetari i Komunës ka marr vendim që të aktivizohet QOE e komunës dhe kanë filluar aktivitetet për koordinimi e operacioneve.<br><br>Përmes 112, është kërkuar ndihëm nga komunat fqinje si dhe gadishmëri të institucioneve qeveritare. |
| Pasojat primare dhe efektet anësore | Dy persona të vdekur dhe rreth 13 të plagosur<br><br>Janë djegur plotësisht depot dhe pjesa më e madhe e hapësires komerciale<br><br>Janë djegur 15 vetura të klienteve. |

Ndikimi- Indikatorët Tregues

| | |
|---|---|
| Rastet me fatalitet | -Dy persona të vdekur dhe 13 të plagosur |
| Mungesë e nevojave elementare | Si pasojë e këtij zjarri: Janë ndërprerë përkohësisht aktivitetet ditore të banorëve në zonën e incidentit |
| Të evakuuarit | Gjatë kohës së intervenimit, NJZSH dhe Policia e Kosovës, kanë kryer veprime operacionale: -U evakuan 150 persona dhe 35 vetura. |

| | |
|---|---|
| Ndikimi i përgjithshëm ekonomik | Dëmet e shkaktuara në: - Vlera e përafërt e dëmeve të përllogaritura = mbi 5.000.000 €. |
| Ndërprerjet në jetën e përgjithshme | - Funksionimi i infrastrukturës rrugore ( ndërprerje të akseve të caktuara rrugore apo kalim me vështirësi) |
| Humbje në trashëgimi kulturore | Jo |
| Implikime politike | Jo |
| Ndikimi i përgjithshëm | Rrezik "katastrofë" |
| Probiliteti-gjasat | |
| Probabiliteti | Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësorë dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit "Katastrofë", duke marrë për bazë të dhënat historike, |
| Masat parand. gjatë periudhës së paralajmërimit të hershëm | Inspektorët në vazhdimësi kanë gjobitur ndërmarrjen për mosrespektim të masave kundër zjarrit të parapara me ligj. |

Reagimi dhe rimëkëmbja

| | |
|---|---|
| Koha e paralajmërimit | Disa orë |
| Masat parandaluese dhe pregaditore të zbatuara gjatë periudhës së paralajmrimit | Angazhimin e punëtorve në teren për vëzhgim dhe parandalim të shpërthimit të zjarreve . Të jetë në kontakt me qytetar dhe banorët e fshatrave në pjesët malore po ashtu edhe me barinjt të cilat i shfrytëzojnë këto pjesë malore për kullosa të bagtive për informimin e pasojave, dëmeve dhe rreziqet nga zjarret.<br>Të vendosen shenjat për mos përdorimin e zjarrit të hapur në vend pikniqe dhe vende më të rizikuara për shpërthimin e zjarreve.<br>Në rastë të shpërthimit të zjarreve të informoj njësin zjarrfikëse me kohë për intervenim sa më të shpejtë për lokalizimin e zjarrit dhe mosëpërhapjes së tijë. Të sigurohen të dhëna për pjesët më të rrezikuara nga shpërthimi i zjarrit. Të bëhet sigurimi i makinave për hapjen e rrugëve për depërtimin e automjeteve zjarrfikëse dhe formimin e brezave mbrojtëse.<br>Të evidentohen burimet e ujrave në teren për furnizim të mundshëm të zjarrfikësve. Gjithë ashtu, në bazë të vlerësimit të gjendjes të përforcohen patrullimet dhe vëzhgimet në teren të përgjegjësisë dhe për ngjarjet eventuale me kohë ta informoni njësin e zjarrfikësve, Stacionin policor ose Qendrën Operative 112 , për angazhimin e mundshëm të NJPZSH-ve të tjera për këtë |

| | |
|---|---|
| | ngjarje. |
| Kohë zgjatja  e pritur e ngjarjes | Faza akute e kësaj ngjarje ka zgjatur deri në orën 13:00 të datës 02.08.2024, në orën 14:00 zjarri është shuar. -Sipas vlerësimeve nga terreni, koha e parashikuar e nevojshme për sanim të gjendjes është rreth 2 muaj |
| Nevoja për kordinim | Bazuar në informacionet nga terreni për rritjen e intensitetit të zjarrit, është aktivizuar QOE e komunale dhe Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim, i cili kryesohet nga Kryetari i Komunës apo i deleguari i tij. -Koordinimi i aktiviteteve nga niveli qendror deri tek ai lokal dhe anasjelltas bëhet përmes QOE -112 në nivel rajonal; -Menaxhim dhe koordinim i situatës është bërë nga QOE komunale – DMSH sipas Planit të Reagimit Emergjent të Komunës së Prizrenit |

**Vlerësimi i pasojës:**

Matrica 1: *Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut:*



**Matrica 2:** ***Rreziku për pasojat në ekonomi:***




Matrica 3: *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social– dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:*



**Matrica 4:** ***Pasqyron rrezikun e  përgjithshëm***




**Vlerësimi i pasojës:** Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut -Të dhënat për numrin e banorëve të rrezikuar janë marrë në bazë të të dhënave të mbledhura nga terreni nga Komisioni i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësia, ku ka pasur viktima,

***Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut:***

| **Kategorizimi:** | **Pasojat:** | **Kriteret:** | **I përcaktuar:** |
|---|---|---|---|
| 1 | Të vogla/ minimale | < 50% | |
| 2 | Të vogla | 50 - 200 | |
| 3 | Mesatare | 201 - 500 | |
| 4 | Kritike | 501-1500 | |
| 5 | Katastrofike | > 1500 | X |

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

-Dëmet materiale janë vlerësuar në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë vlerën: 5,000 000.00 €.

***Pasqyrimi i pasojave në ekonomi***

| Kategorizimi | Pasojat | Kriteret | Përcaktimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Të papërfillshme | < 3% GDP | |
| 2 | Të vogla | 3 - 5% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5- 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 10-15% GDP | X |
| 5 | Katastrofike | >15% GDP | |

Hartezimi i Skenarit III të zjarreve Industriale / tregtare



## 6.6. TËRMETET

### 6.6.1. Karakteristikat sizmike të zonave dhe rreziku sizmik

Tërmeti pasqyron përplasjen/luhatjen e pllakave të tokës si pasojë e lirimit të energjisë së brendshme të tokës. Nga pikëpamja sizmologjike territori i Komunës sonë paraqet aktivitet sizmik relativisht të lartë, i cili është goditur në të kaluarën dhe mund të goditet edhe në të ardhmen nga tërmetet e forta. Territori i Komunës sonë, në të kaluaren është përfshirë nga një mori tërmetesh të cilat përgjithësisht kanë pasur karakter autokton, ku si karakteristikë e veqantë mund të themi se janë vatrat e cekëta, të cilat gjenerohen në afërsi të korës së tokës, maksimumi i thellësisë së vatrave mund të jetë 15 - 20 km thellë në nëntokë. Studimet e sizmicitetit varen shumë nga informacioni që disponohet nga plotësia dhe besueshmëria e të dhënave mbi tërmetet që paraqiten në katalogun e tërmeteve.

### 6.6.2. Vendbanimet e rrezikuara , numri dhe struktura e banorëve

Pasi që tërmetet janë dridhje të shkurta dhe të pa pritura të sipërfaqes së tokës, atëher mund të themi se është i rrezikuar i tërë territori i komunës së Prizrenit.

### 6.6.3. Rrezikshmëria e zonave të caktuara

- Ngjarjet sizmike tregojnë se brenda 20 viteve të fundit vendi ynë është goditur me tërmete me magnitude mesatare, me madhësi të vogël dhe nuk ka pasur viktima njerëzore dhe dëme materiale.
- Zonat me densitet të lartë të popullsisë (zonat e caktuara me dendësi të madhe janë Qyteti i Prizrenit duke përfshirë lagjen Arbana dhe Lubizhda si pjese urbane, pastaj fshati Zhur, Korishë,Piranë etj.
- Zonat e caktuara të objekteve me ndërtime të dobëta në aspektin e kualitetit të materialit ndërtimor;
- Zonat e pastudjuara në aspektin e fizibilitetit dhe qëndrueshmërisë së tokës, etj.;

### 6.6.4. Shpeshtësia, intensiteti dhe epiqendra e tërmetit (dridhjeve)

Si rezultat i burimeve nga shërbimet sizmologjike në vend dhe rajon, sidomos nga Instituti Sizmologjik i Kosovës, egzistojnë të dhëna më të plota për tërmetet që kanë prekur territorin e Kosovës që nga periudha kohore, nga vitet 1900 kurse të dhënat/informacionet e mëhershme janë mjaft të pakta. Këto tërmete që kanë prekur teritorin e Kosovës, ku më shumë e ku më pak kanë goditur edhe komunën tonë. Ndër tërmetet më të fuqishme që kanë goditur vendin tonë , në 20 vitet e fundit mund të përmendim:

1. Tërmeti i Gjilanit 24.04.2002, **Mag.5.7, intensiteti VIII**
2. Tërmeti i Istogut 10.03.2010, **Mag.5.2, intensiteti VII**
3. Tërmeti i Vushtrrisë 18.11.2013, **Mag.4.8, intensiteti VI**

*Tab. Nr 55 Disa nga tërmetet më të forta që kanë goditur teritorin e Kosovës ndër vite!*

| Location of earth. | Magnitude | Intensity |
|---|---|---|
| Prizreni 1456 | MS=6.1 | VIII1/2 |
| Peja 1662 | MW=6.0 | VIII1/2 |
| Ferizaj-Viti 1921 | M l=6.1 | IX |
| Viti 1921 | Ml = 5.4; | VIII |
| Gjilan 1921 | Ml = 5.0; | VIII |
| Kaçanik-Viti 1921 | Ml = 5.6 | VIII |
| Gjakova 1922 | Ml = 5.3 | VII1/2 |
| Prizren 1945 | Ml = 5.0 | VII |
| Klinë 1947 | Ml = 5.2 | VIII |
| Kopaonik 1980 | MW=5.7 | VIII |
| Gjilani 2002 | MW=5.7 | VII-VIII |
| Istog 2010 | Ml = 5.2 | VII |
| Vushtrri 2013 | MI=4.8 | VI |

### 6.6.5. Pasojat e tërmeteve

Komuna e Prizrenit nuk ka ndonje raport zyrtar për vlerësimin e demeve të shkaktuara nga Termetet.

#### Masat parandaluese;

-Ndërmarrja e masave parandaluese, me qëllim të zvogëlimit/zbutjes së rrezikut sizmik janë e vetmja mënyrë efektive për t'u mbrojtur nga tërmetet:

- Rregullat për ndërtime seizmike;
- Ligje dhe rregullore bashkëkohore për ndërtimet sipas Eurokode 8;
- Mbikqyrjen strikte të zbatimit të rregulloreve;
- Kontrollet periodike të hartave sizmike;
- Implementimi i studimit të mikro-zonimit për secilin qytet ( Zona urbane);
- Për të rritur sigurinë sizmike, mund të ndërmerren disa masa specifike dhe aspekte të rëndësishme:

**Konstruksioni i ndërtesave:**

- Përdorimi i materialeve dhe teknikave të ndërtimit që përmirësojnë qëndrueshmërinë.
- Zbatimi i kodeve të ndërtimit që parashikojnë masat sizmike.

**Forcimi i strukturave ekzistuese:**

- Rishikimi dhe forca e ndërtesave të vjetra që nuk i përmbushin standardet sizmike.
- Përdorimi i teknologjive moderne si shtesa në bazat e ndërtesave.

**Edukimi dhe trajnimi:**

- Organizimi i trajnimeve për inxhinierët dhe arkitektët mbi dizajnin sizmik.
- Informimi i publikut për masat që duhet të marrë gjatë një tërmeti.

**Planifikimi i emergjencave:**

- Hartimi i planeve të emergjencës për të përballuar situatat sizmike.
- Kryerja e stërvitjeve për të testuar efikasitetin e këtyre planeve.

**Infrastruktura publike:**

- Sigurimi që urat, rrugët dhe sistemet e transportit të jenë të qëndrueshme ndaj tërmeteve.
- Modernizimi i objekteve publike dhe shërbimeve kritike.

**Monitorimi dhe hulumtimi:**

- Investimi në teknologji për monitorimin e aktivitetit sizmik.
- Mbështetje për kërkime që eksplorojnë mënyra për të përmirësuar qëndrueshmërinë sizmike.
- Implementimi i këtyre masave kërkon bashkëpunim midis qeverisë, profesionistëve të ndërtimit, dhe komuniteteve lokale për të siguruar një ambient të sigurt ndaj rreziqeve sizmike.

Hartat sizmike:




Harta nr 40 Harta e sizmicitetit për teritorin e Kosovës , Epiqendrat e tërmeteve me magnitudë ≥ 3.5, Periudha 1456-2021, aneksi i hartave, faqe 41




Zonat kryesore burimore sizmike:

1. Zona sizmogjene Prizren-Pejë;
2. Zona sizmogjene Ferizaj-Viti –Gjilan;
3. Zona sizmogjene e Kopaunikut;

Harta nr 41 Harta e rrezikut sizmik për teritorin e kosovës, viti 2009, aneksi i hartave, faqe 42




Harta nr. 41 Zonat e popullūara të ekspozuara në zonat sizmike, aneksi i hartave, faqe 43

## Skenari (Tërmeti)

Tërmeti pasqyron luhatjen e pllakave të tokës, të nxitura nga shkaqe natyrore ose artificiale e që janë pasojë e lirimit të brendshëm të energjisë së tokës.

***TËRMETET Skenari 1***

| **Emri i skenarit:** | ***Skenari 1* – Tërmetet** |
|---|---|
| **Frekuenca e ndodhjes:** | |
| **☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );**<br>**☐E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);**<br>**x Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);**<br>**☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);** | |

| |
|---|
| **Madhësia e mundshme:** |
| ☐ **E papërfillshme (më pak se 10%)** x☐ **E kufizuar( 10 deri 25%)**<br>☐ **Kritike: 25 deri 50% .** ☐ **Katastrofike: Më shumë se 50%** |
| **Lloji i skenarit:** |
| **x ☐ Skenari 1;** ☐ **Skenari 2;** ☐ **Skenari 3;** |
| **Ndikimi:** |
| ☐ **I papërfillshëm;** **x ☐ I vogël ;** ☐ **I mesëm ;** ☐ **Katastrofike;** |
| **Data e vlerësimit:** |
| **18.03.2022** |

***Konteksti***

| **Parametrat:** | **Përmbajtja:** |
|---|---|
| Vendi i ngjarjes (lokacioni) | Komuna e Prizrenit , vendet më të rrezikuara nga Tërmetet janë vendbanimet: Zhur, Shkozë, Vërmicë, Dobrushë, Lokacioni është 11 km ne jug-perëndim te Prizrenit |
| Kushtet meteorologjike | Regjioni i Prizrenit është përfshirë nga një tërmet. Edhe pse tërmeti ishte i intenzitetit të ulët, temperaturat e ulta bënë që qytetarët ta përballojnë me vështërsi situatën e krijuar nga paniku. |
| Periudha e vitit: | **18.03.2022** |
| Lloji i ditës: | Ditë pune |
| Popullata | Numri i familjeve të prekura nga lëkundjet e tërmetit , janë 1745 familje kurse numri i banorëve ishte 7853, prej tyre:<br>➢ Fëmijë: 2310<br>➢ Te tjerë 5543 (2771 Burra 2772 Gra),<br>➢ Të moshuar: 405 të Moshuar mbi 65 vjeç |
| Infrastruktura kritike ekzistuese | Bazuar në kriteret e paracaktuara sipas urdhëresës administrative për rregullimin e infrastrukturës në zonën e përfshirë nga Tërmeti, ka pasur infrastrukture e cila ka pasur pasoja në këtë zonë.<br>➢ Rruga magjistrale Prizren – Kukës<br>➢ Autostrada Kosovë - Shqipëri<br>➢ Urat standarde,<br>➢ Sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit |

| | |
|---|---|
| Gatishmëria për menaxh. e rrezikut) | Në nivelin lokal- Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, Njësia Profesionale e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, Policia e Kosovës, Shërbimet Emergjente Mjekësore, Kryqi i Kuq dhe kompani të kontraktuara nga Komuna e Prizrenit për intervenime emergjente gjatë fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. |
| Info plotësuese | Në bazë të vlerëmit të gjendjes në terren, situata është e përballueshme nga njësitë emergjente komunale dhe nuk është e nevojshme të fillohet procedurae shpalljes së gjendjes emergjente. |

**INCIDENTI-NGJARJA**

| | |
|---|---|
| Shkaku dhe shkaktari | Nga lëkundjet intensive të tërmetit gjatë orëve të paradites të datës 18.03.2022, nga qytetarët e Prizrenit, kemi marrë informacion se në këtë lokalitet janë shkaktuar Lëkundje të forta.<br>-Shkaqet e termetit mund te jene te ndryshme si: Kufijtë e Pllakave Tektonike:<br>• Kufijtë e Ngjitjes: Kur dy pllaka ngjiten njëra me tjetrën, krijohen tensione të mëdha që mund të shpërthejnë në formën e një tërmete.<br>• Kufijtë e Lëvizjes: Kur pllakat kalojnë njëra mbi tjetrën, kjo lëvizje mund të shkaktojë tensione dhe shpërthime që çojnë në tërmete.<br>• Kufijtë e Shkëputjes: Kur pllakat janë të ndara nga njëra-tjetra, ndodhin lëvizje të papritura që mund të shkaktojnë tërmete. |
| Pasojat primare dhe efektet anësore | -Humbje e pasurisë në objekte banimi ( pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara nga termeti);<br>-Dëmtim i Infrastrukturës rrugore, rrugë të dëmtuara në lokalitete të prekura nga Tërmeti;<br>- Dëmtim i Infrastrukturës kritike ( sistemi i ujësjellësit, sistemi energjetik);<br>- Shtëpi/ndërtesa te qara dhe te dëmtuar<br>-Vlera e përgjithshme e përllogaritur e dëmit : 1.600.000.00 €. |

**NDIKIMI- INDIKATORËT TREGUES**

| | |
|---|---|
| Rastet me fatalitet | -Nuk ka pasur raste me fatalitet. |
| Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar | - Janë lënduar lehtë afër 15 përsona. |
| Mungesë<br>e nevojave elementare | - Si pasojë e tërmetit kemi dëmtime të rrugëve dhe të ndërtesave të vjetra;<br>- Punëtorët nuk mund të shkojnë në punë, fëmijët në shkolla;<br>- Mungesa e ujit të pijshëm, etj. |
| Të evokuarit | - Nuk kemi pasur raste për evakuim. |

| | |
|---|---|
| Ndikimi i përgjithshëm ekonomik | - Dëmet në njerëz (shëndetësore: fizike, traumatike, psikologjike, etj), të pa evidentuara;<br>- Dëmet e shkaktuara në ndërtesa ( rreth 230 ndërtesa), të përllogaritura: 1.600.000.00 €;<br>- Vlera e përafërt e dëmeve të përllogaritura është: 1.600.000.00 €. |
| Ndërprerjet në jetën e përgjithshme | - Ndërprerje e furnizimit me ujë të pijshëm;<br>- Funksionimi i infrastrukturës rrugore( ndërprerje të akseve të caktuara rrugore apo kalim me vështirësi). |
| Humbje në trashëgimi kulturore | Jo. |
| Implikime politike | Jo. |
| Ndikimi i përgjithshëm | Rrezik i vogël. |

**PROBABILITETI-GJASAT**

| | |
|---|---|
| Probabiliteti | - Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësor dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të mesëm të mundshëm, duke marrë për bazë të dhënat historike. |
| Kohëzgjatja e ngjarjes | -Faza akute ka zgjatur shkurt disa sekonda;<br>-Koha e nevojshme për sanim të gjendjes është rreth 3 muaj. |
| Koordinimi | Koordinimi i aktiviteteve nga niveli qendror deri tek ai lokal dhe anasjelltas bëhet përmes QOE -112 në nivel rajonal;<br>-Duhet të bëhet aktivizimi i Komisionit lokal për mbledhjen e të dhënave mbi vlerësimin e dëmeve në terren të shkaktuara nga fatkeqësia /termeti, të përcaktojë gjendjen aktuale faktike në terren, duke bërë vlerësimin e dëmeve dhe raportimin në komisionin qeveritar;<br>- Komisioni Qendror, bashkon raportet e komisioneve lokale dhe bën verifikimin e vërtetësisë së dëmeve të vlerësuara nga komisionet lokale dhe këtë raport ia dorëzon Qeverisë së RK-së për shqyrtim dhe miratim;<br>-Raportin e miratuar nga qeveria ia dorëzon Agjencisë/DKMSh-së në afat prej 15 ditësh;<br>- Është dhënë ndihma nga shteti dhe persona të tjerë juridikë e fizikë për popullatën brenda mundësive dhe kapaciteteve; |

| Probabiliteti / frekuenca | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Kategorizimi | Cilësia | Probabiliteti/gjasat | Frekuenca | Përcaktimi |
| 1 | E papërfillshme/E pamundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 2 | E vogël/E pabesueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në 20 deri 100 vjet | X |
| 3 | Mesatare/E mundur | 6-50 % | 1 ngjarje në 2 deri 20 vjet | |
| 4 | E madhe /Gati e mundur | 51-98 % | 1 ngjarje në 1 deri 2 vjet | |
| 5 | Jashtëzakonisht e madhe / E mundur | >98 % | 1 ngjarje në vit apo më shpesh | |

**Vlerësimi i pasojës:**

Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut

-Të dhënat për numrin e banorëve të rrezikuar janë marrë në bazë të të dhënave të mbledhura nga terreni nga Komisioni i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë, për fat të mirë nuk ka pasur viktima, por duke pasur parasysh numrin e banorëve në nevojë, rrezikun dhe pasojat, vërshimet vlerësohen (përllogariten) si mjaft serioze.

-Përveç kërcënimit të drejtpërdrejtë nga termeti, vlerësohet si një përkeqësim afatgjatë i standardit jetësor në zonën së prekur.

***Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut:***

| Kategorizimi: | Pasojat: | Kriteret: | I përcaktuar: |
|---|---|---|---|
| 1 | Të vogla/ minimale | < 50% | |
| 2 | Të vogla | 50 - 200 | X |
| 03 | Mesatare | 201 - 500 | |
| 4 | Kritike | 501-1500 | |
| 5 | Katastrofike | > 500 | |

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

-Dëmet materiale në ekonomi familjare dhe biznese janë vlerësuar në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë vlerën: 1.600.000.00 €.

-Dëmet materiale në infrastrukturë janë vlerësuar në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë vlerën: 500 000 €.

***Pasqyrimi i pasojave në ekonomi***

| Kategorizimi | Pasojat | Kriteret | Përcaktimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Të papërfillshme | < 3% GDP | |
| 2 | Të vogla | 3 - 5% GDP | X |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 3 | Mesatare | 5- 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 10-15% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >15% GDP | |

**Matrica e gjasës: *Nivelet e fatkeqësive:***

Shkalla e ashpërsisë

| | |
|---|---|
| 5 | Veprim katastrofik – (rrezik nr. 15 – 25) |
| 4 | Prioritet i ashpër – (rrezik nr. 10 – 12) |
| 3 | Prioritet mesatar – (rrezik nr. 5 – 9) |
| 2 | Prioritet i mbrojtur – (rrezik nr. 2 – 4) |
| 1 | Prioritet i ulët – (rrezik nr. 1) nuk kërkohet veprim |

Matrica 1: *Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut:*



**Matrica 2:** ***Rreziku për pasojat në ekonomi:***




Matrica 3: *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:*



**Matrica 4:** ***Pasqyron rrezikun e përgjithshëm***





Lëkundja është ndjerë dhe ka qenë me magnitudë 4.4 të shkallës Rihter.
Epiqendra e tërmetit ka qenë 11 kilometra në Jug-perëndim të Prizrenit.
Janë shkaktuar dëme materiale por jo viktima në Njerëz.







Hartëzimi i skenarit I – Zona ku ka ndodhur tërmeti

## 6.7. RRËSHQITJET DHE EROZIONET

### 6.7.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonave potenciale të rrëshqitjes dhe erozioneve

Erozioni është njëri nga faktorët ekzogjen që duhet trajtuar për shkak se rrezikon sipërfaqet bujqësore, infrastrukturën, por edhe begatitë e krijuara dhe të planifikuara nga faktori antropogjen. Kjo dukuri është prezente pothuajse në tërë territorin e komunës së Prizrenit, në forma dhe madhësi të ndryshme. Një rol të rëndësishëm në përshpejtimin e tij, në shumë raste, e ka luajtur edhe faktori antropogjen si rezultat i mosshfrytëzimit racional të tokave bujqësore, të prerjes së pakontrolluar të pyjeve, por edhe gjatë shfrytëzimit të pakontrolluar të materialeve inerte dhe ndërtimore. Më tepër është prezent mbi formacionet molasike, si rezultat i degradimit të pyjeve, vegjetacionit dhe pjerrtësisë së terrenit dhe paraqitet në formë të shpërlajeve sipërfaqësore, lugjeve rrëkenore, por edhe përgjatë brigjeve të shtretërve të lumenjve, e përrenjve, etj.

### 6.7.2. Kushtet klimatike, intensitetin, shpeshtësinë e paraqitjes;

Klima ndikon në shumë fenomene e veprimtari të rëndësishme në jetën e përditshme të njeriut, si në shtrirjen e vendbanimeve, në tipin e ndërtesave, në lokalizimin e bujqësisë, industrisë, turizmit, komunikacion etj. [4]
Klima e Prizrenit është e ndryshueshme kontinentale me një ndikim të lehtë të klimës mesdhetare në pjesët më të ulëta të Rrafshit të Dukagjinit në jugperëndim, ndërsa në male dominon klima malore. Klima mesdhetare vjen nga deti Adriatik nëpërmjet të luginës së Drinit të Bardhë. Ajo ndihmon në kultivimin e rrushit dhe frutave e perimeve tjera.
Pozita gjeografike, largësia prej bregdetit (vetëm 105 km), lartësia mbidetare, ekspozicioni, ndikojnë drejtpërdrejtë në klimën e Komunës së Prizrenit.

Rëndësi të madhe në shtrirjen e vendbanimeve dhe infrastrukturës rrugore ka klima, duke i njohur elementet meteorologjike, si diellëzimi, temperatura, reshjet, erërat etj., mundëson një vendbanim të vendoset në ato shpate ku kemi ekspozicion jugor, të vendoset në atë mënyrë që të evitohen erërat lokale veriore etj.

Elementet kryesore meteorologjike që mundësojnë njohjen më të mirë të klimës në Komunën e Prizrenit janë: diellëzimi, temperatura, reshjet, lagështia e ajrit, erërat, të cilët janë trajtuar më poshtë. **Sasitë e të reshurave**: në rajonin e Prizrenit sillen rreth 620,9 mm, ndërsa.

Reshjet, pas temperaturës janë elementi më i rëndësishëm i klimës. Reshjet atmosferike ndikojnë në kushtet hidrologjike, mbulesën bimore, pamjen e peizazhit, varësisht nga sasia, intensiteti, regjimi pluviometrik dhe tipi, kanë ndikim të rëndësishëm për mjedisin jetësor dhe për aktivitetet njerëzore. Në regjimin pluviometrik në Prizren ndikim më të madh kanë aktivitetet ciklonike, të cilat manifestohet me depërtimin nga rajoni i Mesdheut. Mesatarja vjetore e reshjeve në Prizren është 620.9 mm. Mesatarja

[4] R. Pllana, Klima e Kosovës, ASHAK, Prishtinë 2015, fq 12

më e lartë e reshjeve në Prizren është regjistruar në vitin 1937 me gjithsej 1.554 mm reshje, ndërsa më e ulët është regjistruar në vitin 1953 me gjithsej 458 mm reshje.[5]

### 6.7.3. Zonat e rrezikuara nga rrëshqitjet dhe erozioni, numri i banorëve, objekteve, lloji i tyre, pasqyra e lokacioneve kritike;

**Zonat e rrezikuara nga rrëshqitja dhe erozioni janë të prezantuar në hartën 42 në aneks 1.**

*Harta 42:* Zonat e rrezikuara nga rrëshqitja dhe erozioni *(burimi i te dhënave Instituti për hidroekonomi"Jaroslav çerni" Beograd 1981)*

### 6.7.4. Përshkrimi i strukturave gjeologjike të tokës (rrëshqitjet aktive dhe pasive);

Komuna e Prizrenit është mjaft interesante sa i përket gjeologjisë së saj, aspektit tektonik, petrologjisë dhe pasurisë me minerale.

Prizreni ka shkëmbinj të moshave dhe litologjisë së ndryshme. Shkëmbinjtë më të vjetër datojnë nga Paleozoiku, Permiani, Triasiku i hershëm dhe i vonshëm, Jurasik, Kretaku, Neogjeni dhe Kuaternari. Shkëmbinjtë e Paleozoikut formojnë majat e larta të Maleve Kuqibaba, Konjusha e Madhe, Nikolla e Zeze, pjesët e basenit të Lumit të Brodit etj. Këta shkëmbinj janë formuar nga rreshpet kristalin, graniti, migmatitet e granitit etj.

Granitet – janë shkëmbinjtë acidike magmatike që gjenden në kurorat e Kuqibabës dhe në Lumbardhë. Shkëmbinjtë Permian – Triasik – gjenden në afërsi të Lubiqevës, Jeshkovë dhe Reqan. Këto shkëmbinj formohen nga sedimentet e pelitit psamit pas një metamorfoze të dobët. Shkëmbinjtë e Mezozoikut.

Shkëmbinjtë e Triasikut – sedimentet karbonike të triasikut të mesëm dhe të vonshëm formojnë masivet e Maleve të Korritnikut, Cvilenit dhe luginën e Lumëbardhit. Shkëmbinjtë e Triasikut përfaqësohen nga gurët masive gëlqerore me shtresa të trasha, mermer dhe dolomit me ngjyrë të përhimët kah e kuqja.

Shkëmbinjtë e Jurasikut – rrethojnë brezin e përmendur të shkëmbinjve të Triasikut në jug të fshatit Nashec dhe pjesët tjera të regjionit. Përfaqësues i këtyre shkëmbinjve është melanzhi olistromik.

Shkëmbinjtë e Kretakut – përfaqësohen nga sedimentet senoniane, të pasuara nga Turoniane dhe më pak nga senomaniane.

Senomanian –sedimentet e senomanianit formojnë majat e larta të Pashtrikut. Ato shtrihen në formë transgresive mbi melanzhin e Jurasikut. Turonian – sedimentet e Turonianit gjenden në pjerrinat e Pashtrikut dhe janë formuar gradualisht nga gëlqeret e senomanianit. Trashësia e kësaj shtrese është 150 – 200 m

Senonian – sedimentet e senonianit gjendën nën pjesët e pjerrëta të Pashtrikut dhe janë formuar gradualisht nga sedimentet e turonianit dhe janë shpërndarë në afërsi të fshatit Mazrek, Zym dhe Dedaj. Nivelet e larta të senonianit janë kryesisht të përbërë nga peliti dhe gëlqeret me globturkana. Këto sedimente formojnë hipuritet dhe janë të trasha 600m.

Shkëmbinjtë e Kenozoikut

[5] R. Pllana, Klima e Kosovës, ASHAK, Prishtinë, 2015, f.180

Sedimentet e Pliocenit – përfaqësohen nga sedimentet e pliocenit të mesëm dhe të vonshëm që formojnë regjionin e ngushtë të fshatit Gjonaj. Rezervat kryesore të këtyre shkëmbinjve gjenden në pjesën e rrafshët të Prizrenit, në jug të luginës së Dukagjinit. Ato janë kryesisht të mbuluar me sedimentet e kuaternarit. Në afërsi të Krushës së madhe, Landovicës dhe Randobravës, këta shkëmbinj janë kryesisht të mbuluar dhe formohen nga rëra, argjila dhe zhavorri. Në bazë të studimeve, del se shtresat e thella të pliocenit dominohen nga argjila psamite dhe pelite deri në fund të kretakut të vonshëm ku janë gjetur shtresa të qymyrit.

Sedimentet e Pliocenit në Prizren kanë ruajtur zgjatimin e tyre parësor, respektivisht kanë shtrirje horizontale dhe një trashësi prej afro 350 m. Në fshatin Gjonaj janë gjetur dy horizonte të qymyrit.

Sedimentet e kuaternarit – përfaqësohen nga sedimentet e liqeve dhe të teracave të lumenjve të Pleistocenit si dhe nga depozitat proluviale të terra rosa dhe aluvialet e Holocenit.

Sedimentet e liqeve – gjenden në jug të fshatit Nashec dhe luginën e Prizrenit.

Terra Rosa është e zhvilluar në shkëmbinjtë e Kretakut në gropat e vogla të luginave karstike siç është rasti me fshatin Zym. Trashësia e tyre është 100 m.

Sedimentet aluviale – janë kryesisht të koncentruar në shtratin e Drinit të Bardhë dhe përfaqësohen nga materialet argjilore, rëra dhe zhavorri.

**Tektonika** Sa i përket tektonikës së Prizrenit dhe regjionit, ekzistojnë disa mendime dhe hipoteza për shkak të mungesës së të dhënave stratigrafike si dhe komplikimeve me njësitë gjeotektonike. Kjo ka rezultuar me diskutimet e hapura dhe mos kompletimin e të dhënave tektonike të regjionit. Në nivel regjional, pjesa më e madhe e territorit është e ndërtuar nga formacionet eugeosinklinale që i përkasin njësive gjeotektonike të Korabit dhe Mirditës. Struktura më impozante është ajo e Pashtrikut e përbërë nga shkëmbinjtë e Kretakut të vendosura mbi shkëmbinjtë e Jurasikut që formojnë bazën e saj. Sinklinali i Pashtrikut zgjatet nga juglindja deri në veri lindje. Krahët e sinklinalit dallohen për nga pjerrësia e butë e shtresave (20-300) dhe strukturat e rrudhosura të nivelit të dytë në krahët e strukturës kryesore.

***Burimet e mineraleve dhe mineralizimi***

Ndërtimi gjeologjik dhe tektonik i Komunës së Prizrenit është indikatori kryesor për pritjet e vendndodhjeve të burimeve të mineraleve. Ky territor është i njohur me burimet e mineraleve të dobishme në të kaluarën.

Burimet e mineraleve metalike.

Burimet e kromit lidhen me shkëmbinjtë bazike dhe ultra bazike të Korishës dhe Mushutishtit.

Mineralet magnetike të hekurit ndërlidhen me seritë e rreshpeve amfibolite që janë në kontakt të drejtpërdrejtë të serpentineve të Greikocit. Piriti dhe halkopiriti është gjetur në fshatin Lubizhdë. Bakri ndërlidhet me formacionet e kuarcit-porfirinës.

### 6.7.5. Sipërfaqet e përfshira;

Territori i komunës së Prizrenit karakterizohet me pjesëmarrje të sipërfaqeve erozive sipas këtyre kategorive: Sipërfaqet të cilat i janë nënshtruar erozionit shumë të dobët kapin një hapësirë prej 15% të territorit të kësaj komune. Këto sipërfaqe shtrihen kryesisht në pjesën rrafshinore të komunës së Prizrenit, përkatësisht në

lokalitetet Prizren,Pirane,Zojz , Petrovë etj. Këto siperfaqe shtrihen në reliev të ulët. Territoret me erozion të dobët kapin sipërfaqe afër 21 % te territorit të komunës se Prizrenit. Shtrihen në pjesën qendrore të komunës dhe përfshijnë vendbanimet: Atmaxhe , Tupec, Vlashnje, Nebregoshte,Lubinjë e Poshtme, Mushnikovë, Gornjaselle, Pllamjan. Erozioni i mesëm shtrihet në sipërfaqe prej 36% të territorit të komunës se Prizrenit . Ka shtrirje të madhe në hapësirë. Ky lloj erozioni shtrihet kryesisht në vendbanimet: Randobravë, Zym, Dedaj, Kushnin, Kabash i Hasit, Mazrek, Kojushe,Planeje,Muradem,Milaj, Poslishte,Billushe, Hoqe e Qytetit, Manastirice, Stredske , Kabash, Korishë, Skorobishtë, Novosellë, Lubizhdë, Verbiçan etj.

Hapësirat me erozion të fortë në komunën e Prizrenit kapin sipërfaqe prej 11 % të territorit te komunës se Prizrenit . Shtrirje më të madhe ka në lokalitetet Shkoze,Zhur,Vërmice, Zhivinjan, Reçan, Struzhë etj. Ndikimet më të larta erozive janë në viset e larta, në toka të zhveshura, me rreth 10% janë të përshtatshme për pyllëzim.

Tab 56. Sipëfaqet sipsa kategorisë së Erozionit

| Kategoria erosive | sip-ha |
|---|---|
| **Sipërfaqet pa erosion** | **4291.3** |
| **Erozion shumë i dobët** | **9258** |
| **Erozion i dobët** | **13110.7** |
| **Erozion i mesëm** | **22613.1** |
| **Erozion I forte** | **6796.5** |
| **Erozion shumë i forte** | **6588.5** |

Graf. 29 Sipëfaqet sipsa kategorisë së Erozionit



### 6.7.6. Pasojat nga rrëshqitjet dhe erozionet;

Duke marë për bazë kushtet fiziko-gjeologjike, përbërjen litologjike të kores së tokës, kushtet klimatologjike dhe faktorët e tjerë, të cilët kanë ndikim në krijimin e shembjeve dhe të erozionit të tokës, është vlerësuar se një dukuri e tillë nuk eshtë e theksuar në përmasa të mëdha në komunën e Prizrenit. Megjithatë, viteve të fundit, ka ndodhje të fenomeneve të tilla për shkak të ndërrimeve klimatike. Kategoria me erozion shum i fortë është me e theksuar sidomos në rajonin e Zhupës (rruga Prizren – Prevallë) gjithashtu në fshatin Nebregoshte ka pasur rrëshqitje të dheut dhe janë të rrezikuara disa ekonomi familjare, komuna duhet të marr masa parandaluese.

Këtu janë disa prej pasojave kryesore të këtyre fenomeneve natyrore:

1. Dëme ndaj jetës dhe pronës:

Rrëshqitjet e dheut: Mund të shkaktojnë dëme të mëdha ndaj ndërtesave, rrugëve, infrastrukturës dhe jetës njerëzore. Shtëpitë që janë të vendosura në zona të pasigurta mund të shkatërrohen plotësisht, duke shkaktuar humbje të jetëve dhe dëme ekonomike të mëdha.

Erozioni i tokës: Mund të shkatërrojë parcela bujqësore, duke reduktuar mundësitë e prodhimit bujqësor dhe duke shkaktuar humbje të rëndësishme të pasurive natyrore.

2. Përkeqësimi i infrastrukturës:

Rrëshqitjet dhe erozioni mund të shkatërrojnë rrugët, urat dhe rrjetet e tjera të infrastrukturës, duke vështirësuar transportin dhe qasjen në zona të caktuara.

Shkatërrimi i sistemeve ujësjellës dhe kanalizimeve: Erozioni mund të ndikojë negativisht në sisteme të tilla, duke shkaktuar probleme me furnizimin me ujë dhe pastrimin e ujërave të ndotura.

3. Shkatërrimi i pasurive natyrore dhe monumenteve historike:

Shkatërrimi i monumenteve dhe objekteve historike: Rrëshqitjet dhe erozioni mund të shkaktojnë dëme të mëdha në monumentet kulturore dhe historike, siç janë kështjellat, objektet fetare, dhe vendet arkeologjike.

Në përfundim, pasojat e rrëshqitjeve dhe erozionit janë shumëdimensionale dhe kërkojnë masa parandaluese dhe ndërhyrje urgjente për të mbrojtur jetën e njerëzve, pasuritë natyrore dhe infrastrukturën.

### Masat parandaluese

Me qëllim të pengimit të krijimit të ndodhjeve të vërshimeve, shembjeve dhe erozionit në territorin e komunës së Prizrenit, përgjatë rrjedhës së lumenjve dhe të përrenjve, të cilët përshkojnë këtë territor, e me qëllim të pengimit të ndodhjeve emergjente, e ruajtjes së tokave bujqësore, ruajtjes së ambientit dhe ruajtjes së shëndetit të njërzve e ruajtjen e pasurisë së tyre, Drejtoria për Menaxhimin e Emergjencave, propozon që të ndërmeren këto masa preventive të domosdoshme:

1. Kërkimi i mundësive financiare për rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe mbrojtjeve anësore të brigjeve të tyre, me qëllim të ruajtjes së tokave bujqësore, të akseve rrugore dhe të urave;

2. Pastrimi i shtretërve të lumenjve nga mbeturinat;

3. Ndalimi i hedhjes së mbeturinave përgjatë rrjedhës së tyre;

4. Ndalimi i shfrytëzimit pa kriter të rërës dhe të zhavorit nga shtretërit e lumenjve;

5. Ndërtimi i pendave për pengimin e gërryrjes së shtratit të lumenjve dhe ndaljen e bartjes së rërës, zhavorit, gurëve dhe materialit tjetër që bartin rrymat e ujit;

6. Ndalimi i prerjes së drunjve përgjatë brigjeve të lumenjve;

7. Mbjellja e bimësisë përgjatë brigjeve;

8. Pastrimi i shtretërve të lumenjve nga bimësia e cila ka mbirë vetvetiu (shelgje, verra etj), të cilat pengojnë rrjedhën normale të lumit;

9. Mbushja e pjerrtësisë së brigjeve të lumenjve me mjete natyrore dhe artificiale;

10. Pastrimi i pendave në shtretërit e lumenjve dhe përrenjve nga gurët, zhavori, rëra dhe materiali tjetër;

11. Si dhe masa të tjera që do të propozoheshin nga Drejtoria e Bujqësisë, Urbanizmit dhe Ndërmarrja Hidro-ekonomike;

12. Mosrespektimi i normave teknike të punëve dhe me rastin e ndërtimit të objekteve ndërtimore, si dhe masat e ndalimit të ndërtimit të objekteve ndërtimore në zonat të cilat janë evidentuar si terrene jo -stabile;

13. Gjithashtu, ndalimi me ligj i punëve; nuk sanksionohen sipas normave ligjore, që edhe më tepër rëndon dhe komplikon situatën.

14. Inspektimi në terren i objekteve të evidentuara në këtë vlerësim nga inspektorët komunalë të urbanizmit, bujqësisë dhe ambientit dhe propozimi i masave sanuese dhe sanksionuese.

## Harta e rreziqeve

*Harta 42: Zonat e rrezikuara nga rrëshqitja dhe erozioni në komunën e Prizrenit, Shih aneksin 1 faqe 44, Burimi i te dhënave- Plani hapësinor i Kosovës 2010-2020+*

**Skenari 1 i Erozionit**

| **Parametrat:** | **Përmbajtja:** |
|---|---|
| Vendi i ngjarjes (lokacioni) | Vendbanimi Kushnin |
| Kushtet meteorologjike | Reshje Shiu |
| Periudha e vitit: | **18.02.2022** |
| Lloji i ditës: | Ditë vikendi |

| | |
|---|---|
| Popullata | Numri i familjeve të prekura - rrezikuar nga Erozioni , janë 20 familje kurse numri i banorëve ishte 80, prej tyre:<br>➢ Fëmijë: 15<br>➢ Te tjerë 49 (25 Burra 24 Gra),<br>➢ Të moshuar: 16 të Moshuar mbi 65 vjeç |
| Infrastruktura kritike ekzistuese | Bazuar në kriteret e paracaktuara sipas urdhëresës administrative për rregullimin e infrastrukturës në zonën e përfshirë nga Erozioni, ka pasur infrastrukture e cila ka pasur pasoja në këtë zonë.<br>➢ Rruga e fshatit që të dërgon te shkolla<br>➢ Shkolla e fshatit<br>➢ Sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit |
| Gatishmëria për menaxh. e rrezikut) | Në nivelin lokal- Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, Njësia Profesionale e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, Policia e Kosovës, Shërbimet Emergjente Mjekësore, Kryqi i Kuq dhe kompani të kontraktuara nga Komuna e Prizrenit për intervenime emergjente gjatë fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. |
| Info plotësuese | |

| | |
|---|---|
| Shkaku dhe shkaktari | Nga reshjet qe kane ndodhur ka pasur rrëshqitje të tokës gjatë orëve të paradites të datës 18.02.2022, nga qytetarët e Kushninit, kemi marrë informacion se në këtë lokalitet janë shkaktuar rrëshqitje të dheut.<br>-**Shkaqet e rrëshqitjes mund të jenë të ndryshme si: reshjet e mëdha si dhe terreni i pjerrët në afërsi të zonës së banuar të fshatit Kushnin.** |
| Pasojat primare dhe efektet anësore | -Humbje e pasurisë në objekte banimi ( pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara nga erozioni , rrëshqitja e dheut);<br>-Dëmtim i Infrastrukturës rrugore, rrugë të dëmtuara në lokalitete të prekura nga Rreshqitja;<br>- Dëmtim i Infrastrukturës kritike ( sistemi i ujësjellësit, sistemi energjetik);<br>- Rrugë të bllokuar<br>-Vlera e përgjithshme e përllogaritur e dëmit 200.000.00 €. |

**NDIKIMI- INDIKATORËT TREGUES**

| | |
|---|---|
| Rastet me fatalitet | -Nuk ka pasur raste me fatalitet. |
| Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar | - Janë lënduar lehtë afër 3 përsona. |

| | |
|---|---|
| Mungesë<br><br>e nevojave elementare | - Si pasojë e erozionit kemi dëmtime të rrugëve dhe të ndërtesave të vjetra;<br><br>- banoret e zonës janë bllokuar, Punëtorët nuk mund të shkojnë në punë, fëmijët në shkolla; Mungesa e ujit të pijshëm, etj. |
| Të evokuarit | - Nuk kemi pasur raste për evakuim. |
| Ndikimi i përgjithshëm ekonomik | - Disa raste të lëndimeve të njerëzve (shëndetësore: fizike, traumatike, psikologjike, etj),<br><br>të pa evidentuara;<br><br>- Dëmet e vogla të shkaktuara në ndërtesa ( rreth 20 ndërtesa), të<br><br>përllogaritura: 200.000.00 €;<br><br>- Vlera e përafërt e dëmeve të përllogaritura është: 200.000.00 €. |
| Ndërprerjet në jetën e përgjithshme | - Ndërprerje e furnizimit me ujë të pijshëm;<br><br>- Funksionimi i infrastrukturës rrugore( ndërprerje të akseve të<br><br>caktuara rrugore apo kalim me vështirësi). |
| Humbje në trashëgimi kulturore | Jo. |
| Implikime politike | Jo. |
| Ndikimi i përgjithshëm | Rrezik i vogël |

**PROBABILITETI-GJASAT**

| | |
|---|---|
| Probabiliteti | - Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësor dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të mesëm të mundshëm, duke marrë për bazë të dhënat historike. |
| Kohëzgjatja e ngjarjes | -Faza akute ka zgjatur shkurt disa minuta;<br><br>-Koha e nevojshme për sanim të gjendjes është rreth 3 ditë. |
| Koordinimi | Koordinimi i aktiviteteve nga niveli qendror deri tek ai lokal dhe anasjelltas bëhet përmes QOE - 112 në nivel rajonal;<br><br>-Duhet të bëhet aktivizimi i Komisionit lokal për mbledhjen e të dhënave mbi vlerësimin e dëmeve në terren të shkaktuara nga fatkeqësia /Erozioni, të përcaktojë gjendjen aktuale faktike në terren, duke bërë vlerësimin e dëmeve dhe raportimin në komisionin qeveritar;<br><br>- Komisioni Qendror, bashkon raportet e komisioneve lokale dhe bën verifikimin e vërtetësisë së dëmeve të vlerësuara nga komisionet lokale dhe këtë raport ia dorëzon Qeverisë së RK-së për shqyrtim dhe miratim;<br><br>-Raportin e miratuar nga qeveria ia dorëzon Agjencisë/DKMSh-së në afat prej 15 ditësh;<br><br>- Është dhënë ndihma nga shteti dhe persona të tjerë juridikë e fizikë për popullatën brenda mundësive dhe kapaciteteve; |

| Probabiliteti / frekuenca | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Kategorizimi | Cilësia | Probabiliteti/gjasat | Frekuenca | Përcaktimi |
| 1 | E papërfillshme/E pamundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet | |
| 2 | E vogël/E pabesueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në 20 deri 100 vjet | X |
| 3 | Mesatare/E mundur | 6-50 % | 1 ngjarje në 2 deri 20 vjet | |
| 4 | E madhe /Gati e mundur | 51-98 % | 1 ngjarje në 1 deri 2 vjet | |
| 5 | Jashtëzakonisht e madhe / E mundur | >98 % | 1 ngjarje në vit apo më shpesh | |

**Vlerësimi i pasojës:**

Matrica 1: *Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut:*



**Matrica 2:** ***Rreziku për pasojat në ekonomi:***




Matrica

3: *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social– dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:*



**Matrica 4:** ***Pasqyron rrezikun e  përgjithshëm***







Hartëzimi i Skenarit I të Erozionit

**Skenari i 2 i Erozionit**

| **Parametrat:** | **Përmbajtja:** |
|---|---|
| Vendi i ngjarjes<br>(lokacioni) | Vendbanimi Reçan komuna e Prizrenit |
| Kushtet meteorologjike | Me shi |
| Periudha e vitit: | **16.04.2023** |
| Lloji i ditës: | Ditë vikendi |
| Popullata | Numri i familjeve të prekura - rrezikuar nga Erozioni , janë 55 familje kurse numri i banorëve ishte 220, prej tyre:<br>➢ Fëmijë: 20<br>➢ Te tjerë 182 (90 Burra 92 Gra),<br>➢ Të moshuar: 18 të Moshuar mbi 65 vjeç |
| Infrastruktura kritike ekzistuese | Bazuar në kriteret e paracaktuara sipas urdhëresës administrative për rregullimin e infrastrukturës në zonën e përfshirë nga Erozioni, ka pasur infrastrukture e cila ka pasur pasoja në këtë zonë.<br>➢ Rruga Prizren – Brezovicë<br>➢ Sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit |
| Gatishmëria për menaxh. e rrezikut) | Në nivelin lokal- Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, Njësia Profesionale e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, Policia e Kosovës, Shërbimet Emergjente Mjekësore, Kryqi i Kuq dhe kompani të kontraktuara nga Komuna e Prizrenit për intervenime emergjente gjatë fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. |
| Info plotësuese | |

| | |
|---|---|
| Shkaku dhe shkaktari | Nga reshjet qe kane ndodhur ka pasur rrëshqitje të tokës gjatë orëve të paradites të datës 16.04.2023, nga qytetarët e Reçanit, kemi marrë informacion se në këtë lokalitet janë shkaktuar rrëshqitje të dheut.<br><br>**-Shkaqet e rreshqitjes mund të jene të ndryshme si:** reshjet e mëdha si dhe terreni i pjerrët ne afërsi të zonës së banuar të fshatit Reçan , skaj rrugës rajonale Prizren-Prevallë. |
| Pasojat primare | -Humbje e pasurisë në objekte banimi ( pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara nga |

| | |
|---|---|
| dhe efektet anësore | erozioni , rrëshqitja e dheut);<br>-Dëmtim i Infrastrukturës rrugore, rrugë të dëmtuara në lokalitete të prekura nga Rreshqitja;<br>- Dëmtim i Infrastrukturës kritike ( sistemi i ujësjellësit, sistemi energjetik);<br>- Rrugë të bllokuar<br>-Vlera e përgjithshme e përllogaritur e dëmit 200.000.00 €. |

**NDIKIMI- INDIKATORËT TREGUES**

| | |
|---|---|
| Rastet me fatalitet | -Nuk ka pasur raste me fatalitet. |
| Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar | - Janë lënduar lehtë afër 5 përsona. |
| Mungesë<br>e nevojave elementare | - Si pasojë e erozionit kemi dëmtime të rrugëve dhe të ndërtesave të vjetra;<br>- banoret e zonës janë bllokuar, Punëtorët nuk mund të shkojnë në punë, fëmijët në shkolla;<br>- Mungesa e ujit të pijshëm, etj. |
| Të evokuarit | - Nuk kemi pasur raste për evakuim. |
| Ndikimi i përgjithshëm ekonomik | - Disa raste të lëndimeve të njerëzve (shëndetësore: fizike, traumatike, psikologjike, etj),<br>të pa evidentuara;<br>- Dëmet e vogla të shkaktuara në ndërtesa ( rreth 30 ndërtesa), të<br>përllogaritura: 200.000.00 €;<br>- Vlera e përafërt e dëmeve të përllogaritura është: 200.000.00 €. |
| Ndërprerjet në jetën e përgjithshme | - Ndërprerje e furnizimit me ujë të pijshëm;<br>- Funksionimi i infrastrukturës rrugore (ndërprerje të akseve të<br>caktuara rrugore apo kalim me vështirësi). |
| Humbje në trashëgimi kulturore | Jo. |
| Implikime politike | Jo. |
| Ndikimi i përgjithshëm | Rrezik i mesem |

**PROBABILITETI-GJASAT**

| | |
|---|---|
| Probabiliteti | - Ngjarja e përshkruar  në aspektin cilësor dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të mesëm të mundshëm, duke marrë për bazë të dhënat historike. |
| Kohëzgjatja e ngjarjes | -Faza akute ka zgjatur shkurt disa minuta;<br>-Koha e nevojshme për sanim të gjendjes  është rreth 7 ditë. |
| Koordinimi | Koordinimi i aktiviteteve  nga niveli  qendror deri tek ai lokal dhe anasjelltas bëhet përmes QOE -112 në nivel rajonal;<br>-Duhet të bëhet aktivizimi i Komisionit lokal për mbledhjen e  të dhënave mbi vlerësimin  e dëmeve në terren të shkaktuara nga fatkeqësia /Erozioni, të përcaktojë gjendjen aktuale faktike në terren, duke bërë vlerësimin e  dëmeve dhe raportimin në komisionin qeveritar;<br>- Komisioni Qendror, bashkon raportet e komisioneve  lokale dhe bën verifikimin e vërtetësisë së dëmeve të vlerësuara nga komisionet lokale  dhe këtë raport ia dorëzon Qeverisë së RK-së për shqyrtim dhe miratim;<br>-Raportin e miratuar nga qeveria ia dorëzon Agjencisë/DKMSh-së në afat  prej 15 ditësh;<br>- Është dhënë ndihma nga shteti dhe persona të tjerë juridikë e fizikë<br>për popullatën brenda mundësive dhe kapaciteteve; |

| Probabiliteti / frekuenca | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Kategorizimi | Cilësia | Probabiliteti/gjasat | Frekuenca | Përcaktimi |
| 1 | E papërfillshme/E pamundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet | |
| 2 | E vogël/E pabesueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në 20 deri 100 vjet | |
| 3 | Mesatare/E mundur | 6-50 % | 1 ngjarje në 2 deri 20 vjet | X |
| 4 | E madhe /Gati e mundur | 51-98 % | 1 ngjarje në 1 deri 2 vjet | |
| 5 | Jashtëzakonisht e  madhe /<br>E mundur | >98 % | 1 ngjarje në vit apo më shpesh | |

**Vlerësimi i pasojës:**

Matrica 1: *Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut:*




**Matrica 2: *Rreziku për pasojat në ekonomi:***

Matrica



3: *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social– dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:*




**Matrica 4:** ***Pasqyron rrezikun e përgjithshëm***







Hartëzimi i Skenarit II të Erozionit

**Skenari 3 i Erozionit**

| **Parametrat:** | **Përmbajtja:** |
|---|---|
| Vendi i ngjarjes (lokacioni) | Vendbanimi : Gjonaj |
| Kushtet meteorologjike | Reshje Shiu |
| Periudha e vitit: | **18.02.2024** |
| Lloji i ditës: | Ditë vikendi |
| Popullata | Numri i familjeve të prekura - rrezikuar nga Erozioni , janë 80 familje kurse numri i banorëve ishte 320, prej tyre:<br>➢ Fëmijë: 65<br>➢ Te tjerë 223 (112 Burra 111 Gra),<br>➢ Të moshuar: 32 të Moshuar mbi 65 vjeç |
| Infrastruktura kritike ekzistuese | Bazuar në kriteret e paracaktuara sipas urdhëresës administrative për rregullimin e infrastrukturës në zonën e përfshirë nga Erozioni, ka pasur infrastrukture e cila ka pasur pasoja në këtë zonë.<br>➢ Rruga Prizren –Gjonaj<br>➢ Sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit |

| | |
|---|---|
| Gatishmëria për menaxh. e rrezikut) | Në nivelin lokal- Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, Njësia Profesionale e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, Policia e Kosovës, Shërbimet Emergjente Mjekësore, Kryqi i Kuq dhe kompani të kontraktuara nga Komuna e Prizrenit për intervenime emergjente gjatë fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. |
| Info plotësuese | |

| | |
|---|---|
| Shkaku dhe shkaktari | Nga reshjet qe kane ndodhur ka pasur rrëshqitje të tokës gjatë orëve të paradites të datës 18.02.2024, nga qytetarët e Gjonaj, kemi marrë informacion se në këtë lokalitet janë shkaktuar rrëshqitje të dheut.<br><br>-**Shkaqet e rrëshqitjes mund të jenë të ndryshme si: reshjet e mëdha si dhe terreni i pjerrët në afërsi të zonës së banuar të fshatit Gjonaj , skaj rrugës rajonale Prizren-Gjonaj:** |
| Pasojat primare dhe efektet anësore | -Humbje e pasurisë në objekte banimi ( pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara nga erozioni , rrëshqitja e dheut);<br><br>-Dëmtim i Infrastrukturës rrugore, rrugë të dëmtuara në lokalitete të prekura nga Rreshqitja;<br><br>- Dëmtim i Infrastrukturës kritike ( sistemi i ujësjellësit, sistemi energjetik);<br><br>- Rrugë të bllokuar<br><br>-Vlera e përgjithshme e përllogaritur e dëmit 500.000.00 €. |

**NDIKIMI- INDIKATORËT TREGUES**

| | |
|---|---|
| Rastet me fatalitet | -Nuk ka pasur raste me fatalitet. |
| Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar | - Janë lënduar lehtë afër 10 përsona. |
| Mungesë<br><br>e nevojave elementare | - Si pasojë e erozionit kemi dëmtime të rrugëve dhe të ndërtesave të vjetra;<br><br>- banoret e zonës janë bllokuar, Punëtorët nuk mund të shkojnë në punë, fëmijët në shkolla;<br><br>- Mungesa e ujit të pijshëm, etj. |
| Të evokuarit | - Nuk kemi pasur raste për evakuim. |
| Ndikimi i përgjithshëm ekonomik | - Disa raste të lëndimeve të njerëzve (shëndetësore: fizike, traumatike, psikologjike, etj),<br><br>të pa evidentuara;<br><br>- Dëmet e vogla të shkaktuara në ndërtesa ( rreth 50 ndërtesa), të<br><br>përllogaritura: 500.000.00 €; |

| | |
|---|---|
| | - Vlera e përafërt e dëmeve të përllogaritura është: 500.000.00 €. |
| Ndërprerjet në jetën e përgjithshme | - Ndërprerje e furnizimit me ujë të pijshëm;<br>- Funksionimi i infrastrukturës rrugore( ndërprerje të akseve të caktuara rrugore apo kalim me vështirësi). |
| Humbje në trashëgimi kulturore | Jo. |
| Implikime politike | Jo. |
| Ndikimi i përgjithshëm | Rrezik i mesëm |

**PROBABILITETI-GJASAT**

| | |
|---|---|
| Probabiliteti | - Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësor dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të mesëm të mundshëm, duke marrë për bazë të dhënat historike. |
| Kohëzgjatja e ngjarjes | -Faza akute ka zgjatur shkurt disa minuta;<br>-Koha e nevojshme për sanim të gjendjes është rreth 10 ditë. |
| Koordinimi | Koordinimi i aktiviteteve nga niveli qendror deri tek ai lokal dhe anasjelltas bëhet përmes QOE -112 në nivel rajonal;<br>-Duhet të bëhet aktivizimi i Komisionit lokal për mbledhjen e të dhënave mbi vlerësimin e dëmeve në terren të shkaktuara nga fatkeqësia /Erozioni, të përcaktojë gjendjen aktuale faktike në terren, duke bërë vlerësimin e dëmeve dhe raportimin në komisionin qeveritar;<br>- Komisioni Qendror, bashkon raportet e komisioneve lokale dhe bën verifikimin e vërtetësisë së dëmeve të vlerësuara nga komisionet lokale dhe këtë raport ia dorëzon Qeverisë së RK-së për shqyrtim dhe miratim;<br>-Raportin e miratuar nga qeveria ia dorëzon Agjencisë/DKMSh-së në afat prej 15 ditësh;<br>- Është dhënë ndihma nga shteti dhe persona të tjerë juridikë e fizikë<br>për popullatën brenda mundësive dhe kapaciteteve; |

Probabiliteti / frekuenca

| Kategorizimi | Cilësia | Probabiliteti/gjasat | Frekuenca | Përcaktimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | E papërfillshme/E pamundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet | |
| 2 | E vogël/E pabesueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në 20 deri 100 vjet | |
| 3 | Mesatare/E mundur | 6-50 % | 1 ngjarje në 2 deri 20 vjet | X |
| 4 | E madhe /Gati e mundur | 51-98 % | 1 ngjarje në 1 deri 2 vjet | |
| 5 | Jashtëzakonisht e madhe /<br>E mundur | >98 % | 1 ngjarje në vit apo më shpesh | |

**Vlerësimi i pasojës:**

Matrica 1: *Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut:*




**Matrica 2:** ***Rreziku për pasojat në ekonomi:***

Matrica



3: *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social– dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:*




**Matrica 4:** ***Pasqyron rrezikun e përgjithshëm***






Hartëzimi i Skenarit III të Erozionit

## 6.8. RESHJET E DËBORËS DHE NGRICAT;

### 6.8.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonave potenciale me të reshura të dendura të dëborës dhe ngricave;

Duke u bazuar në reshjet e njëpasnjëshme me vite, konsiderojmë se zonat më të prekura dhe më problematike nga ngricat dhe dëbora janë rruga Prizren – Prevallë, ndërsa zonat që përfshihen nga vështirësitë në qarkullim janë vendbanimet e rajonit të Zhupës, Hasit, që edhe nga lartësia mbidetare konsiderohen vendbanime që janë afër bjeshkëve.

### 6.8.2. Intensiteti i reshjeve, shpeshtësia e paraqitjes, temperaturat ekstreme;

Klima ndikon në shumë fenomene e veprimtari të rëndësishme në jetën e përditshme të njeriut, si në shtrirjen e vendbanimeve, në tipin e ndërtesave, në lokalizimin e bujqësisë, industrisë, turizmit, komunikacion etj. [6]

Klima e Prizrenit është e ndryshueshme kontinentale me një ndikim të lehtë të klimës mesdhetare në pjesët më të ulëta të Rrafshit të Dukagjinit në jugperëndim, ndërsa në male dominon klima malore. Klima mesdhetare vjen nga deti Adriatik nëpërmjet të luginës së Drinit të Bardhë. Ajo ndihmon në kultivimin e rrushit dhe frutave e perimeve tjera , Pozita gjeografike, largësia prej bregdetit (vetëm 105 km), lartësia mbidetare, ekspozicioni, ndikojnë drejtpërdrejtë në klimën e Komunës së Prizrenit.

Rëndësi të madhe në shtrirjen e vendbanimeve dhe infrastrukturës rrugore ka klima, duke i njohur elementet meteorologjike, si diellëzimi, temperatura, reshjet, erërat etj., mundëson një vendbanim të vendoset në ato shpate ku kemi ekspozicion jugor, të vendoset në atë mënyrë që të evitohen erërat lokale veriore etj. Elementet kryesore meteorologjike që mundësojnë njohjen më të mirë të klimës në Komunën e Prizrenit janë: diellëzimi, temperatura, reshjet, lagështia e ajrit, erërat, të cilët janë trajtuar më poshtë. **Sasitë e të reshurave**: në rajonin e Prizrenit sillen rreth 620,9 mm, ndërsa.

---

[6] R. Pllana, Klima e Kosovës, ASHAK, Prishtinë 2015, fq 12

Reshjet, pas temperaturës janë elementi më i rëndësishëm i klimës. Reshjet atmosferike ndikojnë në kushtet hidrologjike, mbulesën bimore, pamjen e peizazhit, varësisht nga sasia, intensiteti, regjimi pluviometrik dhe tipi, kanë ndikim të rëndësishëm për mjedisin jetësor dhe për aktivitetet njerëzore. Në regjimin pluviometrik në Prizren ndikim më të madh kanë aktivitetet ciklonike, të cilat manifestohet me depërtimin nga rajoni i Mesdheut. Mesatarja vjetore e reshjeve në Prizren është 620.9 mm. Mesatarja më e lartë e reshjeve në Prizren është regjistruar në vitin 1937 me gjithsej 1.554 mm reshje, ndërsa më e ulët është regjistruar në vitin 1953 me gjithsej 458 mm reshje.[7] Zakonisht në disa vende ka potenciale të akumulimit me të madh të dëborës që përfshin rrugën për Prizren – Brezovice, pastaj në vendbanimet e rajonit të Zhupës, Hasit etj. Në këto zona, përveç përfshirjes se erës së shpejtë, ka pasur edhe vështirësi në qarkullim për shkak të grumbullimit të borës. Temperaturat ekstreme(të ftohta) që ndodhin janë në këto zona: e Zhupes dhe të Hasit.

### 6.8.3. Pasojat nga dëbora dhe ngrica;

Vështirësitë më të mëdha në rrugë ka pasur në qarkullimin e automjeteve, e në të cilën ka pasur edhe aksidente të vazhdueshme, është rruga rajonale Prizren - Brezovicë, pjesa e rrugës prej 30 km që ka vështirësi të vazhdueshme si pasojë e rënies së borës dhe e ngricave në rrugë. Në këtë segment rrugor ka pjerrtësi dhe ka hije të vazhdueshme për shkak se është terren malor, ku gjatë dimrit shfaqen këto probleme të qarkullimit të automjeteve. Pasojat mund të jene në humjen e jetës së njerëzve në aksidente eventuale andaj kërkohet mirembatje të vazhdueshme.

**Masat parandaluese**

Si mase parandaluese është mirëmbatja e rrugëve gjatë stinës se dimrit sidomos. Rruga rajonale Prizren - Brezovice, kjo rrugë mund te shfaqet me probleme në qarkullim. Ndërsa, në rrugët që menaxhohen nga komuna, janë marrë masa parandaluese dhe ka një kujdes të veçantë, sepse komuna vit pas viti ka kontraktuar kompani për mirëmbajtje rrugore verore dhe dimërore. Këto kompani i kanë të ndara zonat e përgjegjësisë dhe ka një kujdes të mjaftueshëm në mirëmbajtje rrugore, duke përfshirë edhe pastrimin e trotuareve.

**Harta e rreziqeve**

*Harta 43: Vendbanimet e prekura nga ngricat ( Burimi i te dhënave nga kontakti me udhëheqës të vendbanimeve por edhe raportet nga komuna e Prizrenit ). Shih ankesin 1 të hartave faqe 45*

## 6.9. BRESHËRI

### 6.9.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale të prekura nga breshëri;

Stuhitë e breshërit, që zakonisht ndodhin në përiudhën mes pranverës së hershme e vjeshtës së vonë, gjithashtu janë karakteristikë e klimës së Prizrenit. Kohëzgjatja e stuhisë së breshërit sillet prej disa sekondash e deri në një orë. Më së shpeshti zgjat 10, deri 15 minuta. Temperaturat e ulëta janë faktor i rendësishem meteorologjik, që ka ndikim të madh në klimën e këtij territori. Tempëraturat e ulëta, në vjeshtën e hershme dhe pranverën e vonë, lënë pasoja të rënda, posaqërisht në rritjen e frutave dhe në kultivimin e perimeve.

[7] R. Pllana, Klima e Kosovës, ASHAK, Prishtinë, 2015, f.180

### 6.9.2. Shpeshtësia e paraqitjes dhe muajt kritik;

Shpeshtësia e paraqitjes është mes pranverës së hershme dhe vjeshtës së vone, mund të jene të rrezikuara të gjitha vendbanimet e komunës se Prizrenit, por dëmet me të mëdha shkaktohen tek zonat bujqësore.

Komisioni ka evidentuar dëme në 393 fermerë ku shuma e përgjithshme e dëmit arrin vlerën prej 1 milion e 93 mijë euro. Evidentimi i dëmeve është bërë nga 22 deri me 25 maj 2020 në Medvec, Zojz, Randobravë, Krushë e Vogël, Sërbicë e Poshtme, Landovicë, Nashec, Atmaxhë, Kobaj, Vlashnje, Caparc, Piranë, Gjonaj dhe fshatrat përreth.



Figura 15, që tregon demet e shkaktuara nga Bresheri në komunën e Prizrenit Maj 2020

### 6.9.3. Pasojat nga breshëri;

Bresheri vazhdimisht ka bere dëme në bujqësi , dëmtimin e produkteve bujqësore, të cilët Ministria e Bujqësisë vazhdimisht është munduar me i kompenzue dëmet tek Ekonomitë familjare bujqësore.



Figura 16 , Dëmet e shkaktuara nga breshëri në fshatin Randobravë me datë 26.06.2024

**Harta e rreziqeve;**

Harta 44: Vendbanimet e prekura nga breshëri ( Burimi i të dhënave, kontakti me udhëheqës të vendbanimeve

por edhe raportet e vlerësimit nga komuna e Prizrenit). Aneksi i hartave faqe 46.

## 6.10. ORTEKËT

### 6.10.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale

Orteku është grumbull bore që rrëshqet teposhtë maleve ku është terreni i pjerret. Ortekët po ashtu quhen edhe rrëshqitje bore. Orteku paraqitet kur trysnia (e gravitetit), që provon ta shtyjë borën teposhtë, ia kalon fuqisë (nga lidhja e topave të borës) së mbështjellësit të borës. Ortekët shkatërrojnë strukturat e ndërtuara, rrugët, kabllot dhe linjat e komunikimit, kur bora rrëshqet nga lartësitë e mëdha, ose duke i groposur ato. Ortekët janë rreziqe kryesore në shumë vise malore. Faktorët që shkaktojnë ortekun janë:

- kushtet atmosferike,

- temperatura,

- pjerrësia e këndit (topografia),

- shtresa e borës - drejtimi i erës,

- bimësia,

- gjendja e përgjithshme e grumbullit të borës.

. Ortekët lirohen zakonisht në pjerrësinë në kufirin e zonës malore që rri matanë erës ekzistuese (në pjerrësinë ku nuk fryn era grumbullohet bora që vjen prej drejtimit nga fryn era ose malet). Ortekët fillojnë të lëvizin vetëm në ndonjë pyll mesatarisht të dendur apo të zhveshur. Të gjithë Ortekët e ndjekin një shteg të ortekëve, që përmban tri elemente: - zonën e nisjes, ku fillimisht bora çahet, - shtegun e ortekut ose rrugën aktuale që e ndjek, dhe - zonën e zbrazjes, ku bora ngadalësohet dhe ndalet.

**Pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve;.**

Deri më tani nuk ka pasur raste ku janë zhvilluar Ortekët në komunën e Prizrenit. Duke u bazuar në konfiguracionit e terrenit, mund te themi që vendbanimi më i rrezikuar është fshati Nebregoshtë.

### 6.10.2. Treguesit statistikor të pasojave nga ortekët;

Nuk ka pasur raste të Ortekëve në këto 20 vitet e fundit në komunën e Prizrenit që ka shkaktuar dëme në njerz dhe ekonomi familjare. Zonat me të rrezikuara potenciale nga orteqet është vendbanimi Nebregoshtë , kjo zone karakterizohet me pjerrtësi të madhe.

**Masat parandaluese;**

Mbulesa bimore, pyjet, shkurret, relievi i butë, ndikojnë në frenimin e orteqeve. Orteqet mund të parashikohen me paralajmërimin e ndryshimeve klimatike në zona të caktuara, por rreziku asnjëherë nuk është i evitueshëm.

Gjithashtu, duhet të vendosen shenja paralajmëruese në zonat ku rrezikshmëria nga orteqet është më e lartë.

Rreziku nga orteqet mund të minimizohet nëse mbillen drunjë, duke rritur stabilitetin e shpateve dhe duke ndihmuar për të zvogëluar dëmtimet më tej në luginë.

Kosova nuk bën pjesë në zona të rrezikshmërisë së orteqeve, por në vitin 2012 një ortek në fshatin Restelicë të

komunës së Dragashit, fshat i thellë në rajonin e Gorës, kishte mbuluar disa shtëpi dhe u mori jetën 10 banorëve të këtij vendbanimi.

**Harta e rreziqeve;**

Harta 45: Lokacioni i rrezikuar nga Orteqet

Burimi i te dhënave: Analize nga hartat topografike (gjeoportali kombëtar) shih ankesin 1. Faqe 47

## 6.11. ERËRAT E FUQISHME DHE STUHITË

Stuhia është çrregullim atmosferik, e cila shkakton ndryshime atmosferike, që inicojnë ndryshime të rëndësishme në fushën e erërave, shtypjes dhe tempëratures në shkallë hapësinore që zgjaten nga madhësia e tornados (me shpejtësi nga 1 km.)
Stuhitë korrespondojnë me fenomenet e rafalëve të erës. Këto fenomene meteorologjike kanë të bëjnë me një shtrirje që shkon nga disa qindra metra deri në disa dhjetëra kilometra dhe një kohëzgjatje nga disa minuta në disa orë.

### 6.11.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale

Situatat meteorologjike, në origjinën e tyre, kanë një jo - stabilitet të fuqishëm të atmosferës. Ky lloj i fenomenit duket mjaft i shpeshtë në Kosovë, sidomos këto vitet e fundit, që korrespondon me periudhat e ngrohjës së klimës në mes të qershorit dhe të shtatorit.

### 6.11.2. Pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve;

Në rastet eventuale të përfshirjes së territorit të komunës së Prizrenit nga stuhitë e erërave të fuqishme, mund të përfshihet i gjithë territori i komunës dhe mund të jenë të rrezikuar të gjithë banorët e komunës se Prizrenit.

### 6.11.3. Treguesit statistikor të pasojave nga erërat e fuqishme dhe stuhitë ;

Është me rëndësi të theksohet se ky territor është nën ndikimin e klimës mesdhetare e cila depërton përmes luginës së lumit Drini i Bardhë. Klima është mjaft e butë dhe nuk ka variacione karakteristike ekstreme në temperaturën e ajrit gjatë vitit.

Efektet e këtyre fatkeqësive natyrore janë të shumta, bëhet fjalë për:

- Shkuljen e drunjve,
- Rrëzimin e kulmeve,
- Lëvizjen dhe hedhjen e objekteve të ngurta (mobile të kopshtit, kontejnerëve…),
- Shkatërrimin e pjesshëm të rrjetit elektrik dhe të telefonisë,
- Çrregullimin e transportit (ajror, hekurudhor dhe rrugor),
- Aksidentet e komunikacionit,
- Zvogëlimin, madje paralizimin e aktiviteteve socio-ekonomike,
- Vdekjet ose lëndimet nga goditjet ose nga rëniet e objekteve,
- Mbytjet,
- Vdekjet ose lëndimet nga rënia.

### Masat parandaluese;

Masat parandaluese ndaj erërave të fuqishme dhe stuhive janë thelbësore për të minimizuar dëmet dhe rreziqet për jetën e njerëzve dhe pasuritë. Këtu janë disa nga masat kryesore:

1. Monitorimi dhe Parashikimi, Sisteme të Monitorimit: Përdorimi i teknologjisë për të ndjekur kushtet meteorologjike dhe për të identifikuar stuhitë në zhvillim.

Parashikimet e Motit: Informimi i publikut për stuhitë e mundshme dhe erërat e fuqishme përmes paralajmërimeve të hershme.

2. Edukimi dhe Ndërgjegjësimi,Kampanjat e Edukimit: Inkurajimi i komuniteteve për të njohur rrezikun dhe përgatitjet që duhet të bëjnë.Planifikimi Familjar: Krijimi i planeve të emergjencës në familje për situata stuhish.

3. Infrastrukturë e Qëndrueshme,Ndërtimi i Qëndrueshëm: Përdorimi i materialeve të forta dhe teknikave të ndërtimit që rezistojnë ndaj erërave të fuqishme.Mbrojtja e Infrastruktures: Rregullimi i pemëve dhe strukturave për të parandaluar dëmtimet nga erërat.

4. Masa të Sigurisë për Individët, Strehimi: Identifikimi i vendeve të sigurta për t'u strehuar gjatë stuhive, siç janë bodrumet ose ndërtesat e forta. Mjetet e Sigurisë: Sigurimi i mjeteve si drita, ushqim, ujë dhe ilaçe për periudha emergjente.

Këto masa parandaluese janë të rëndësishme për të minimizuar rreziqet që sjellin erërat e fuqishme dhe stuhitë, duke siguruar mbrojtjen e individëve dhe pasurive.

### Harta e rreziqeve;

*Harta 46: Vendbanimet e prekura nga Erat ( Burimi i të dhënave, kontakti me udhëheqës të vendbanimeve por edhe raportet e vleresimit të demeve nga komuna e Prizrenit) shih ankesin 1 faqe 48*

## 6.12. THATËSIRAT

### 6.12.1. Treguesit statistikor për mungesën e theksuar të të reshuarave atmosferike;

Komuna e Prizrenit është një vend me sipërfaqe të konsiderueshme rurale ku gjatë sezonit veror mund të ketë periudha më të gjata të vapës, që kryesisht manifestohen me mungesa të mëdha të të reshurave atmosferike, të cilat mund të shkaktojnë thatësi. Thatësirë është një përiudhë e zgjatur mujore në komunën e Prizrenit sidomos gjatë muajit Korrik dhe Gusht kur temperaturat janë të larta dhe ka mungesë të reshjeve, nganjeherë marrin masa për kursimin e ujit pasi që paraqitet mangësi në furnizim me ujë. Në përgjithësi, kjo ndodh kur në komunën e Prizrenit në vazhdimsi ka reshje atmosferike nën mesataren e nëvojshme. Thatësira mund të ketë një ndikim negativ mbi ekosistemin dhe bujqësinë e zones së prekur.

### 6.12.2. Dëmet dhe pasojat;

Nuk ka ndonjë të dhënë statistikore të publikuar në lidhje me dëmet dhe pasojat nga thatësirat në komunën e Prizrenit. Në këto vitet e fundit, nuk ka pasur thatësira të mëdha që vlen të përmenden me

dëme ne jetën e njerëzve, përpos në fushën e bujqësisë që ka shkaktuar dëme në rendimentet bujqësore në zonat kodrinore (që nuk kanë sistem të ujitur të tokës bujqësore).

### 6.12.3. Pasqyra e vendbanimeve/zonave të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve;

Vendbanimet me të rrezikuara janë pjesa kodrinore-malore , pasi gjatë sezonit veror ka pak të reshura atmosferike si dhe ka mungesë të ujit nga Sistemi i Radoniqit. Vendbanimet me të rrezikuara janë: Fshatrat e rajonit të Hasit të cilët janë terrene karstike dhe ka mungesë të burimeve ujore.

### 6.12.4.Rezervat ujore ( mbitokësore dhe nëntokësore);

Lumenjtë dhe rrjedhat e tjera ujore në Prizren, janë pjesë e pellgut ujor të lumit Drini i Bardhë. Komuna e Prizrenit është e pasur me burime natyrore dhe ka rrjet hidrografik relativisht të dendur. Kjo paraqet pasurinë natyrore të komunës dhe një ndër kushtet për ekzistencën e botës bimore dhe të aktiviteteve njerëzore. Rrjetin hidrografik të komunës së Prizrenit e përbëjnë disa lumenj dhe ujërrjedha/ përrenj, qindra burime natyrore dhe ujërat nëntokësorë.

Lumi më i madh që kalon në territorin e komunës së Prizrenit është Drini i Bardhë. Edhe pse nuk buron në komunën e Prizrenit, ai është ujëmbledhës i të gjitha rrjedhave dhe i lumenjve të komunës. Nëpër komunën e Prizrenit, ky lumë rrjedh me një gjatësi prej 34 km. Lumenjtë-përrockat që derdhen në Drinin e Bardhë janë: Lumbardhi i Prizrenit, Toplluha etj. Shfrytëzimi i zhavorit kryesisht nga shtrati i lumit Drini i Bardhë është veprim shumë negativ i cili krahas dëmtimit të peizazhit, dëmton edhe biodiversitetin e lumit dhe përreth tij. Shfrytëzimi i zhavorit nga shtretërit e lumenjve apo ngushtimit të shtratit të tyre me ndërtime buzë bregut, apo hedhjes së mbetjeve ndërtimore, çrregullon rrjedhën e tyre dhe për pasojë kemi edhe vërshime të vendbanimeve dhe të tokave bujqësore përgjatë këtyre rrjedhave, pothuaj çdo vit në pranverë apo vjeshtë kur rritet intensiteti i reshjeve të shiut apo shkrirja e hovshme e borës. Mungesa e infrastrukturës për trajtimin ujërave sanitare apo industriale të shkarkuara në trupa ujorë edhe në të ardhmen do të jetë burim i ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntoksore si burime që përdoren për nevoja të qytetarëve. Një burim tjetër i ndotjes është edhe hedhja e mbeturinave urbane apo atyre ndërtimore në shtretër të ujërrjedhave apo afër tyre.

### Masat parandaluese;

Zgjerimi i rrjetit të ujitjes së tokave bujqësore nga institucionet kompetente, ose krijimi i ndonjë pende në pjesën kodrinore të komunës se Prizrenit, i cili pastaj do ta mundësojë zbutjen e problemeve që shkaktohen nga thatësirat e tokave bujqësore.

1. Gjetja e burimeve të reja për ujë të pishem,

2. Zgjerimi i ujësjellësit nëpër zonat ku mungon ujesjellesi,

3. Shfrytëzim racional i ujit të pishëm nga vetë banorët,

4. Rregullimi i rrejtit të ujitjes nga ana e Ministrisë së Bujqësisë në zonat ku janë tokat pjellore dhe të përshtatshme pë ujitje.

**Harta e rreziqeve;**

*Harta 47: Vendbanimet e prekura nga Thatësira ( Burimi i të dhënave, kontakti me udhëheqës të vendbanimeve). Shih aneksin 1 faqe 48*

## 6.13. RREZIQET NGA EPIDEMITË DHE PANDEMITË

### 6.13.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale;

Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale për epidemitë dhe pandemitë përfshijnë disa faktorë kryesorë:

1. Dendësia e Popullsisë- Zonat me densitet të lartë me popullate,janë më të rrezikshme për shpërthime epidemish për shkak të kontaktit të shpeshtë midis individëve.

2. Sistemet shëndetësore - Zonat me sisteme shëndetësore të dobëta ose me mungesë qasjeje në kujdesin shëndetësor janë më të prirura për shpërthime të mëdha.

3. Mungesa e Edukimit Shëndetësor - Njohuria e ulët për higjienën dhe parandalimin e sëmundjeve mund të kontribuojë në përhapjen e epidemive.

Këto karakteristika ndihmojnë në identifikimin e zonave të rrezikshme dhe në planifikimin e masave të parandalimit dhe kontrollit për epidemitë dhe pandemitë.

### 6.13.2. Pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve ;

Mund të jete i rrezikuar i gjithë territori i komunës se Prizrenit sikur rasti i COVID-19, me numrin dhe strukturën e banoreve që jetojnë në komunën e Prizrenit.

### 6.13.3. Shkaktarët e paraqitjes së epidemisë, endemisë dhe pandemisë;

Depërtimi i agjenësve biologjikë dhe shumëzimi i tyre në organizmin e sulmuar, quhet infektim. Nese ky infektim përcillet me reaksion të organizmit të sulmuar, është fjala për shfaqjen e smundjes ngjitëse. Kushtet e nëvojshme për shfaqjen dhe zhvillimin e smundjes ngjitëse- infektimit, janë:

1. Burimet e infektimit: janë njerëzit e sëmurë, kafshët, bartësit e bakterieve dhe të virusëve, si dhe kufomat e njerëzve dhe të kafshëve.
2. Rrugët e bartjes: janë mënyrat e bartjes së agjenësve biologjikë, prej burimit të infektimit, deri në organizmin pranues. Të shumtën janë personat e infektuar, uji, ajri, ushqimi, toka, si edhe faktorë të tjerë, si brejtësit dhe insektet.

### 6.13.4. Sëmundjet ngjitëse;

Dyert e hyrjes janë lëkura, mukoza, organet e frymëmarjes dhe organet e tretjes. Numri dhe virulentshmëria: është aftësia e bakterieve dhe e virusëve për të depërtuar në organizëm, t'i përshtaten ambientit të ri, të fillojnë të shumëzohen dhe të shkaktojnë sëmundjen ngjitëse.

Dispozita dhe imuniteti: Dispozita është prirja e organizmit për ndonjë infektim. Në këtë ndikojnë: vjetërsia , gjinia, profesioni, kushtet sociale-ekonomike, kondicioni fizik, stina dhe kushtet e tjera jetësore. Imuniteti është rezistenca e organizmit ndaj sëmundjes së caktuar ngjitëse. Vijat mbrojtëse të organizmit: Njeriu, si edhe qeniet e tjera të gjalla, ka tre vija mbrojtëse, për luftë kunder mikroorganizmave:

¬ Vija e parë mbrojtëse: lëkura dhe mukoza e shëndoshë.

¬ Vija e dytë mbrojtëse: rruazat e kuqe të gjakut dhe sistemi limfatik.

¬ Vija e tretë mbrojtëse: mëlqia dhe pankreasi. Sëmundjet infektuese shfaqen në formë:

- Endemie: përfshin një lokalitet të caktuar;
- Epidemia: përhapja e shpejtë e infektimit të popullatës në një zonë të caktuar dhe
- Pandemia: kur popullatën e një ose më shumë kontinenteve e pëfshin smundja ngjitëse;
- Gripi pandemik: Gripi i shpendëve, Gripi i ri ( i derrave);
- Sëmundjet bio-terroriste (Ethet hemorragjike, Bruceloza, Tularemia)
- Epidemitë dhe pandemitë e papritura ( shembull: ethet hemorragjike - krime kongo, COVID 19, lija e majmunit, etj.)
- Helmimet masive me ujë dhe ushqim.
- Gripi pandemik : Gripi i shpendëve, Gripi i ri (derrave)
- Sëmundjet bio-terroriste (Ethet hemorragjike, Bruceloza, Tularemia)
- Epidemitë dhe pandemitë e papritura ( shembull: ethet hemorragjike - krime kongo, COVID 19 , lija e majmunit, etj.)
- Helmimet masive me ujë dhe ushqim.

### 6.13.5. Pasojat nga epidemitë dhe pandemitë ;

Në dhjetor 2019, autoritetet në Kinë zbuluan një virus krejtësisht të ri që që atëherë është përhapur në mbarë botën duke çuar në një pandemi. Virusi është quajtur që atëherë SARS-CoV-2 dhe kontribuon në infektimin e Covid-19. Banorët e komunës së Prizrenit janë përballur me një numër të madh problemesh shëndetësore. Sipas statistikave në rastin e komunës se Prizrenit kemi të prekur afër 2085 raste me covid 19 në vitin 2020, ndërsa ne vitin 2021 jane prekur afër 6718 banorë. Ne vitin 2020 kane vdekur 147 persona në komunën e Prizrenit nga Covid 19.

*Tab 57 Numri i pacienteve me Rastet e semundjeve ngjitëse në komunën e Prizrenit nga viti 2017- 2021.*

| Lloji i semundjës ngjitëse | Pneumania& Ari | Sari | Influenca sezonale | Diarea akute | Variçela |
|---|---|---|---|---|---|
| Viti 2017 | 69 | 47 | 2319 | 2102 | 258 |
| Viti 2018 | 1014 | 2 | 6507 | 5566 | 916 |
| Viti 2019 | 849 | 5 | 6996 | 9556 | 1412 |
| Viti 2020 | 964 | 0 | 8150 | 3001 | 456 |
| Viti 2021 | 969 | 1 | 7999 | 8367 | 854 |

*Graf 30 Numri i pacienteve me TBC në komunën e Prizrenit*




*Burimi i të dhënave ASK - https://askapi.rks-gov.net/Custom/d96bb22b-6b14-420c-a4e0-097928f283f0.pdf*

### 6.13.6. Epidemitë dhe pandemitë/vlerësimet e bazuara në vlerësimet dhe analizat e shërbimeve kompetente;

Epidemitë dhe pandemitë janë ngjarje shëndetësore që kërkojnë vlerësime dhe analiza të kujdesshme nga shërbimet kompetente, si Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), qeveritë vendore dhe institucionet shëndetësore. Vlerësimet e bazuara në analiza të thelluara janë të rëndësishme për të kuptuar shpërthimet dhe për të zbatuar masa efektive. Ja disa aspekte kyçe:

1. Vlerësimi i Rrezikut
2. Monitorimi
3. Analizat Epidemiologjike
4. Planifikimi i Emergjencave
5. Komunikimi me Publikun
6. Vlerësimi i Ndikimeve Shëndetësore dhe Ekonomike
7. Studime pas Epidemive për çeshtjet :Shëndetësore, sanitare,veterinere,bujqësore, treguesit real të shkaktarëve , institucioneve përkatëse me specifikat e zonave më të rrezikuara .

Këto vlerësime dhe analiza janë thelbësore për menaxhimin efektiv të epidemive dhe pandemive, duke siguruar një qasje të strukturuar dhe të bazuar në prova për mbrojtjen e shëndetit publik.

### 6.13.7. Bartësit dhe përgjegjësit e aktiviteteve të rregullta dhe masat parandaluese;

* Kur kolliteni ose teshtini, gojën dhe hundën mbylleni me një shami. Shaminë që përdoret hidheni.

* Pasi teshtini ose kolliteni, duart lajëni me ujë dhe sapun ose me antiseptikë që përmbajnë alkool.

* Mos prekni me duar të palara hundën dhe gojën.

* Në qoftëse. sëmureni, 7 ditët e para qëndroni në shtrat.

* Qëndroni larg njerëzve që dyshoni.

* Ajroseni shpesh ambientin ku qendroni.

**Harta e rreziqeve;**

Nuk ka hartë të rreziqëve por mund të jete i rrezikuar i gjithë territori i komunës se Prizrenit sikur rasti i COVID-19, apo nga ndonjë sëmundje tjetër gripe të ndryshme siç janë të njohura: Covid 19, Gripi i Derrit H1N1, Gripi i Shpezëve , Bruceloza etj.

# KREU VII-TË

# 7. FATKEQËSITË TJERA

## 7.1. Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë tjera ;

Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë tjera bazohet në analizën e rreziqeve dhe pasojave të mundshme në popullatë, të mira materiale, kulturore dhe mjedis, brenda zonës së tyre si dhe atyre që mund të vijnë nga zonat fqinje si në vijim:

### 7.1.1. Numrin, llojin dhe madhësinë e objekteve në të cilat deponohen, përdoren apo prodhohen materiet e rrezikshme;

Në komunën e Prizrenit nuk ka ndonjë objekt në të cilat deponohet përdoren apo prodhohen materie e rrezikshme.

### 7.1.2. Numrin, llojin dhe cenueshmërinë e trafikut rrugor, hekurudhor dhe ajror;

Infrastruktura rrugore edhe shenjat e komunikacionit jane rregulluar dhe janë të standardizuara në të gjitha rrugët e komunës se Prizrenit. Shprehen shqetësimet lidhur me numrin e madh të aksidenteve në trafik, ku si pasojë kanë gjetur vdekjen qinda përsona që paraqesin shifra alarmante dhe shumë shqetësues fakti se shumica e viktimave janë këmbësorë. Shkaqet janë të ndryshme por sigurisht se faktori njeri është më i shpeshtë pasi që nuk janë duke u respektuar rregullat e përgjithshme në trafik, tejkalimi i shpejtësisë, mos mbajtja e distancës, mos respektimi i shenjave të trafikut dhe mos përshtatja e kushteve të rrugës përdorimi i shpeshtë i telefonave mobil, vozitja nën ndikimin e alkoolit, substancave narkotike, ndikimi i lodhjes apo pagjumësisë etj.

Duhet ndërmarrë masa të përgjithshme për zvogëlimin e rrezikut nga aksidentet në komunikacion edhe atë:

- Zhvillimin e infrastrukturës rrugore, sidomos në qytet, në bazë të planit urbanistik të qytetit;

- Largimi nga komunikacioni i veturave që nuk janë në gjendje të rregullt teknike;

- Inspektimet e rregullta në komunikacion;

- Edukimi dhe arsimimi i vozitësve;

- Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve;

- Kufizimi i shpejtësisë dhe mbikëqyrja e trafikut;

-Kontrollimi teknik i automjeteve i detyrueshëm, si dhe masat tjera adekuate.

#### 7.1.3. Llojin dhe sasinë e materieve të rrezikshme;

Llojet kryesore të rrezikut janë: kamionët cisternë dhe kamionët e rrafshët, si dhe të gjithë kontejnerët transportues.

#### 7.1.4. Distanca nga zonat e banuara;

Zonat me të rrezikuara janë zonat e banuara për gjatë rrugëve kryesore rajonale/nacionale si dhe pikave të karburantit që disa prej tyre janë me nje distance të vogël e që paraqesin rrezik të madh për banorët e zones, Sidomos zona urbane në segmentin e rrugeve Prizren-Suhareke, Prizren-Vermice dhe Prizren – Gjakovë.

**7.1.5. Përqendrimin e materieve të rrezikshme dhe të dëmshme; -** të cilat mund ta rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe tërë strukturës ekologjike me pasqyrën e ndërmarrjeve të cilat merren me prodhimin, deponimin dhe shitjen e materieve të rrezikshme dhe të dëmshme;

#### 7.1.6. Llojin dhe sasinë reale të materieve të rrezikshme dhe të dëmshme në qarkullim;

Materiet e rrezikshme janë substanca që për nga përbërja fizike - kimike ose për nga natyra e reaksioneve mund të paraqesin rrezik për njeriun, të mirat materiale ose ambientin. Ato mund të jetë materie që digjen, toksike, eksplozive, gërryese (korrozive) ose radioaktive. Aksidentet e mjeteve dhe automjeteve që transportojnë materie të rrezikshme kanë si efekt primar të menjëhershëm dhe që vërehet lehtë (zjarrin, eksplodimin, derdhjen) dhe efektet sekondare ( përhapjen ajrore të avujve toksik ndotjen e ujërave dhe të tokës). Vlerësimi në vazhdim ka të bëjë me aksidente ose incidente të transportit rrugortë materive të rrezikshme. Dallojmë dy lloje të aksidenteve të transportit rrugor me materie të rrezikshme:

• Aksidente të llojit ‘’C’’ - janë aksidentet gjatë të cilave materiet e rrezikshme mbesin neutrale,

• Aksidente të llojit’’M’’ - janë aksidente që karakterizohen qoftë me ndryshime të pa riparueshme të materies së rrezikshme qoftë me plehërimin e materies ose të humbjes së ngarkesës ose në fund qoftë edhe me eksplodimin ose djegien e materies së rrezikshme.

#### 7.1.7. Rrjedhjen e materieve të rrezikshme dhe të dëmshme në vendet me rrezikshmëri të lartë/tubacionet, rrugët të cilat kalojnë nëpër vendet me specifika të veçanta;

#### 7.1.8. Rreziku nga shpërthimi i pendave hidro-akumuluese,

Në komunen e Prizrenit nuk ka ndonjë rrezik nga shpërthimi i ndonjë pende hidroakumuluese.

#### 7.1.9. Pasojat nga shpërthimi i pendës hidro-akumuluese;

Në komunën e Prizrenit nuk ka ndonjë pende të madhe e ndërtuar që paraqet rrezik për banoret e komunës së Prizrenit.

**7.1.10. Raporti vlerësues i matjeve dhe gjendjes së trupit të pendës;**

## 7.2. Vlerësimi për fatkeqësitë Nukleare Radiologjike Kimike Biologjike

**H**artohet ekskluzivisht në nivelin qendror, ndërsa autoritetet e nivelit lokal planifikojnë zbatimin e obligimeve që dalin nga planet dhe programet qendrore të kësaj fushe.

## 7.3. VLERËSIMI PËR RREZIQET NGA VEPRIMET LUFTARAKE DHE TERRORISTE

**H**artohet në bazë të dokumenteve strategjike të Republikës së Kosovës, dokumenteve publike që i harton Ministria e Punëve të Brendshme apo Ministria e Mbrojtjes, bazuar në strukturën e përcaktuar, madhësinë dhe veprimet e forcave operative për veprim në fatkeqësi. Duhet të theksohet se komuna e Prizrenit nuk ka përjetuar ndonjë sulm terrorist dhe, në përgjithësi, nuk konsiderohet si vend me rrezik të veçantë për sulmet terroriste. Karakteristikat bazë të veprimeve terroriste:

• Ekspertiza për aktet terroriste dhe parandalimi i tyre realizohet nëpërmjet një pune shumë të specializuar ku përfshihen shërbimet sekrete, njësi të specializuara të policisë dhe të forcave të armatosura dhe shpesh edhe rrjete ndërkombëtare të specializuara. Si rezultat, këto çështje janë jashtë përgjegjësive dhe parametrave të punës së atyre që merren me çështjet e emergjencave civile.

• Sidoqoftë, në rast të ndodhjes së ndonjë akti terrorist mbi objekte ose mbi njerëz, atëherë janë mekanizmat e përballimit të emergjencave civile, të cilët duhet të përgjigjen në të njëjtën mënyrë, si në rastet e fatkeqësive natyrore.

• Eksplozionet mund të kërkojnë ndërhyrjen e menjëhershme të grupeve të kërkim-shpëtimit dhe menaxhimin e të dëmtuarve në masë për të shpëtuar jetët e njerëzve në të njëjtën mënyrë, si dhe në rastin e një tërmeti të vogël. Në mjaft situata kërcënuese terroriste janë dashur evakuime të shpejta dhe masive të njerëzve për t'i siguruar ata nga kërcënimet e mundshme, madje edhe nga një paralajmërim.

• Megjithate, ka faktorë të veçantë shtesë që duhet të merren parasysh, duke përfshirë sulmet dytësore pas një sulmi që, nga pamja e jashtme, duket si kryesor, si dhe ngjarje jo të zakonshme, si për shembull sulmet me armë të shkatërrimit në masë (ASHM), për të cilat nuk ka shumë përvojë.

• Duke u nisur nga natyra e tyre, sulmet terroriste zakonisht ndodhin pa paralajmërim ose me një lajmërim në çastin e fundit, por mund të pasohen nga një numër ngjarjesh të lidhura dhe ndonjëherë të koordinuara që shkaktojnë panik dhe strese të mëdha.

• Parandalimi është detyrë e strukturave dhe e institucioneve të specializuara.

• • Praktikimi dhe testimi i planeve nëpërmjet stërvitjeve është me shumë vlerë edhe në një situatë sulmi terrorist.

• Veprimet e menjëhershme të kërkim–shpëtimit ndërmerren kryesisht nga komunitetet e prekura, ku pjesa më e madhe e njerëzve shpëtohen nga familjarët, miqtë ose fqinjët.

• Trajtimi i menjëhershëm mjekësor do të nevojitet për t´ua ofruar të plagosurve. Një fatkeqësi e një përmase të madhe do të kërkojë angazhim të gjerë jo vetëm të kapaciteteve lokale, por edhe të atyre kombëtare.

• Bëhet, gjithashtu, edhe një vlerësim i shpejtë i sigurisë së objekteve si dhe për dëmet dhe nevojat më emergjente.

• Mbajtja e rendit publik dhe dhënia e një informacioni të saktë janë shumë të rëndësishme për të vendosur qetësinë si dhe për të ulur pështjellimin e mëtejshëm që të mos shkaktohen viktima të tjera.

• Mund të jetë e nevojshme të evakuohet e gjithë popullsia nga zona e prekur

• Mbështetja logjistike është shumë e rëndësishme për një përballim të suksesshëm.

• Pjesa më e madhe e personave që shpëtohen do të jetë gjatë 24-48 - orëshit të parë pas ngjarjes.

• Siguria, eliminimi i materialeve të rrezikshme ose pastrimi i zonës nga ndotjet, si dhe sigurimi i strukturave të dëmtuara, duhet të garantohen para se popullsia të kthehet e sigurt në zonën e prekur.

• Shërbimet publike bazë ku përfshihen uji i pijshëm, ujërat e zeza, përdorimi i rrugëve dhe furnizimime me energji, duhet të sigurohen sa më shpejt të jetë e mundur.

• Duhet të merren vendime të shpejta në lidhje me objekte bazë publike (duke përfshirë ndërtesat e shkollave dhe të spitaleve) që mund të jenë shkatërruar ose dëmtuar rëndë.

### 7.4. Vlerësimi për pasojat e infrastrukturës kritike

Identifikimi i natyrës së fatkeqësive në komunën e Prizrenit (tërmete, përmbytje, etj.) mund të ndikojnë në infrastrukturën kritike.

Intenziteti: Përcaktimi i shkallës së ndikimit që ka çdo lloj rreziku, duke përfshirë forcën dhe frekuencën e ndodhjes. Analiza e pasojave të mundshme për shërbimet dhe funksionimin normal të infrastrukturës. Pasojat e mundshme: Identifikimi i pasojave ekonomike, sociale dhe ambientale në rastin e një fatkeqësie. Vlerësimi i infrastrukturës kritike dhe prioritizimi i saj janë të domosdoshme për të minimizuar pasojat nga fatkeqësitë natyrore dhe për të siguruar që komunitetet të jenë më të përgatitura dhe më të qëndrueshme. Implementimi i masave të propozuara do të kontribuojë në një sistem më të fortë dhe më të qëndrueshëm.

### 7.5. Strukturat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë /SMShN

Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim është organ profesional, i cili merret me çështjet emergjente në komunë dhe si e tillë bën planifikimin dhe marrjen e masave për parapengimimin, zbutjen dhe eliminimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore, teknologjike e të tjera.

Struktura e saj organizative dhe përgatitjet e planeve mbrojtëse, mundësojnë mbulimin e të gjitha segmenteve me të cilat do të ballafaqohet shoqëria civile dhe strukturat shtetërore në komunë, në rast

të situatave emergjente. Në punën e saj të përditshme, ajo i përgjigjet Kryetarit të Komunës dhe Asamblesë Komunale në Prizren, e sipas resorëve edhe nivelit Qendror - Agjencionit për Menaxhim të Emergjencave, ndërsa me shpalljen e emergjencave civile, i përgjigjet dhe është komplet me tërë potencialin e saj në shërbim të Komitetit Komunal për Emergjencë, Planifikimi efektiv që bëhet në kuadër të sektorit është në funksion fillestar të menaxhimit, i cili njëherit siguron udhëheqje të mirëfilltë dhe rekomandon metodën e ekzekutimit (reagimit), përmes të të cilave u jupet përgjigje shumë pyetjeve siç janë: detyrat, potenciali njerëzor, koordinimi reciprok, ndarja e përgjegjësive, ndarja e mjeteve gjatë emergjencave etj.

### 7.6. Në vlerësim duhet të përcaktohen kapacitetet, forcat dhe shërbimet

Në bazë të vlerësimeve të gjithanshme profesionale dhe konstatimeve faktike në terren dhe duke marrë për bazë kompetencat dhe funksionet që ushtron ky sektor i jep propozimin Komitetit Komunal për Emergjencë shpalljen e gjendjes së emergjencës civile në një pjesë apo në tërë territorin e komunës. Në kuadër të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim veprojnë ekipet:

a) Njësia e Zjarrfiksëve;

b) Zyra për Alarmim dhe Koordinim emergjent.

#### a. Njësia e Zjarrfiksëve

Detyrat dhe përgjegjësitë: Në raste të aksidenteve-fatkeqësive të përmasave të mëdha, Njësia e Zjarrfikësve, së bashku me subjektet e tjera përkatëse të involvuara në raste emergjente do t'i kryejnë këto veprime:

• Zjarrfikje dhe detyra të tjera në raste zjarri.

• Pozicionimi dhe shuarja e zjarreve përgjatë akseve rrugore dhe hapja e korridoreve për intervenim deri në zonën e incidentit;

• Do të sigurojë hyrje për shpëtimtarët për në lokacionet me tym, nëse ata nuk janë të pajisur me mjete standarde ( boca oksigjeni etj);

• Misione shpëtuese lidhur me aksidentet dhe katastrofat natyrore, në raport me mundësitë dhe pajisjet e tyre;

• Do të sigurojnë operacione të shpëtimit në pyje;

• Veprime të Evakuimit dhe të Shpëtimit në rast zjarri;

•Veprime të kërkim-shpëtimit në aksidente rrugore;

•Veprime të kërkim-shpëtimit në ambiente nënujore etj.

•Kryen edhe shërbime të tjera të natyrës medikale në vendin e incidentit dhe bartjen e të lënduarve në qendrën spitalore;

•Kryen edhe punë e detyra të tjera sipas nevojës dhe situatës emergjente dhe lidhur me këto detyra i përgjigjet në vertikale Kryetarit të Komitetit Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim;

Aktualisht, Njësia e Zjarrfikësve, në përbërjen e vet, ka:

- 16 Zjarrfikës;
- 1 Komandant i Njësisë.

Tab 58 Automjetet në përdorim nga NJPZSH- Prizren

| Targat e Automjetit | Lloji i Automjetit | Shfrytëzuesi i Automjetit | Gjendja teknike e automjetit |
|---|---|---|---|
| 112-115-05 | Kia | I regjistruar | I rregullt |
| 112-116-05 | Mitsubish | I regjistruar | I rregullt |
| 112-125-05 | Nisan | I regjistruar | I rregullt |
| 112-133-05 | Iveco sulmues | I regjistruar | I rregullt |
| 112-127-05 | Iveco teknik | I regjistruar | I rregullt |
| 112-129-05 | Iveco tanker | I regjistruar | I rregullt |
| 112-126-05 | Volvo sulmus | I regjistruar | I rregullt |
| 112-128-05 | Volvo sulmus | I regjistruar | I rregullt |
| 112-179-05 | Mercedes sulmues | I regjistruar | I rregullt |
| 112-132-05 | Otokar | I regjistruar | I rregullt |
| 112-130-05 | Unimag malor | I regjistruar | I rregullt |
| 04Z-57-20 | Mercedes Autoshkall | I regjistruar | I rregullt |
| 04Z-56-20 | Daf | I regjistruar | I rregullt |
| 112-176-05 | Renault skenic | Qlajmërim | Defekt |
| 112-114-05 | Pezho | Qlajmërim | Defekt |
| 112-177-05 | Mercedes auto shkall | Qlajmërim | Defekt |
| 112-173-05 | Daf | Qlajmërim | Defekt |
| 112-175-05 | Mercedes tanker | Qlajmërim | Defekt |
| 112-172-05 | Fap | Qlajmërim | Defekt |
| 112-174-05 | Mercedes sulmus | Qlajmërim | Defekt |
| 112-171-05 | Magirus | Qlajmërim | Defekt |

**b. Zyra për Alarmim dhe Koordinim Emergjent**

Roli dhe rëndësia:

•Sigurimi me kohë i të dhënave (informacioneve) kualitative për të ndërmarrë vendime dhe aksione drejtuese për t'i përballuar situatat emergjente në komunë e me gjerë.

• Bën grumbullimin, ruajtjen dhe distribuimin e të gjitha informacioneve që kanë të bëjnë me të gjitha llojet e rreziqeve për jetën e njerëzve, qenieve të gjalla, pronës dhe ambientit.

• Kontrolli dhe komunikimet në operacionet emergjente.

• Koordinimi i ekipeve dhe pajisjeve emergjente.

• Bashkëpunon me të gjitha subjektet, ekipet dhe personelin tjetër të involvuar në situatat emergjente.

• Mosfunksionimi i ZAKE-së rrezikon shfaqjen e defekteve serioze në menaxhimin e emergjencave në komunë. Lidhjet dhe qasjet e ZAKE-së, me shërbimet emergjente, momentalisht me të gjitha shërbimet emergjente ZAKE, ka qasje përmes:

• Telefonisë fikse dhe asaj mobile të PTK-së;

• Rrjetit të radiovalëve në dy frekuenca, ndërsa në përspektivë planifikohet që në kuadër të modernizimit dhe përsosjes së teknikës edhe qasja përmes :

• Rrjetit të Internetit,

• Rrjetit të Intranetit, dhe

• Rrjetit të mikrovalëve. Qytetarët do të kenë mundësi të kontaktojnë **Zyrën për Alarmim dhe Koordinim Emergjent** përmes :

• Telefonisë fikse,

• Radiolidhjes, përmes bashkëpunëtorëve të ZAKE-së, në territorin e komunës, ndërsa në të ardhmen qytetarëve do t'u mundësohet qasja edhe përmes telefonisë mobile dhe Internetit.

**POLICIA E KOSOVËS**

Policia e Kosovës, në raste të aksidenteve të mëdha (katastrofave), do të kryejë:

• Rrethimin e  perimetrit të sigurisë në vend - incident;

• Sigurimin e kontrollit në vend të ngjarjes (zonën e incidentit);

• Sigurimin e lëvizjeve dhe të trafikut në vendin e ngjarjes dhe përreth vendit te ngjarjes;

• Evakuimin e qytetarëve në rast shpërthimi - eksplodimi nga objektet;

• Mbledhjen dhe shpërndarjen e informatave me interes me subjektet e tjera të involvuara në situata emergjente;

• Veprimet e hetuesisë në vendngjarje;

• Parandalimin e dukurive negative dhe vënien nën kontroll të situatës në rastet emergjente (vjedhjet, kaosi, anarkia, abuzimet e ndryshme etj);

• Mbështetje në sigurinë fizike të personelit komandues të incidentit.

**FORCA E SIGURISË SË KOSOVËS ( FSK )**

Force e Sigurisë së Kosovës, në rast të situatave emergjente, do t'i kryejnë gati të gjitha detyrat e emergjencës dhe do të jetë bashkëvepruese në këto raste. Brigada e BRSH – FSK-së, e cila operon në Jug të territorit të Kosovës, do:

•Të sigurojë shërbime në raste të shkatërrimeve;

•Të kryejë shërbime të kërkim-shpëtimit në situata të ndryshme emergjente, dhe angazhimi i tyre në eliminimin e pasojave të shkaktuara;

•Të sigurojë asistencën humanitare në regjione të izoluara;

•Të kryejë shërbime emergjente medikale;

•Të bëjë zbatimin e detyrave të transportit në rast të kërkesës;

•Të bëjë aktivizimin e mjeteve të paeksploduara;

•Ndihmë në zbatimin e evakuimeve, si dhe detyra të tjera, të cilat paraqiten në raste emergjente.

**SHËRBIMET MEDIKALE EMERGJENTE**

Ekipet profesionale të shërbimeve medicinale, janë bartëse kryesore të aktiviteteve në sferën e shpëtimit të jetës dhe mbrojtjes shëndetësore të qytetarëve në situata emergjente. Struktura organizative e shërbimeve medikale, të cilat veprojnë në territorin e komunës së Prizrenit, mundëson që në situata emergjente, të ofrojë shërbime cilësore si në terren (mobile) ashtu edhe në mjekimin stacionar. Kapacitetet medikale në kuptimin e kuadrit profesional, teknikës dhe pajisjes medicinale, si dhe të objekteve të tjera përcjellëse për veprim emergjent, në komunën e Prizrenit, janë relativisht të mira. Detyrat e ekipeve për shërbime medikale në situata emergjente:

•Ofrimi i ndihmës së parë medicinale në vendin e incidentit;

•Trijazhimi i personave të aksidentuar, plotësimi i kartonit të trijazhës së pacientit dhe mbajtja e evidencës;

•Evakuimi dhe bartja adekuate e personave të lënduar nga zona e fatkeqësisë në qendrat spitalore dhe repartet e tjera të specializuara medicinale;

•Marrja e masave preventive antiepidemiologjike, si dhe luftimi i vatrave të mundshme të paraqitjes së tyre;

•Aplikimi i sistemit të mbrojtjes karantinë me rastin e shfaqjes së sëmundjeve të ndryshme infektive e të tjera;

•Informimi i popullatës lidhur me gjendjen sanitare në terren dhe dhënia e udhëzimeve - këshillave adekuate medicinale për veprim në situata të caktuara emergjente;

•Asanimi i terrenit - lokacionit të aksidentuar;

•Planifikimi dhe krijimi i rezervave kritike në medikamente dhe produkte të tjera farmaceutike për funksionim adekuat në situata emergjente.

Tab . 59 Kontaktet e zyrave me të rëndësishme të komunës së Prizrenit

| **Nr rendor** | **Funksioni** | **Kontakti:** |
|---|---|---|
| 1 | Kryetari i Komunës | 038 200 44 700 |
| 2 | Asistentja e kryetarit | 038 200 44 702 |
| 3 | Nënkryetar i Komunës | 038 200 44 703 |
| 4 | Kryesus i Asamblesë komunale | 038 200 44 701 |
| 5 | Drejtoria për Administratë | 038 200 44 728 |
| 6 | Drejtoria për Ekonomi dhe Financa | 038 200 44 738 |
| 7 | Drejtoria për Urb. Plan. Mb. Mjedis | 038 200 44 731 |
| 8 | Drejtoria për Bujqësi e ZhR | 038 200 44 733 |
| 9 | Drejtoria për Arsim | 038 200 44 737 |
| 10 | Drejtoria për Shendetsisë MS | 038 200 44 711 |
| 11 | Drejtoria e Inspektorateve | 038 200 44 708 |
| 12 | Spitali rajonal i Prizrenit | 029 241 123 |
| 13 | Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport | 038 200 44 734 |
| 14 | Drejtoria për Shërbime Publike Komunale | 038 200 44 730 |
| 15 | Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë | 038 200 44 736 |
| 16 | Drejtoria Emergjencës dhe sigurisë | 038 200 44 732 |
| 17 | Policia | 192 |
| 18 | Zjarrëfikësi | 193 |
| 19 | Ndihma Shpejtë | 194 |
| 20 | KRU Hidroregjioni Jugor | 029 222 631 |
| 18 | Distribucioni i KEDS-it | 0800 791 00 |
| 19 | Shërbimet publike (Mbeturinat) | 038 200 44 750 |
| 20 | QKMF | 038 200 35 344 |
| 21 | Telekomi i Kosovës | 0800 10 000 |
| 22 | Shërbimi emergjent medikal | 029 623 931 |

**SHËRBIMET PUBLIKE**

Për funksionimin efikas të shoqërisë në situata emergjente civile, kontribut tejet të rëndësishëm japin shërbimet publike komunale, të cilat me organizimin dhe shkallën e tyre të gatishmërisë vepruese, ndikojnë direkt në kualitetin e menaxhimit të emergjencave. Ndërmarrjet të cilat kryesisht i japin ngjyrën infrastrukturës publike në territorin e komunës së Prizrenit, janë: SHP-ja, KEDS-i, PTK-ja, Ndërmarrja për pastrim, si dhe disa kompani nga sektori privat, që kryesisht merren me veprimtari shërbyese, furnizuese, transportuese, rrugore - ndërtimore dhe të pastrimit. Në situata emergjente, secila nga fushëveprimtaria e saj:

•Zbaton vendimet e Komitetit Komunal për Menaxhim Emergjent dhe për aktivitetet e saja i përgjigjet këtij organi;

•Merr pjesë aktive në punën e këtij Komiteti dhe jep propozimet konkrete për tejkalimin e gjendjes emergjente, duke u bazuar në profesionalizmin dhe përvojat nga fushëveprimtaria e tyre;

•Me kohë bëjnë planifikimin e resurseve njerëzore dhe teknike për funksionim racional në situata emergjente dhe lidhur me këtë njofton KKME-në mbi mundësitë reale të tyre.

•Caktojnë prioritetet në kryerjen e shërbimeve të tyre, dhe me pëlqim të KKME-së, vendos disiplinimin e vet të kryerjes së shërbimeve.

**ORGANIZATAT JOQEVERITARE**

Në situata emergjente, organizatat joqeveritare bëjnë:

•Sensibilizimin e opinionit të brendshëm dhe të jashtëm lidhur me situatën emergjente;

•Informimin e drejtë lidhur me masat dhe veprimet, të cilat subjektet involvuese, në situata emergjente, ndërmarrin për tejkalimin e gjendjes së krijuar;

•Parandalojnë panikun dhe shpërndarjen e dezinformatave të qytetarët;

•Hartimi i projekteve të cilat janë në funksion të përballimit të situatave emergjente në komunë;

•Krijimi i fondeve emergjente dhe thithja e donacioneve të ndryshme për plotësimin e nevojave akute;

•Pjesëmarrja aktive në furnizimin e qytetarëve nga zonat e aksidentuara me artikuj dhe gjëra të tjera elementare për jetesë;

•Pjesëmarrja aktive në lëmin e evakuimit dhe të strehimit;

•Bëjnë kërkime për burime të mëtejme për nevoja emergjente;

•Bashkëpunimi i ngushtë reciprok i tyre me të gjitha subjektet involvuese në emergjenca;

•Hartimi i analizave, i raporteve, i bilanceve dhe përpunimi i treguesve (indikatorëve) përmes të cilave përcillen rrjedhat në situata emergjente.

# KREU I VIII-TË

## 8. VLERËSIMET PËRFUNDIMTARE –SPECIFIKE

### 8.1. Vlerësimet pëfundimtare

Vlerësimet për masat e mbrojtjes dhe shpëtimit, sidomos në kontekstin e Fatkeqësive Natyrore, janë të domosdoshme për të siguruar gatishmërinë dhe efektivitetin e reagimit. Këtu janë disa pika kyçe që duhen marrë parasysh:

**1. Vlerësimi i Masave të Mbrojtjes**

Identifikimi i Masave: Përcaktimi i masave të nevojshme për mbrojtjen e individëve dhe infrastrukturës (p.sh., ndërtimi i mbrojtjeve nga përmbytjet, rregullimi i zonave të ndjeshme).

Eficienca e Masave: Vlerësimi i efektivitetit të masave ekzistuese në parandalimin e fatkeqësive ose lehtësimin e pasojave.

**2. Mundësitë Reale për Mbështetje**

Analiza e Kapacitetit: Vlerësimi i infrastrukturës dhe burimeve të nevojshme për të mbështetur masat e mbrojtjes (p.sh., rrugët, qendrat e shpëtimit).

Pjesëmarrja e Komunitetit: Aktivizimi i qytetarëve dhe organizatave lokale në mbështetje të masave të mbrojtjes.

**3. Vlerësimi i Resurseve Njerëzore**

Numri dhe Kualifikimi i Personelit: Vlerësimi i numrit të punonjësve të trajnuar dhe të kualifikuar për të përballuar situata emergjente.

Formimi dhe Trajnimi: Identifikimi i nevojave për trajnime të mëtejshme dhe zhvillimin e kapaciteteve.

**4. Vlerësimi i Resurseve Materiale**

Inventari i Pajisjeve: Përcaktimi i pajisjeve dhe mjeteve të nevojshme për reagim (p.sh., automjete shpëtimi, pajisje të komunikimit).

Financimi: Analiza e burimeve financiare të nevojshme për të mbështetur operacionet e mbrojtjes dhe shpëtimit.

**5. Planifikimi dhe Koordinimi**

Plani i Reagimit: Hartimi i një plani të detajuar për reagim në situata emergjente, duke përfshirë rolet dhe përgjegjësitë e secilës agjenci.

Koordinimi Ndër-agjencor: Sigurimi i një sistemi efektiv të komunikimit dhe koordinimit midis agjencive dhe organizatave të ndryshme.

**6. Monitorimi dhe Rishikimi**

Vlerësimi Pas-incident: Pas çdo fatkeqësie, analiza e performancës së masave dhe reagimit, për të identifikuar forcët dhe dobësitë.

Përditësimi i Planeve: Rishikimi dhe përditësimi i masave të mbrojtjes dhe planit të reagimit në përputhje me mësimet e nxjerra. Këto vlerësime përbëjnë një hap të rëndësishëm në krijimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe efektiv për mbrojtje dhe shpëtim, duke siguruar që resurset janë të përdorura në mënyrë optimale për të përballuar pasojat e Fatkeqësive Natyrore.

### 8.1.1. Vlerësimet për strukturën dhe madhësinë e forcave për reagim emergjent

Vlerësimi i strukturës dhe madhësisë së forcave për reagim emergjent është një proces kyç për të siguruar gatishmërinë dhe efektivitetin e përgjigjes ndaj situatave emergjente. Ky vlerësim përfshin disa komponentë kryesorë:

**1. Analiza e Rrezikut**

Identifikimi i Rreziqeve: Njohja e llojeve të situatave emergjente (zjarre, përmbytje, tërmete, etj.).

Vlerësimi i Ndikimit: Kuptimi i ndikimit potencial të këtyre rreziqeve mbi komunitetet dhe infrastrukturën.

**2. Struktura e Forcave**

Organizata e Reagimit: Përcaktimi i strukturës organizative, përfshirë rolet dhe përgjegjësitë e secilës njësi (policia, zjarrfikësit, shërbimet mjekësore, etj.). Koordinimi: Krijimi i mekanizmave të koordinimit midis agjencive dhe organizatave të ndryshme që merren me emergjencat.

**3. Madhësia e Forcave**

Numri i Anëtarëve: Vlerësimi i numrit të nevojshëm të punonjësve për të përballuar situatat emergjente, duke marrë parasysh madhësinë dhe kompleksitetin e rrezikut.

Specializimi: Përcaktimi i nevojave për trajnim të veçantë dhe ekspertizë në fusha të caktuara (p.sh., shpëtimi nga uji, ndihma mjekësore emergjente).

**4. Kapaciteti dhe Burimet**

Burimet Materiale: Vlerësimi i pajisjeve dhe mjeteve që nevojiten për reagim (automjete, pajisje komunikimi, mjete shpëtimi).

**5. Trajnimi dhe Simulimet**

Programet e Trajnimit: Zhvillimi i trajnimeve për stafin e reagimit dhe organizimin e ushtrimeve për të provuar gatishmërinë. Simulime të Situatave: Kryerja e stërvitjeve për të testuar dhe vlerësuar strukturën dhe procedurat e reagimit.

**6. Pjesëmarrja e Komunitetit**

Edukimi i Publikut: Ngritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi procedurat e emergjencës dhe mënyrat e ndihmës. Inkurajimi i Vullnetareve: Aktivizimi i qytetarëve në grupe vullnetarësh që mund të ndihmojnë në situata emergjente, Ky vlerësim ndihmon në ndërtimin e një sistemi të fortë dhe efektiv për reagim emergjent, duke siguruar që forcate janë të përgatitura dhe të gatshme për të përballuar çdo situatë që mund të ndodhë.

## 8.2. KOSTOJA FINANCIARE E DOKUMENTIT TË VLERËSIMIT;

### 8.2.1. Identifikimi dhe analizmi i rreziqeve nga FNFT

Komuna e Prizrenit, do të ndanë mjete për 3 vitet e ardhshme. DVRR (Dokuementi i vlerësimit te rreziqeve) synon realizimin e projekteve me qellim të ndërmarrjes se masave parandaluese dhe zvogëlim të rreziqeve nga FNTF. Per periudhën 2025-2028 Komuna e Prizrenit do të ndanë mjete financiare si me poshtë:

Tab 60. Projektet e planifikuar per 3 vitet e ardhshme për ndërmarrjes se masave parandaluese dhe zvogëlim të rreziqeve nga FNTF

| Objektivi | Masa | Faza 1 (2025-2026) | Faza 2 (2026-2027) | Faza 3 (2027-2028) | Kosto e afërt në (euro) | Përgjegjësia Institucionale | Rreziku |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.1 | Ngritja e Grupeve Vullnetare | x | x | x | 0 | Komuna e Prizrenit,AME | Mungesë vullnetarësh, mungesë eksperiencë në menaxhimin e vullnetarëve |
| 1.2 | Trajnimi i Grupeve Vullnetare | x | x | x | 3,000 | Komuna e Prizrenit,AME | Mungesë Vullnetarësh; mungesë fondesh |
| 1.3 | Trajnimi i Komunitetit | x | x | x | 3,000 | Komuna e Prizrenit,AME | Mungesë eksperience për trajnimin e komunitetit; mungesë përfshirje nga komuniteti; |
| 1.4 | Fushata Informimi Komuniteti | x | x | x | 4,000 | Komuna e Prizrenit, AME, Mediat lokale | Mungesë bashkëpunimi me media lokale |
| 1.5 | Fushata Ndërgjegjësimi për pastrimin e kanaleve nga Fermeret | x | x | x | 1,000 | Ministria Bujqësisë , Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komuna | Mungesë bashkëpunimi nga fermerët; mungesë angazhimi në pastrimin e kanaleve; |
| 1.6 | Fushata Ndërgjegjësimi për rrezikun ndaj zjarrit në pyje | x | x | x | 1,000 | Ministria Bujqësisë , Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komuna | Mungesë kapaciteti për menaxhimin e pyjeve; mungesë interesi nga komuniteti; |
| 1.7 | Ngritja dhe mirëmbatja e databazës së GIS dhe trajnimi i Stafit | x | x | x | 3,000 | Komuna e Prizrenit | Mungesë infrastruktures (kompjuter/ programe); mungesë bashkëpunimi midis sektorëve |
| 1.8 | Pastrimi i Kanaleve | x | x | x | 100,000 | Ministria Bujqësisë , Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komuna | Mungesë fondesh; mungesë bashkëpunimi midis nivelit qëndror dhe atij lokal |
| 1.9 | Ndertimi i kanaleve për mbrotje nga vërshimet | x | x | x | 700,000 | Komuna e Prizrenit | Mungesë fondesh |
| 1.10 | Mirëmbajtja e rrugëve nga ngricat | x | x | x | 200,000 | Komuna e Prizrenit, Ministria e Mjedisit dhe Infrastrukturës | Mungesë fondesh; mungesë bashkëpunimi midis nivelit qëndror dhe atij lokal |
| 1.11 | Ndërtimi i urave të reja në vend të urave të vogla dhe të vjetra | x | x | x | 1,000,000 | Komuna e Prizrenit dhe Ministria e Mjedisit dhe Infrastrukturës | Mungesë fondesh; mungesë bashkëpunimi midis nivelit qëndror dhe atij lokal |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.12 | Studim sizmik për ndërtesat me moshë mbi 30 vjet | | x | x | 10,000 | Komuna e Prizrenit, Instituti Gjeologjik i Kosovës | Mungesë bashkëpunimi midis nivelit qëndror dhe atij lokal |
| 1.13 | Studim sizmik për ndërtesat me rëndësi të veçantë | | x | x | 6,000 | Komuna e Prizrenit, Instituti Gjeologjik i Kosovës | Mungesë bashkëpunimi midis nivelit qëndror dhe atij lokal |
| 1.14 | Studim dhe Monitorim i Zonave me rrezik Rrëshqitje | | x | x | 3,000 | Komuna e Prizrenit, Instituti Gjeologjik i Kosovës | Mungesë bashkëpunimi midis nivelit qëndror dhe atij lokal |
| 1.15 | Ndërtimi i mureve mbojtëse (për tu shmangur erozionit) | x | x | x | 1,500,000 | Komuna e Prizrenit | Mungesë fondesh |
| 1.16 | Pyllëzimi i Zonave Pyjore të Djegura | x | x | x | 20,000 | Agjencia e Pyjeve dhe Komuna e Prizrenit | Mungesë bashkëpunimi midis nivelit qëndror dhe atij lokal |
| 1.17 | Rehabilitimi dhe mirëmbatja e sistemit te kanalizimit dhe ujësjellësit | x | x | x | 2,500,500 | Hidroregjioni Jugor , Komuna e Prizrenit | Mungesë fondesh |
| 1.18 | Hartimi i Planeve të Evakuimit në ndërtesa të rëndësisë së veçantë dhe vendosja e sinjalistikës së nevojshme | x | x | x | 30,000 | Komuna e Prizrenit | Mungesë fondesh |
| 1.19 | Plotësimi i nevojave me pajisje për rastet e emergjencave | x | x | x | 8,000 | Komuna e Prizrenit, AME | Mungesë fondesh |
| 1.20 | Ngritja e Sistemeve të Alarmit | x | x | x | 10,000 | Komuna e Prizrenit, AME | Mungesë fondesh |

Të gjitha strukturat, të cilat kanë përgjegjësi dhe detyrime për situatat emergjente civile, duhet të jenë të pavarura në veprime, në mënyrë që të jenë në gjendje të veprojnë menjëherë dhe në çdo kohë. Është më se e nevojshme që strukturat të kenë mundësi për të siguruar mjete financiare të mjaftueshme për veprim. Duhet të merren të gjitha masat që pajisjet, mjetet e transportit, nafta, kostot e komunikimit që parashikohen të nevojshme, të jenë në dispozicion dhe të bëhen paraprakisht të përdorshme nga të gjitha strukturat e përfshira në situata emergjente, në mënyrë që të fillojë menjëherë veprimi.

Kostot financiare sekondare: Gjatë zhvillimit të situatës emergjente, problemet financiare rriten dhe bëhen afatgjata. Këtu përfshihen kostot për orë shtesë të përsonelit, kostot për sigurimin dhe vënien në funksion të pajisjeve të specializuara dhe të mjeteve të transportit, si dhe kostot për sigurimin e vendstrehimeve, asistencën mjekësore dhe ato humanitare në përgjithësi, për ata që janë të prekur nga situata emergjente. Këto shpenzime përbëjnë probleme afatgjata buxhetore dhe duhet të planifikohen.

Kostot financiare për rimekëmbje: Në të shumtën e rasteve, janë të lidhura me përpjekjet për stabilizimin e situatës para rikthimit të fazës në gjendjen normale. Këto mund të përfshijnë kostot për: ¬ Riparimin e ndërtesave, ¬ Të infrastrukturës, ¬ Të ujit, ¬ Të energjisë elektrike, ¬ Të strehimit për të gjithë ata të cilët për një përiudhë më të gjatë kohore nuk mund të kthehen në shtëpitë e tyre, këto burime financiare buxhetore duhet të garantohen nëpërmjet procedurave të brendshme, duke krijuar mekanizma lehtësuese për përdorim në mënyrë sa më të efektshme në situata emergjente.

### 8.2.2. Identifikimi i nevojave për resurset humane dhe teknike;

Për territorin e komunës se Prizrenit ka nevoje të ngritën kapacitetet si:

a. Ekipi profesional, afër 150 persona;
b. Vullnetarët nga Shoqata e zjarrëfikseve (sipas rastit dhe nevojës);

c. Identifikimi i kapaciteteve për nevoja elementare ( shtretër, shatorre, batanije, pako higjenike, pako ushqimore, stufa për nxemje etj);

d. Momerandum bashkëpunimi me kompanitë vendore për aktivizimin e paisjeve teknike ne rastet emergjente (për hapjen e rrugëve, të kanaleve etj);

e. Makineritë e tjera te nevojshmem - afër 30 (Kamione, zjarrfikëse, dhe mjetet e tjera per transportin e njerëzve).

#### 8.2.3. Identifikimi i nevojave për trajnim dhe aftësim profesional;

Pasi të krijohet ekipi për reagim emergjent (ERE), Komuna e Prizrenit,kërkon trajnim dhe çertifikim profesional nga AME-në.

#### 8.2.4. Zbatimi i akteve ligjore, nënligjore dhe monitorimi i tyre;

Komuna e Prizrenit bazohet në rregulloren nr (QRK) 18/2015 per organizimin e Njësive të SMSHN.

#### 8.2.5. Masat parandaluese për zvogëlimin e efekteve nga FNFT;

Rregullimi i shtretërve te lumejve,

Rritja e kapaciteteve humane dhe teknike

Rritja e kapaciteteve në shëndetësi me staf human dhe teknik,

Aktivizimi i ekipeve reaguse emergjente në periudhën e thatësirave

Realizimi i projekteve që ndikojnë në zvogëlimin e rreziqeve;

## 9. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

**Bazuar në dispozitat përfundimtare të rregullores nr 25/2022 për metodologjinë e hartimit të dokumentit të vlerësimit të rrezikshmërisë, rishikimi pasues i dokumentit të vlerësimit për komunën e Prizrenit të bëhet çdo tre vjet, në raste specifike, sipas nevojës edhe më herët.**
Hartimi i "Dokumentit të Vlerësimit të Rrezikshmerisë nga FNFT është i bazuar ne Ligjin 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera; Në grumbullimin e të dhënave për azhurnimin e Dokumentit janë shfrytëzuar burime nga: ASK (Agjencia e Statistikave të Kosovës), KEDS, Policia e Kosovës, stacioni i Prizrenit, Qendra për punë sociale, QKMF, KRU "Hidroregjioni jugor", Enti për punësim. Drejtoritë përkatëse te Kuvendit Komunal Prizrenit, Plani Zhvillimor i Komunës, si dhe burime të tjera nga literatura të ndryshme. Dokumenti u hartua me ndihmën e grupit punues i caktuar nga Kryetari i komunës se Prizrenit, z. Shaqir Totaj.

## 10. REKOMANDIME

Në kuadër të Dokumentit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë nga FNFT për komunën e Prizrenit , grupi punues rekomandon që:

1. Dokumenti i Vlerësimit të merret në konsideratë dhe për bazë gjatë hartimit të planeve të reagimit emergjent, planeve operative dhe planeve tjera sipas legjislacionit përkatës në fuqi;

2. Hartojë programin (edukimin, trajnimin dhe vetëdijësimin qytetar) si  dhe masat parandaluese për tri vitet e ardhshme;
3. Merret si bazë  për analizimin e  nëvojave dhe fuqizimin e kapaciteteve reaguese;
4. Të hartojë skenarët dhe  ushtrimin e tyre me qëllim të testimit të  kapaciteteve reaguese humane dhe teknike;
5. Ndajë  një fond për reagim  emergjent bazuar në  historikun  e fatkeqësive për  komunën e Prizrenit dhe vlerësimin e dëmeve dhe pasojave;

**REFERENCAT:**


1. Ligji Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera LIGJI NR. 04/L-027 PËR MBROJTJE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA (rks-gov.net)
2. RREGULLORE (QRK) Nr. 25/2020 PËR METODOLOGJINË E HARTIMIT TË VLERËSIMIT TË RREZIKSHMËRISË (rks-gov.net)
3. Plani Zhvillimor komunal i komunës se Prizrenit
4. Harta Zonale e komunës së Prizrenit
5. Agjencia Kadastrale e Kosovës – Ortofotot e vitit 2018 http://geoportal.rks-gov.net/search
6. Agjencia e Statistikave të Kosovës https://ask.rks-gov.net/
7. Instituti Hidro-meteorologjik i Kosovës , https://ihmk-rks.net/ (https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Vjetari_final_2022-al.pdf)
8. Vlerësimi i rreziqeve nga Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, Prishtinë Korrik 2016, Vleresimi i Rreziqeve nga Fatkeqësite Natyrore....pdf (rks-gov.net)
9. Raportet e vlerësimeve nga Komuna e Prizrenit
10. Zyra e KEDS në Prizren
11. Zyra e Ujësjellësit në komunën e Prizrenit (Hidro regjioni Jugor)
12. Puna në terren nga ekipet profesionale

KOMUNA E PRIZRENIT

Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë

# VLERËSIMI I RREZIKSHMËRISË NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA PËR KOMUNËN E PRIZRENIT

# ANEKSI I HARTAVE

## Draft

## Prizren 2024




Harta 1. Pozita gjeografike e komunës së Prizrenit në Kosovë




Harta 2. Harta fizike e Kosovës dhe ajo morfologjike e komunës së Prizrenit




Harta 3. Vendbanimet dhe zonat kadastrale të komunës së Prizrenit




Harta 4. Rrjeti hidrografik në Kosovë dhe në Komunën e Prizrenit, Burimi i të dhënave: Vjetari statistikor 2023 Agjencia e Statistikave të Kosovës




Harta 5. Rrjeti hidrografik në Komunën e Prizrenit




Harta 6. Dendësia e popullsisë në komunën e Prizrenit sipas rrjetit 1km x 1km




Harta 7. Dendësia e popullsisë në komunën e Prizrenit sipas vendbanimeve




Harta 8. Shpërndarja e popullsisë në Komunën e Prizrenit




Harta 9. Organizimi i procesit mësimor sipas tipit të shkollave fillore, te mesme dhe fakultetet




Harta 10. Asetet e trashëgimisë kulturore në komunën e Prizrenit




Harta 11. Trashëgimia natyrore në komunën e Prizrenit




Harta 12. Zonë turistike me interes të veqantë për komunën e Prizrenit




Harta 13. Parku Nacional “Mali Sharr” në Komunën e Prizrenit




Harta 14. Shtrirja e pyjëve në Komunën e Prizrenit




Harta 15. Pozita e PN "Mali Sharr" në Kosovë dhe rajon




Harta 16. Struktura dhe shpërndarja e tokave bujqësore në komunën e Prizrenit (zoonimi agroekologjik)




Harta 17. Zonat industriale në komunën e Prizrenit.




Harta 18. Harta turistike e Komunës së Prizrenit



Harta 19. Trashëgimia kulturore dhe natyrore në komunën e Prizrenit



Harta 20. Shtrirja hapësinore e objektëve shëndetësore në Komunën e Prizrenit




Harta 21. Infrastruktura e transportit në komunën e Prizrenit




Harta 22. Harta e zonave të rrezikshmerisë nga bora dhe ngricat në Komunën e Prizrenit




Harta 23. Segmenti i transportit hekurudhor lokal  në komunën e Prizrenit




Harta 24. Rrjeti  hekurudhor-urat në rrjetin hekurudhorë në komunën e Prizrenit




Harta 25 Urat  në komunën e Prizrenit



Harta 26 Urat dhe tunelet në Komunën e Prizrenit




Harta 27. Rrjeti elektro-energjetike në komunën e Prizrenit




Harta 28. Shpërndarja e antenave/kullave shpërndarëse të telefonisë mobile




Harta 29 Furnizimi me ujë të pijshëm në komunën e Prizrenit




Harta 30 Deponia e mbeturinave në rajonin e Prizrenit




Harta 31. Sistemi i shpërndarjes së naftës dhe gazit në komunën e Prizrenit




Harta 32 Objektet e sigurisë në Komunën e Prizrenit




Harta 33 Objektet me rëndësi dhe hapësirat qeveritare në Komunën e Prizrenit




Harta 34. Objektet financiare në Komunën e Prizrenit ,



Harta 35 Objektet edukative-arsimore  në Komunën e Prizrenit




Harta 36 Zonat e rrezikshmerisë nga vërshimet në komunën e Prizrenit




Harta 37 Vendbanimet e prekura nga vërshimet në komunen e Prizrenit




Harta nr 38 Zonat e vërshuara- përmbytura në komunën e Prizrenit




Harta 39. Reliefi i Komunës së Prizrenit



Harta 40. Harta e sizmicitetit për teritorin e Kosovës , Epiqendrat e tërmeteve me magnitudë ≥ 3.5, Periudha 1456-2021




Harta nr 41 Harta e rrezikut sizmik për teritorin e  kosovës, viti 2009




Harta 41. Zonat e populluara të ekspozuara në zonat sizmike




Harta 42. Zonat e rrezikshmërisë nga rrëshqitja dhe erozioni në komunën e Prizrenit




Harta 43. Rrugët e rrezikuara nga ngricat në komunën e Prizrenit




Harta 44. Vendbanimet e prekura nga breshëri në komunën e Prizrenit




Harta 45. Lokacioni i rrezikuar nga Orteqet në komunën e Prizrenit




Harta 46. Vendbanimet e prekura nga Erat në komunën e Prizrenit




Harta 47. Vendbanimet e prekura nga Thatësira në komunën e Prizrenit




Harta 48. Harta e shfrytëzimit të tokës në Komunën e Prizrenit




Harta 49: Hart e zonave të rrezikuar nga termetet në Komunën e Prizrenit




Harta 50: Harta e ndërtesave në Komunën e Prizrenit




Harta 51. Harta e zonave të rrezikshmerisë nga zjarri në Komunën e Prizrenit




Harta 52: Vendbanimet e prekura nga  Erozioni në Komunën e Prizrenit




Harta 53. Vendbanimet e prekura nga Zjarret në Komunën e Prizrenit




Harta 54. Vendbanimet e prekura nga vërshimet në Komunën e Prizrenit




Harta 55. Të reshurat mesatare në mm në Komunën e Prizrenit




Harta 56: Harta e Integruar e rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera në Komunën e Prizrenit

Në bazë të Nenit 12, paragrafit 1 dhe 2(d) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, viti III, nr. 28, 4 qershor 2008), në mbështetje të nenit 9, paragrafi 9 i Ligjit Nr.02/L – 088 për Trashëgiminë Kulturore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, viti III, nr. 29, 1 korrik 2008) dhe neni 8 paragrafi 2, dhe nenit 9, të Ligjit nr. 08/L-245 për Artin dhe Kulturën (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 4, 11 janar 2024), si dhe dispozitave përkatëse për trashëgiminë kulturore nga Ligji Nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11, 1 prill 2007), Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur me datë __/__/2025, miratoi:

**PROPOZIM-VENDIM**
**PËR THEMELIMIN E MUZEUT TË NËNËS TEREZË**

1.

Me këtë vendim themelohet “Muzeu i Nënës Terezë” në Prizren.

2.

Muzeu do të paraqet jetën dhe trashëgiminë e Nënës Terezë si personalitet që promovon humanizmin, dashurinë, kujdesin dhe bamirësinë, duke kontribuar për trashëgiminë kulturore dhe promovuar atë, bashkë me aktivitetet tjera shoqërore të ndërlidhura.

3.

Selia e Muzeut ndodhet në qytetin e Prizrenit, në zonën e Qendrës së Mbrojtur Historike të Prizrenit, rruga “Sheshi i Shatërvanit” ku edhe zhvillohet veprimtaria kryesore e Muzeut.

4.

Muzeu ka statusin e institucionit të shërbimit publik që ushtron veprimtari muzeore në përputhje me legjislacionin në fuqi për kulturë dhe atë që rregullon organizimin dhe fushëveprimtarinë e muzeve në Republikën e Kosovës.

5.

Fushëveprimi, përgjegjësitë, organet drejtuese dhe struktura organizative, mënyra e financimit dhe çështjet tjera rreth organizimit të Muzeut do të përcaktohen me Statut dhe aktet tjera normative të Muzeut.

6.

Obligohet Kryetari i Komunës, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe organet tjera përkatëse për zbatimin e këtij Vendimi.

7.

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Prizren, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Na osnovu člana 12, stav 1 i 2(d) Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi (Službeni list Republike Kosovo, godina III, br. 28, 4. jun 2008), oslanjajući se na član 9, stav 9 Zakona br. 02/L - 088 o Kulturnom Nasleđu (Službeni list Republike Kosovo, godina III, br.29 1 jul 2008) i član 8 stav 2, i član 9, Zakona br. 08/L-245 za Umetnost i Kulturu (Službeni list Republike Kosovo, br. 4, 11. januar 2024. godine), kao i relevantne odredbe za kulturno nasleđe iz Zakona br. 02/L-57 za Institucije Kulture (Službeni list Republike Kosovo, br. 11, 1. april 2007.), Skupština opštine Prizren je na sednici održanoj __/__/2025. godine usvojila:

**PREDLOG-ODLUKU**
**ZA OSNIVANJE MUZEJA MAJKE TEREZE**

1.

Ovom odlukom osniva se „Muzej Majke Tereze“ u Prizrenu.

2.

Muzej će predstaviti život i naslijeđe Majke Tereze kao ličnosti koja promoviše humanost, ljubav, brigu i dobročinstvo, doprinoseći kulturnom naslijeđu i promovisanju istog, uz druge praćene društvene aktivnosti.

3.

Sedište Muzeja se nalazi u gradu Prizrenu, u zoni Zaštićenog istorijskog centra Prizrena, u ulici „Trg Šadrvana“, gde se i odvija glavna delatnost Muzeja.

4.

Muzej ima status javne službe koja obavlja muzejsku delatnost u skladu sa važećim zakonima o kulturi i onim koji reguliše organizaciju i delokrug muzeja u Republici Kosovo.

5.

Djelokrug, nadležnosti, organi upravljanja i organizaciona struktura, način finansiranja i druga pitanja u vezi sa organizacijom Muzeja utvrđuju se Statutom i drugim normativnim aktima Muzeja.

6.

Obavezuje se Gradonačelnik opštine, Direktorijat za Kulturu, Omladinu i Sport i ostali odgovarajući organi za sprovođenje ove odluke.

7.

Nakon usvajanja od strane Skupštine opštine Prizren, ova odluka stupa na snagu 30 dana nakon slanja nadzornom organu, u skladu sa članom 8, u vezi sa članom 9, Zakona br. 08/L-284, za administrativni pregled akata opština, objavljen u „Službenom listu Republike Kosovo, br. 24/2024“ i nakon javnog objavljivanja na oglasnoj tabli i službenoj web stranici Opštine.

Gradonačelnik Opštine
Shaqir Totaj

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

03/L-040 sayılı Yerel Yönetim Kanunu'nun (Kosova Cumhuriyeti Resmî Gazetesi'nde yayımlanan, III. yıl, 28 sayılı 4 Haziran 2008 tarihli) 12. maddesinin 1. ve 2(d) fıkralarına, 02/L-088 sayılı Kültürel Miras Kanunu'nun 9. maddesinin 9. fıkrasına, 08/L-245 sayılı Sanat ve Kültür Kanunu'nun 8. maddesinin 2. fıkrası ile 9. maddesine, ayrıca 02/L-57 sayılı Kültürel Kurumlar Kanunu'nda belirtilen ilgili hükümler çerçevesinde dayanılarak, Prizren Belediye Meclisi'nin __/__/2025 tarihinde yapılan toplantısında aşağıdaki karar alınmıştır:

**RAHİBE TERESA MÜZESİNİN KURULMASI HAKKINDA**
**ÖNERİ - KARAR**

1.

İş bu Karar ile Prizren' de "Rahibe Teresa Müzesi" kurulur.

2.

Müze, Rahibe Teresa'nın yaşamını ve mirasını, insan sevgisini, merhameti, bakımı ve hayırseverliği teşvik eden bir şahsiyet olarak sunacak; kültürel mirasa katkıda bulunacak ve bunu diğer sosyal faaliyetlerle birlikte tanıtacaktır.

3.

Müzenin merkezi, Prizren şehrinde, Prizren'in Korunan Tarihi Merkez Bölgesi'nde, "Sheshi i Shatërvanit" caddesinde yer almakta olup, müzenin ana faaliyetleri de burada yürütülmektedir.

4.

Müze, kültür alanındaki yürürlükteki mevzuata ve Kosova Cumhuriyeti'nde müzelerin organizasyonunu ve faaliyet alanlarını düzenleyen yasal çerçeveye uygun olarak müzecilik faaliyetlerini yürüten bir kamu hizmet kurumu statüsüne sahiptir.

5.

Müzenin faaliyet alanı, sorumlulukları, yönetim organları ve organizasyon yapısı, finansman şekli ve diğer organizasyonel konular Müze'nin Tüzüğü ve diğer normatif aktlarla belirlenecektir.

6.

Belediye Başkanı, Kültür, Gençlik ve Spor Müdürlüğü ile diğer ilgili organlar, bu Kararın uygulanmasını sağlamakla yükümlüdür.

7.

Prizren Belediye Meclisi tarafından onaylanmasının ardından, bu karar, 08/L-284 sayılı "Belediyelerin İdari İşlemlerinin Gözden Geçirilmesi" Kanunu'nun 8. ve 9. maddeleri uyarınca, gözetim organına gönderilmesinden 30 gün sonra yürürlüğe girer ve Prizren Belediyesi'nin resmi internet sitesi ve duyuru panosunda yayımlandıktan sonra resmiyet kazanır.

Belediye Başkanı
Shaqir Totaj

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**



# RAPORTI I REALIZIMIT TË BUXHETIT

# PËR PERIUDHËN TETOR -DHJETOR 2024

**Janar 2025, Prizren**

**PASQYRA E TË HYRAVE TË BUXHETIT KOMUNAL**
**PËR PERIUDHËN TETOR -DHJETOR 2024**

| Të hyrat | Buxheti me ndryshime 2024 | Shpenzimet X-XII-2024 | Ind. Shp./ plan |
|---|---|---|---|
| **Granti qeveritar 2024** | 55,977,138 | 15,354,199 | 27.43 |
| **Të hyrat vetanake 2024** | 10,193,294 | 3,708,463 | 36.38 |
| **Të hyrat vetanake te bartura nga 2023** | 3,270,691 | 1,173,137 | 35.87 |
| **Te hyrat nga donacionet e brendshme - participimi** | 564,068 | 430,864 | 76.39 |
| **Donacionet e jashtme** | 371,630 | 89,530 | 24.09 |
| **Financimet nga huamarrjet** | 1,000,000 | - | - |
| **Totali** | **71,376,821** | **20,756,192** | **29.08** |

Për periudhën Tetor-Dhjetor shuma e shpenzuar nga granti qeveritar, i planifikuar për vitin 2024 prej 55,977,138 €, është 15,354,199 € ose 27.43% .

Gjatë periudhës Tetor-Dhjetor 2024 nga të hyrat vetanake të planifikuara prej 10,193,294€ janë shpenzuar 3,708,463 € ose 36.38% e shumës së parashikuar për vitin aktual.

Shpenzimi nga të hyrat vetanake të bartura nga viti paraprak për periudhën Tetor-Dhjetor 2024 ka qenë 1,173,137€ ose 35.87% e shumës së parashikuar prej 3,270,691 €.

Të hyrat prej participimit me popullatën, në periudhën Tetor-Dhjetor 2024, janë shpenzuar në shumë prej 430,864 ose 76.39% e shumës së planifikuar prej 564,068 €.

Gjatë periudhës Tetor-Dhjetor të vitit 2024, nga kategoria e të hyrave nga donatorët e jashtëm janë shpenzuar 89,530 € ose 24.09 % e shumës së planifikuar prej 371,630 €.

Të hyrat prej financimit nga huamarrjet gjatë periudhës Tetor-Dhjetor 2024 janë planifikuar në shumë prej 1,000,000 €. Shpenzim nga këto të hyra nuk ka patur.

Nga të ardhurat totale të planifikuara të buxhetit komunal prej 71,376,821 € për periudhën Tetor-Dhjetor të vitit 2024 janë shpenzuar 20,756,192 € ose 29.08% e shumës së planifikuar .

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shpenzimet sipas burimeve të financimit.



## TË HYRAT VETANAKE TË BUXHETIT KOMUNAL
## PER PERIUDHËN TETOR -DHJETOR 2024

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë të hyrat vetanake të arkëtuara për periudhën Tetor-Dhjetor 2024 të kategorizuara në bazë të grupeve.

Shuma e tërësishme e arkëtuar e të hyrave vetanake komunale për periudhën Tetor-Dhjetor 2024 është 2,261,373 € ose 22.18% e shumës së planifikuar prej 10,193,294 € .

| | Planifikimi 2024 | % | Realizimi X-XII-2024 | Real./plan % |
|---|---|---|---|---|
| **Liçensat komerciale dhe të biznesit / Lejet** | 30,000 | 0.29 | 3,753.94 | 12.51 |
| **Shfrytëzimi i tokës dhe lejet e ndërtimit** | 2,050,000 | 20.11 | 485,030.75 | 23.66 |
| **Inspektimi i tokës dhe aktivitetet gjeodezike** | 200,000 | 1.96 | 25,898.00 | 12.95 |
| **Shërbimet e inspektimit të Shëndetit dhe Sigurisë** | 265,000 | 2.60 | 47,410.42 | 17.89 |
| **Shfrytëzimi i pronës Komunale** | 175,000 | 1.72 | 71,074.90 | 40.61 |
| **Pagesat në lidhje me automjetet** | 1,600,000 | 15.70 | 734,524.17 | 45.91 |
| **Çertifikatat dhe dokumentet zyrtare** | 600,000 | 5.89 | 91,638.00 | 15.27 |
| **Tatimi në pronë** | 3,203,294 | 31.43 | 466,999.20 | 14.58 |
| **Të ardhurat tjera** | 150,000 | 1.47 | 32,485.00 | 21.66 |
| **Menaxhimi I mbeturinave** | 1,200,000 | 11.77 | 215,302.80 | 17.94 |
| **Totali i të hyrave vetanake të Adm. Lokale** | **9,473,294** | **92.94** | **2,174,117** | **22.95** |
| **Shendetesia** | 230,000 | 2.26 | 60,957.50 | 26.50 |
| **Arsimi** | 470,000 | 4.61 | 25,297.00 | 5.38 |
| **Te hyrat nga Biblioteka** | 10,000 | 0.10 | 730.00 | 7.30 |
| **Te hyrat ngaTeatri** | 10,000 | 0.10 | 271.80 | 2.72 |
| **Totali i të hyrave vetanake** | **10,193,294** | **100.00** | **2,261,373** | **22.18** |

Të hyrat vetanake të realizuara sipas drejtorive janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

| | Planifikimi | Realizimi X-XII-2024 | % |
|---|---|---|---|
| **Administrata dhe Personeli** | 445,000 | 95,191 | 21.39 |
| **Inspekcioni** | 55,000 | 5,275 | 9.59 |
| **Ekonomi, Financa dhe Zhvillim** | 3,203,294 | 466,999 | 14.58 |
| **Sherbimet Publike , Mbrojtja civile, Emergjenca** | 3,180,000 | 1,028,847 | 32.35 |
| **Bujqesi , Pylltari dhe Zhvillim Rural** | 30,000 | - | - |
| **Kadaster dhe Gjeodezi** | 500,000 | 77,721 | 15.54 |
| **Planifikim Urban dhe Mjedisi** | 2,060,000 | 500,083 | 24.28 |
| **Sherbimet e Kujdesit Primar Shendetesor** | 230,000 | 60,958 | 26.50 |
| **Kultra, Rinia dhe Sporti** | 20,000 | 1,002 | 5.01 |
| **Arsim dhe Shkence** | 470,000 | 25,297 | 5.38 |
| **Gjithsej** | **10,193,294** | **2,261,373** | **22.18** |

**PASQYRA E TË DALAVE TË BUXHETIT KOMUNAL**
**PËR PERIUDHËN TETOR-DHJETOR 2024**

| Shpenzimet | Buxheti me ndryshime 2024 | Shpenzimet X-XII-2024 | Ind. Shp./ Plan. |
|---|---|---|---|
| **Pagat** | 27,466,351 | 6,663,764 | 24.26 |
| **Mallrat dhe shërbimet** | 12,917,748 | 4,031,312 | 31.21 |
| **Shpenzimet komunale** | 1,001,267 | 214,051 | 21.38 |
| **Subvencionet** | 4,175,288 | 1,064,502 | 25.50 |
| **Investimet kapitale** | 25,816,167 | 8,782,563 | 34.02 |
| **Totali** | **71,376,821** | **20,756,192** | **29.08** |

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit gjatë periudhës Tetor-Dhjetor 2024 kanë arritur në 20,756,192 € ose 29.08 % nga 71,376,821 € të parashikuara për vitin 2024 .

Në kategorinë e pagave për vitin 2024 janë planifikuar 27,466,351€. Në periudhën Tetor-Dhjetor nga kjo kategori janë shpenzuar 6,663,764 € ose 24.26% e shumës së planifikuar.

Shpenzimet në kategorinë e mallra dhe shërbimeve , për këtë periudhë të raportimit kanë qenë 4,031,312 € ose 31.21% e shumës së planifikuar prej 12,917,748 €.

Në kategorinë e shpenzimeve komunale nga shuma e planifikuar prej 1,001,267 €, për vitin 2024, në periudhën e raportimit shpenzimet kanë qenë 214,051 €.

Planifikimi për subvencione për vitin 2024 është 4,175,288 €, prej nga janë shpenzuar 1,064,502 € pra 34.02% e shumës se planifikuar.

Për investime kapitale për vitin 2024 janë planifikuar 25,816,167 €. Në periudhën Tetor-Dhjetor nga kjo kategori janë shpenzuar 8,782,563€ ose 34.02 % e shumës së planifikuar .

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shpenzimet sipas kategorive.



## Investimet kapitale sipas drejtorive  Tetor-Dhjetor 2024

| | Planifikimi | Shpenzimet X-XII-2024 | % |
|---|---|---|---|
| Administrata dhe personeli | 403,416 | 169,904 | 42.12 |
| Buxhet dhe financa | 1,460,000 | 248,432 | 17.02 |
| Sherbimet publike , mbrojtja civile, emergjenca | 16,018,828 | 5,110,658 | 31.90 |
| Zyra e komuniteteve | - | - | #DIV/0! |
| Bujqesia pylltaria zhvill. Rural | 965,982 | 652,034 | 67.50 |
| Zhvillimi ekonomik | 852,708 | 268,516 | 31.49 |
| Planifikimi urban dhe mjedisi | 54,566 | - | - |
| Kultura, rinia dhe sporti | 1,369,628 | 576,737 | 42.11 |
| Sherbimet Sociale | 652,000 | 270,795 | 41.53 |
| Arsimi | 2,539,039 | 540,909 | 21.30 |
| Shendetesia | 1,500,000 | 944,578 | 62.97 |
| **Gjithsej** | **25,816,167** | **8,782,563** | **34.02** |



**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT**



# RAPORTI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR PERIUDHËN (JANAR-DHJETOR 2024)

## PËRMBAJTJA:

1. **Hyrje**
   1.1. Hyrje ....................................................................................................3

2. **Veprimtaria e Kuvendit Komunal**
   2.1. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Kuvendit të Komunës..............................................4
   2.2. Përbërja e Kuvendit të Komunës së Prizrenit...............................................................4

3. **Përmbledhje e aktiviteteve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit**
   3.1. Numri i mbledhjeve të Kuvendit ....................................................................................5
   3.2. Numri i pikave të shqyrtuara, diskutuara dhe miratuara,..............................................6

4. **Përmbledhja e të gjitha Akteve**
   4.1. Përmbledhje e Akteve të miratuara sipas muajve dhe mbledhjeve...............................7
   4.2. Aktet e Kuvendit të kthyera për Rishqyrtim nga Organi Mbikëqyrës..........................11

5. **Plani i Punës së Kuvendit**
   5.1. Realizimi i Planit të Punës.............................................................................................12
   5.2. Sfidat në realizimin e Planit të Punës............................................................................12

6. **Transparenca e Kuvendit**
   7.1. Hapja dhe transparenca e proceseve vendimmarrëse .................................................13
   7.3. Bashkëpunimi dhe mirëmbajtja e dialogut me shoqërinë civile.................................13

7. **Sfidat dhe Problemet Kryesore**
   7.1. Identifikimi i sfidave kyçe dhe problematikave ..........................................................14
   7.2. Hapat që janë ndërmarrë për të adresuar këto sfida....................................................14

8. **Përfundim**
   8.1. Prioritetet e planifikuara për vitin 2025......................................................................15
   8.2. Përmbledhje e përgjithshme, komente, sugjerime......................................................15

# 1. Hyrje

Të nderuar dhe të respektuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Prizrenit,

Me kënaqësi ju paraqesim raportin vjetor që përmbledh me kujdes aktivitetet, punët, angazhimet, arritjet dhe sfidat e Kuvendit tonë, për periudhën janar-dhjetor 2024. Këtë dokument e kemi hartuar me përkushtim dhe synim për të ofruar një pasqyrë të qartë dhe të kompletuar për qytetarët tanë të dashur, duke i njohur ata me punën dhe përpjekjet tona të përbashkëta në shërbim të komunitetit.
Raporti ynë ka si synim themelimin e një marrëdhënieje të fortë dhe të hapur me qytetarët tanë të nderuar. Përmes këtij mediumi, synojmë të rrisim nivelet e transparencës dhe llogaridhënies duke e bërë të mundur për qytetarët të kenë një panoramë të qartë mbi veprimtarinë dhe vendimmarrjen tonë.
Me kujdes dhe përpikëri, kemi dokumentuar hapat tanë drejt përmbushjes së detyrave tona ligjore dhe morale, duke u fokusuar në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve tanë. Për ne, kujdesi ndaj nevojave të komunitetit dhe angazhimi për zgjidhjen e sfidave janë në qendër të veprimtarisë sonë.
Ju lutemi të gjeni këtë raport si një burim të vlefshëm informacioni të përkushtimit tonë ndaj përmirësimit të jetës së përgjithshme të komunitetit tonë të dashur.

Faleminderit për vëmendjen tuaj të çmuar dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm.

## 2. Veprimtaria e Kuvendit të Komunës

Në këtë kapitull do të paraqitet veprimtaria e Kuvendit, kompetencat, përgjegjësitë, si dhe përbërja Kuvendit të Komunës.

### 2.1. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Kuvendit të Komunës

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë i cili zgjidhet drejtpërdrejti nga qytetarët dhe funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore.

Kuvendi i Komunës ka kompetenca dhe përgjegjësi ekskluzive për çështjet vijuese:

- Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas statutit apo Rregullores së punës;
- Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- Themelimin e komisioneve të kërkuara sipas Ligjit;
- Nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
- Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- Emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
- Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe
- Përgjegjësive të tjera që kërkohen me ligj.

Për marrjen e vendimeve në çështje të caktuara, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komiteteve të përhershme të Kuvendit të Komunës, apo Kryetarit të Komunës.

Kuvendi është i obliguar t'i ushtroj detyrat dhe kompetencat sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi në mënyrë sa më transparente karshi publikut.

### 2.2.Përbërja e Kuvendit të komunës së Prizrenit

Legjislatura aktuale e Kuvendit të Komunës së Prizrenit është zgjedhur nga zgjedhjet lokale të tetorit të vitit 2021.

Komuna e Prizrenit si qyteti i dytë me numrin më të madh të banorëve në Republikën e Kosovës, përbëhet nga 41 anëtarë të Kuvendit, me përfaqësim të dhjetë (10) subjekteve të ndryshme politike.

Në këtë vegëzë gjeni të publikuara në web-faqen e Komunës së Prizrenit anëtarët e Kuvendit, informatat e tyre si dhe kontaktet:

https://prizren.rks-gov.net/anetar-i-kuvendit/

## 3. Përmbledhje e aktiviteteve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit

Në këtë kapitull do të paraqiten të dhënat statistikore për KK-Prizren 2024, siç janë: Numri i mbledhjeve, numri i pikave që janë diskutuar në Kuvend, numri i akteve që janë miratuar, numri i informatave, raporteve dhe të tjera.

### 3.1.Numri i Mbledhjeve të Kuvendit

Përmes grafikut do të paraqesim numrin e mbledhjeve të Kuvendit:

**Grafiku 1: Mbledhjet e Kuvendit**




Në këtë vegëzë gjeni të publikuara të gjitha thirrjet e mbledhjeve gjatë vitit 2024:

https://prizren.rks-gov.net/thirrjet-procesverbalet/?tax=ekstraktet-e-procesverbaleve-te-kuvendit

### 3.2.Pika të shqyrtuara, diskutuara dhe miratuara:

Përmes grafikut do të paraqesim numrin e pikave:

**Grafiku 2: Pikat..**




Në këtë vegëzë gjeni të publikuara të gjitha ftesat e mbledhjeve si dhe materialet që janë shqyrtuara, diskutuara dhe miratuara gjatë vitit 2024:

https://prizren.rks-gov.net/thirrjet-procesverbalet/?tax=thirrja-per-kuvend

## 4. Përmbledhja e të gjitha Akteve

Në vijim do të përmbledhim të gjitha aktet të cilat janë miratuar nga Kuvendi i Komunës, gjatë vitit 2024 sipas muajve.

### 4.1.Përmbledhje e Akteve të miratuara sipas muajve dhe mbledhjeve:

**Mbledhja e rregullt – 31 janar 2024:**

Në këtë mbledhje është bërë miratimi i procesverbalit të kaluar si dhe është dhënë betimi nga anëtarja e re e Kuvendit të Komunës znj. Dafina Bllaca. Mbledhja nuk u vazhdua për shkak të mungesës së kuorumit.

**Mbledhja e rregullt - 09 shkurt 2024:**

Në këtë mbledhje u bë vetëm miratimi i rendit të ditës, më tej nuk vazhdoi dhe u mbyll për shkak të mungesës së kuorumit.

**Mbledhja e rregullt – 06 mars 2024 e vazhduar më 12 mars 2024**

1. Vendim për miratimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024;
2. Vendim për vënien në shqyrtim publik të planit rregullues të hollësishëm “zona e parkut për industri të lehtë në Prizren - Parku i Biznesit”, sipas hartës zonale të Komunës së Prizrenit, (sipas kërkesës të MMPHI);
3. Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 001/011-99275 të datës 30 qershor 2022 për taksa komunale;
4. Vendim për miratimin e strategjisë komunale dhe planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2024-2027;
5. Vendim mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm (Zonë të veçantë – Parku i Biznesit);
6. Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 001-011- 182 mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm publik;
7. Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 001/011-14771 të dt. 27 janar 2022, sipas Rekomandimit të Komitetit për Komunitete;
8. Vendim për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale “Ndërmarrja Publike Banesore dhe Parkingjet” SH.A. në Prizren;
9. Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.001/011-157578 të datës 31 tetor 2022 (Këshillin e fshatit Zym të Hasit);
10. Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.001/011-64795 të datës 04 maj 2023 (KKA i NPL “Stacionit Autobusëve”);
11. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungu i Qarrit (Quercus cerris) në fshatin Vlashnjë të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
12. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: “Shpellat” në fshatin Shkozë të Prizrenit, si Monument i Natyrës;

13. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Burimi i ujit natyral në Vërmicë, si Monument i Natyrës;
14. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: “Burimi i ujit natyral”, në Poslishtë, si Monument i Natyrës;
15. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Kompleksi i pishave (Pinus nigra) në fshatin Malësi e Re të Prizrenit, si Peizazh i Mbrojtur;
16. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Humnerë në Lubizhdë e Hasit të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
17. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: “Trungu i Vjosës-Vadhës” (Sorbus domestica L.) në fshatin Lubizhdë e Hasit të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
18. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungu i rrënjës (Quercus robur) në fshatin Kabash i Hasit të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
19. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungu i rrënjës (Quercus robur) në fshatin Zym të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
20. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: “Liqeni karstik i Zymit” në Prizren, si Monument i Natyrës;
21. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: “Shpella” në fshatin Zym të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
22. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: “Trungu i Rrënjës” (Quercus robur) në fshatin Romajë të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
23. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: “Kompleksi i Trungjeve” (Quercus sp.) në fshatin Dedaj të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
24. Vendim mbi vendosjen e reklamave në territorin e Komunës së Prizrenit;

**Mbledhja e rregullt – 28 mars 2024:**

1. Vendim për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Prizrenit për z. Ali Ahmeti;
2. Vendim për lejimin e ndarjes së mjeteve për projektet me bashkëfinancim me fermerë në Komunën e Prizrenit;
3. Vendim për shpalljen e ankandit-tenderit publik për dhënien në shfrytëzim- qera të objekteve –lokaleve pronë komunale;
4. Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për dhënie në shfrytëzim – qera të objekteve-lokaleve pronë komunale;
5. Vendim për formimin e Komisionit të Ankesave;
6. Vendim për miratimin e planit të mobilitetit të qëndrueshëm urban 2024-2034;

**Mbledhja e jashtëzakonshme – 23 prill 2024:**

1. Vendim për Bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të rritura nga ato të planifikuara të vitit 2023, në vitin 2024.

**Mbledhja e rregullt – 30 prill 2024 vazhduar më 03 maj:**

1. Vendim për miratimin e kërkesës të Kryetarit të Komunës për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 001/011-48190 të datës 31 mars 2022

**Mbledhja e rregullt – 30 maj 2024 vazhduar më 03 qershor 2024:**

1. Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 001/011-53593 të datës 23 prill 2024;
2. Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr.01/011-3250 dt.08.03.2012 për përdorimin e gjuhëve në komunën e Prizrenit;
3. Rregullore për shërbime komunale në Komunën e Prizrenit;
4. Vendim për shfuqizimin e vendimeve (sipas rekomandimeve të MMPHI-së);
5. Vendim për miratimin e planit të punës për ekipin komunal për të drejtat e fëmijës (2024-2026);

**Mbledhja e rregullt – 27 qershor 2024:**

1. Vendim për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (2025-2027);
2. Vendim mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm publik;
3. Vendim për lirim nga pagesa e qirasë për lokalet pronë komunale dhe shfrytëzimin e hapësirës publike komunale (për tavolinat dhe karriget) për Zonën Historike të qytetit të Prizrenit, për periudhën prill-shtator 2024;

**Mbledhja e jashtëzakonshme – 18 korrik 2024:**

1. Vendim paraprak mbi dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër organizatave të shoqërisë civile;
2. Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues;
3. Vendim për miratimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal për komunën e Prizrenit 2024-2029;

**Mbledhja e jashtëzakonshme – 12 shtator 2024:**

1. Vendim për miratimin e projekt buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026 dhe 2027.

**Mbledhja e rregullt – 26 shtator 2024 vazhduar më 30 shtator.**

Në këtë mbledhje u miratuan vetëm procesverbalet. Kishte diskutime rreth pikave të rendit të ditës, një nga ato pika u votua kundër dhe nuk u miratua, ndërsa te pikat e tjera kuvendarët lëshuan mbledhjen dhe për shkak të mungesës së kuorumit, mbledhja u mbyll.

**Mbledhja e rregullt – 31 tetor 2024:**

1. Vendim për kursimin dhe ridestinimin e mjeteve buxhetore në kategorinë ekonomike të investimet kapitale

**Mbledhja e rregullt – 13 nëntor 2024:**

1. Vendim për harmonizimin e pagave dhe meditjeve në Komunën e Prizrenit për dy muajt e fundit të vitit 2024;
2. Rregullore për dhënien e dekoratave nga komuna e Prizrenit;
3. Vendim për miratimin e planit lokal të veprimit për barazinë gjinore (2024-2026);
4. Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr.001/011-95083 të datës 18.07.2024;
5. Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 001/011-14771 të dt. 27 janar 2022, sipas Rekomandimit të Komitetit për Komunitete;
6. Vendim për miratimin e planit Zhvillimor Komunal të Arsimit 2025-2027;
7. Vendimin për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm ‘’Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit’’ sipas Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit;

**Mbledhja e rregullt – 19 dhjetor 2024:**

1. Vendim për miratimin paraprak të listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025;
2. Vendim për dhënien në shfrytëzim të objektit pronë komunale për raste të veçanta;
3. Vendim për formimin e grupit punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Prizrenit, për vitin 2025.
4. Vendim për miratimin e raportit të Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
5. Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik;
6. Vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore 2024-2026;
7. Vendimin për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm ‘’Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit’’ sipas Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit, sipas kërkesës së MMPHI-së.

Në këtë vegëzë gjeni të publikuara në web-faqe të Komunës së Prizrenit të gjitha aktet të cilat janë miratuar dhe i’u është konfirmuar ligjshmëria nga organi mbikëqyrës:

Rregulloret: https://prizren.rks-gov.net/vendimet-rregulloret/?tax=rregulloret-planet
Vendimet: https://prizren.rks-gov.net/vendimet-rregulloret/?tax=vendimet

### 1.2. Aktet e Kuvendit të kthyera për Rishqyrtim nga Organi Mbikëqyrës

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës është i obliguar që të dërgoj listën e akteve të miratuara për shqyrtim të ligjshmërisë në autoritetin mbikëqyrës si dhe të presë konfirmimin e tyre për t'i futur në fuqi.Gjatë vitit 2024, Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka nxjerrur akte nga të cilat disa i'u janë kthyer për rishqyrtim nga ana e autoritetit mbikëqyrës (MAPL). Theksohet se Kuvendi i Komunës së Prizrenit, ka përmbushur detyrat e saj në raport me obligimet ligjore dhe në afat ligjor ka përmirësuar aktet e cekura më lartë.

Aktet të cilat janë kthyer në rishqyrtim, janë si vijon:

| |
|---|
| 1. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungu i Qarrit *(Quercus cerris)* në fshatin Vlashnjë të Prizrenit, si Monument i Natyrës; |
| 2. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: "Shpellat" në fshatin Shkozë të Prizrenit, si Monument i Natyrës; |
| 3. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Burimi i ujit natyral në Vërmicë, si Monument i Natyrës; |
| 4. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: "Burimi i ujit natyral", në Poslisht, si Monument i Natyrës; |
| 5. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Kompleksi i pishave *(Pinus nigra)* në fshatin Malësi e Re të Prizrenit, si Peizazh i Mbrojtur; |
| 6. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Humnerë në Lubizhdë e Hasit të Prizrenit, si Monument i Natyrës; |
| 7. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: "Trungu i Vjosës-Vadhës" *(Sorbus domestica L.)* në fshatin Lubizhdë e Hasit të Prizrenit, si Monument i Natyrës; |
| 8. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungu i rrënjës *(Quercus robur)* në fshatin Kabash i Hasit të Prizrenit, si Monument i Natyrës; |
| 9. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungu i rrënjës *(Quercus robur)* në fshatin Zym të Prizrenit, si Monument i Natyrës; |
| 10. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: "Liqeni karstik i Zymit" në Prizren, si Monument i Natyrës; |
| 11. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: "Shpella" në fshatin Zym të Prizrenit, si Monument i Natyrës; |
| 12. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: "Trungu i Rrënjës" *(Quercus robur)* në fshatin Romajë të Prizrenit, si Monument i Natyrës; |
| 13. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës: "Kompleksi i Trungjeve" *(Quercus sp.)* në fshatin Dedaj të Prizrenit, si Monument i Natyrës; |
| 14. Vendimi për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm ''Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit'' sipas Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit. |

## 5. Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2024

Çdo vit kalendarik, Kuvendi i Komunës duke u bazuar në ligjet dhe akte nënligjore, miraton planin e punës së Kuvendit, në të cilën parasheh mbledhjet që do të mbahen sipas muajve, pushimin vjetor si dhe pikat që duhet të sillen në kuvend për shqyrtim, diskutim dhe miratim. Në vijim do të paraqesim realizimin e planit të punës si dhe ngecjet në realizim.

### 5.1. Realizimi i Planit të Punës

Plani i punës së KK-Prizren për vitin 2024, ka paraparë të mbahen 10 mbledhje të rregullta por duke mos u kufizuar në to. Pra, është përmbush një obligim i Kuvendit, pasi që më shumë se 10 mbledhje të rregullta janë mbajtur. Po ashtu nga 53 pika që janë paraparë që të diskutohen, shqyrtohen dhe miratohen nga Kuvendi, numri i cili është përmbushur është 42 prej tyre.

### 5.2. Sfidat në realizimin të Planit të Punës

Sfidat gjatë vitit 2024 kanë qenë kryesisht në sjelljen apo paraqitjen e pikave të planit të punës nga ana e ekzekutivit komunal. Më poshtë do të paraqesim listën e pikave që nuk janë sjellë në Kuvend për tu shqyrtuar.

1. Raporti i Bordit për dhënien në shfrytëzim të objekteve kulturore-sportive
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së KKSB-së për vitin 2024
3. Informatë rreth raportit të punës të Njësisë së Burimeve Njerëzore për vitin 2023.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për shërbime më të mira sociale në Komunën e Prizrenit 2025-2027.
6. Informatë mbi ndarjen e subvencioneve nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
7. Informatë mbi ndarjen e subvencioneve nga Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik.
8. Informatë mbi ndarjen e subvencioneve nga Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
9. Informatë mbi ndarjen e subvencioneve nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
10. Raporti i Zyrës për Komunitete dhe Kthim 2024.
11. Raporti i Komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve të qytetit te Prizrenit.

Bashkëlidhur gjeni vegëzën e wep-faqes zyrtare të Komunës, ku gjendet i publikuar plani i punës së Kuvendit:

https://prizren.rks-gov.net/planet-raportet-e-kuvendit/

## 6. Transparenca dhe Llogaridhënia

### 6.1.Hapja dhe transparenca e proceseve vendimmarrëse

Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2024, ka demonstruar një nivel të lartë të transparencës në procesin e vendimmarrjes, për të siguruar informimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve. Disa aspekte thelbësore që tregojnë transparencën janë si vijon:

- Publikimi i Shpalljeve dhe Njoftimeve:

Kuvendi përmes zyrës për informim ka bërë publike shpalljet dhe njoftimet lidhur me datat e mbajtjes së takimeve nëpërmjet mediave, duke përfshirë faqen zyrtare në internet, rrjetet sociale, portale elektronike, dhe mediat nacionale.

- Transmetimi i Drejtpërdrejtë i Mbledhjeve:

Mbledhjet e Kuvendit transmetohen drejtpërdrejt në rrjetet lokale të televizionit dhe rrjetet sociale. Po ashtu, të gjitha mbledhjet postohen në web-faqen zyrtare të Komunës, duke e bërë shpërndarjen e informacionit më të gjerë dhe të lehtë.

- Publikimi i Dokumenteve të Mbledhjeve:

Të gjitha dokumentet për pikat e rendit të ditës paraqiten në web-faqen e Komunës dhe në rrjetet sociale, duke e mundësuar qasjen për të gjithë të interesuarit. Ky veprim siguron transparencën dhe hapësirën për vlerësimin dhe komentimin e publikut.

- Publikimi i Akteve të Miratuara nga Kuvendi:

Aktet që miratohen nga Kuvendi dhe konfirmohet ligjshmëria e tyre janë publikuar në mënyrë të hapur në web-faqen zyrtare të Komunës. Ky proces siguron që vendimet e Kuvendit të jenë të njohura publikisht.

Në këtë vegëzë, gjendet i publikuar në web-faqen zyrtare të Komunës rubrika Kuvendi, ku janë të gjitha të punët që bëhen nga Kuvendi:

https://prizren.rks-gov.net/ , nënrubrika kuvendi.

### 6.2. Bashkëpunimi dhe mirëmbajtja e dialogut me shoqërinë civile

Organizatat e shoqërive civile kanë dhënë kontribut të vazhdueshëm në fusha të ndryshme, të cilat aktivitete bashkëpunuese kanë qenë të shpeshta edhe me Kuvendin e Komunës gjatë vitit 2024.
Kuvendi ka mbajtur dialog dhe bashkëveprim të rregullt me organizatat e shoqërisë civile. Ndër më të rëndësishmet kanë qenë: Konsultimi Aktiv, Pjesëmarrje në Komisione dhe Grupe Punuese, Komunikimi, etj.
Këto veprime tregojnë përkushtimin e Kuvendit të Komunës së Prizrenit për të qenë transparent dhe për të përfshirë sa më shumë qytetarë në proceset vendimmarrëse.

## 7. Sfidat dhe Problemet Kryesore

Në këtë kapitull do të paraqesim sfidat dhe problemet që janë trashëguar dhe paraqitur për gjatë vitit 2024, si dhe hapat që janë ndërmarr për t'i zgjidhur ato probleme.

### 7.1. Identifikimi i sfidave kyçe dhe problematikave

Në listën vijuese do të paraqesim sfidat dhe problematikat që po e përcjellin Kuvendit e Komunës edhe në vitin 2024:

1. Mungesë e stafit në sektorin e Kuvendit të Komunës,
2. Ngecje e përkthimeve në gjuhët zyrtare të dokumenteve të Kuvendit,
3. Mos respektimi i kohës së përcaktuar të diskutimeve, gjatë seancave të Kuvendit,
4. Moszbatimi në tërësi i planit të punës së Kuvendit nga ana e ekzekutivit.

### 7.2. Hapat që janë ndërmarrë për të adresuar këto sfida

Përpjekje të vazhdueshme për të zgjidhur sfidat  e paraqitura në Kuvendin e Komunës, ka bërë jo vetëm Kryesuesja e Kuvendit, por edhe anëtarët e Kuvendit duke reaguar përmes seancave dhe formave tjera.
Kryesuesja e Kuvendit në vazhdimësi ka bërë kërkesa drejtuar Kryetarit të Komunës dhe ekzekutivit komunal, në formë verbale dhe me shkrim për zgjidhjen e problemeve që janë paraqitur në funksionimin sa më efikas të Kuvendit si dhe ka dhënë ide, propozime për një zgjidhje të qëndrueshme dhe përfundimtare për probleme të trashëguara dhe aktuale të Kuvendit të Komunës.

Pika 1 e pikës 7.1 veç se është përfunduar gjatë vitit 2024 dhe janë pajisur me laptop anëtarët e Kuvendit, ndërsa pikat e tjera pritet që do të realizohen gjatë vitit 2024, po ashtu presim nga ekzekutivi komunal që të ketë parasysh kërkesat e Kryesueses së Kuvendit, në raport me obligimet që i kanë karshi Kuvendit të Komunës.

## 8. Përfundim

### 8.1. Prioritetet e planifikuara për vitin 2025

Një nga prioritetet kryesore të përcaktuara për vitin 2025 për Kuvendin e Komunës sonë është funksionalizimi i plotë në secilën sferë të veprimtarisë së tij.
Funksionalizimi i Kuvendit në secilën sferë ka potencialin të sjellë një ndikim pozitiv të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së qytetarëve dhe zhvillimin e përgjithshëm të komunës sonë.

Në përpjekje për të arritur këtë synim, parashihen të ndërmerren hapa të rëndësishëm, duke përfshirë:

1. Respektimin dhe zbatimin e Ligjeve dhe akteve nënligjore të Republikës së Kosovës,
2. Organizimi i punëtorive, vizitave studimore, trajnimeve për anëtarët e Kuvendit,
3. Përforcimi i transparencës dhe përfshirjes së qytetarëve,
4. Bashkëpunim më i ngushtë me ekzekutivin komunal.

Me një angazhim të përbashkët në realizimin e këtyre hapa si dhe duke i ruajtur praktikat e mira të cilat i kemi krijuar në bazë të ligjeve, synojmë që të dalim si një Kuvend më i suksesshëm në nivelin e Republikës së Kosovës, dhe të jemi një model për Kuvendet e Komunave të tjera.

### 8.2. Përmbledhje e përgjithshme, komente, sugjerime, vërejtje

Ky raport është një përmbledhje e aktiviteteve kryesore që kanë ndodhur në periudhën janar-dhjetor 2024 në Kuvendin e Komunës së Prizrenit.

Pas diskutimeve të këtij raporti në Komitetin për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Kuvend të Komunës, planifikohet publikimi i tij në faqen zyrtare të Komunës së Prizrenit.

Mirëpresim komente, vërejtje dhe sugjerime nga pjesëmarrësit dhe ndjekësit e këtij raporti, pasi që kjo kontribuon në një proces të hapur dhe transparent për të gjithë.

Raporti do të jetë në dispozicion për të gjithë qytetarët në faqen zyrtare të Komunës së Prizrenit, duke theksuar përkushtimin ndaj hapësirës së transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut.

Ju ftojmë të ndani mendimet dhe vlerësimet tuaja në lidhje me ngjarjet e raportuara dhe të jeni pjesë e këtij procesi të rëndësishëm për zhvillimin e komunitetit tonë.

Me respekt,
Kryesuesja e Kuvendit

2 HYRESE-ULAZ-GIRIS

02-030 167713 30/12/24

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

**Komuna e Prizrenit**
Opština Prizren - Prizren Belediyesi

| | |
|---|---|
| Datë: | 30.12.2024 |
| Për: | Divizioni për Integritet dhe Strategji, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit; |
| CC: | z.Shaqir TOTAJ, Kryetar i Komunës së Prizrenit<br>znj.Edona HASHANI, Koordinatore/Kryesuese, Komuna e Prizrenit |
| Nga: | znj.Emine Gashi, Zyrtare përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Planit të Integritetit të Komunës së Prizrenit Emine Gashi |
| Tema: | Raporti gjashtëmujor 01 Korrik -31 Djetor 2024, për Plan të Integritetit 2024-2026 |

Në përputhje me Udhëzuesin për Monitorimin dhe Raportimin e Zbatimit të Planit të Integritetit, sipas Vendimit Nr.704/2024 të datës 16.05.2024, me qëllim të raportimit të Planit të Integritetit, përkatësisht për periudhën kohore 01 Korrik – 31 Djetor 2024, më datë 30.12.2024 paraqes këtë:

# RAPORT

Ky raport përmban një analizë të performancës dhe aktiviteteve të kryera gjatë periudhës 01 Korrik – 31 Djetor 2024 nga Komuna e Prizrenit, në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit. Qëllimi i këti raporti është të ofroj një pasqyrë të rezultateve kryesore për periudhën 6 mujore korrik-dhjetor, duke evidentuar arritjet kryesore, sfidat, afatet kohore si dhe rreziqet që janë hasur gjatë implementimit të planit dhe periudhës së parë.

Të dhënat janë analizuar për të vlerësuar efektivitetin e masave të marra për të siguruar integritetin dhe për të identifikuar zonat që kërkojnë përmirsime të mëtejshme. Raporti përfundon me rekomandime për veprime të ardhshme që synojnë përmirësimin e mëtejshëm të procesimit dhe minimizimin e rreziqeve gjatë viteve në vazhdim.

Matrica e dërguar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit është plotësuar nga zyrtare përgjegjes të digastereve të Komunës së Prizrenit. Procesi ka kërkuar kohë dhe ka hasur disa vështirësi, por janë tejkaluar dhe është përfunduar me sukses në mbledhjen e të dhënave. Këtu janë detajet e përmbajtjes dhe procedurës:

1. Përshkrimi i Rreziqeve:

- Çdo fushë e rrezikut në Planin e Integritetit është përshkruar në detaje. Kjo përfshin identifikimin e rreziqeve të mundshme që mund të ndikojnë në integritetin e procesit dhe aktiviteteve të Komunës.

2. Masat e Propozuara:

- Janë propozuar masa specifike për menaxhimin dhe zvogëlimin e rreziqeve të identifikuara. Këto masa përfshijnë procedura, politika dhe kontrolla të reja që duhet të aplikohen.

3. Njësitë/Zyrtarët Përgjegjës:

- Çdo masë e propozuar është lidhur me një njësit ose zyrtar të caktuar përgjegjës për implementimin dhe mbikëqyrjen e saj. Kjo ndarje e përgjegjësive ndihmon në sigurimin e zbatimit të duhur të masave.

4. Afatet e Realizimit:

- Janë caktuar afate të qarta për implementimin e masave. Këto afate ndihmojnë në planifikimin dhe monitorimin e progresit të veprimeve të ndërmarra.

5. Veprimet e Ndërmarra:

- Raporti përfshin informacion mbi veprimet që janë ndërmarrë deri tani për të adresuar rreziqet dhe për të implementuar masat e propozuara. Kjo ndihmon në vlerësimin e përparimit dhe efektivitetit të masave.

6. Niveli i Realizimit:

- Ky seksion shqyrton nivelin e realizimit të masave të propozuara, duke vlerësuar nëse janë përmbushur objektivat e caktuara dhe në çfarë mase janë zbatuar masat.

7. Mjetet e Verifikimit:

- Përdoren mjete të ndryshme për të verifikuar dhe monitoruar implementimin e masave. Këto mjete ndihmojnë në sigurinë e transparencës dhe efektivitetit të procesit.

8. Vështirësitë e Hasura:

- Raporti përmban një analizë të vështirësive dhe pengesave që janë hasur gjatë procesit të implementimit të masave. Këto vështirësi ndihmojnë në identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim.

9. Rekomandimet:

- Janë ofruar rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të procesit dhe masave të propozuara. Këto rekomandime synojnë forcimin e planit të integritetit dhe përmirësimin e menaxhimit të rreziqeve.

Ky raport ofron një pasqyrë të detajuar të përparimit dhe sfidave në implementimin e masave për menaxhimin e rreziqeve në Komunën e Prizrenit.

| Nr. | Fusha e Rrezikut | Përshkrimi i Rrezikut | Masa e propozuar | Njësia/zyrtari përgjegjës | Afati i realizmit | Veprimet e ndërmarra | Niveli i realizmit | Mjetet e verifikimit | Vështirësitë | Rekomandimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Planifikimi dhe menaxhimi financiar | 1.Mungesa e rregullores për zhvillimin e kontrolles së plotë dhe procedurave në DPK | Hartimi i rregullores me specifikat e kërkuara | DPK/Drejtori i APK-së | 2024-2026 | Grupi punues për hartimin e Rregullores së Brendshme për zhvillimin e kontrollës së plote dhe procedurave në DPK, u formua sipas Vendimit nr...., te datës.... te Drejtorit te APK-se. Grupi punues u takua me datat si ne vijim:....., Rregullorja është miratuar me date...., e cila është publikuar ne ueb faqen e APK-së me date | Pjeserisht e Realizuar | Linku ku mund ta gjeni rregulloren.....e publikuar ne ueb faqen e APK-se | Mungesa e anëtarëve te grupit për shkak te angazhimeve te tyre ne punët e tyre te përditshme | Çdo grup punës kur caktohet çdo akti juridik, ta shton intensitetin e punës edhe pas orarit te rregull te punës ose gjate vikendit, me qellim qe grupi punues te mos mungon ne takime pune |
| | | 2.Mos Planifikimi në detale i planit të shpenzimeve | Ndikimi i vendimmarrjes nga niveli qendror në nivelin lokal në zvogëlimin e efikasitetit ne punët e komunës | Intensifikimi i takimeve për koordinim në vendimmarrje në mes të dy niveleve dhe marrja e masave ligjore. | 2024-2026 | Njoftimi ne Ministri te Financave per ekzekutimin e lendeve permbarimore | Pjeserisht e Realizuar | | Ekzekutimi jo adekuat I buxhetit per lendet permbarimore sipas vendimeve gjyqesore | Ekzekutimi I lendeve permbarimore neper kategorit adekuate ekonomike |
| | | 3. Mos Planifikimi në detale i planit të shpenzimeve | Takime vetëdijësuese me stafin në hartimin e planit të zotimeve dhe shpenzimit; | Programet dhe nën programet | Ne vazhdimesi | Njoftimi I drejtorive dhe zyrtareve per planifikim adekuat te shpenzimeve | Pjeserisht e Realizuar | | Mungese e stafit professional | Rekomandojme trajnime per stafin e nivelit profesional |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 4. Mos koordinimi i drejtorive/njësive ne fushën e planifikimit buxhetore, barazimi i të hyrave | Formimi i grupeve punuese profesionale në fusha të caktuara, caktimi i zyrtarëve për barazime në të hyra | ZKA dhe Drejtorët | Ne vazhdimesi | Organizimi I takimeve per planifikim sa me te drejte te buxhetit | Pjeserisht e Realizuar | | Trajnimi I zyrtareve te cdo drejtorive per Planifikim te buxhetit dhe barazim te te Hyrave | Trajnimi I zyrtareve te cdo drejtorive per Planifikim te buxhetit dhe barazim te te Hyrave Trajnimi I zyrtareve te cdo drejtorive per Planifikim te buxhetit dhe barazim te te Hyrave Trajnimi I zyrtareve te cdo drejtorive per Planifikim te buxhetit dhe barazim te te Hyrave |
| | | 5. Mangësi në procesin e inventarizimin dhe regjistrimin e pasurisë komunale | Formimi i komisionit për inventarizim në afatin e duhur, zyrtarët përgjegjës Regjistrimi i të gjitha pagesave kapitale në sistemin SIMFK | Komisioni për inventarizim, zyrtari i pasurisë | Ne vazhdimesi | Komisioni do te formohet me kohe per inventarizimin e pasurise | Pjeserisht e realizueshme | | Nuk kemi informata te sakta lidhur me invetarizimin dhe vleresimin e pasurise | Formimi me kohe I komisionit dhe regjistrimit sipas dative te parapura ne rregullore |
| | | | | | | | | | | |
| | | Zbatim jo i plotë i rregullativës së brendshme që lidhen me fushën e planifikimit urban, rural banim dhe ndërtim. | Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban rural, ndërtim dhe banim. | Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm, Njësia e Burimeve Njerëzor | 2024-2026 | Është në fazën e hartimit të Dokumentimit | E Realizuar | Ligjet, aktet nënligjor e në fuqi, dhe aktet e brendshm e të komunës | Proceduart në fazën fillestare | Proceduart në fazën fillestare(mbledhja e të dhënave) |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Kuadro i pamjaftueshëm i personelit për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve për planifikim urban, rural, banim dhe ndërtim | Të sigurohet personel shtesë adekuat profesional për planifikim urban dhe rural | Kryetari i Komunës, Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore | 2024-2026 | // | Pjeserisht e Realizuar | Ligjet, aktet nënligjor e në fuqi, dhe aktet e brendshm e të komunës | // | // |
| | | Mungesa e kontrolleve konsistente mbi ndërtimet (vend punishtet) | Shtimi I kontrolleve në vendet e ndërtimit, me qëllim të ndalimit me kohë të ndërtimeve pa leje | Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm | 3 muaj | Nuk është ndërmare | // | // | Hapja e tenderit për natzrë të tillë të punës | Marrja e masave për shtim të kontrollit apo mbikqyrja nga ana e jashtme si organ mbikqyrës |
| 12. | Burimet Njerëzore | Mos plotësimi i vendeve të punës me staf adekuat dhe të mjaftueshëm | Zhvillimi dhe miratimi i Planit të Personelit | Kryetari i Komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive | 2024-2026 | Sipas legjislacioneve në fuqi është bërë planifikimi për vitin 2024 dhe është duke plotësuar me staf sipas këtij planifikimi dhe kërkesat të kryetarit. | E Realizuar | Sipas ligjit e zyrtërave publik Nr. 08/L-197, Rregullore për planfikimin e personelit | Nuk ka pas vështërsi në implementim | Pasi që plani po realizohet me sukses nuk ka rekomandim. |
| | | Profesionalizmi dhe kompetenca e pamjaftueshme e të punësuarve. | Të bëhet analiza e nevojave për trajnime; Trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarave; Të bëhet vlerësimi i ndikimit të trajnimeve të mbajtura. | Kryetari i Komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive | 2024-2026 | Së bashku me planifikimin e personelit është bërë edhe planifikimi i trajnimeve për stafin adekuat dhe stafin në periudhë provuese e cila varet nga IKAP | Pjeserisht e Realizuar | Siças evidencave për trajnimet e mbajtura | Jemi duke pritur përgjigje nga ministria përkatëse për trajnime | Të ofrohen trajnime në institucione |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Mungesa e informimit dhe sensibilizimit për ekzistencën e kodit të etikës për stafin drejtues dhe stafin tjetër të komunës Në vazhdimësi | Shpërndarja e Kodit të Etikës për të gjithë zyrtaret komunal dhe organizimi i takimeve për informim me përmbajtjen e Kodit. | Kryetari i Komunës dhe i Kuvendit, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëv | 2024 | Stafi komunal është në informim të kodit të etikës sapo krijon marrdhëenie pune e pranojnë kodin e etikës dhe ligjet e aplikueshme. | E Realizuar | Kodi i etikës i Komunës së Prizrenit 01nr.246120 | Nuk ka pas vështirsi në implementim | Nuk kemi rekomandime pasi procesi është I zbatueshëm |
| | | Niveli i pamjaftueshëm i ndërgjegjësimit të punonjësve për raportimin e korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme brenda institucionit. | Të sigurohet mbajtja e takimeve të rregullta ndërmjet menaxhmentit dhe personelit për prezantimin dhe diskutimin për mekanizmat e raportimit të korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme.<br>Të gjithë nëpunësit publik të punësuar dhe ata të cilët do të rekrutohen, të nënshkruajnë deklaratën e integritetit në bazë të secilës nëpunësi do të merr përgjegjësinë përkatëse | Kryetari i Komunës dhe Kuvendit dhe drejtuesit e drejtorive Njesia e personelit | 2024-2026 | Në vijjim me këtë pike do të punonjmë në lidhje me realizmimin e deklaratës së integritetit. | E Parealizuar | Në vijjim me këtë pike do të punonjmë në lidhje me realizmimin e deklaratës së integritetit | Në vijjim me këtë pike do të punonjmë në lidhje me realizmimin e deklaratës së integritetit | Në vijjim me këtë pike do të punonjmë në lidhje me realizmimin e deklaratës së integritetit |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT**
**Komiteti për Politikë dhe Financa**

# RAPORTI I PUNËS SË

# KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA (KPF)

# JANAR - DHJETOR 2024

**Dhjetor, 2024**

# PËRMBAJTJA

- **Hyrje...........................................................................................................3**
- **Roli i KPF-së.....................................................................................................4**
- **Përbërja e KPF-së dhe anëtaret e KPF-së për mandatin aktual.................5**
- **Aktivitetet e KPF-së..........................................................................................6**
- **Mbledhjet dhe rekomandimet e KPF-së ........................................................7**
- **Transparenca dhe monitorimi i KPF-së......................................................16**
- **Përfundimi......................................................................................................16**

# ➢ Hyrje

Të nderuar anëtarë të KPF-së dhe Kuvendit.

Siç dihet Kuvendi i Komunës është organi me i lart vendimmarrës në Komunë dhe zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale.

Si rrjedhoje për shkak të aktiviteteve të shumta dhe punëve me qëllim të ndihmës, Kuvendit me ligj i jepet e drejta që të themeloje Komitete/ Komisione dhe trupa të tjerë të cilat i ndihmojnë në kryerjen e punëve sa më efikase të Kuvendit.

Kuvendi i Komunës me vendim themelon komitetet e përhershme të cilat janë obligative, si dhe komitete të tjera për të cilat konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësive të cilat i'u delegohen.

Komitetet obligative janë:

- Komiteti për Politikë dhe Financa,
- Komitetin për Komunitete.

Këtë mandate aktual Kuvendi ka themeluar edhe shumë komitete dhe komisione të tjera.

## ➢ ROLI I KPF-SË

KPF është komiteti obligativ i cili paraprakisht shqyrton dhe rekomandon pothuajse te gjitha pikat e rendit të ditës, të cilat janë paraparë që të shqyrtohen diskutohen dhe miratohen në Kuvendin e Komunës.

Më konkretisht KPF është përgjegjës për këto pika si në vijim:

1. Shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, si dhe dokumentet e planifikimit strategjik;
2. Kornizën vjetore buxhetore afatmesme;
3. Planin vjetor të prokurimit;
4. Rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat;
5. Buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Mbledhjet e KPF-së, thirren nga Kryesuesi i KPF-së apo nga 1/3 e anëtareve të KPF-së.

Rekomandimet e KPF-së, merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

Mandati i anëtarëve të KPF-së, është i lidhur me mandatin e anëtarëve të kuvendit.

## ➢ PËRBËRJA E KPF-SË DHE ANËTARËT E KPF-SË PËR MANDATIN AKTUAL

Meqë Kuvendi i Komunës së Prizrenit përbehet prej 41 anëtareve, atëherë sipas ligjeve në fuqi, KPF përbëhet prej 9 anëtareve, 5 meshkuj dhe 4 femra.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa janë:

1. Antigona Bytyqi-Kryesuese
2. Karanfil Haxhillari-LVV
3. Adem Shabanaj-LVV
4. Dafina Alishani-LVV
5. Levent Bus-PDK
6. Egzona Hoxhaj-PDK
7. Florent Ukaj-LDK
8. Naxhije Memaj-LDK
9. Bajram Kastrati-AAK

Ky komitet nuk e zgjedh kryesuesin si të gjithë komitetet e tjera, por ai që është kryesues i Kuvendit atëherë me automatizëm është edhe kryesues i KPF-së.

Partitë politike përfaqësohen në KPF, sipas numrit të votave që kanë marr në zgjedhjet lokale.

## ➢ AKTIVITETET E KPF-SË

| Nr. | Statistikat e KPF-s | Rezultati |
|---|---|---|
| 1. | **Numri i Mbledhjet të KPF-së**<br>**( Të jashtëzakonshme dhe të rregullta)** | **Gjithsej 14**<br><br>2 jashtëzakonshme<br>12 të rregullta |
| 2. | **Numri i pikave të shqyrtuara, diskutuara në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF),** | 157 |

## ➢ MBLEDHJET DHE REKOMANDIMET E KPF-S

KPF- ka mbajtur gjithsej 14 mbledhje :

02 të jashtëzakonshme
12 të rregullta

Më poshtë do të paraqesim të gjitha pikat në të cilat janë shqyrtuar dhe diskutuar në KPF, ku i'u kanë rekomanduar Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

## Mbledhja e I (parë) e rregullt e KPF-së, dt.29.01.2024

### R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të datës 29 dhjetor 2023;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për vënien në shqyrtim publik të planit rregullues të hollësishëm “zona e parkut për industri të lehtë në Prizren - Parku i Biznesit”, sipas hartës zonale të Komunës së Prizrenit, (sipas kërkesës të MMPHI);
5. Shqyrtimi dhe miratimi propozim-rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 001/011-99275 të datës 30 qershor 2023 për taksa komunale;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Strategjisë Komunale dhe planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2024-2027;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm (Zonë të veçantë – Parku i Biznesit);
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 001-011- 182 mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm publik;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 001/011-14771 të dt. 27 janar 2022, sipas Rekomandimit të Komitetit për Komunitete;
10. Vazhdim i diskutimit të raportit për 6 (gjashtë) mujorin e dytë të Kryetarit të Komunës;
11. Raporti financiar për periudhën tetor-dhjetor 2023;
12. Raporti për zbatimin e planit të integritetit në Komunën e Prizrenit, për vitin 2023;
13. Raporti i performancës të Komunës së Prizrenit, për vitin 2022;
14. Informatë rreth raportit të punës të Zyrës së Përfaqësuesit Ligjor të Komunës, për vitin 2023.
15. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2023;
16. Raportet e punës të Komiteteve të themeluara nga Kuvendi i Komunës, për vitin 2023:
    - Komitetit për Politike dhe Financa,
    - Komitetit për Komunitete,
    - Komitetit për Arsim,

## **Mbledhja e II (dytë) e rregullt e KPF-së, dt.08.02.2024**

(Kjo mbledhje është ndërprerë për shkak të mungesës së kuorumit).

### **R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për vënien në shqyrtim publik të planit rregullues të hollësishëm “Zona e parkut për industri të lehtë në Prizren - Parku i Biznesit”, sipas hartës zonale të Komunës së Prizrenit, (sipas kërkesës të MMPHI);
4. Shqyrtimi dhe miratimi propozim-rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 001/011-99275 të datës 30 qershor 2023 për taksa komunale;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Strategjisë Komunale dhe planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2024-2027;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm (Zonë të veçantë – Parku i Biznesit);
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 001-011- 182 mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm publik;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 001/011-14771 të dt. 27 janar 2022, sipas Rekomandimit të Komitetit për Komunitete;
9. Vazhdim i diskutimit të raportit për 6 (gjashtë) mujorin e dytë të Kryetarit të Komunës;
10. Raporti financiar për periudhën tetor-dhjetor 2023;
11. Raporti për zbatimin e planit të integritetit në Komunën e Prizrenit, për vitin 2023;
12. Raporti i performancës të Komunës së Prizrenit, për vitin 2022;
13. Informatë rreth raportit të punës të Zyrës së Përfaqësuesit Ligjor të Komunës, për vitin 2023.
14. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2023;
15. Raportet e punës të Komiteteve të themeluara nga Kuvendi i Komunës, për vitin 2023:

- Komitetit për Politike dhe Financa,
- Komitetit për Komunitete,
- Komitetit për Arsim,

## Mbledhja e III (tretë) e rregullte e KPF-së, dt. 04 mars 2024

**R E N D  D I T E**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për vënien në shqyrtim publik të planit rregullues të hollësishëm "zona e parkut për industri të lehtë në Prizren - Parku i Biznesit", sipas hartës zonale të Komunës së Prizrenit, (sipas kërkesës të MMPHI);
4. Shqyrtimi dhe miratimi propozim-rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 001/011-99275 të datës 30 qershor 2022 për taksa komunale;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-strategjisë komunale dhe planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2024-2027;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm (Zonë të veçantë – Parku i Biznesit);
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 001-011- 182 mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm publik;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 001/011-14771 të dt. 27 janar 2022, sipas Rekomandimit të Komitetit për Komunitete;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale "Ndërmarrja Publike Banesore dhe Parkingjet" SH.A. në Prizren;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.001/011-157578 të datës 31 tetor 2022 (Këshillin e fshatit Zym të Hasit);
11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.001/011-64795 të datës 04 maj 2023 (KKA i NPL "Stacionit Autobusëve");
12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungu i Qarrit *(Quercus cerris)* në fshatin Vlashnjë të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: "Shpellat" në fshatin Shkozë të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
14. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Burimi i ujit natyral në Vërmicë, si Monument i Natyrës;
15. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: "Burimi i ujit natyral", në Poslishtë, si Monument i Natyrës;
16. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Kompleksi i pishave *(Pinus nigra)* në fshatin Malësi e Re të Prizrenit, si Peizazh i Mbrojtur;
17. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Humnerë në Lubizhdë e Hasit të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
18. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: "Trungu i Vjosës-Vadhës" *(Sorbus domestica L.)* në fshatin Lubizhdë e Hasit të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
19. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungu i rrënjës *(Quercus robur)* në fshatin Kabash i Hasit të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
20. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungu i rrënjës *(Quercus robur)* në fshatin Zym të Prizrenit, si Monument i Natyrës;

21. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: "Liqeni karstik i Zymit" në Prizren, si Monument i Natyrës;
22. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: "Shpella" në fshatin Zym të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
23. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: "Trungu i Rrënjës" *(Quercus robur)* në fshatin Romajë të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
24. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: "Kompleksi i Trungjeve" *(Quercus sp.)* në fshatin Dedaj të Prizrenit, si Monument i Natyrës;
25. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit mbi vendosjen e reklamave në territorin e Komunës së Prizrenit;
26. Vazhdim i diskutimit të raportit për 6 (gjashtë) mujorin e dytë të Kryetarit të Komunës;
27. Raporti financiar për periudhën tetor-dhjetor 2023;
28. Raporti për zbatimin e planit të integritetit në Komunën e Prizrenit, për vitin 2023;
29. Raportet e punës të Komiteteve të themeluara nga Kuvendi i Komunës, për vitin 2023:

- Komitetit për Politike dhe Financa,
- Komitetit për Komunitete,
- Komitetit për Arsim,
- Komitetit për Shëndetësi.

## Mbledhja IV (katër) e rregullte e KPF-së, dt. 27 mars 2024

**R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datës 29 janar 2024 dhe 08 shkurt 2024; Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
2. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Prizrenit për z. Ali Ahmeti;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për lejimin e ndarjes së mjeteve për projektet me bashkëfinancim me fermerë në Komunën e Prizrenit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen e ankandit-tenderit publik për dhënien në shfrytëzim- qera të objekteve –lokaleve pronë komunale;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Vlerësues për dhënie në shfrytëzim – qera të objekteve-lokaleve pronë komunale;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit të Ankesave;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e planit të mobilitetit të qëndrueshëm urban 2024-2034;
9. Raporti vjetor financiar janar dhjetor 2023;
10. Raporti i punës i Zyrës së Prokurimit për vitin 2023;
11. Raporti i përformancës të Komunës së Prizrenit, për vitin 2022;

## Mbledhja e jashtëzakonshme e KPF-së, dt. 22 prill 2024

**R E N D D I T E**

1. Bartja e mjeteve nga të hyrat vetanake të rritura nga ato të planifikuara të vitit 2023, në vitin 2024.

## Mbledhja e V (pestë) e rregullt e KPF-së, dt. 26 prill 2024

**R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve: 04 mars 2024 dhe 27 mars 2024;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës të Kryetarit të Komunës për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 001/011-48190 të datës 31 mars 2022;
5. Raporti financiar janar-mars 2024;
6. Informatë rreth raportit të punës të Zyrës-Njësisë për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore për vitin 2023;
7. Raporti i Komisionit Komunal të Aksionarëve të NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A – Prizren.

## Mbledhja VI (gjashtë) e rregullt e KPF-së, dt. 28 maj 2024

**R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datës 22 prill 2024 (e jashtëzakonshme) dhe 26 prill 2024 (e rregullt);
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 001/011-53593 të datës 23 prill 2024;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr.01/011-3250 dt.08.03.2012 për përdorimin e gjuhëve në komunën e Prizrenit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për shërbime publike komunale në Komunën e Prizrenit;
6. Miratimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimeve (sipas rekomandimeve të MMPHI-së);
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-planit të punës për ekipin komunal për të drejtat e fëmijës (2024-2026);
8. Informatë rreth raportit të punës së zyrës-njësisë për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, për vitin 2023.

## Mbledhjen e VII (shtatë) e rregullt e KPF-së, dt. 26 qershor 2024

## Rend Dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të datës 28 maj 2024;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (2025-2027);
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm publik;
5. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për periudhën janar-qershor 2024;
6. Informatë rreth raportit së punës të Zyrës për Integrime Evropiane për vitin 2023;
7. Raporti i Këshillit të fshatit Zym i Hasit për periudhën janar-qershor 2024;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për lirim nga pagesa e qirasë për lokalet pronë komunale dhe shfrytëzimin e hapësirës publike komunale (për tavolinat dhe karriget) për Zonën Historike të qytetit të Prizrenit, për periudhën prill-shtator 2024;
9. Diskutim për mundësinë se subvencionimit të bujqëve në Komunën e Prizrenit, për shkak të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.

## Mbledhja VIII (tetë) e rregullt e KPF-së, dt. 16 korrik 2024

## Rend Dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të datës 26 qershor 2024;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit paraprak mbi dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër organizatave të shoqërisë civile;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Vlerësues;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i strategjisë për zhvillim ekonomik lokal për komunën e Prizrenit 2024-2029;
6. Informatë rreth gjendjes së furnizimit me ujë, menaxhimit të mbeturinave dhe energjisë elektrike;
7. Raporti financiar janar - qershor 2024;
8. Informatë rreth përfundimit të vitit shkollor;
9. Raporti i Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit për periudhën gusht 2023- qershor 2024.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i planit lokal të veprimit për barazinë gjinore (2024-2026).

## Mbledhja e jashtëzakonshme e KPF-së, 10 shtator 2024

**R E N D  D I T E**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026 dhe 2027.

## Mbledhja IX (nëntë) e rregullt e KPF-së, 24 shtator 2024

**R E N D  D I T E**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të datës 16 korrik 2024;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit lokal të veprimit për barazinë gjinore (2024-2026);
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Përzgjedhës (DKA);
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për zëvendësimin e anëtares të Komisionit Vlerësues;
6. Raporti financiar janar – qershor 2024;
7. Raporti i Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit për periudhën gusht 2023- qershor 2024;
8. Informatë rreth përfundimit të vitit shkollor 2023/2024 dhe informatë rreth fillimit të vitit të ri shkollor 2024/2025;
9. Diskutim rreth raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Prizrenit për vitin 2023 dhe planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2023;
10. Informatë rreth raportit të punës të Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), për periudhën janar-gusht 2024;
11. Raporti i Performancës Komunale për Komunën e Prizrenit, për vitin 2023.

## Mbledhja e X (dhjetë) e rregullt e KPF-së, 29 tetor 2024

**R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të datës 10 shtator 2024 (mbledhje e jashtëzakonshme) dhe 24 shtator 2024 (mbledhje e rregullt);
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për kursimin dhe ridestinimin e mjeteve buxhetore ne kategorinë ekonomike te investimeve kapitale;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-rregullores për dhënien e dekoratave nga komuna e Prizrenit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i planit lokal të veprimit për barazinë gjinore (2024-2026);
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr.001/011-95083 të datës 18.07.2024;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 001/011-14771 të dt. 27 janar 2022, sipas Rekomandimit të Komitetit për Komunitete;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-planit Zhvillimor Komunal të Arsimit 2025-2027;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Përzgjedhës (DKA);
10. Raporti financiar janar – qershor dhe janar-shtator 2024;
11. Diskutim rreth raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Prizrenit për vitin 2023 dhe planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2023;
12. Informatë rreth raportit të punës të Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), për periudhën janar-gusht 2024;
13. Raporti i Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit për periudhën gusht 2023- qershor 2024;
14. Informatë rreth përfundimit të vitit shkollor 2023/2024 dhe informatë rreth fillimit të vitit të ri shkollor 2024/2025;
15. Raporti i Performancës Komunale për Komunën e Prizrenit, për vitin 2023.

## Mbledhja e XI (njëmbëdhjetë) e rregullt e KPF-së, 12 nëntor 2024

**R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-rregullores për dhënien e dekoratave nga komuna e Prizrenit;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit lokal të veprimit për barazinë gjinore (2024-2026);
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr.001/011-95083 të datës 18.07.2024;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 001/011-14771 të dt. 27 janar 2022, sipas Rekomandimit të Komitetit për Komunitete;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-planit Zhvillimor Komunal të Arsimit 2025-2027;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Përzgjedhës (DKA).
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimin për miratimin e Planit Rregullues te Hollësishëm ‘’Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit’’ sipas Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit;
9. Raporti financiar janar – qershor 2024;
10. Raporti i Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit për periudhën gusht 2023- qershor 2024;
11. Informatë rreth përfundimit të vitit shkollor 2023/2024 dhe informatë rreth fillimit të vitit të ri shkollor 2024/2025;
12. Diskutim rreth raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Prizrenit për vitin 2023 dhe planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2023;
13. Informatë rreth raportit të punës të Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), për periudhën janar-gusht 2024;
14. Raporti i Performancës Komunale për Komunën e Prizrenit, për vitin 2023

## Mbledhja e XII (dymbëdhjetë) e rregullt e KPF-së, 17 dhjetor 2024

**R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të datës 29 tetor dhe 12 nëntor 2024;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin paraprak të listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të objektit pronë komunale për raste të veçanta;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e grupit punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Prizrenit, për vitin 2025.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e raportit të Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore 2024-2026;
9. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimin për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm ‘’Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit’’ sipas Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit, sipas kërkesës së MMPHI-së.

## ➢ TRANSPARENCA DHE MONITORIMI I KPF-S

KPF, gjatë kësaj periudhe ka qenë shumë transparente ndaj të gjithëve të cilët kanë qenë të interesuar për t'i përcjellë takimet e KPF-së.

Vlen të ceket se KPF, sa i përket punimeve të cilat i ka zhvilluar si dhe të gjitha dokumentet të cilat janë zhvilluar nga mbledhjet e KPF, janë publikuar në web-faqe të komunës si dhe në të gjitha rrjetet sociale po ashtu edhe në medie lokale.

Për të gjitha këto që u cekën më lartë, gjeni të bashkëngjitur linkun e web-faqes zyrtare të Komunës, ku gjendet data baza e KPF-se:

**https://kk.rks-gov.net/prizren/kuvendi/**

- KPF, është monitoruar vazhdimisht nga mediat lokale dhe nga shoqëria civile.

## ➢ PERFUDIMI

Ky raport është përmbledhës i punimeve të KPF-se, gjatë periudhës janar-dhjetor 2024.

Po ashtu është dëshmi sepse është bazuar në ligje dhe akte nënligjore në fuqi si dhe dëshmi për transparencën karshi qytetarëve të Komunës së Prizrenit, por edhe ndaj atyre që monitoruan nga afër punimet që janë zhvilluar.

Pasi që raporti do të diskutohet në KPF- dhe Kuvend, do të publikohet në webfaqen zyrtare të Komunës së Prizrenit.

Mirëpresim komente, vërejtje, sugjerime.

Me respekt;
Kryesuesja e KPF-së
Antigona Bytyqi

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

# Kuvendi i Komunës së Prizrenit
# Komiteti për Komunitete

## RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2024

**Periudha Janar – Dhjetor 2024**

# HYRJE

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë i komunës i përbërë nga anëtarët e tij të cilët zgjedhen drejtpërdrejt nga qytetarët dhe udhëhiqen nga kryesuesi i cili zgjedhet me shumicë votash nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.
Kuvendi i Komunës ka nevojë për organe ndihmëse me qëllim të shqyrtimit të hollësishëm të politikave, dokumenteve strategjike, vendimeve dhe rregulloreve të komunës, nga njëra anë, si dhe me qëllim të mbikëqyrjes së veprimtarive të degës ekzekutive, në anën tjetër. Andaj, Kuvendi i Komunës themelon komitete të posaçme të cilat e ndihmojnë atë në përmbushjen e këtyre obligimeve dhe ushtrimin e këtyre kompetencave:
**Komitetet obligative** – Kuvendi i Komunës është i obliguar që të themelojë dy komitete obligative:

**a) Komitetin për Politikë dhe Financa; dhe**
**b) Komitetin për Komunitete.**

**a. Komiteti për Politikë dhe Financa** konsiderohet si organi kryesor i Kuvendit të Komunës, i cili shqyrton paraprakisht pothuajse të gjitha çështjet që parashihen të shqyrtohen në Kuvendin e Komunës.

**b. Komiteti për Komunitete** – është komiteti i dytë obligativ i Kuvendit të Komunës detyrë e të cilit është:
1) Shqyrtimi i përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim.
2) Shqyrtimi i të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se respektohen plotësisht të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
3) I rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për të avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

*Gjatë themelimit të Komitetit për Komunitete duhet të sigurohet që:*

1) Çdo komunitet që jeton në komunë të ketë të paktën një përfaqësues në Komitetin për Komunitete.

2) Shumica e anëtarëve të Komitetit për Komunitete njëherësh të jenë përfaqësues të komuniteteve të cilat jetojnë në komunë.
Me datën 27 Janar 2022 është marrë Vendimi për themelimin dhe emërimin e anëtarëve e Komunitetit për Komunitete në Kuvendin e Komunës së Prizrenit. Me këtë vendim themelohet Komiteti për Komunitete në përbërje prej pesëmbëdhjetë (15) anëtarëve.

Anëtaret e Komitetit për Komunitete janë:

1. Admir Alilji  - Boshnjak
2. Agim Muqaj - Shqiptar
3. Elvira Gorani - Gorane
4. Drita Qenaj – Shqiptare
5. Ertan Simitçi - Turk
6. Gani Elshani - Ashkalli
7. Hysnije Berisha – Egjiptian
8. Shyret Hoxhaj – Rome
9. Marin Përgjokaj – Shqiptar
10. Merdžan Osmani – Boshnjak
11. Mimoza Bushrani – Shqiptar
12. Sead Arifi – Boshnjak
13. Sevil Kazazi – Turk
14. Shukrije Berisha – Shqiptare
15. Tihomir Stojanovič – Sërb

# I. AKTIVITETET

**1. <u>25 Janar 2024</u> – Mbledhja XXIII**

a. Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të punës për vitin 2023 të Komitetit për Komunitete, i cili raport do të prezantohet në Kuvendin e Komunës së Prizrenit.

b. Shqyrtimi dhe aprovimi i planit të punës të KpK-së, për vitin 2024.

**2. <u>23 Shkurt 2024</u> - XXIV**

a. Informim dhe shkëmbim të përvojës së punës mes Komiteteve për Komunitete të komunave Prizren dhe Gjakovë; të cilën kryesuesi i Komitetit për Komunitete pranë Kuvendit të Komunës së Gjakovës, z. Ergit Qeli do të jetë prezent,

b. Informim rreth punës së Zyrës për Komunitete dhe Kthim për vitin 2023; të cilen Drejtoresha e ZpKK znj. Derya Kazaz Kala do të jetë prezent.

**3. <u>21 Mars 2024 – XXV</u>**

a. Vizit në Shkollën e Mesme Ekonomike "Ymer Prizreni" në Prizren

b. Vizit në Shkollën e Mesme e Mjekësisë "Luciano Motroni" në Prizren

**4. <u>29 Prill 2024 - XXVI</u>**

a. Informim dhe diskutim rreth procesit te Regjistrimit te Popullsise, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2024, ku prezent do te jene perfaqesuesit te komunes-anetaret te Komisionit Komunal.

**5. <u>29 Maj 2024 - XXVII</u>**

a. Shqyrtimi i Rregullorës për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullorës nr.01/011-3250 dt. 08.03.2012 për përdorimin e gjuhëve në Komunen e Prizrenit.

**6. <u>28 Qershor 2024 - XXVIII</u>**

a. Vizita në qendrat dhe objektet shëndetësore pranë Komunës së Prizrenit siç janë: QKMF,

AMF dhe qendrat tjera shëndetësore, me qëlim për të monitorohet puna dhe angazhimi i menaxhmentit dhe stafit.

**7. <u>25 Korrik 2024 - XXIX</u>**

a. Raporti dhe diskutimi i punes se Drejtorise per Pune dhe Mireqenie Sociale, present do te jete drejtori z. Rasim Demiri,

**8. <u>29 Gusht (e enjte) 2024 - XXX</u>**

a. Distkutim rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore të vitit 2025-2027 dhe diskutim rreth Buxhetit për vitin 2025 të Komunës së Prizrenit, në këtë mbledhje do të jetë present zëvendës kryetari z. Kujtim Gashi dhe përfaqësuesi i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

b. Kërkesat dhe propozimet rreth projekte

**<u>9. 01 Tetor 2024 - XXXI</u>**

a. Presentimi i raportit të punës për periudhën Janar – Qershor të vitit 2024 të Zyrës për Komunitete dhe Kthim (ZKKK)

b. Rekomandim për plotësim/ndryshim të vendimit të datës 27 Janar 2022 të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, lidhur me themelimin dhe emërimin e anëtarëve të Komitetit për Komunitete për mandatin 2021-2025.

**10. <u>06 Nentor 2024 – XXXII</u>**

a. Vizitë në disa shkolla parafillore, fillore dhe të mesme në Komunën e Prizrenit.

b. Takim me drejtoret të shkollave në Prizren për të diskutuar rreth aktivitete.

## II. SFIDAT DHE ÇËSHTJET TË NGRITURA NË MBLEDHJET E KOMITETIT

Komiteti për Komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht.

Komiteti për Komunitete gjithashtu i rekomandon kuvendit dhe kryetarit të komunës për masat që duhet të ndërmirren për të siguruar që të mbrohen të drejtat e komuniteteve brenda komunës. Komiteti për Komunitete, është përgjegjës për të trajtuar çfarëdo çështje që ka të bëjë me komunitetin jo shumicë.

Si shembull:
1. Qasja në punësim,
2. Qasja në arsimim,
3. Qasja në gjuhë,
4. Qasja në shërbime komunale etj.

Komiteti për Komunitete, është organ legjislativ i cili mund të zbatojë mandatin e vet vetëm në bashkëpunim me organet legjislative dhe me mbështetjen e ekzekutivit si dhe me mekanizmat tjera pjesëmarrëse të komunitetit që janë në dispozicion në nivel lokal (p.sh. ZKKK). Komiteti për Komunitete, në këtë mandat ka hasur disa probleme lidhur me moszbatimin e ligjeve në fuqi.

- Komunitetet përballen gjithashtu me barriera të ndryshme të **punësimit në vende publike** – në nivel komunal. Situata aktuale e punësimit nuk dihet saktësisht për arsye sepse mungojnë të dhëna të përditësuara/zyrtare.

- Komuniteti Boshnjak dhe Turk, ndihen diskriminuar nga pikëpamja e aksesit në **përdorimin e gjuhëve të zyrtare**. Gjithashtu, ekziston mungesa e kapaciteteve të brendshme për të adresuar rregullisht çështjet lidhur me zbatimin e Ligjit Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve.

- Çështja e nënkryetarit për komunitete në Prizren, mbetët si një çështje pa përfunduara.

- Ligji NR. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovë, komunitetet janë njohur zyrtarisht si komunitet jo shumicë. Përfaqësimi, promovimi dhe njohja e identitetit të komuniteteve jo shumicë si pjesë përbërëse e shoqërisë, has vështirësi të natyrave të ndryshme. psh:

- punësimi i ulët i komuniteteve pranë institucione komunale dhe ndërrmarje komunale;
- pjesëmarrja e ulët në komisione komunale;
- përfaqësimi i ulët në shkollat në pozicionin drejtor, zv. drejtor, sekretar;
- mospërkthimi i dokumenteve zyrtare dhe mospublikimi i tyre sipas afateve ligjore;
- Përqindja e ulët të planifikimit të buxhetit për komunitete jo shumicë;

***Synimet dhe Veprimet në të ardhmen:***

- Implementimi dhe zbatimi i ligjislacionit,
- Përmbushja e objektivave dhe projekteve të KAB-it 2025-2027,
- Ngritja e kapaciteteve zyrtarëve, për përdorimin e gjuhëve zyrtare,
- Përmirësimi i mëtejmë i cilësisë së shërbimeve për qytetarët/komunitetet.
- Mbështetja e projekteve të ndryshme sipas kërkesës së zyrës për Komunitete dhe Khthim,

## III. PËRFUNDIM

